- Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit për vendbanimet: Goshicë, Binqë, Beguncë, Smirë, Stubell, Radivojcë dhe Sadovinë.
- Ndërtimi i gropave septike për vendbanimet të cilat nuk janë të kycura në rrjetin kryesor.
- Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në të gjitha vendbanimet rurale.
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane.
- Përmiresimi i rrjetit energjetik.
- Ndërtimi i pikës së transferit të mbeturinave.
- Riorganizimi i deponive egzistuese apo ndërtim i deponive të reja për mbeturina inerte.

- Ndriçimi publik i rrugëve në të gjithë zonën urbane si dhe zonat qendër te vendbanimeve tjera.
- Orientimi drejt energjisë së ripërtërithsme / Vendosja e reflektorëve me energji solare.
- Shtrirja e kabllit optik në të gjitha vendbanimet.
- Stimulimi i shfrytëzimit të energjisë alternative deri në vitin 2031.
- Promovimi i mobilitetit jo-motorik.
- Rregullimi i shtretërve të lumenëjve dhe përroskave deri në vitin 2031.
- Trajtimi i ujërave të zeza deri në vitin 2026 .
- Promovimi i sistemeve të reciklimit.
- Marrja e masave dhe hartimi i politikave për mbrojtje ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore deri në vitin 2031.
- Qerdhe të reja në vendbanimet: Viti*, Pozharan, Smirë, Gjylekar, Kabash, Sllatinë e Epërme, Drobesh, Ramnishtë dhe Stubëll e Epërme.
- Zgjerimi i hapësirave shkollore për disa shkolla fillore.
- Zgjerimi i hapësirave shkollore për shkollimin e mesëm të lartë edhe me 8,000 m^2.
- Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe Avancimi i sistemit informativ shëndetësor.
- Përmirësimi i gjendjes në banim social.
- Rritja e kujdesit ndaj grupeve sociale me gjendje të vështirë shëndetësore dhe ekonomike.
- Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e shërbimeve administrative.
- Ofrimi i objekteve të reja të kulturës dhe artit për të gjithë banorët e komunës së Vitisë deri në vitin 2031.
- Sigurimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2031.
- Shtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në zonën urbane dhe nën-qendrat e komunës së Vitisë deri në në vitin 2031.
- Konservimi i aseteve të trashëgimisë kulturore deri në vitin 2031.
- Konservimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit.
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës për banim të qëndrueshëm dhe cilësor deri në vitin 2031.
- Rritja e proporcionit të banimit kolektiv deri në 2031.
- Trajtimi i ndërtimeve pa leje deri në vitin 2023.
- Shfrytëzimi racional I tokës ndërtimore.
- Implementimi i konceptit të zhvillimit hapësinor të përcaktuar me këtë PZHK.
- Aplikimi i modelit të qytetit dhe vendbanimit kompakt.
- Ruatja strikte dhe konsolidimi i tokës bujqësore.

1.6. NDËRLIDHJET ME PLANET RREGULLUESE URBANE NË FUQI

Komuna e Vitisë ka dy Plane Rregulluese Urbane (PRrU) dhe një Plan Rregullues të Hollësishme (PRrH) të cilët mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të zonës urbane të komunës.

Nga këto PrrU dhe PRrH, komuna e Vitisë ka të miratuara që të tri planet.

Tabela 3 Mbulueshmëria e tërësive hapësinore urbane me PRrU

Emri dhe periudha e Planeve Rregulluese Urbane (PRrU)	Tërësia urbane	Sipërfaqja (ha)
PRrU – Qendra, Zona Jugore dhe Lumi – Qyteti i Vitisë	Banim, Shfrytëzim i përzier, Lumi	99.52
PRrU – Zona Veriore	Banim, Shfrytëzim i përzier	110.20
Zona Ekonomike me Statusin Parku Industrial	Industri, Biznese	15.50
Total		**225.22**

1.7. NDRYSHIMET NË TEMATIKË OSE NË STRATEGJITË SEKTORIALE LOKALE QË NGA MIRATIMI I PZHK-SË

Harta Zonale e Vitisë është në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal 2023 - 2031 dhe nuk ka asnjë ndryshim në fushat e ndryshme tematike. Në PZHK janë paraparë këto destinime me sipërfaqet e paraqitura në tabelën me poshtë.

Tabela 4 Sipërfaqet e (ha) destinuara sipas PZhK - së

Destinimi i sipërfaqeve	Sipërfaqja / ha
Zonë Banimi	2,908..37
Zonë Bujqësore	10,669.42
Zonë Pyjore	12,240.73
Zonë e Shërbime	114.17
Zonë rekreative - turistike	24.54
Zonë komerciale	10.16
Zonë e Shfrytëzimot të përzier	89.33
Zonë e Industrisë	607.19
Zonë e Infrastrukturës së transportit	201.45
Zonë arkeologjike-historike	0.73
Sipërfaqe ujore	127.75
Zonë ushtarake e sigurisë	80.98

Gjendja ekzistuese e fundit, ka shtrirje më të zgjeruar të objekteve të banimit, objekteve afariste dhe objekteve industriale në dëm të tokës bujqësore, duke e zvogëluar fondin e tokës së punueshme bujqësore dhe duke i rritur dhe zgjeruar vendbanimet në mënyrë të shpërndarë.

1.8. SHQYRTIMI I PËRGJITHËSUAR I DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT PARAPRAK TË PO TË NJEJTIT NIVEL

Gjatë përgatitjes së Hartës Zonale të Vitisë, nuk ishte e mundur të bëhet shqyrtimi i përgjithësuar i dokumentit të planifikimit paraprak saktësisht i të njëjtit nivel, pasi që kjo është Harta Zonale Komunale e parë e Vitisë. Pas miratimit të këtij dokumenti me siguri se do të kemi edhe hartime të dokumenteve të reja të të njëjtit nivel, ku mund të kemi shqyrtim të përgjithësuar të dokumentit të planifikimit paraprak të po të njëjtit nivel, pra të kësaj HZK-je, edhe gjatë rishikimit dhe plotësimit, nëse ndodhë pas 4 viteve mund të ketë shqyrtim të përgjithësuar të Hartës Zonale Komunale.

Prandaj, këtu kemi trajtuar si dokumente paraprake të njëjtit nivel Planin Zhvillimor Komunal dhe Planin Zhvillimor Urban që mbulon zonën urbane.

2. ARSYETIMI

Gjatë përgatitjes së HZK-së së Vitisë, në harmoni edhe me detyrimet ligjore, kemi trajtuar dhe sqaruar arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale për krijimin e Zonave, zonave mbishtresore si dhe zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedhë nga Plani Zhvillimor Komunal 2023 - 2031.

Arsyeshmëria e përdorur në pjesën e arsyetimit përfshin marrjen në konsideratë të kritereve të përcaktuara në nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 24/2015, të cilat duhet t'i marrim për bazë, që në fakt paraqesin parimet e tilla si :

- Parimi i demokracisë, subsidiaritetit, pjesëmarrjes, integrimit, proporcionalitetit dhe parandalimit.
- Parimi i zonimit të përdorur gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Vitisë:
- Trajtimi i këtij dokumenti si mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal dhe për shtrirjën hapësinore si dhe gjeografike të tyre.

Në bazë të Hartës së Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës nga Plani Zhvillimor Komunal 2023 - 2031, Harta Zonale e Komunës ofron përcaktimin e detajuar të zonave dhe kushteve zhvillimore. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit të planifikimit hapësinor Nr.04/L-013 dhe në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 Harta Zonale e Komunës hartohet në pajtim me parimet specifike në vijim:

1. Promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale dhe hartat e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal 2023 - 2031;
2. Promovimin e objektivave të komunitetit, ashtu si janë deklaruara në Planin Zhvillimor Komunal 2023 – 2031, si krijimi i mundësive të reja për punë, ofrimi i banimit të përballueshëm, etj.;
3. Promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme;
4. Sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara;
5. Balancimin e interesin publik me të drejtat e pronës private dhe shfrytëzimin të arsyeshëm të pronës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;
6. Sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në:
   - Modelet e shfrytëzimit të tokës të bazuara të Planit Zhvillimor Komunal 2023 - 2031;
   - Gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qëllim që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm;
   - Karakteristikat natyrale të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshmërisë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë dhe ndjeshmërisë ndaj ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
   - Kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike dhe private;
   - Nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;
   - Harmonizimin e kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private nëpërmjet shfrytëzimit të arsyeshëm të pronës;
   - Promovimin e teknikave inovative për zhvillim;
   - Sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, ndotjes akustike ujërave tokësor edhe nëntokësor;
   - Sigurimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, ortekëve, tërmeteve dhe vërshimeve;
   - Sigurimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peizazhor të territorit të Komunës;
   - Ruajtjen dhe promovimin e traditës në prodhimtarinë bujqësore, pylltari, peshkim, rekreacionit dhe aktiviteteve në hapësirë të hapur;

- Promovimin e veprimtarive të organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme;
- Sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshëm në funksion të transportit urban, ndërurban, rural dhe menaxhim të mbeturinave;
- Promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të komunës së Vitisë;
- Sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës së Vitisë apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në komunë;
- Sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën e Vitisë;
- Sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor; dhe
- Sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillim dhe kërkesave për leje ndërtimore për sqarim dhe përshpejtim të procedurës.

Harta Zonale e Komunës së Vitisë:

- Është bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, në Hartën Zonale të Kosovës (ky dokument ende nuk është hartuar nga niveli qendror dhe për momentin nuk është relevant) dhe interesat kombëtare të paraqitura si objektiva, plane dhe politika zyrtare të Qeverisë.
- Ka marrë parasysh mundësitë e integrimit të Planeve Rregulluese Urbane që janë në fuqi. Harta Zonale e Komunës e Vitisë është hartuar në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor.
- Është hartuar në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin dhe ka kaluar në procese të diskutimeve dhe shqyrtimit publik, ku janë marrë në konsideratë kërkesat e të gjithë qytetarëve si dhe kërkesat dhe nevojat specifike të përsonave me nevoja të veçanta, të të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet e ndjeshme gjinore.

Hartimi i Hartës Zonale të Vitisë është bazuar edhe në parimet e mëposhtme:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të komunës së Vitisë, duke mbrojtur burimet natyrore, trashëgiminë kulturore dhe përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;
- Promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;
- Promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Vitisë
- Promovimin e cilësisë së lartë të jetesës dhe sistemeve të qëndrueshme për zhvillimin e vendbanimeve;
- Promovimin e planifikimit hapësinor të integruar përmes ecurive efikase
- Promovimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm bazuar në nevojat publike dhe ekonomike; dhe

- Promovimin e vazhdueshëm të harmonizimit me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe me parimet Evropiane për zhvillim hapësinor;
- Zhvillim të qëndrueshëm dhe proporcional të komunitetit, duke shfrytëzuar në mënyrë efikase fondet publike; dhe
- Parimet ndërkombëtare të planifikimit hapësinor, zhvillim të qëndrueshëm, dhe qeverisje në harmoni me normat e BE-së.

Elementet dhe kërkesat themelore e përdorura gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale të Vitisë janë:

1. Të bazohet në aktivitetet zhvillimore hapësinore të cilat rrjedhin nga Plani Zhvillimor Komunal 2023 - 2031, përkatësisht nga harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës, planet zhvillimore sektoriale dhe plani i veprimit.
2. Të përcaktojë ndarjen precize të territorit të komunës në zona funksionale dhe për secilën zonë përcakton shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikuar të zhvillimit.

2.1. TË PËRMBAJË ZONAT FUNKSIONALE TË CILAT RRJEDHIN NGA PLANI HAPËSINOR I KOSOVË DHE PLANET HAPËSINORE PËR ZONA TË VEÇANTA

Gjatë hartimit të Hartës Zonale të Vitisë në funksion të kompletimit të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji i ri i planifikimit, po edhe më shumë të krijimit një bazë reale për trajtimin zhvillimeve të ardhme hapësinore përmes me HZK, si dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e komunës së Vitisë për precizimin e Zonave, Zonave mbishtresore dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal.

Është bërë një analizë e hollësishme, reale dhe e qëndrueshme ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale siç edhe është kërkuar në këtë pjesë të dokumentit.

2.2. ZONAT

Arsyeja e precizimit si zona të cilat në elemente të caktuara dallojnë nga planet e më hershme të shfrytëzimit të tokës, rrjedh nga analizat e hollësishme, reale dhe të qëndrueshme ligjore, qoftë arsyeja se shumica e objekteve pa leje ndërtimore janë në proces të legalizimit bazuar në Ligjin Nr. 04/L-188 Për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, te arsyet mjedisore janë analizuar ndikimet e mundshme negative në mjedisore për tu propozuar ose jo ndryshimi. Në aspektin ekonomik janë vlerësuar se sa kemi zhvillim të bizneseve në zonë, cilat janë potencialet ekonomike dhe cilat do ishin pasojat nga aspekti ekonomike nëse nuk do lejohej ndryshimi , edhe në kuptimin financiare janë analizuar se cilat janë kostot e ndërtesave dhe zhvillimeve në zonë dhe cilat do ishin kostot e rrënimeve eventuale dhe në aspektin financiar është vlerësuar se sa ja vlen ndryshimi ose ruajtja e destinimit të mëhershëm dhe krejt në fund nga aspekti social është vlerësuar se sa do të ishte numri i familjeve që do kishin pasoja nëse nuk merret për bazë gjendja ekzistuese.

Një element tjetër përmbajtjesor është analizimi gjatë precizimit të zonave bazë janë edhe parimet e hartimit të Hartës Zonale të Komunës dhe dihet se hartimi i këtij dokumenti bazohet në parimet e lartpërmendura dhe ndër më të rëndësishmet janë:

Parimi i demokracisë, subsidiariteti, pjesëmarrja, integrimit, proporcionaliteti dhe parandalimi.

- Në këtë kuadër edhe parimet specifike si promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor;
- Promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone, të drejta dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor;
- Promovimin e kornizës themelore, transparente dhe të planifikuar të shfrytëzimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore, si dhe të drejtave pronësore;
- Promovimin e mundësive të barabarta të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor për të gjithë qytetarët e Vitisë.

Duke i zbatuar këto parime profesionalisht, seriozisht dhe si obligim për hartimin e HZK-së dhe analizuar dokumente të ndryshme hapësinore dhe gjendjen ekzistuese, Harta Zonale ka përcaktuar Zonat e radhitura në kapitullin 4 të këtij dokumenti si kushtet zhvillimore për to të përshkruara në kapitullin 5 të këtij dokumenti.

2.3. ZONAT MBISHTRESORE

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore Për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës por edhe në shembujtë e vendeve që përgatisin Harta Zonale, ekipet punese kemi trajtuar zonat mbishtresore si një teknikë të zonimit që përdoret për vendosjen e kushteve zhvillimore alternative, në kuadër të një sipërfaqeje specifike të komunës së Vitisë, e cila kërkon vëmendje të veçantë dhe zonat për të cilat duhen kushte plotësuese përpos kushte zhvillimore dhe kushte ndërtimore në zonën bazë, vendosen mbi një apo disa zona bazë dhe krahas kushteve të zonës bazë, për zonat mbishtresore vendosen kushte apo masa plotësuese dhe në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë.

Duke e ditur se zonat mbishtresore përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte dhe masave mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike, për definimin e zonave mbishtresore është analizuar komplet territori i Komunës së Vitisë se ku ka nevojë, me qëllim të përcaktohen masat mbrojtëse për:

- Resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- Resurset lokale natyrore, si:

  Mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, etj. të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- Ndikimet në mjedis, si:

  Ndotja e ajrit, ujit, akustike, etj.;
- Sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, ortekëve, tërmetet, e të tjera dhe standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për t'u zbatuar në gjithë territorin e Komunës së Vitisë.

Gjatë analizave të hollësishme të dokumenteve të ndryshme dhe gjendjes ekzistuese, Harta Zonale ka përcaktuar Zonat Mbishtresore të radhitura në kapitullin 4 të këtij dokumenti si kushtet plotësuese për to të përshkruara në kapitullin 6 të këtij dokumenti.

3. KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZHVILLIM PËR TË GJITHA ZONAT

Emërues i përbashkët i kushteve zhvillimore të përgjithshme, është se këto kushte vlejnë për tërë territorin e Komunës dhe duhet të zbatohet gjatë zhvillimeve dhe përdorimeve sipas asaj që është përcaktuar për zonat e përfshira në këtë dokument. Duke e trajtuar më tutje ketë materie, bazuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH-së nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të komunës ku edhe specifikohet se "Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme" përcaktojnë rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillimet e ardhme. Megjithatë, ka disa rregulla si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme sipas të cilave mund të sigurohet :

- Qëndrueshmërisë - rregull i përgjithshëm është marr trajtimi nga aspekti social, ekonomik dhe mjedisor për të gjitha zonat për arritjen e qëllimeve të qëndrueshmërisë.
- Realizueshmëri - rregull i përgjithshëm është marr analiza financiare dhe e KAB (Korniza Afatmesme Buxhetore) dhe mundësi të tjera financiare për realizim.
- Drejtësi -rregull i përgjithshëm është marr trajtimi i zhvillimeve, pronës dhe kushteve me HZK në mënyrë të barabartë për të gjithë, pa marrë parasysh statusin etnik, gjinor, social etj.
- Demokraci dhe drejta të njeriut - rregull i përgjithshëm informimi cilësor, kyçja në proces dhe pjesëmarrje në vendimmarrje si dhe përmbushja e rregullave dhe standardeve tjera të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.
- Legjitimim - rregull i përgjithshëm është marr që Komuna është bartëse e procesit të përgatitjes së HZK-së dhe akterët tjerë janë të mirëseardhur që të jenë pjesë sa më shumë e vendimeve në kuadër të rregullave që do ishte shumë e dëshirueshme. Për disa zhvillime anëtarët e komunitetit do të duhej të bie dakord për një seri rregullash të brendshme.

E cekëm më lart se rregullat u trajtuan edhe nga aspekti teknik që sipas Ligjit për Standardizim (Nr.2004/12) të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, termi rregulla teknike përkufizohet si vijon :

"Rregullat Teknike - janë aktet nënligjore me karakter teknik të cilat i përcaktojnë karakteristikat, proceset, ku përfshihen edhe masat administrative që zbatohen në rast të shkeljes së tyre. Rregullat teknike mund të përmbajnë terminologjinë, simbolet, ambalazhin, shënjimet ose kërkesat për etiketimin që kanë të bëjnë me produktin, procesin apo metodën e prodhimit."

Rregullat teknike janë të detyrueshme për zbatim nga subjektet fizike dhe juridike, të fushës përkatëse dhe duhet të zbatohen gjatë të projektimit, të ndërtimit, përdorimit, etj.

Ligjet dhe aktet nën-ligjore të Republikës së Kosovës kanë përcaktuar kritere të cilat duhet të përmbushen gjatë zbatimit të Hartës Zonale të Komunës, mirëpo në mungesë të kritereve specifike për zhvillime specifike dhe Komuna dhe zhvilluesit tjerë të Hartës Zonale të Komunës duhet të i plotësojnë standardet vijuese.

3.1. MASAT MBROJTËSE

Bazuar në udhëzimin administrativ Kushtet Zhvillimore të Përgjithshme mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, masat mbrojtëse, modelet e projektimit dhe udhëzimet, derisa sa shkruhet se përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat, fare lehtë konstatohet se ekipet punuese mund të shtojnë kërkesa dhe rregulla tjera plotësues dhe të njëjtat janë trajtuar shumë seriozisht, në vazhdimësi janë trajtuar masat mbrojtëse si pjesë e Kushteve zhvillimore të përgjithshme.

Masat mbrojtëse janë veprime apo mënyra të veprimit, urdhra apo udhëzime të nevojshme për të arritur qëllime të caktuara, në këtë rast mbrojtje të jetës, pasurisë ose vlerave tjera sociale, ekonomike apo mjedisore dhe mund t'i klasifikojmë si :

- Masa parandaluese, masa të rëndësishme (të shpejta, të ngutshme, të drejta, të rrepta);
- Masa konkrete (praktike, energjike, rrënjësore, përgatitore);
- Masa organizative;
- Masa lehtësuese;
- Masat e nevojshme;

- Masa mjekësore (higjienike, parandaluese, parambrojtëse);
- Masa sigurimi. etj.

Masat mbrojtëse qoftë ndaj rreziqeve, qoftë potencialeve që duhet mbrojtur, apo edhe potencialeve që duhet ruajtur që më vonë të zhvillohen, janë pjesë e detyrueshme që rrjedhin nga Kushtetuta, ligjet, aktet nënligjore, konventat ndërkombëtare dhe një gamë e gjerë e obligimeve dhe përgjegjësive që ushtrohen qoftë në nivelin qeveritarë qoftë në atë lokal dhe e një numri institucioneve, për t'u kujdesur për një cilësi të jetës, për florë dhe faunë të pasur dhe për qëndrueshmëri sociale, ekonomike dhe mjedisore, e të cilat për emërues të përbashkët kanë gjitha zonat - në këtë rast territorin e komunës.

Ky dokument ka trajtuar me kujdes masat mbrojtëse, si një formë e kushteve zhvillimore për të baraspeshuar nevojat për mbrojtje të pasurive natyrore dhe kërkesave për zhvillim. Për shembull, një pikë me potencial të zhvillimit të turizmit që shtrihet brenda tokës bujqësore, ose mbi pasuri nëntokësore, ose zonës arkeologjike, shpesh krijojnë interesa të ndryshme të zhvillimit dhe ruajtjes.

Masat mbrojtëse janë efektive kur hartohen në suaza të kapaciteteve të komunës për t'i zbatuar ato, dhe kur iu bëhet e qartë qytetarëve se masat mbrojtëse janë të obligueshme për të gjitha zhvillimet për të cilat vlejnë, por nuk kufizohen vetëm në këtë nivel se komunat sfidohen edhe nga rreziqet që i tejkalojnë kompetencat komunale.

Masat mbrojtëse përcaktohen edhe për një zonë të vetme me specifika të caktuara, apo për një sipërfaqe më të madhe si p.sh. zonë rurale. Nëse kufijtë e sipërfaqes që duhet mbrojtur janë të ndryshme nga kufijtë e zonave të përcaktuara, dhe në çfarëdo rasti kur përveç zonës bazë kemi edhe një shtresë tjetër me specifikat si të lartcekura trajtohen me kushte zhvillimore për zonat që janë të determinuar si Zona Mbishtresore.

Masat mbrojtëse ndër të tjera përfshijnë kushte hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ku definohen kushte zhvillimore (caktohen kushtet hapësinore, urbane dhe ndërtimore) me qëllim të parandalimit apo zvogëlimit të efekteve të dëmshme si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera si dhe për të mundësuar mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën.

Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizim të qytetarëve, transport publik, si dhe deponim, prodhim dhe përdorim të materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate për siguri nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

3.1.1. EVAKUIMI

Duhet të mendohet edhe për evakuimin e banorëve të rrezikuar atëherë kur me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre. Lëvizja e banorëve nga zona e paraparë për evakuim në vendin e caktuar, duhet të bëhet sipas mënyrës dhe afateve kohore të përcaktuara në planet e reagimit emergjent apo siç është përcaktuar në vendimin e organit kompetent.

3.1.2. AKOMODIMI DHE KUJDESI I NJERËZVE TË RREZIKUAR

Qeveria dhe komunat janë të obliguar të sigurojnë strehim dhe kujdes të domosdoshëm për qytetarët, të cilët në rast të fatkeqësisë natyrore apo fatkeqësisë tjetër kanë humbur shtëpitë dhe mjetet e tyre të jetës dhe nuk mund të kthehen në vendbanimet e tyre për shkak të rrezikut.

Në raste të jashtëzakonshme, kur nuk mund të sigurohet akomodim tjetër, Kryetari i Komunës kërkon nga pronarët ose shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit t'i strehojnë përkohësisht banorët e evakuuar të cilët janë të rrezikuar.

3.1.3. MBROJTJA RADIOLOGJIKE, KIMIKË DHE BIOLOGJIKE

Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga efektet e armëve nukleare, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e incidenteve që përfshijnë materiet e rrezikshme.

Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve, ushqimit për kafshë, shërbimet publike, shëndetësore, ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.

Me akt nënligjor qeveria ka rregulluar organizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe i ka përcaktuar mjetet dhe masat për mbrojtje. andej kur specifikohen masat mbrojtëse nëse ky rrezik merret në konsideratë duhet bazuar në aktin nënligjor.

3.1.4. STREHIMI

Strehimoret dhe objektet tjera për mbrojtje ndërtohen me qëllim të mbrojtjes së njerëzve në raste të luftës apo rreziqeve të tjera. Strehimoret ndahen në strehimore të mbrojtjes elementare dhe plotësuese.

Strehimoret e mbrojtjes elementare ndërtohen në qytete dhe vendbanime të rrezikuara brenda ndërtesave të reja, të destinuara për shërbime të shëndetit publik, kujdesit dhe edukimit të fëmijëve, mbrojtje të trashëgimisë kulturore, informimit publik, televizioneve dhe radiove kombëtare, trafikut hekurudhor dhe ajror si dhe në ndërtesat e rëndësishme për furnizim me energji dhe ndërtesat industriale të destinuara për tu shfrytëzuar në kohë lufte për mbajtjen e aktiviteteve të rëndësisë së veçantë për mbrojtje dhe siguri.

Strehimoret në ndërtesat e reja në vendbanimet e caktuara, pllaka e parë duhet të përforcohet deri në masën që i reziston depërtimit të rrënojave. Strehimoret ndërtohen si objekte të përdorimit të dyfishtë deri në masën që nuk e çrregullon funksionin e tyre mbrojtës. Objektet tjera për mbrojtje duhet të ndërtohen në atë formë që sigurojnë strehim nga rrënojat.

Me qëllim të sigurimit të strehimit për njerëzit në vendet publike duhet të përdoren strehimoret publike apo objektet tjera të përshtatshme. Strehimoret publike janë në kompetencë të autoriteteve lokale të komunës të cilat janë shqyrtuar gjatë hartimit të HZK-së. Strehimoret për mbrojtje elementare duhet të sigurojnë mbrojtje nga mbi-presioni, rrënojat, radioaktiviteti, zjarri dhe efektet e armëve dhe materiet tjera kimike si dhe duhet të furnizohen në masën që mundëson banim për një kohë më të gjatë.

3.1.5. MBROJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore përfshinë përgatitjet dhe ndërmarrjen e masave për zvogëlimin e rreziqeve, parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore.

Përgatitjet dhe masat zbatohen nga pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore, shërbimi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, nivelet qendrore dhe lokale.

Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikës, si dhe strukturat tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Qeveria me akt nënligjor rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Në qoftë se gjatë zhvillimit në teren në fazën e gërmimeve haset në mbetje arkeologjike investitorët janë të obliguar ti ndërpresin punimet dhe menjëherë të njoftojnë organet kompetente komunale. Kjo vleni për të gjitha kategoritë e ndërtimeve.

3.1.6. MASAT PËR MBROJTJE NGA ZJARRI SIPAS KATEGORIVE TË OBJEKTEVE

Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të obliguar të marrin masat për mbrojtje nga zjarri, të përcaktuara sipas ligjit LIGJI Nr. 04/L-012 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, si dhe në përputhje me planin e mbrojtjes nga zjarri.

Pronarët apo shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit janë të detyruar të ndërmarrin masat si në vijim:

- Për kategorinë e I (parë) të rrezikshmërisë, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë, si dhe të formojnë njësitë e mbrojtjes nga zjarri me kuadro të nevojshëm dhe mjete e domosdoshme për punë për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri;
- Për kategorinë e II (dytë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të hartojnë planin e mbrojtjes nga zjarri në bazë të vlerësimeve të rrezikshmërisë nga zjarri, të kenë numër të mjaftueshëm të punëtorëve të cilët janë të trajnuar në këtë fushë dhe mund të kryejnë kujdestarinë e përhershme për fikjen e zjarrit dhe zbatimin e masave mbrojtëse nga zjarri ;
- Për kategorinë e III (tretë) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë së paku një punëtor i cili është i trajnuar dhe drejtpërdrejt organizon dhe përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojte nga zjarri;
- Për kategorinë e IV (katërt) të rrezikshmërisë nga zjarri, janë të obliguar të kenë një punëtor të trajnuar dhe ngarkuar me punë te mbrojtjes nga zjarri.

Planin e mbrojtjes nga zjarri, janë të obliguar ta nxjerrin pronarët, përkatësisht shfrytëzuesit e objekteve, pjesëve të objekteve dhe mjedisit, të radhitura në kategorinë e parë dhe të dytë të rrezikshmërisë dhe ky plan duhet të jetë i harmonizuar me planin komunal për mbrojtje nga zjarri. Personat juridik përgjegjës për punët e mbrojtjes nga zjarri, duhet të punësojnë personat të cilët kanë të kryer trajnimet profesionale për zjarrfikës apo drejtimit teknik, dhe të cilët e kanë të dhënë provimin profesional për kryerjen e punëve për mbrojtje nga zjarri.

Janë vlerësuar disa masa mbrojtëse në gati të gjitha sfidat dhe të gjitha fushat, që trajtohen me HZK, si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme, për sigurimin e një mbrojtje, shfrytëzim dhe zhvillim të qëndrueshëm, e disa që nuk adresohen këtu janë adresuar në kushtet zhvillimore. Duke e kuptuar se masat mbrojtëse nuk kufizohen vetëm te rreziqet por edhe në këto sfida dhe probleme (nuk kufizohen vetëm në këto) të cilat shkaktohen nga ndotja, erozioni, humbja e potencialeve dhe resurseve sipërfaqësore dhe nëntokësore.

3.1.7. MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E NATYRËS

Këto masa mbrojtëse janë precizuar me Ligjin Nr. 03/l-233 për Mbrojtjen e Natyrës, i cili rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:

- Mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- Përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- Vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;
- Pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara ,si dhe vendbanimeve të tyre;
- Sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- Sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- Parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridikë dhe fizikë në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- Mirëmbajtjen ose skanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes së vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për komunat, Kosovën sipas standardeve të BE-së;
- Ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Rregullimi i tokës – masat për përmirësimin e projektimit të zonës rurale, si zhvillimin e shfrytëzimit më ekonomik dhe racional të tokës, grupimin e tokës bujqësore dhe rritjen e sipërfaqes së fermave, përmirësimin e infrastrukturës dhe mundësinë e qasjes në të, ruajtjen e peizazhit dhe natyrës, zbatimin e masave agroteknike, agromelioruse dhe hidromelioruese, ripyllëzimin e tokës me kualitet të ulët ose tokës së ndotur dhe masat e reja të tokës edhe këtu kemi masat e parapara me ligjin nr. 04/l-040 për rregullimin e tokës dhe në kuadër të masave meliorative për rregullimin e tokës përfshihet edhe :

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Meliorimi i livadheve dhe kullotave;
- Kthimi i tokës së pa punueshme në tokë të punueshme;
- Përmirësimi i cilësisë dhe vetive të tokës bujqësore përmes klasifikimit, humusimit, kullimit, shkripëzimit, Plehërimit meliorativ, rikultivimit të tokave të dëmtuara dhe të degraduara.

Ndër masat tjera të rregullimit të tokës janë: Masat mbrojtëse të tokës bujqësore nga erozioni.

Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmbytjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundër erozive si në vijim:

1. Ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lërimit të livadheve, kullotave dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetore;
2. Prezantimi i kulturave bujqësore në rotacion;
3. Kultivimin e plantacioneve shumëvjeçare;
4. Ngritjen e ndërtesave specifike përkatëse;
5. Përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore;
6. Ngritjen dhe kultivimi ne brezave mbrojtës bujqësor apo mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare;
7. Ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara;
8. Ndalimi i prerjes se pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar;

3.2. MASA TË TJERA MBROJTËSE

3.2.1. MASAT MBROJTËSE TË TOKËS BUJQËSORE NGA FRAGMENTIMI

Masat kundër fragmentuese janë :

- Toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e secilës është ≤0.50 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela ;
- Toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela.

3.2.2. MASAT MBROJTËSE DHE RREGULLIMI I TOKËS PYJORE

Masat mbrojtëse dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

1. Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo pyjore;
2. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
3. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në formë të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale(nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

3.2.3. MASAT PËR RIKULTIVIMIN E TOKËS PËR BUJQËSI DHE INDUSTRI

Ndër masat e para është përgatitja e projektit për rikultivim e projekti për rikultivim duhet të përmbajë:

1. Mënyrën e heqjes dhe ruajtjes së shtresës pjellore dhe shtresës me potencial pjellor.
2. Procedurat teknike, agroteknike, dhe biologjike të rikultivimit të tokës bujqësore dhe afatet e kryerjes së rikultivimit biologjik të tokës bujqësore.
3. Dinamika e kthimit të tokës prodhimtarisë bujqësore.
4. Hulumtimi i materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në tokën e rikultivuar dhe

Shumën financiare të projektit.

1. Shfrytëzuesi apo investitori i përkohshëm i tokës bujqësore është i detyruar që për sigurimin e rikultivimit të tokës bujqësore, të paguajë paraprakisht në llogarinë të cilën e cakton organi kompetent komunal për bujqësi shumën prej së paku 30% të mjeteve të nevojshme për rikultivim. Mjetet të cilat mund të shfrytëzohen vetëm për qëllime të rikultivimit dhe pas rikultivimit mjetet i kthehen shfrytëzuesit.
2. Nëse gjatë eksploatimit të lëndëve industriale dhe lëndëve tjera minerale nga toka bujqësore, ç'rregullohet regjimi ujor, apo vjen deri te përmbytjet dhe grumbullimi i ujit, shfrytëzuesi është i detyruar që para kryerjes të rikultivimit biologjik t'i kryej edhe punët hidroteknike me të cilat do të vendos regjimin e mëparshëm ujor në tokë.

3. Nëse shfrytëzuesi pas përfundimit të eksploatimit të lëndëve industriale dhe mineraleve të tjera nuk e kryen rikultivimin e tokës bujqësore, organi kompetent për bujqësi do të angazhoj organizatën tjetër e cila do të bëjë rikultivimin e tokës me shpenzimet e shfrytëzuesit të tokës bujqësore për qëllime jo bujqësore.

3.2.4. TRANSFORMIMI I TOKËS BUJQËSORE

Te sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura. Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera të tilla merren masat e ndalimit të ndërtimit të deponisë për mbeturina. Në lokacionin ku ndërtohet deponia e mbeturinave apo zona e deponisë planifikohet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze.

3.2.5. MASAT PËR MBROJTJEN E UJIT NGA NDOTJA

Masat për mbrojtjen e ujit nga ndotja janë:

1. Eliminimi i shkaqeve të ndotjes së ujit,
2. Zvogëlimi i sasisë së materieve ndotëse në ujë,
3. Ndërmarrja e masave të posaçme të pastrimit.

Shkalla e ndotjes së ujit mund të zvogëlohet me montimin e instalimeve të veçanta për spastrimin e ujërave të ndotura.

Mbrojtja e ujit nga ndotja mund të bëhet edhe duke ndaluar hedhjen e ndotësve në ujë. Zvogëlimi i sasisë së lirimit të materieve ndotëse në ujë është formë e rëndësishme e luftës kundër ndotjes. Kjo nënkupton vendosjen e filtrave përkatës dhe e sistemeve për fundërrim në vendet ku lirohen ujërat e ndotura si dhe ftohjen e obliguar të ujit para se ai të lirohet në rrjedhën e lumit ose në ndonjë recipient tjetër.

Një formë e mbrojtjes së ujërave rrjedhës nga ndotja është edhe mbrojtja speciale e burimeve, planifikimi i lokacionit të deponive për hedhurina sa më larg ujërave rrjedhëse, zvogëlimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave artificiale në bujqësi si dhe pyllëzimi dhe ruajtja e tokës nga erozioni kur prehen pyjet krojet sterri. Me konventa ndërkombëtare ndotja e ujërave është e sanksionuar. Por, vështirë është të binden njerëzit që të mos e ndotin atë. Prandaj, është me rëndësi vetëdijesimi dhe edukimi i popullatës për shfrytëzim racional të resurseve ujore. Mbrojtja e ujërave nga ndotja sigurohet me ndalesë, me përkufizim dhe me pengim të shkarkimit të materieve të dëmshme dhe të rrezikshme në ujëra si dhe marrjen e masave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave.

3.2.6. MASAT MBROJTËSE PREJ SHQETËSIMIT DHE DËMTIMIT NGA ZHURMAT

Çdo shtetas ka të drejtë të mbrohet dhe të përfitojë mbrojtje nga organet shtetërore nga efektet e dëmshme të zhurmës mjedisore. Mbrojtja zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen, në zona të banuara, në mjediset e institucioneve publike, në parqe publike dhe hapësira të tjera, të qeta, çlodhëse, në zona të qeta në natyrë, në institucionet për fëmijë, institucione shëndetësore, arsimore, kulturore, fetare dhe në mjedise të tjera të ngjashme me to.

3.2.7. CILAT JANË MASAT E MBROJTJES NGA ZHURMA

Me masa të mbrojtjes nga zhurma do të kuptojmë ndërhyrjet dhe veprimet që ndërmerren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin ku ai ka ndikim negativ, duke e sjellë atë në një nivel të lejueshëm. Masat kryesore të mbrojtjes nga zhurma janë:

- Përzgjedhja e makinerive apo pajisjeve që nuk bëjnë shumë zhurmë;
- Përzgjedhja e vendit ku do të vendosen dhe do të punojnë pajisjet që lëshojnë zhurmë që të garantojë një nivel të lejueshëm zhurme në mjediset rreth tyre.

3.2.7.1. ÇFARË DUHET TË MBAHET PARASYSH GJATË PROJEKTIMIT DHE REALIZIMIT TË NDËRTESAVE

Çdo ndërtim dhe rikonstruksion ndërtesash, për banim apo për veprimtari të tjera ekonomike e shoqërore, projektohet dhe realizohet në mënyrë që zhurma në brendësi apo në afërsi të saj, të jetë brenda nivelit të lejueshëm.

3.2.8. KU DUHET TË KËRKOHET MIRATIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE TË NDRYSHME

Për zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime të përkohshme, në mjedise të jashtme apo të brendshme, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët, duhet kërkohet miratimi nga organet kompetente dhe për kohë të caktuar, në territorin e komunës ku zhvillohet aktiviteti. Pasi që planifikimi është multisektorial edhe masat duhet jenë për të gjitha fushat por po i trajtojmë edhe disa të përgjithshme si te tërmetet :

- Përgatitja e një rregulloreje për të gjitha ndërtimet në pajtim me shkallën e rrezikut sizmik. Përgatitja e projektit dhe ndërtimi duhet të bëhen sipas standardeve.
- Në rastet e objekteve të veçanta si dhe në ndërtesat shumëkatëshe duhet bërë ndërtimi sipas konceptit dhe rregullave të arkitekturës kundër sizmike.
- Ndërtimi i stacioneve kundër breshrit.
- Masat në periudhën dimërore e veçanërisht në zonat kodrinore-malore.
- Përgatitja e objekteve për akumulim të ujërave lumorë dhe të përroskave që mund t'u nevojitet pendave ashtu qenë rast të ndonjë thatësie eventuale ky ujë të përdoret për ujitje.
- Përgatitja e projekteve përhapjen e kanaleve të reja, pastrimin, mirëmbajtja e kanaleve ekzistuese.
- Ndërmarrja e masave për eliminimin e kthesave të ashpra të lumenjve dhe menaxhimi i brigjeve të lumenjve.
- Ndërmarrja e masave për mbrojtjen e lumenjve nga hedhja e mbeturinave që në këtë rast do të thotë pengimi rrjedhës së lirë të ujit.
- Ndërmarrja e masave për ndalimin e ndërtimeve të objekteve banuese dhe objekteve të karakterit ekonomik afër brigjeve të lumenjve, në largësi prej më së paku 10 metrave nga shtrati lumor (pikës së ujit).
- Ndërmarrja e masave për moslejimin e ndërtimeve ose zbatimi i standardeve atje ku është e nevojshme për objektet apo pajisjet që shkaktojnë zjarr ose ndihmojnë zjarret në pyje dhe vendet tjera të rrezikuara nga zjarret.
- Ndërmarrja e masave mbështetëse për objektet apo pajisjet që pengojnë ose ndihmojnë shuarjen e zjarreve në pyje apo vendet tjera të rrezikuara nga zjarret.
- Hartimi i projekteve për vendosjen e sa më shumë hidrantëve dhe ujit të akumuluar në sa më shumë vende dhe vendbanime.
- Hartimi i projektit për sigurimin e qasjes për veturat që shfrytëzohen për fikjen e zjarrit deri tek secila njësi banesore në komunë.
- Masa kontrolluese kundër shkelësve të ligjit.
- Masat ndëshkuese.

3.2.9. MODELET E PROJEKTIMIT

Përderisa Republika e Kosovës ende nuk ka Kodin Unik të Ndërtimit i cili duhet të zbatohet në tërësi pas miratimit të tij, ky dokument ka përcaktuar kushtet zhvillimore dhe modelet e projektimit të cilat duhet të zbatohen për zhvillimet e reja përderisa nuk shfuqizohen me akte ligjore të reja të cilat mund të hyjnë në fuqi pas miratimit të këtij dokumenti. Deri sa me MODEL definojmë diçka që zakonisht është punuar në mënyrë të veçantë dhe merret si shembull për të bërë edhe një tjetër ose disa të tjera si ajo ose edhe shprehur më ndryshe: diçka në të cilën një kopje mund të bazohet sepse është një shembull jashtëzakonisht i mirë i llojit të tij, dhe me PROJEKTIM definojmë paraqitjen në letër, planin e një objekti të infrastrukturës teknike ose sociale.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda HZK-së do jenë të tilla që të plotësojnë kriteret e funksionalitetit, qëndrueshmërisë, cilësisë së shërbimit, përshtatshmërisë me ambientin.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda HZK -së janë hulumtuar te llojet e ndryshme të projekteve për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore. siç janë: Ndërtesat e banimit, Ndërtesat e banimit me një njësi, Shtëpitë e veçanta, Shtëpitë dyshe, Shtëpitë në varg, Ndërtesat e banimit me shumë njësi, Ndërtesat e veçanta, Ndërtesat në varg, Ndërtesat tarracore.

Gjithashtu edhe te projektet infrastrukturës rrugore dhe sipërfaqet transportuese të përcaktuara për zhvillim si: rrugët publike me nivelimin sipas kategorizimit, të motorizuar dhe jo të motorizuar; rrjeti hekurudhor i lehtë dhe i rëndë; ndërtesat dhe sipërfaqet për transport ajror dhe ndërtesat dhe sipërfaqet për transport publik urban, rural dhe ndër-urban.

Te projektet e infrastrukturës publike dhe sociale, ku përfshihen parqet publike dhe sipërfaqet e hapura, fushat sportive dhe hapësirat rekreative, hapësirat dhe ndërtimet e shërbimeve mjekësore, ndërtesat për shërbim social, ndërtesat e institucioneve parashkollore për përkujdesje ditore, shkollat dhe universitetet, qendrat administrative, hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike dhe varrezat.

Modelet e projektimit si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme brenda **HZK**-së janë bazuar në llojet e ndryshme të projekteve të infrastrukturës teknike për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore, modele që do bazohen në shtrirjen e rrjeteve dhe kapacitetet e ndërtesave përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet, të përcaktuara për zhvillim, si: Rrjetin e ujësjellësit, Rrjetin e kanalizimit, Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza, Sistemet e drenazhimit, Rrjetin e ujitjes, Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji termike, Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji elektrike, Rrjetin e telekomunikacionit dhe instalimet e ngjashme, Rrjetin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore dhe nëntokësore, si dhe Ndërtesa dhe hapësira për riciklim dhe dekompozim.

Modelet e Projektimit në përgjithësi mund të jenë të shumta dhe të ndryshme dhe t'u përgjigjen fushave multisektorale si pjesë e **HZK**-së. Këto modele mund të bazohen duke u bazuar në projektet e zhvilluara më herët, që kanë treguar rezultate të mira ose modele të reja që ende po evoluojnë dhe po paraqiten me përmbajtje më të mira. Sidomos zhvillimi i teknologjive të reja po ndihmojnë në definimin e modeleve të reja të projektimit dhe zhvillimit. Modeli i projektimit mund të definohet si model me të cilën komunat krijojnë dhe përdorin resurset e tyre për t'u ofruar konsumatorëve, partnerëve, furnizuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë të projektimit vlera më të mira për të realizuar përfitim nga ky aktivitet. Modeli i projektimit duhet të paraqesë faktorin që i mundëson komunës të ketë një përparësi, për të performuar më mirë në raport me sfidat dhe problemet në një periudhe afatgjatë.

Përmbajtjet kryesore të Modeleve të Projektimit, do të paraqesim llojet e ndryshme të projekteve, për të cilat duhet dhënë kushte zhvillimore dhe të gjitha këto lloje të zhvillimeve që duhet hartuar një projekt, do të synohet modeli i projektimit, bazuar në përvojat, parimet, rregullat, standardet dhe elementet e tjera që do ta definojnë edhe si model të Projektimit.

Modeli i projektimit për ndërtesat të cilat potencialisht shtrihen në zonat sizmike , do të zhvillohet ashtu, që stabiliteti i objektit të jetë në harmoni me normat dhe standardet e fushës, dhe një ndër kushtet e këtij modeli është të përmbajë një analizë të sistemeve strukturore që mund të përdorën në zonat sizmike , analizë e cila mund të bëhet në dy mënyra: Mënyra e parë dhe më e shpeshtë është në bazë të konceptit mbajtës të sistemit strukturor, pra, në varësi të mënyrës së përcjelljes së forcës sizmike.

Ndërkaq, mënyra e dytë e ndarjes është në varësi të materialeve konstruktive, pra, ndarja në strukturat nga betonarmeja, çeliku, druri apo edhe materiale të tjera dytësore.

Në përgjithësi literatura profesionale preferon ndarjen e parë dhe në këtë drejtim mundësia për zgjidhje të sistemeve strukturore përmblidhet në:

- Sistemet me mure,
- Sistemet me rama rigid,
- Sistemet e shtanguara (sisteme kapriatë, me rama të shtanguar, perimetër të shtanguar etj.),
- Sistemet duale (me rama dhe mure).



Figura 1 Shembuj nga sisteme të strukturave

Në përgjithësi këto sisteme (dhe nënsistemet që derivohen) kundrejt forcës sizmike veprojnë si një konsolë vertikale e ngarkuar me forca horizontale. Shtangësia, rigjiditeti dhe konfiguracioni i kësaj konsole përcakton edhe reagimin sizmik të strukturës.

Në vazhdimësi për të përvetësuar një model ose do përdoret modeli i punuar më herët për zonën bazuar në këto analiza, ose do të merremi me detalisht me secilin prej këtyre sistemeve strukturore asizmike dhe do të përvetësojmë një si model projektimi edhe për rastet tjera bazuar në normat, standardet, parimet dhe kriteret e funksionalitetit, qëndrueshmërisë, cilësisë së shërbimit, përshtatshmërisë me ambientin. Dhe ky model për pos sigurimit të një sistemi i cili do t'i kundërvihet forcave sizmike. Modeli me shpesh projektohet ashtu që mos t'i konkurrojnë arkitekturës se objektit, përkatësisht, që ndikimi i strukturës në arkitekturë të jetë minimal.

Modelet e projektimit janë të rëndësishme në të gjitha zonat por sidomos këto modele fitojnë në peshë te zonat mbishtresore ku përpos kushteve të rëndomta kërkohen edhe kushte shtesë gjatë projektimit dhe duhet përvesuar modelet e dëshmuara si të qëndrueshme funksionale, cilësore dhe të përshtatshme në ambientet dhe situatat e tilla, dhe jo në pak raste edhe materialet që përdoren janë jo të njëjta me kushtet e rëndomta. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së lejes ndërtimore përpos vlerësimit të përputhshmërisë me kushtet zhvillimore, Komuna do të vlerësojë gjithashtu edhe përputhshmërinë e projekteve të propozuara me modelet e projektimit.

Në rast se ndërtesat, infrastruktura teknike dhe sociale përmbushë kushtet zhvillimore, mirëpo projekti nuk është në harmoni edhe me modelet e projektimit të përcaktuara për disa lloje të ndërtimeve, atëherë Komuna është e detyruar për të kërkuar plotësimin edhe të përshtatshmërisë me modelet e projektimit të përvetësuara qoftë nga përvojat, qoftë nga analizat, qoftë edhe nga modelet e përvetësuara nga zhvillimet teknologjike ose kërkesat tjera nëtrend (si objektet e gjelbërta, SMART(objektet e mençura) etj., ose zhvillimet nëse nuk përshtaten me modelet duhet refuzuar kërkesën ndërtimore.

Një pjesë e konsiderueshme modeleve të projektimit bazohet në aktet nënligjore në fuqi apo në praktikat më të mira të projektimit. Në rast se në të ardhmen shfuqizohet nga një akt i ri nënligjor i cili do ta shfuqizojë atë në të ardhmen, atëherë të gjitha zhvillimet e reja duhet të përmbushin kërkesat minimale të projektimit të përcaktuara me aktin e ri nënligjor të miratuar në të ardhmen.

3.2.10. UDHËZIMET

Edhe për udhëzimet u ngritën sfidat se çka janë udhëzimet dhe cilat janë udhëzimet e përgjithshme për zhvillim që zbatohen për të gjitha zonat. Në ketë drejtim edhe udhëzimet u trajtuan nga aspekti praktik të cilat nënkuptojnë: përcaktimi i rrugës dhe mënyrave për të bërë një punë a për të zhvilluar një veprimtari, që tregon si të veprosh, që përmban udhëzime: Material udhëzues, Shkresë udhëzuese, Rregulla udhëzuese, Tekst udhëzues, që përcakton drejtimin nga duhet të lëvizë një zhvillim, apo aktivitet.

Duke e marrë për bazë se Hartat Zonale të Komunës janë multisektorale por edhe bazohen në dokumente dhe strategji të niveleve të ndryshme, edhe numri i udhëzimeve administrative që përcaktojnë kriteret për zhvillimin e ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të zeza, sistemet e drenazhimit, rrjetin e ujitjes, energjisë termike, energji elektrike, telekomunikimit, rrugëve, transportit, tokës bujqësore, pasurive nëntokësore, trashëgimisë, infrastrukturës sociale do shfrytëzohen për bazë dhe do vlejë për të gjitha zhvillimet hapësinore.

Me një fjalë udhëzimet e të gjitha fushave vlejnë për të gjitha zonat dhe në fushat përkatëse duhet marrë për bazë gjatë hartimit të këtij dokumenti Udhëzimet administrative që mbulojnë fushat përkatëse.

3.3. SHFRYTËZIMET E TOKËS

Kushtet zhvillimore sipas shfrytëzimeve të tokës në vijim janë përcaktuar në përputhje me ligjin, udhëzimet dhe nomenklaturën e Sistemit Hierarkik të Klasifikimit të Shfrytëzimit të Tokës (HILUCS) të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ MMPH- Nr.08/2017 Mbi Normat Teknike Të Planifikimit Hapësinor, duke identifikuar llojet e aktiviteteve të cilat lejohen për secilën kategori të shfrytëzimit të paraqitura në këtë kapitull. Për të kuptuar cilat aktivitet specifike përfshihen në shfrytëzimet e tokës të paraqitura në vijim, duhet referuar në Udhëzimin Administrativ MMPH -Nr.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

3.3.1. SHFRYTËZIMET E LEJUARA

Shfrytëzimet e lejuara të tokës janë shfrytëzimet të cilat potencialisht mund të zbatohen dhe janë të lejuara në komplet territorin e komunës, por të cilat realisht zbatohen në një zonë ose më shumë zona specifike e cila ose të cilat janë përcaktuar me Plan Zhvillimor Komunal të Vitisë dhe ka për qëllim zhvillimin e atyre shfrytëzimeve. Shfrytëzimet e lejuara janë e drejtë e cila mund të zhvillohet nga pronarët e tokave derisa i plotësojnë dhe kushtet zhvillimore dhe ndërtimore për zonën ku gjendet prona.

Disa lloje të shfrytëzimeve mund të lejohen në shumicën e zonave. Shfrytëzime tjera, si për shembull industri e rëndë, mund të mos lejohet në shumicën e zonave, bile dhe zonat përreth industrive të rënda mund të përdoren si tampon zona me qëllim të zvogëlimit të ndikimit negativ në zonat përreth. Megjithatë, mund të ketë më shumë se një shfrytëzim/ndërtim të lejuar në zonë/parcelë përveç shfrytëzimit dominues.

Për shembull, shfrytëzime të lejuara të tokës janë:

- Zonë Banimi (ZB),
- Zonë Komerciale (ZK),
- Zonë Industriale (ZI),
- Zonë Teknologjike (ZT),
- Zonë Bujqësore (Zb),
- Zonë për shfrytëzim të përzier (ZShP),
- Zonë e mbrojtur (Zm),
- Sipërfaqe e Mbrojtur (SM),
- Zonë e Veçantë e Mbrojtur (ZVM), dhe
- Zonë e Veçantë (ZV).

Në kuadër të NTPH janë krijuar edhe disa kategori tjera të zonave, siç janë:

- Zonë ushtarake - Sigurisë (ZuS),
- Zonë rekreative -Turistike (ZrT),
- Zonë e Komunikacionit - Transportit (ZKT),
- Zonë e Shërbimeve (ZSh),
- Zonë Pyjore (ZP) dhe
- Zonë - minierë Sipërfaqësore (ZmS).

Këto zona të dhëna shtesë në kuadër të NTPH do të gjejnë më shumë përdorim në Hartën Zonale të Kosovës, gjegjësisht në dokumentet e planifikimit hapësinor të nivelit qendror.

3.3.2. SHFRYTËZIMET E LEJUARA DYTËSORE

Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksione dhe aktivitete që janë dytësore dhe/ apo vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë dhe mund të gjenden në të njëjtën parcelë në të cilën zhvillohet shfrytëzimi i lejuar parësor. Një shfrytëzim dytësor mund të kufizohet të zhvillohet në kuadër të së njëjtës parcelë me shfrytëzimin kryesor. Zakonisht, shfrytëzimi dytësor ndalohet të zhvillohet pa prezencën apo zhvillimin e shfrytëzimit kryesor ndaj të cilit është vartës apo i shërben. Edhe shfrytëzimet e lejuara dytësore, ashtu si shfrytëzimet e lejuara kryesore, mund të jenë subjekt i kufizimeve në zonë lidhur me madhësinë, formën dhe vendndodhjen. Një shfrytëzim dytësor mund të rezultojë me një ndërtim dytësor si në vijim :

- Infrastrukturë e transportit rrugor, Infrastrukturë e transportit hekurudhor, Formë tjetër e infrastrukturës së transportit
- Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza,
- Infrastrukturës publike dhe sociale.

Shfrytëzimet dytësore në kuadër të zonave mund të jenë verandat, garazhet, pishinat për shfrytëzim privat, ndërtime të pa banueshme më të vogla se 25 m^2, ose të ngjashme. Kurse, shfrytëzim dytësor në kuadër të një zone komerciale mund të jetë një kopsht për fëmijë, ose kënd i lojërave për fëmijë. Gjeni më poshtë shembuj të shfrytëzimeve të lejuara dytësore:

- Një garazhë si funksion dytësor i shërben vetëm ndërtesës kryesore - shtëpisë dhe si funksion varet nga shfrytëzimi/ndërtesa kryesore si nga aspekti i formës/madhësisë, prandaj është shfrytëzim dytësor vartës; kurse
- Një çerdhe si pjesë e një parcele / ndërtesë zyrash si funksion dytësor i shërben jo vetëm ndërtesës / parcelës ku gjendet, dhe mund ti shërbejë dhe ndërtesave përreth dhe më gjerë, por nuk varet nga shfrytëzimi kryesor në këtë rast zyrat, si nga aspekti i funksionit / formës / madhësisë, prandaj është shfrytëzim dytësor.

Praktikë e zakontë në kuadër të hartave zonale është të përcaktohen shfrytëzime dytësore që vlejnë për të gjitha zonat apo për të gjitha zonat urbane apo rurale. Raste tjera përcaktojnë shfrytëzime dytësore për të gjitha zonat banimore, komerciale apo industriale. Shembuj që mund të përdoret për përshkrim dhe përcaktim të shfrytëzimeve të lejuara dytësore:

- Lejohen shërbimet rekreative që i shërbejnë dhe janë pjesë e integruar në kuadër të blloqeve banimore. Si shërbim rekreativ mund të jenë por nuk kufizohen në hapësirat e hapura, hapësirat dhe lodrat për fëmijë, terrenet sportive e të gjitha madhësive dhe parkingjet e hapura në shërbim të bllokut në kuadër të blloqeve banimore.
- Lejohen shfrytëzime dhe objekte ndërtimore si:
    1. Pishina dhe të ngjashme;
    2. Fusha për tenis , basket, dhe fusha tjera sportive të ngjashme;
    3. Ndërtesa ose struktura që shërbejnë zyrat e menaxhimit ose mirëmbajtjes, ose pajisje të mirëmbajtje ose pajisje të tjera dhe furnizime që lidhen me hapësirën e hapur ose shfrytëzimin rekreativ;
    4. Lodra për fëmijë apo mbuloja për piknik;
    5. Fontana dhe art publik.

3.3.3. SHFRYTËZIME TË LEJUARA TË VEÇANTA

Shfrytëzime të lejuara të veçanta janë shfrytëzime të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në zonë dhe lejohen me kusht që aplikuesi të përmbushë disa kushte plotësuese të përcaktuara në HZK. Shfrytëzimet e lejuara të veçanta janë të nevojshme, por mund të paraqesin shqetësime ose rreziqe të cilat duhet të parandalohen, prandaj edhe i nënshtrohen kushteve plotësuese. Është e rëndësishme të theksohet se shfrytëzimet e lejuara të veçanta duhet të lejohen nëse aplikuesi mund të dëshmojë se propozimi i zhvillimit i plotëson të gjitha kushtet e HZK dhe kushtet plotësuese të shfrytëzimit të veçantë dhe se është në pajtueshmëri të plotë (nuk kanë ndikim negativ në mjedis dhe nuk pengojnë zhvillimin normal të shfrytëzimeve bazë) dhe që do të lejohen me dhënien e lejes së veçantë për shfrytëzim.

Leja e veçantë për shfrytëzim jepet, pasi të plotësohen kushtet plotësuese të përcaktuara në mënyrë specifike në shërbim të shfrytëzimit të veçantë dhe mbrojtjes së mjedisit rrethues nga ndikimet negative të shfrytëzimit të veçantë. Nëse shfrytëzimi i lejuar i veçantë përfshin punë ndërtimore, atëherë kërkohet edhe leje ndërtimore. Kushtet plotësuese trajtojnë vendndodhjen, shiritat mbrojtës nga llojet specifike të shfrytëzimeve, sipërfaqe minimale ose maksimale të parcelave, rregullin e rrafshit 45°, sipërfaqe minimale gjelbëruese, numër i caktuar i parkingjeve shtesë, dhe të tjera. Rezultati i kushteve plotësuese është se ndërsa një shfrytëzim lejohet në zonë, kushtet plotësuese kontrollojnë që shfrytëzimi i veçantë mos funksionojë ose ndërtohet në çdo pronë brenda zonës. Kjo qasje është e orientuar drejt performancës sepse ndikon direkt në zhvillim dhe arritjes së standardeve.

Për shembull, le të imagjinojmë një zonë banimi ka një restorant të mirë. Banorët e zonës e pëlqejnë restorantin. Megjithatë, gjatë natës, restoranti shndërrohet në një diskotekë. Muzika është me zë të lartë deri natë vonë, duke i mbajtur njerëzit të zgjuar që jetojnë në apartamente mbi disko dhe duke krijuar trafik të zhurmshëm nga klientët e diskotekës. Komuna mund të reagojë: "Restoranti është në rregull. Ashtu që, ky është një shfrytëzim i lejuar në zonë. Megjithatë, diskotekat duhet t'i ndjekë këto kushte plotësuese: të ndalet muzika me zë të lartë pas një kohë të caktuar në mbrëmje, dritaret dhe dyert e mbyllura në mbrëmje, duhet siguruar izolim nga zhurma në dyshemetë lart dhe mureve që prekin hapësirat e banimit dhe duhet të sigurojnë parkim shtesë në mbrëmje."

Shumë prej masave mbrojtëse ndaj ndriçimit, zhurmës, dridhjeve, mbrojtja e mjedisit, shiritat mbrojtës dhe standarde të peizazhit aplikohen si kushte zhvillimore të përgjithshme. Në raste të tjera, masat mbrojtëse të diskutuara më lart përdoren për t'u kontrolluar shfrytëzime veçanërisht shqetësuese, që mund të shkaktojnë shqetësime për pronarët përreth.

Rrjedhimisht, lista e shfrytëzimeve të lejuara të veçanta duhet të përmbajë vetëm ato shfrytëzime që komuna është e sigurt që duhet të lejohen nëse përmbushen kushtet plotësuese dhe standardet e duhura. Në rastet ideale, lejohet një numër më i madh i shfrytëzimeve të lejuara, dhe shumë pak shfrytëzime të veçanta. Në këtë mënyrë, komunat mund të arrijnë të lejojnë fleksibilitet maksimal për zhvillim për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut.

3.3.4. SHFRYTËZIMET E LEJUARA TË PËRKOHSHME

Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme janë funksione dhe aktivitete që janë të lejuara për shfrytëzimin e një ndërtese apo parcele për një periudhë të përkohshme kohore për diçka të ndryshme nga shfrytëzimet e lejuara. Pas periudhës specifike kohore shfrytëzimet e tilla duhet që plotësisht të tërhiqen nga ndërtesa apo parcela.

Shfrytëzime të përkohshme mund të përfshihen edhe instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, si objekte të përkohshme ndërtimore në vend ndërtim, tenda, konstruksion festivalesh dhe koncertesh, pika shitjeje dhe kioske. Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme mund të përdoret nga komunat si më poshtë:

- Shfrytëzime të lejuara me afat kohor të përcaktuar në çertifikatën e përdorimit, por jo më shumë se dy vjet.
- Nuk do të rezultojnë në ngritje të objekteve ndërtimore të përhershme, edhe pse objektet ndërtimore dhe ndërtimet ekzistuese mund të përdoren për shfrytëzime të përkohshme.

Nëse objektet e përkohshme ndërtimore nuk largohen brenda periudhës kohore të përcaktuar në lejen ndërtimore dhe/apo në çertifikatën e përdorimit, inspektori i ndërtimit ka për detyrë dhe autorizim që të "urdhërojë poseduesin e lejës ndërtimore të rrënojë objektet ndërtimore të përkohshme që nuk janë rrënuar brenda afatit të përcaktuar", apo të "marrë masa për rrënim të këtyre objekteve ndërtimore të përkohshme, nga ana e komunës" pa kompensim dhe shpenzime të mbuluara nga vetë investitori.

3.3.5. SHFRYTËZIMET E NDALUARA

Shfrytëzime që nuk janë të lejuara në një zonë nën asnjë rrethanë apo kusht, përcaktohen si shfrytëzime të ndaluara. Mirëpo, një listë specifike me shfrytëzime të ndaluara është e rrallë. Harta zonale thjesht do të përcaktojnë që çdo shfrytëzim që nuk është i listuar si i lejuar, dytësor, përkohshëm apo i lejuar i veçantë, konsiderohet si i ndaluar. Shfrytëzimet e ndaluara janë ato shfrytëzime të cilat është e nevojshme të specifikohen si të palejuara, me qëllim të sigurimit që zhvillimet apo funksionet e tilla të mos kenë efekte negative mbi zhvillimet përreth në zonë. Efektet negative mund të jenë si ndotje mjedisore apo zhurmë, dhe që paraqesin rrezik për jetesën dhe mirëqenien e pronave përreth. Për shembull, shfrytëzim i ndaluar në një zonë me shfrytëzim dominues banim, mund të jetë industria e rëndë. Shfrytëzimet e ndaluara në zonë përcaktojnë funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe janë të deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara.

Kriteret për përcaktimin e zhvillimeve të ndaluara në një zonë, por pa u kufizuar vetëm në to, janë:

- Kategoritë e shfrytëzimit të tokës që bien në kundërshtim me qëllimet e zonimit sipas përcaktimeve të HZK- së zhvillimi dhe instrumenteve të planifikimit në fuqi;
- Kur një zhvillim kërkohet të realizohet në një zonë që i përket një kategorie bazë të ndryshme nga ajo e zhvillimit të kërkuar, për sa kohë që nuk parashikohet ndryshe dhe në mënyrë të argumentuar në instrumentin e planifikimit në fuqi;
- Çdo përdorim që pavarësisht nga kategoria bazë të cilës i përket, krijon ndotje në mjedis përtej parametrave dhe standardeve të parashikuara në legjislacionin e posaçëm mjedisor, dëmton shëndetin, dëmton strukturat dhe monumentet e trashëgimisë kulturore;
- Çdo zhvillim në tokë bujqësore që edhe pse mund të jetë brenda kategorisë bazë të shfrytëzimit të tokës dhe strukturave në të, nuk respekton rregullat, standardet dhe treguesit e planifikimit dhe të zhvillimit sipas përcaktimeve të HZK-së zhvillimi dhe të instrumenteve të planifikimit në fuqi;
- Përdorime të ndaluara janë ato që përcaktohen për çdo njësi strukturore / zonë më prioritet zhvillimi në HZK. Si rregull i përgjithshëm, përveç sa përcaktohet ndryshe në këtë HZK.
- Përdorimet e ndaluara përmbushin përcaktimet e HZK-së.
- Përdorime të ndaluara për zonat e banimit janë: industritë e rënda, kimikë dhe të tjera ndotëse më ndikim të lartë në mjedis, ndërtimet ushtarake, varrezat, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura; zonat ku bëhet kompostimi i mbetjeve organike.
- Aktivitetet në zonën e banimit në zonat rurale, përpos rritjes së -
- bletëve, mbajtja e bagëtive dhe gjedhëve si ekonomi familjare në kapacitete të vogla janë të ndaluara stallat me mbi 25gjedhe, 50 krerë dele, dhi apo derra, 1,000 shpezë, kurse në zonën urbane ndalohen gjitha këto aktivitete të sipërpërmendura. Në zonën urbane lejohen vetëm aktivitete të kultivimit dhe hortikulturës në oborret dhe kopshtet individualë të ndërtesave, në kuadër të bujqësisë urbane.
- Nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e banimit, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore.
- Përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosën në brigjet ujore, në zonat të mbrojtura natyrorë pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për monumentet e kulturës, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave / objekteve.

- Përdorimet e ndaluara në territoret e zonave të mbrojtura natyrore dhe në zonat e tyre buferike, si dhe në zonat që mbrohen nga legjislacioni për trashëgiminë kulturore, përfshirë brezat mbrojtës / zonat buferike të këtyre zonave / objekteve, përcaktohen në legjislacionin në fuqi.
- Të gjitha funksionet janë të ndaluara në hapësirën e përcaktuar si brez mbrojtës, apo tampon/buferik për infrastrukturën rrugore dhe kanalet e kullimit dhe ujitjes të tokave bujqësore nga legjislacioni në fuqi.

3.4. QASJA NË PARCELËN KADASTRALE

Është synim të sigurohet qasje në të gjitha parcelat kadastrale, dhe në këtë formë në të gjitha zonat, pra në tërë territorin e komunës së Vitisë. Qasja do të sigurohet përmes:

- Rrugëve të niveleve dhe kategorive të ndryshme, e sidomos me anë të rrugëve lokale ku komuna është kompetente, por edhe me rrugë bujqësore dhe rrugë pyjore.
- Servitute publike dhe të gjitha servituteve të tjera sipas Kapitullit 1, neni 3 I UA 08/2017.

Një servitut është një e drejtë e garantuar për të shfrytëzuar pasurinë e paluajtshme te një pronari tjetri ose për të kufizuar shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme, pa e poseduar atë. Një servitut publik jep një servitutit për shfrytëzim publik ose për interes të përgjithshëm.
Do të përkrahen zhvillimet e reja që nuk cenojnë të drejtën apo nuk pamundësojnë qasjen me mjete transporti apo në këmbë të pronarit apo shfrytëzuesi i parcelës kadastrale fqinje në rrugë publike. Në rast se për parcelat fqinje nuk ekziston ndonjë alternativë e qasjes në rrugë publike, atëherë pronarët e tokave dhe investitorët duhet të përcaktojnë një shteg përbrenda parcelës kadastrale që do të shërbejë si servitut i qasjes në parcelat fqinje për pronarët apo shfrytëzuesit e tyre.

Pronari i tokës apo investitori që dëshiron të ushtrojë një zhvillim të ri duhet të dëshmojë që zhvillimi i propozuar nuk cenon qasjen e papenguar të për pronarët apo shfrytëzuesit e parcelave kadastrale fqinje. Në rast se zhvillimi i ri propozohet për parcelë kadastrale e cila gjendet në mes të rrugës publike dhe parcelës fqinje nuk ka qasje tjetër në rrugë publike, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të krijojë një shteg me gjerësi prej së paku 3 metra dhe lartësi prej së paku 4 metra përgjatë kufirit të parcelës kadastrale nga rruga publike deri në kufirin e parcelës kadastrale fqinje që nuk ka qasje tjetër në rrugë publike.

Para se të jepet pëlqimi për zbatimin e zhvillimit të ri, pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë marrëveshjen mes pronarit apo shfrytëzuesit të parcelës fqinje të cilit i cenohet e drejta e qasjes në parcelën e tyre kadastrale.

Në rast se pronari i tokës apo investitori që synon të shfrytëzojë parcelën kadastrale për zhvillime të reja nuk ka pas mundësi të gjej shfrytëzuesin apo pronarin e parcelës kadastrale fqinje, atëherë pronari i tokës apo investitori duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar që shtegu i qasjes me gjerësi prej së paku tre metra do të jetë në disponim të pronarit apo shfrytëzuesve të parcelës fqinje.

3.5. QASJA NË INFRASTRUKTURËN TEKNIKE

Qasja në infrastrukturën teknike si pjesë e kushteve zhvillimore të përgjithshme synon të ofrojë qasje për të gjithë akterët qasje sa më të lehtë dhe të lirë bazuar në rregullat dhe standardet e përgjithshme për zhvillim, dhe që nuk kufizohen vetëm në kërkesat dhe rregullat por edhe në masat mbrojtëse dhe modelet më të përshtatshme të projektimit dhe në harmoni me udhëzimet për Infrastrukturë teknike. Bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marrë parasysh gjendjen ekzistuese duhet që me hartë zonale të trajtohet infrastruktura teknike si: kapaciteti dhe shtrirja e rrjeteve , ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për të siguruar qasje për të gjitha zonat, në varësi të specifikave në :

1. Rrjetin e ujësjellësit;
2. Rrjetin e kanalizimit;
3. Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza;
4. Sistemet e drenazhimit;
5. Rrjetin e ujitjes;

6. Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji termike;
7. Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji elektrike;
8. Rrjetin e telekomunikacionit dhe instalimet e ngjashme;
9. Rrjetin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore dhe nëntokësore; dhe ndërtesat dhe hapësirat për riciklim dhe dekompozim.
10. Qasja duhet sigurohet në harmoni me normat e planifikimit hapësinor dhe standardet për infrastrukturë teknike.

3.6. RREGULLA PËR PARKIM DHE SHKARKIM

Qëllimi i këtij kapitulli është që përmes krijimit të rregullave që synojnë zvogëlimin e ngarkesave të automjeteve dhe rreziqeve që kanosen nga trafiku të zhvillohet një mjedis i sigurt dhe adekuat.

Përpos në raste se kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore kanë përcaktuar ndryshe, në kushtet vijuese paraqesin kërkesat minimale për vend-parkingje të cilat duhet të vendosen përbrenda parcelave kadastrale për të cilën kërkohet leja ndërtimore:

Tabela 5 Kërkesat minimale për vend-parkingjet për automjete sipas llojit të ndërtesës

Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes se ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m², por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, se paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjese të pa ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për shfrytëzim publik
	Ndërtesat e banimit të ulët/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m², por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjese të pa ndërtuara, domosdoshmërish të planifikohet edhe 1 VP/ 1 ndërtese të banimit të ulet.
	Ndërtesat e banimit të ulet- vilat (deri në 4 njësi maksimal)	3 VP/ njësi banimi	-
Hoteleria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 5*	0.75VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP/ 100 m²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesa/ hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m²	-

Biznes dhe publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/ 100 m²	Për sipërfaqe me të vogla se 100m², të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative (publike)	2 VP/ 100 m²	
Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m²	-
Kultura dhe arsimi	Ndërtesat e kopshteve/ çerdheve të fëmijëve	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m²	Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës.
	Ndërtesat e shkollave të mesme	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve	1 VP/ 100 m²	Për sipërfaqet e kompleksëve, nr. i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta, përkatësisht me plane operative.
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat religjioze- xhamitë, kishat, etj	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat/ sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP/ 100 m²	Numri i VP duhet të jetë jo me i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmije)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.

	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
Terminalet e udhëtareve	Ndërtesat e terminaleve të autobusëve	-	Për ndërtesat e terminaleve duhet të hartohet projekti i teknik i trafikut, me kalkulimin e numrit të VP, në veçanti për: Vendqëndrimet (ngarkim/shkarkim); parkim afat-shkurtë; parkim afatgjatë.
	Ndërtesat e terminaleve të trenit	-	
	Ndërtesat e terminaleve të aeroporteve	-	

Të gjitha hapësirat e dedikuara për vend parkingje duhet të jenë shënjuara me vijat ndarëse në projektin e propozuar dhe në sipërfaqet e ndërtuara.

Duke u bazuar në konfiguracionit të rrafshët të terrenit që shtrihet në territorin e Komunës dhe vonesat që udhëtimi me automjet shkakton për shkak të ngarkesave të mëdha të trafikut, në të ardhmen pritet një rritje në numër të udhëtimeve në Komunë me biçikleta.

Në mënyrë që të mbrohet mjedisi dhe shëndeti i banorëve të Komunës, Harta Zonale Komunale ka përcaktuar edhe numrin minimal të vend-parkimeve sipas llojit të ndërtesës të cilat duhet të përmbushen gjatë projektimit dhe ndërtimit të tyre si vijon:

Tabela 6 Kërkesat minimale për vend parkingjet për biçikleta sipas llojit të ndërtesës

Lloji i ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta(VPB)
Banim me shumë njësi	1VPB/100m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5VPB/100m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar(BSN)për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1VPB/100m²të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1VPB/5 nxënës, për vizitor + 1VPB/10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore-teatro dhe muze	20VPB/100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore-spitale	10VPB/100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	20VPB/100 ulëse, për vizitor

3.7. RREGULLAT PËR ZHVILLIM TË PEIZAZHIT DHE SHIRITAVE TË GJELBËR MBROJTËS

Qëllimi i këtyre rregullave është përcaktimi i kushteve të cilat do të përmirësojnë mjedisin dhe shëndetin e banorëve të Komunës. Varësisht nga kategoria e rrugëve publike, Harta Zonale e Komunës ka përcaktuar gjerësitë minimale të brezave të gjelbër të cilat zhvillimet e reja duhet të respektojnë dhe përmbushin:

Tabela 7 Gjerësia e brezave të gjelbërt sipas kategorive të rrugëve publike

Kategoria e rrugës publike	Vendbanime Urbane
Rrugë nacionale	35m
Rrugë regjionale	22m
Rruge urbanë	10m
Rrugë në vendbanime	8m

Të gjitha ndërtimet e ardhme duhet të respektojnë distancat minimale të parashtruara sipër dhe këto kritere janë të detyrueshme përgjatë të gjithë rrugëve publike, ku nuk është planifikuar zhvillimi i ndërtimeve me PZhK. Në sipërfaqet ku është paraparë zhvillimi i ndërtimeve, kushtet ndërtimore përcaktojnë brezin e gjelbër rrugor. Peizazhi nënkupton çdo kombinim të vegjetacionit

të gjallë, si bar, bimë, shkurre ose drunjtë, dhe mund të përfshijë edhe objekte ndërtimore në shërbim të peizazhit siç janë shëtitoret, gardhet, bankat, sheshet publike, artet publike, fontanat dhe të ngjashmet. Rrugët publike ose hapësirat për ngarkim, parkim ose ruajtje të automjeteve ose materialeve nuk janë sipërfaqet të trajtohen nga këto rregullat vijuese:

Çdo pjesë e një parcele me shfrytëzim të përzier, komerciale, industriale, teknologjike, shërbimeve publike ose banim që nuk përdoret për ndërtim, rrugë publike, ngarkim dhe parkim dhe hapësira të caktuara të magazinimit do të zhvillohet me peizazhe që do të mirëmbahen.

Për çdo dhjetë (10) hapësira të reja parkimi në kuadër të vend parkimeve jashtë rrugore, nevojitet të paktën mbjellja e një (1) druri gjetherënës. Nëse një vend parkim jashtë-rrugor do të përfshijë 20 ose më shumë hapësira të reja parkimi, hapësira me peizazh të rregulluar do të sigurohen brenda hapësirës së parkimit. Përndryshe, në rastet kur një parcelë do të përfshijë më pak se 20 hapësira të reja parkimi, drunjtë mund të mbillen përreth hapësirës së parkimit. Peizazhi i rregulluar do të mbrohet me anësore, ose pajisje të tjera për mbrojtje nga dëmtimi i automjeteve.

Si pjesë e ndërtimit të çfarëdo rruge të re ose ndërtese të re duhet të kërkohet që të mbillen drunjtë përgjatë rrugëve. Një mesatare prej një dru për çdo 20m^2 do të mbillen përgjatë gjatësisë së rrugës. Drunjtë e rrugëve mund të mos mbillen në intervale të caktuara, por mund të lëvizin për t'u përshtatur me infrastrukturën teknike, infrastrukturën publike, infrastrukturën sociale, rrugët publike dhe karakteristika të tjera. Lokacionet për mbjelljen e drurëve mund të jenë ose të mos jenë ndërmjet vijës së rregulluese dhe skajit së rrugës, në varësi të rrethanave të vendit. Nëse drunjtë nuk janë të vendosur ndërmjet të vijës rregulluese dhe skajit së rrugës, ato vendosen brenda parcelës menjëherë pranë vijës rregulluese, apo përgjatë vijës aksiale qarkulluese të rrugëve publike. Drunjtë të ri rrugor nuk do të kërkohen aty ku ka drunjtë ekzistues përgjatë rrugëve publike janë të shëndetshëm. Drunjtë e tillë do të ruhen dhe do të shërbejnë për të njëjtin qëllim.

Të gjitha rregullimet e nevojshme të peizazhit mirëmbahen vazhdimisht nga pronari i pronës dhe mbahen të pastra nga mbeturinat. Çdo peizazh i kërkuar që vdes, hiqet ose dëmtohet rëndë, duhet të zëvendësohet nga pronari aktual i pronës sa më shpejt që është praktike duke pasur parasysh sezonet e rritjes, brenda një maksimumi prej 150 ditësh.

3.8. RREGULLIMI I PEIZAZHIT

Rregullimi i peizazhit për hapësira të përbashkëta dhe parcela individuale, bashkë me arkitekturën e ndërtesës, mundet që në një sasi të madhe t'i shtoj vlerat e zonës. Rregullimi i peizazhit plotëson qarkullimin e këmbësorëve dhe automjeteve dhe duhet të jetë i vendosur në atë mënyrë që të përforcojë karakteristikat funksionale dhe vizuale të rrugës. Karakteristikat fizike të lokacionit si destinimi i tokës, kushtet klimatike, karakteristikat topografike, vegjetacioni ekzistues, menaxhimi i ujërave atmosferik, etj., janë të rëndësisë së veçantë në zhvillimin e planit të gjelbërimit.

Në Komunën e Vitisë janë paraparë disa sheshe të reja, korridore gjelbërimi përgjatë rrugëve si breza mbrojtës rrugor. Brenda ngastrave individuale detyrimisht duhet të parashihen sipërfaqe të lira/të pa ndërtuara si hapësira gjelbërimi, për lojëra të fëmijëve, pllakosje, etj. Këto sipërfaqe të lira brenda ngastrave private kushtimisht do të balancojnë raportin me sipërfaqen e ndërtuar. Klasifikimi i sipërfaqeve të lira /të pa ndërtuara janë të ndara në:

1. Shesh
2. Park/hapësirë e gjelbër
3. Sport dhe rekreacion
4. Shirit gjelbërimi
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës
6. Elementet mikro-urbane
7. Ndriçimi

- **SHESHET**

Sheshet janë hapësira të lira publike të dedikuara kryesisht për lëvizjen dhe grumbullim e qytetarëve. Sheshet karakterizohen edhe nga kufizimi i tyre me funksione aktive. Sheshe tjera publike janë propozuar brenda oborreve të brendshme të ndërtesave ekzistuese shumë banesore dhe se lidhja e tyre me rrugët kryesore duhet të jetë e qartë me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë të këtyre hapësirave. Për të krijuar hapësirë sa më të madhe të lirë është propozuar që nën këto sheshe të ndodhen parkingje publike.

- **HAPËSIRAT E GJELBËRTA**

Hapësirat e gjelbërta apo parqet e pushimit janë elemente shumë me rëndësi. Në këtë zonat e komunës së Vitisë sidomos në zonën urbane ekzistojnë këto hapësira, mirëpo ato mund të organizohen në brendi të blloqeve më të mëdha urbanistike ku mund të ketë përmbajte të lojës për fëmijë, shtigje të këmbësorëve, hapësira për rekreacion duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve. Nëse ekziston kërkesa dhe hapësira po ashtu në këto hapësira të hapura mund të parashihen përmbajtje të përkohshme hoteliere.

Shiritat e gjelbërimit janë hapësira të gjelbërimit të lartë të parapara si barrierë mbrojtëse ndaj zonave të caktuara dhe rrugëve. Shiritat e gjelbërimit përgjatë rrugëve përmbledhëse dhe lokale janë planifikuar në të dy anët e rrugëve dhe janë shirita ndarëse në mes të rrugës dhe shtigjeve për këmbësorë. Përveç mbrojtjes nga zhurma dhe ndotja ato në të njëjtën kohë përmirësojnë pamjen vizuale të rrugës dhe hapësirës përreth. Sipërfaqet e gjelbra në profilet e rrugës duhet të jetë rezistuese ndaj nivelit të lartë të ndotjes.

Duhet kontrolluar lartësinë dhe kurorën e tyre në mënyrë që të mos pengohet trafiku.

Drunjtë e rrugëve duhet:

- Të sigurojnë definimin e profilit;
- Të jenë rezistues ndaj ndotjes dhe pluhurit (me gjethe të mëdha, kurorë të madhe); si dhe
- Të mos jenë gjetherënëse, nuk lëshojnë fruta ose rënie të degëve të mos pengojnë shikueshmërinë.

Gjelbërimi - në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secili zhvillues i ngastrës. Nëse raporti i sipërfaqes së ndërtuar dhe të pa ndërtuar është i ndryshueshëm dhe ajo përcaktohet varësisht prej etazhitetit. Hapësira e gjelbër duhet të përfshijë min. 20% të sipërfaqes së përgjithshme, ose 40% të sipërfaqes së pa ndërtuar. Gjelbërimi i lartë në kuadër të ngastrës duhet të vendoset në mënyrë proporcionale përgjatë qarkullimit të trafikut, oborrit, në hapësirat e parkingjeve dhe në qasjet e parcelës. Pasi që këto hapësira nuk janë publike ato mund të organizohen në kuadër të ngastrave individuale varësisht prej kërkesës së investitorit por nuk duhet të kenë karakter komercial dhe të përfshijnë një hapësirë më të madhe se 20% të sipërfaqes së lirë. Raporti i hapësirave të pllakëzuara dhe atyre të gjelbra duhet minimum të jetë 80%: 20% në të mirë të sipërfaqeve të gjelbëruara në të cilën duhet të jenë rekuizitat për rekreacion. Kjo sipërfaqe duhet të jetë e mbrojtur me shirit për gjelbërim të lartë (për mbrojtje nga zhurma dhe ndotja). Në pjesën grafike të HZK-së së Vitisë nuk janë paraqitur hapësirat e tilla. Kushtet e rregullimit të sipërfaqeve të lira janë :

- Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve;
- Përqindja e sipërfaqeve të gjelbra në ngastër;
- Zonat e përcaktuara për sipërfaqe të lira(vija rregulluese, vija ndërtimore, tampon gjelbërimi, pjesa e pasme, etj.)
- Llojet specifike të bimëve;
- Madhësia minimale e bimëve dhe diametri i drunjëve ;
- Sistemi i ujitjes;
- Forma e hapësirës së parkimit;
- Standarde te nivelimit së paku një dru me kurorë të gjerë duhet të mbillet për 500 m 2 të sipërfaqes së pa ndërtuar të zonave të ndërtimit. Sugjerohet mbjellja e bimëve autoktone, që i përshtaten klimës dhe vendit.

Trupat ekzistues të drunjtëve të ruhen.

- Nëse një numër i caktuar duhet të prehen për shkak të ndërtimit, atëherë ato duhet të zëvendësohen me drunj të rinj të mbjellë në pjesën e lirë të parcelës. Gjatë ndërtimit të sipërfaqeve të gjelbra duhet pas parasysh largësinë e nevojshme nga instalimet nëntokësore.
- Këto janë raporte që duhet respektuar. Në rast të mbjellës së drunjtëve me rrënjë shumë të zhvilluara, largësia duhet të jetë më e madhe, ose më e vogël në rastin e kundërt.

Sipërfaqja gjelbëruese e absorbuese e parcelës (SGJAP):

Paraqet raportin mes sipërfaqes gjelbëruese dhe absorbuese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim shumëzuar me 100. Kjo përqindje mund të jepet si vlerë e vetme e përqindjes së SGJAP apo si shumë e kalkuluar nga shuma e përqindjes së sipërfaqes gjelbëruese të parcelës (SGJP) dhe përqindjes së sipërfaqes absorbuese të parcelës (SAP).

Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP):

Paraqet raportin mes sipërfaqes gjelbëruese dhe sipërfaqes së parcelës kadastrale për zhvillim, shumëzuar me 100.

Sipërfaqja gjelbëruese e parcelës (SGJP) e lejuar me dokument të planifikimit hapësinor mund të arrihet përmes kombinimit të sipërfaqes private, të përbashkët, gjysmë-pub like dhe/ose sipërfaqes së hapur publike të ofruar në parcelë apo bllok.

Sipërfaqja e përdorshme e gjelbër mund të mos jetë e vendosur në tokë, por mund të shtrihen edhe në mënyrë vertikale përbrenda parcelës kadastrale. Kopshtet dhe peizazhet mbi kulm, duke përfshirë kulmet mbi strukturat e parkimit, mund të përdoren për të përmbushur kërkesat për sipërfaqe të hapura. Kërkesa për sipërfaqe të hapura gjelbëruese nuk përmbushet përmes sipërfaqeve përdhes të parkimit, rrugëve për automjete ose sipërfaqeve shërbyese.

Mundësia e kombinimit, si në aspektin e shtrirjes vertikale të hapësirave të gjelbra, si dhe shtrirjen horizontale të hapësirave të gjelbra i specifikohet në dokumentet e planifikimit hapësinor.

- **SPORT DHE REKREACION**

Sporti dhe rekreacioni hyn në sipërfaqet e dedikuara për sport dhe rekreacion në kuadër të hapësirave të lira. Hapësirat për sport dhe rekreacion si lojëra për fëmijë, fusha për sport të përshtatshme për lokacionin duhet të parashihen edhe brenda blloqeve të banimit varësisht prej kërkesës së banorëve.

- **GJELBËRIMI I PËRGJITHSHËM PUBLIK**

Gjelbërimi i rrugëve, rrugicave dhe shëtitoreve - Shtigjet e shtruara me materiale të forta për automjete dhe këmbësorë, shoqërohen nga një rresht i vetëm ose disa rreshta me drunj apo shkurre, që mund të mbillen drejtpërdrejtë në tokë, mbajtëse ose përgjatë në rripi toke të pashtruar.

Gjatë projektimit të merren në konsideratë:

- Aspektet funksionale të planit të rrugës: drejtimet, lloji dhe intensiteti i lëvizjes
- Pozicioni dhe kërkesat e instalimeve nën dhe mbitokësore (sidomos tubacionet dhe kabllot)
- Drurët për gjelbërimin e rrugëve dhe bulevardeve duhet të mbillen në shiritat e gjelbëruar, ose kur nuk ka të tillë, në trotuar, jo më pak se 0.70 m nga buza e rrugës
- Drurët të kenë formë të mirë, strukturë degësh të përshtatshme për ngritjen e mëvonshme të kurorës
- Trungu 2-3 m mbi sipërfaqen e tokës, degët tjera të arrijnë deri në 4.5m (drunj të tillë mbillen si drunj të vetmuar, dhe janë të përshtatshëm për parqe, hapësira publike, zona me lëvizshmëri të mjeteve të rënda, etj).

- **HAPËSIRAT LËNDINË ME BAR**

1. Zonat me bar mbillen me specie të përshtatura mirë për kushtet lokale të rritjes dhe qëllimet e dizajnit. Ato mund të pastrohen, të mbyllen, të mbulohen, të përdoren mulçe organike ose të mbjellen me farë, përveç zonave të ekspozuara nga erozioni përdoren shtresat e biodegradueshme.

- **PEMËT/DRUNJTË**
    1. Madhësia e pemëve:
       Të gjitha pemët, përveç pemëve të rrugës, duhet të jenë të paktën 3m të larta dhe të kenë një kaliper minimal prej 5cm në kohën e mbjelljes, përveç se 30% e kërkesës për pemë mund të plotësohet nga speciet vendase me një lartësi minimale prej 2.5m dhe një kaliper minimal prej 3.5cm në kohën e mbjelljes.
    2. Madhësia e pemëve në rrugë dhe nevoja për hapësirë:
- **PËRZGJEDHJA E DRUNJËVE PËR MBJELLJE VARET SHUMË NGA AJO SE ÇFARË OFROHET NË TREGUN LOKAL DHE TË IMPORTUAR NË KOSOVË**

Pemët e rrugës:

Duhet të jenë specie që rriten në kushtet e zonës të cilat normalisht në pjekuri arrijnë lartësinë prej të paktën 6 metra. Pemët e rrugëve duhet të kenë një trung të pastër prej 1.2m në kohën e mbjelljes, dhe duhet të sigurohen përgjatë të gjitha rrugëve në një distancë 5-8-12 metra, varësisht species, formës dhe qëllimit të përdorimit.

Drunjtë mbjellen në largësi të tillë që të sigurojnë rritjen e plotë dhe të lirë të kurorës.

Kjo vlen edhe për drunjtë në parqe/hapësira të gjelbra dhe për drunjtë në rrugë.

Llojet e drunjve për mbjellje në rrugë:

Mështekna (Betula pendula), Panja e Heldraikut (Acer heldreichii), Shkoza (Carpinus betulus), Frashëri i bardhë (Fraxinus ornus), Bliri (Tilia), Panja gjethehirtë (Acer negundo), Rrapi gjethepanje (Platanus x acerifolia) etj.

Speciet me kurorë piramidale vendosen më dendur (2-4 m), ndërsa ato me **kurorë të plotë dhe gjethe të mëdha** mbillen në distancë 10-12 m respektivisht.

1. Gropat e mbjelljes:
   Gropat e pemëve të jenë sa më të mëdha për të lejuar hapësirë të mjaftueshme për rritjen e rrënjëve dhe kurorën e pemës, me madhësi optimale 1.5 m. Gjerësia e trotuarit mund të kufizojë madhësinë e gropës.
   Në raste kur kemi të bëjmë me hapësirë parku, inkurajohen gropa të vazhdueshme pemësh kur është e mundur, dhe sidomos kur përfshihen bimë grupore.
2. Bimët grupore:
   Mbjellja e bimëve në grup preferohet për shkak të përfitimeve të pemëve kur gjenden në afërsi, duke përfshirë maksimizimin e hijes, më pak ngjeshje të tokës, më pak nxehtësi të thithur nga një pemë e vetme, etj.

Bimët e gropuara mund të mbjellen në disa lloje sipërfaqesh:

- Trekëndësh në rrugë, rreth-rrotullim, me mundësi për të krijuar një shtrat mbjelljeje
- Një shtrat/strukturë e mbjellur brenda një sheshi apo përgjatë një kalimi për këmbësorë

3.9. BREZI I GJELBËR

Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ka për qëllim :

- Izolimin e këmbësorëve, çiklisteve dhe ndërtesave nga trafiku i veturave/zhurma;
- Krijimin e kushteve të përshtatshme higjienike dhe mikro-klimatike;
- Përmirësimin e cilësisë estetik të peizazhit.

Brezi i gjelbër përgjatë rrugëve dhe shtigjeve ndahet në:

Brez të gjelbër përgjatë sistemeve kombëtare të infrastrukturës rrugore, si pjesë e sistemeve lokale të infrastrukturës rrugore:

- Rrjeti i rrugëve nacionale: ≥35m;
- Rrjeti i rrugëve rajonale: ≥22m.

Brezi gjelbër përgjatë sistemit lokal të infrastrukturës rrugore:

- Rrjeti primar: ≥ 10 m;
- Rrjeti sekondar: ≥8.00 m;
- Brez i gjelbër, përgjatë shtigjeve: ≥3.00m;
- Brez i gjelbër, përgjatë vend-parkimeve: ≥2.50-4.50m.



Figura 2 Brezi i gjelbër

- **Standardet dhe llojet e bimëve të cilat mund të përdoren**

Gardhet:

Gardhet dhe muret nuk duhet të ndërtohen ose të përmbajnë asnjë material që mund të shkaktojë dëme fizike, të tilla si tela elektrike ose me gjemba, xhamat e thyer, thumba ose ndonjë material tjetër të rrezikshëm, përveç si më poshtë:

Klasifikimi sipas lartësisë:

- Gardhe me bimë xhuxhe: deri 0.5 m; p.sh. Bushi (Buxus)
- Gardhe të ulët, me lartësi 0.5–1 m, për ndarjen e zonave të ndryshme, me shkurre me formë të rregullt; p.sh. Bushi (Buxus sempervirens), Ashja (Ilex aquifolium), Tuja (Thuya), Spirea (Spiraea) etj.
- Gardhe me lartësi mesatare 1-3 m; Forzicija (Forsythia), Mahonia (Mahonia aquifolium), Tuja (Thuya), Juniperus sabina, Trëndafili (Rosa), Spirea (Spiraea), etj.

Shkurret:

Të gjitha shkurret duhet të jenë të paktën 45 cm në lartësi menjëherë pas mbjelljes. Kur përdoren në formë gardhi apo për çështje vizuale, shkurret duhet të mbillen në një distancë maksimale mesatare prej 75 cm në qendër ose nëse mbillen në një lartësi minimale prej 90 cm, preferohet të kenë një hapësirë mesatare prej 1.20 m në qendër, për të formuar gardhin solid brenda një viti pas mbjelljes.

Shkurret ngjithëse për muret mbajtëse, sygjerohet që në çdo 2 m të strukturës mbajtëse të mbillet nga një bimë ngjitëse/kacavjerrëse.

Lloje të shkurreve:

Mëlqinja (Berberis vulgaris), Hibiskusi (Hibiscus syriacus), Tamarix tetrandra, Tasllani (Laurocerasus officinalis), etj.

Lloje të shkurreve ngjitëse: Hardhia kanadeze (Parthenocissus quinquefolia), Urthi (Hedera helix), Euonymus fortunei, Dioscorea balcanica, etj

Hardhitë:

Duhet të jenë të paktën 30 cm të larta menjëherë pas mbjelljes dhe mund të përdoren për ngjitjen në mure apo çfarëdo strukture tjetër, për të përmbushur kërkesat e barrierave fizike siç specifikohet.

3.10. KËRKESAT DHE DIZAJNI I NDRIÇIMIT NATYROR DHE ARTIFICIAL

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese, të cilat:

- Janë ndërtuar sipas kushteve ndërtimore të këtij dokumenti ;dhe
- Posedojnë leje ndërtimore apo certifikatë të shfrytëzimit;

Rregulli i këndit prej 45° kontrollon hijezimin të strukturave dhe pronave fqinje dhe përdoret kryesisht në zonat me dendësi të mesme dhe të lartë, ose ndërmjet dy zonave me intensitet të ndryshëm të zhvillimit. Rregulli kontrollon që asnjë pjesë e vëllimit të zhvillimit të ri të mos e kalojë vijën e tërhequr në këndin prej 45 shkallë vetëm nga qendra e dritares të katit përdheses së një hapësirë e banueshme, më të afërt në pronat fqinje. Rregulli i këndit prej 45° nuk është obligativ për dritare të kthinave sanitare, komunikuese, garazheve, depove dhe hapësirave të tjera të katit përdhes, për të cilat ndriçimi i natyror nuk është obligativ.

- Zhvillimet e reja drejtpërdrejt përballë dritares së prekur si dhe ndërmjet dy parcelave kadastrale fqinje ose dy zhvillimeve ndërmjet rrugëve publike.

Zhvillimet i reja/zonat me intensitet shumë më të lartë është i kthyer direkt kah zhvillimi ekzistues/zona me intensitet më të ultë.

Sigurimi i ndriçimi natyror të mjaftueshëm për dy zhvillime fqinje në terren të pjerrët arrihet kur këndi 45 shkallë tërhiqet prej një lartësie specifike. Distanca ndërmjet ndërtesave varet nga lartësia e specifikuar dhe varësisht prej terrenit të pjerrtë. Kjo lartësi mund të përcaktohet si plus ose minus në numër dhe varet sipas pjerrësisë së terrenit. Ky rregull mund të përdoret ndërmjet dy parcelave kadastrale fqinje ose zhvillimi në të dy anët i kthyer kah rruga publike.

Në llogaritjen e lartësisë së ndërtesës konform këtij rregulli që përcakton pikën më të lartë të kulmit, nuk duhet të përfshihen edhe lartësia e strukturave vijuese të cilat tejkalojnë lartësinë e kulmit:

- Oxhaqeve, boshteve e ventilimit, spiraleve, shtyllave ose direkëve (kur shtyllat dhe direkët janë më pak se 9m mbi nivelin e tokës), me kusht që dimensioni maksimal i tyre paralel me kufirin për secilën nga këto struktura nuk kalon 1 metër dhe me kusht që për ndërtesat mbi tre kate, këto karakteristika janë të përfshira brenda ose janë të mbështetura direkt në muret e jashtme strukturore;

Boshteve të ashensorëve, boshteve e shkallëve, dhe rezervuarëve të ujit në çati me kusht që ka maksimalisht një ndërhyrje të boshtit të ashensorëve ose boshtit të shkallëve ose rezervuarit të ujit në çati (ose strukture që inkorporon më shumë se njërën nga këto) që lejohet për çdo 20 metra gjatësie të kufirit të brendshëm, dhe që dimensioni maksimal i tyre paralel me kufirin për këtë strukturë nuk tejkalon 3m, dhe me kusht që distanca minimale ndërmjet secilës prej këtyre strukturave është 20m, dhe me kusht që për ndërtesat mbi tre kate, këto karakteristika janë të përfshira brenda ose janë të mbështetura direkt në muret e jashtme strukturore;

Kur një fund çatie i vetëm me një bazë (duke përjashtuar strehët) prej 7.5 metra ose më pak përballet me një kufi dhe rrafshi i tërhequr godet jo më poshtë se në gjysmë ndërmjet strehëve dhe vijës kurrizore, fund çatia mund të ndërhyjë në rrafshin e tërhequr.



Figura 3 Shembulli i llogaritjes së lartësisë dhe vëllimit të ndërtesës bazuar në këndin 45°

3.11. KËRKESAT PËR ZVOGËLIM TË ZHURMËS

Në mënyrë që të sigurohet një mjedis i përshtatshëm për zhvillimin e jetës dhe punës, Komuna ka përcaktuar disa kufizime në për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar efekteve e dëmshme, bezdisjen që shkakton zhurma. Këto kufizime janë të detyrueshme për të gjitha veprimtaritë përbrenda Komunës, të përcaktuara për secilin shfrytëzim të planifikuar të tokës dhe llojit të vendbanimit.

Tabela 8 Kufizimet e nivelit të lejuar të zhurmës

Lloji i zoonimit	Zhurma maksimale e lejuar 08:00 – 22:00	Zhurma maksimale e lejuar 22:00 – 08:00
Zonë Industriale	90db(A)	90dB(A)
Zona Urbane 1	60db(A)	50dB(A)
Zonë Komerciale	55db(A)	45dB(A)
Zonë Mikse–Banimi dhe Komerciale	50db(A)	40dB(A)
Zonë Banimi	45db(A)	35dB(A)
Zonë Hekurudhore	100db(A)	100dB(A)

Efektet më të zakonshme të zhurmës janë shqetësimi dhe bezdisja. Por ato na bezdisin edhe kur punojmë, kur merremi me veprimtari të tjera apo kur pushojmë. Në mënyrë që të mbrohet shëndeti i banorëve, të gjitha veprimtaritë përbrenda Komunës duhet të respektojnë nivelet e përcaktuara për zonat e sipërme, duke përfshirë edhe veprimtaritë ekonomike dhe fetare.

Të gjitha veprimtaritë argëtuese, mihjes sipërfaqësore, gurëthyeseve apo të tjera të ngjashme të cilat ndërmerren jashtë këtyre zonave me kufizime maksimale të lejuar të zhurmës duhet të ndërmarrin masat e nevojshme që mos të tejkalojnë kufizimet e parapara të emetimit të zhurmës përtej kufijve të zonave fqinje.

3.12. PËRDORIMI I SUTERENIT DHE BODRUMIT

LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR e as aktet nënligjore të këtij ligji të cilat duhen të merren parasysh gjatë përgatitjes së Hartës Zonale Komunale, nuk kanë përcaktuar trajtimin e suterenit dhe bodrumeve në këtë dokument apo numrin e etazheve të tyre.

Për trajtim më të detajuar të zonave kodrinore ku mund të aplikohen suterenet, një gjë e tillë mund të bëhet përmes hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme, të cilat përcaktojnë numrin e niveleve të lejuara të suterenit dhe kriteret për llogaritjet e koeficienteve për to.

Sa i përket trajtimit të sipërfaqes nëntokësore për ndërtim SNP në koeficient, UDHËZIMI ADMINISTRATIV MMPH-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR ka përcaktuar kriteret vijuese:

“Kapituli 1.4.2. Kur tejkalohet pragu i (SNP) maksimale (80% nga sipërfaqja e përgjithshme në prerje ortogonale e parcelës kadastrale), duhet të kërkohet projekt i menaxhimit të reshjeve atmosferike. Në këtë rast, leja ndërtimore i nënshtrohet kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim. SNP nuk përfshihet në përllogaritjet e sipërfaqes së ISN dhe ISHPKZh.”

Duke u bazuar në kriterin e lartpërmendur që përjashton llogaritjen e sipërfaqes së bodrumit në përllogaritjet e sipërfaqes së ISN dhe ISHPKZh dhe kriterin në vijim, përllogaritjet e sipërfaqes së ISN dhe ISHPKZh duhet të behët nga kati niveli i të cilës është 1.2 m ose më shumë më i lartë se niveli i tokës ose se niveli i rrugës ngjitur:

“Kapituli 5.3.6. Hapësira nën tokë (themelet, bodrumi) llogaritet si kat nëse cilado pjesë e nivelit të lartë të saj është 1.2 m ose më shumë më i lartë se niveli i tokës ose se niveli i rrugës ngjitur.”

Bazuar në RREGULLOREN MMPH NR.03/2016 PËR NORMAT MINIMALE TEKNIKE PËR NDËRTESAT E BANIMIT NË BASHKËPRONËSI, sutereni nënkupton katin i cili gjendet nën përdhesë ku së paku 50% e vëllimit të tij është në nivelin e Tokës, apo njëra ballore e tij është mbi nivelin e Tokës dhe kjo aplikohet për të gjitha ndërtimet pavarësisht shfrytëzimeve.

Bazuar në LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR , aktet nënligjore të këtij ligji si dhe kriteret e lartpërmendura, Harta Zonale Komunale e komunës së Vitisë nuk kufizon numrin e etazheve për bodrume dhe suterene, por lejon aplikimin e tyre duke mos shkelur kriteret e lartpërmendura.

4. LISTA E ZONAVE DHE LISTA E ZONAVE MBISHTRESORE

Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale, gjendjen e ekzistuese dhe Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike për Planifikim Hapësinor kemi listuar Listën e Zonave dhe Lista e Zonave Mbishtresore vijuese.

4.1. LISTA E ZONAVE TË DESTINUARA SIPAS KUSHTEVE ZHVILLIMORE

Tabela 9 Lista e zonave të destinuara sipas kushteve zhvillimore

HILUCS 1	Emërtimi i Zonave	HILUCS 2	Përmbajtja Zonave (Shfrytëzimi i Planifikuar i Zonave)	HILUCS 3	Kodi	Simboli
5	Zonë banimi	5.1	Banim me një njësi	/	ZB-1	ZB-1
			Banim me një njësi		ZB-2	ZB-2
			Banim me një njësi		ZB-3	ZB-3
			Banim me shumë njësi		ZB-4	ZB-4
			Banim me shumë njësi		ZB-5	ZB-5
			Banim me shumë njësi		ZB-6	ZB-6
5	Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri / Zonë për shfrytëzim të përzier	5.2	Banim me një njësi dhe afarizëm	/	ZSHP-1	ZSHP-1
			Banim me një njësi dhe afarizëm		ZSHP-2	ZSHP-2
			Banim me një njësi dhe afarizëm		ZSHP-3	ZSHP-3
			Banim me një njësi dhe afarizëm		ZSHP-4	ZSHP-4
3	Zonë e shërbimeve të komunitetit	3.3	Shërbim i komunitetit - Varreza	3.3.5	ZSH-1	ZSH-1
			Shërbim fetar	3.3.4	ZSH-2	ZSH-2
			Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	3.3.3	ZSH-3	ZSH-3
			Shërbim arsimor	3.3.2	ZSH-4	ZSH-4
			Shërbim i komunitetit	3.3.1	ZSH-5	ZSH-5
4	Zonë e shërbimeve	4.3	Deponi e përkohshme e mbeturinave	4.3.3	ZSH-6	ZSH-6
2	Zonë industriale	2.3	Industri e prodhimeve të lehta	2.3.1– 2.3.5	ZI-1	ZI-1
		2.3	Prodhim i energjisë së ripërtëritshme		ZI-2	ZI-2
3	Zonë komerciale	3.1	Shërbime Tregëtare	3.1.1-3.1.4	ZK-1	ZK-1
			Shërbim tjera tregtar		ZK-2	ZK-2
3	Zonë rekreative-turistike	3.4	Infrastrukture sportive	3.4.3	ZrT-1	ZrT-1
		3.4	Hapësire e hapur rekreative	3.4.4	ZrT-2	ZrT-2
4	Zonë e komunikacionit- transportit	4.1	Infrastrukturë e transportit rrugor	4.1.1	ZkT-1	ZkT-1

HILUCS 1	Emërtimi i Zonave	HILUCS 2	Përmbajtja Zonave (Shfrytëzimi i Planifikuar i Zonave)	HILUCS 3	Kodi	Simboli
			Stacioni autobusave		ZkT-2	ZkT-2
			Parkingje Publike		ZkT-3	ZkT-3
1	Zonë bujqësore	1.1	Drithëra	1.1.1-1.1.3	Zb-1	Zb-1
			Fruta		Zb-2	Zb-2
			Perime		Zb-3	Zb-3
			Livadhe dhe Kullosa		Zb-4	Zb-4
			Kullosa		Zb-5	Zb-5
1	Zonë pyjore	1.2	Zonë pyjore	1.2.1-1.2.3	ZP	ZP
3	Shërbim kulturor argëtues dhe rekreativ - Zonë e mbrojtur arkeologjike-historike	3.4	Shërbim kulturor argëtues dhe rekreativ - Zonë e mbrojtur arkeologjike-historike	3.4.1	ZmaH	ZmaH
6	Sipërfaqe ujore	6.3	Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik -Lum	6.3.2	SU-1	SU-1

4.2. LISTA E ZONAVE MBISHTRESORE

Tabela 10 Lista e zonave mbishtresore

ZONAT MBISHTRESORE	Kodi
Zonë Sizmike	ZmSh - A
Zonë me Vërshime	ZmSh - B
Zonë e Akuifereve	ZmSh - C
Zonë me pasuri minerare	ZmSh - D
Zonë Arkeologjike	ZmSh - E
Zonë e Trashëgimisë Natyrore	ZmSh - G
Zonë me uranium të varfëruar	ZmSh - H
Zonë e me rrëshqitje të dheut	ZmSh - I
Zonë me Erozion	ZmSh - J
Zonat e Veçantë e Mbrojtur	ZmSh-N

5. ZONAT E DESTINUARA (PËRCAKTUARA) DHE KUSHTET ZHVILLIMORE PËRFSHIRË KUSHTET NDËRTIMORE

5.1. ZONAT E BANIMIT (ZB)

5.1.1. ZONAT E BANIMIT ME NJË NJËSI (ZB-1, ZB-2, dhe ZB-3)

Gjatë procesit të zonimit është paraqitur nevoja e precizimit, zgjerimit dhe ndarjes së zonave në nënzona për shkak të kushteve specifike që janë zhvilluar nga një zonë në tjetrën. Por, në tërësi, zona e banimit me një njësi është ndarë sipas kushteve të veçanta zhvillimore në tre zona vijuese:

Tabela 11 Kategorizimi i zonave sipas strukturave të ndërtuara

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i strukturës së ndërtuar	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZB-1	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të ulët	Ndërtesa banimi me një njësi	2,226.38
ZB-2	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	384.39
ZB-3	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Sub urbane	Ndërtesa banimi me një njësi	228.95

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në kuadër të zonave të banimit me një njësi, shfrytëzime të lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

Ndërtesat e banimit me një njësi – objektet e banimit individual, siç janë shtëpitë e veçanta, shtëpitë dyshe dhe shtëpitë në varg.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në kuadër të zonave të banimit me një njësi, shfrytëzime të lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

Hapësirat e lejuara rekreative, shërbimet kulturore, tregtisë me pakicë, mallrave personale dhe shtëpiake, shërbimet financiare dhe të sigurimeve, shërbimet teknike profesionale dhe shkencore, shërbime të informimit dhe komunikimit, shërbime administrative dhe mbështetëse dhe shërbime arsimore, infrastruktura e transportit rrugorë, infrastruktura e shpërndarjes së energjisë elektrike, termike, gazit, furnizimit me ujë, kanalizimit fekal dhe atmosferik, infrastruktura e post-telekomit dhe internetit, si dhe infrastruktura tjetër në shërbim të ZB-së.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të zonave të banimit me një njësi, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

Shërbimet argëtuese, bujtinat, kampingjet, hotelet, shërbimet shëndetësore, sallonet e ondulimit, shërbimet e auto-servisimeve, infrastruktura e telekomunikacionit.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të zonave të banimit me një njësi, pas së cilës largohen plotësisht janë Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna).

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Funksionet dhe aktivitet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të zonave të banimit me një njësi, për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone janë të ndaluara të gjitha shfrytëzimet të cilat nuk janë të përfshira në:

Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

Tabela 12 Kushtet zhvillimore të zonave të banimit me një njësi

Prodhim primarë	**ZB-1**	**ZB-2**	**ZB-3**
Bujqësi	L	L	LP
Pylltari	L	L	LP
Minierë dhe gurore	N	N	N
Prodhimtari parësore tjetër	N	N	N
Prodhim dytësor			
Industri e lëndës së parë	N	N	N
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N
Prodhim i energjisë	N	N	N
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N
Prodhim tretësor			
Shërbim tregtar	LD	LD	LD
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LD	LD	LD
Shërbim i komunitetit	LD	LD	LD
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD	LD	LD
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike			
Rrjetet e transportit	LD	LD	LD
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	LD	LD	LD
Shërbim publik	LV	LV	LV
Banim			
Banim i përhershëm	L	L	L
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	L	L	L
Banim tjetër	L	L	L
L-Lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar			

Kushtet ndërtimore në zonat e banimit me një njësi janë në pajtueshmëri me nenin 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (nr. 04/L-174) dhe duhet të jenë sipas trajtës dhe elementeve në vijim:

- **Etazhiteti**
  - Në ZB1, numri i etazheve të lejuara është dy, përkatësisht B+P+1.
  - Në ZB-2, dhe ZB-3 numri i etazheve të lejuara është tre, përkatësisht P+2.

Për përdorimin e bodrumeve dhe suterenit, referojuni kapitullit : *3.12 Përdorimi i suterenit dhe bodrumit.*

- **Vija rregullative**

Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikuar publike.

Në raste të planifikimit të rrugëve të reja tek të cilat duhet të caktohen gjërsitë e rrugëve si dhe vija rregulluese, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor si:

Tabela 13 Vija rregulluese sipas profileve të rrugëve të planifikuara

GJËRËSIA E RRUGËS	VIJA RREGULLUESE
Rrugë të rrjetit nacionale apo regjionale- 23,00 m	11.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët transite Urbane – 21,00m	10.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët Transite nëpërmjet vendbanimeve – fshatrave – 9,50 m.	4.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët përmbledhëse / shpërndarëse – 10,5 m	5.25 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët Servisore – 9,00m	4.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët banesore- 8,50 m	4.25 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët industriale – 10,00 m	5.00 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët qaseshe / dykahëshe – 5,50 m	2.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët qaseshe / njëkahëshe – 3,50m	1.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.

Aty ku Komuna ka nevojë për detajime më të mëdha, atëherë me anë të Planeve Rregulluese të Hollësishme do të përcaktohen më saktësisht vijat ndërtimore.

- **Vija ndërtimore**

Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike është 6.00m distancë nga Vija Rregulluese.

Aty ku Komuna ka nevojë për detajime më të mëdha, atëherë me anë të Planeve Rregulluese të Hollësishme do të përcaktohen më saktësisht vijat ndërtimore.

- **Lartësia e lejuar**

Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike është 1L/1GJ , ku GJ është distanca nga vija rregulluese dhe L është lartësia e ndërtesës.

Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale matet si raporti ndërmjet gjatësisë nga kufiri anësor dhe i prapmë i parcelës kadastrale dhe lartësisë së ndërtesës. Ky raport nuk mund të jetë më i vogël se 0.5 L / 1 GJ dhe më i madh se 2 L / 1 GJ, ku GJ- është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës. Mirëpo, në rast se parashtruesi/ja i/e kërkesës për leje ndërtimore ka siguruar marrëveshje paraprake me pronarët e tokave fqinje atëherë raporti L/G maksimal i lejuar për :

1. **Ndërtesë të veçantë është:**

   Deri në 2m distancë (me marrëveshje paraprake me fqinjë, që në të ardhmen edhe fqinji do të respektoj rregullin e njejtë) nga kufiri i parcelës, dhe në fasadat të cilat përdorin këtë raport nuk lejohen të kenë hapësira e jashtme si logja, ballkonet, tarracat, kopshtet dhe atriumi, apo hapje në hapësira për banim si: dhoma e ditës apo dhoma për shumë qëllime, dhoma, tryezaria dhe kuzhina.

2. **Ndërtesë dyshe**:

   Në këto ndërtesa kemi dy mundësi për distance nga kufiri I parcelave fqinje, kufiri nga parcela kadastrale me të cilën nuk lejohet bashkimi por duhet të përdoret raporti 2L/1GJ referoju nënkapitullit 2.1 , si dhe kufiri me parcelën fqinje deri në bashkim të ndërtesave referoju nënkapitullit 2.2

- 2.1. Në njërën anë distanca nga kufiri i parcelës llogaritet duke përdorur raportin 2L/1GJ me parcelën kadastrale fqinje me pronarin e të cilës nuk lejohet marrëveshja për bashkim të ndërtesave;
- 2.2. Në njërën anë ku lejohet ndërtimi i mureve të jashtme në largësi 10cm nga kufiri i parcelës kadastrale, (pjesa ku është siguruar marrëveshja me pronarin e parcelës fqinje për bashkim të ndërtesave) nuk mund të kenë hapje apo konzollë dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri, gjersa në fasadat ballore ngjitur me këtë mur hapjet, logjat, ballkonet, tarracat, kopshtet, atrium dhe konzollat duhet të largohen së paku 1.5m nga kufiri i parcelës për të cilën është arritur marrëveshja me fqinjët;

Te ky tip i ndërtesave është e domosdoshme që me njërën parcelë kadastrale anësore fqinje të respektohet rregulli 2.1 si dhe në anën tjetrën 2.2.

3. Ndërtesë në varg:

Në këtë tipologji të ndërtesave lejohet bashkimi i ndërtesave në të dy anët me parcelat fqinje, gjithmonë me marrëveshje në mes fqinjëve, rregulli I bashkimit të ndërtesave në mes vete vlen si në nënkapitullin 3.1.

- 3.1. Lejohet ndërtimi i mureve të jashtme në largësi 10cm nga kufiri i parcelës kadastrale anësore, nuk mund të kenë hapje apo konzollë dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri, gjersa në fasadat ballore ngjitur me këtë mur hapjet, logjat, ballkonet, tarracat, kopshtet, atriumet dhe konzollat duhet të largohen së paku 1.5m nga kufiri i parcelës për të cilën është arritur marrëveshja me fqinjët. Numri i maksimal i lejuar i ndërtesave në varg është 8 ndërtesa.

Distanca minimale ndërmjet ndërtesës dhe kufirit anësor dhe të pasmë të parcelave kadastrale, me kthina primare në fasada, në rast të pamundësisë të zbatimit të kushteve të përmendura më lart, në zona veç më të ndërtuara (të mbushura me ndërtim më shumë se 60%), është së paku një e katërta (1/4) e lartësisë të ndërtesës më të lartë.

▪ **Lartësia maksimale**

- Në ZB-1 lartësia maksimale është 9m.
- Në ZB-2 dhe ZB-3 lartësia maksimale është 12m.

▪ **Ndërhyrjet e lejuara në lartësi**

Elementet dhe struktura e mëposhtme lejohen të ndërhyjnë në kufizimet e zonës për lartësi maksimale:

1. Kambanarët, majat, sahat kullat ose kullat e kambanave, kupolat, ose shtizat e flamujve;
2. Oxhaqet ose pirgjet;
3. Antenat e radios, televizionit ose telekomunikimit;
4. Pajisjet ndihmëse për navigim;
5. Kullat ose shtyllat e tensionit të lartë;
6. Konstruksionet e rezervuarve të ujit;
7. Hangarët, siloset, furrat, mullinjtë me erë, hambarët e drithërave;
8. Kullat e ashensorëve ose nën-kulmet mekanike që zënë jo më shumë se 10 përqind të sipërfaqes së kulmit të një ndërtese në të cilën ndodhet.

▪ **Distancat në mes ndërtesave të banimit në raport me zona të tjera**

1. Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore është jo me e vogël se 1.5 herë lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat si më lartë në kapitullin **Lartësia e lejuar**.
2. Pavarësisht nga dispozitat e këtushme, distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4.00 m i gjerë dhe 5.00 m i lartë.

3. Në sipërfaqet e mbrojtura, zonat mbrojtëse, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura duhet të respektohen me ligjet si dhe rregulloret sektoriale. Në çdo rast distancat ndërmjet ndërtesave nuk duhet të jenë më të vogla sesa ekzistuese.
4. Distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4 metra i gjerë dhe 5 metra i lartë.
5. Distancat minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në raport me lumenjtë në raste kur është i përcaktuar brezi i gjelbër mbrojtës 10.00 m i lumit është së paku një e katërta (1/4) e lartësisë të ndërtesës nga brezi mbrojtës dhe vlen për zonat brenda kufirit të zonës urbane, në raste kur nuk kemi të përcaktuar brezin mbrojtës përgjatë lumit, distanca nga kufiri i parcelës së lumit duhet të jetë minimum 10m. Për zonat rurale distancat duhet të ruhen sipas Ligjit Nr. 04/L – 147 - për ujërat e Kosovës.

- **Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)**

Në ZB-1 përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e veçantë 10-20%,
- Ndërtesë dyshe 12-24%,
- Ndërtesë në varg 12-25%,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale për zhvillim është:

- Ndërtesë e veçantë 80% deri 60%,
- Ndërtesë dyshe 78% deri 66%,
- Ndërtesë në varg 78% deri 65%.

Në ZB-2 përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e veçantë 10,
- Ndërtesë dyshe 15%,
- Ndërtesë në varg 25%,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është:

- Ndërtesë e veçantë 80%,
- Ndërtesë dyshe 75% deri 65%,
- Ndërtesë në varg 65%.

Në ZB-3 përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e veçantë 25%,
- Ndërtesë dyshe 30%,
- Ndërtesë në varg 35%,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është:

- Ndërtesë e veçantë 65%,
- Ndërtesë dyshe 60%,
- Ndërtesë në varg 55%.

Përqindja e sipërfaqes nëntokësore të parcelës (SNP) maksimale është 80% nga sipërfaqja e përgjithshme në prerje ortogonale e parcelës kadastrale.

▪ **Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)**

Në ZB-1, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISN) është:

- Ndërtesë e veçantë 0.20,
- Ndërtesë dyshe 0.24,
- Ndërtesë në varg 0.25.

Në ZB-2, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISN) është:

- Ndërtesë e veçantë 0.30,
- Ndërtesë dyshe 0.45,
- Ndërtesë në varg 0.75.

Në ZB-3, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISN) është:

- Ndërtesë e veçantë 0.75,
- Ndërtesë dyshe 0.90,
- Ndërtesë në varg 1.00.

Në kuadër të ISN – ve lejohet shfrytëzimi i 20% të ISN për shfrytëzime të lejuara dytësore, të lejuara të veçanta dhe të lejuara të përkohshme, të cilat janë të përcaktuara më sipër.

▪ **Kërkesat minimale për vend-parkingje**

Kërkesat minimale për vend – parkingje në zonat e banimit me një njësi janë: 2 VP/100 m² të sipërfaqes bruto të ndërtuar. Por jo më pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit.

Shih Kapitullin 3.6. Rregullat për parkim dhe shkarkim.

▪ **E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese**

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën e mëposhtme.



Figura 4 Shembulli i llogaritjes së lartësisë së lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale

- **Qasja adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike**

Secila shtëpi duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sjellët situacioni që përmban infrastrukturën teknike ekzistuese.

Të gjitha objektet e banimit duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas standardeve që i përgjigjen nevoja të personave me aftësi të kufizuara.

- **Kufizimet ndaj zhurmës**

Kufizimet e depërtimit të zhurmës në mjedis të hapur dhe mjedise të mbyllura fqinje janë sipas intervaleve kohore:

- 08:00-22:00 = 45db (A), dhe
- 22:00-08:00 = 35db (A)

- **Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore**

Nëse brenda zonës ka zona të tilla atëherë masat për mbrojtjen e tyre janë precizuar në kuadër të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

- **Kërkesa tjera për rregullim të hapësirës gjatë përcaktimit të kushteve ndërtimore**

ZB-1 janë zona banimi me **sipërfaqe rurale me intenzitet të ulët** të destinuara për banim me një njësi, me dendësi maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar në:

- Ndërtesa të veçanta 7 njësi banimi,
- Ndërtesa dyshe 10 njësi banimi,
- Ndërtesa në varg 13 njësi banimi

Ndërkaq sa i përket madhësisë minimale të parcelës kadastrale:

- Ndërtesa të veçanta 1000 m^2,
- Ndërtesa dyshe 900 m^2 dhe
- Ndërtesa në varg 800 m^2.

ZB-2 janë zona banimi me **sipërfaqe rurale me intenzitet të lartë** të destinuara për banim me një njësi, me dendësi maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar në:

- Ndërtesa të veçanta 10 njësi banimi
- Ndërtesa dyshe 13 njësi banimi,
- Ndërtesa në varg 17 njësi banimi

Ndërkaq sa i përket madhësisë minimale të parcelës kadastrale:

- Ndërtesa të veçanta 1000 m^2,
- Ndërtesa dyshe 800 m^2 dhe
- Ndërtesa në varg 600 m^2.

ZB-3 janë zona banimi me **Sipërfaqe sub urbane** të destinuara për banim me një njësi, me dendësi maksimale banesore e shprehur si numri maksimal i njësive banesore për hektar në:

- Ndërtesa të veçanta 21 njësi banimi
- Ndërtesa dyshe 26 njësi banimi
- Ndërtesa në varg 28 njësi banimi

Ndërkaq sa i përket madhësisë minimale të parcelës kadastrale:

- Ndërtesa të veçanta 300 m^2,
- Ndërtesa dyshe 240 m^2 dhe
- Ndërtesa në varg 200 m^2.

- **Formësimi arkitektonik dhe estetik**

Në ZB-1, ZB-2 dhe ZB-3 Fasada duhet te jete ngjyre e bardhë me sipërfaqe prej 60% duke mos llogaritur sipërfaqen e dritareve.

Lejohet përdorimi i gurit apo tullave të fasadës me sipërfaqe prej 40% dhe me ngjyrë të kuqe apo kafe, Kornizat e dritareve nga druri ose PVC me teksturë druri ose ngjyrë të zezë, ngjyra e tjegullave të kulmeve e kuqe.

Në ZB-3, Fasada duhet te jete ngjyre e bardhë me sipërfaqe prej 80% duke mos llogaritur sipërfaqen e dritareve.

Lejohet përdorimi i tullave të fasadës me sipërfaqe prej 20% dhe me ngjyrë të kuqe, kafe dhe të hirtë, Kornizat e dritareve nga druri ose PVC me teksturë druri ose ngjyrë të zezë, ngjyra e tjegullave të kulmeve e kuqe, gjatë fazës së projektimit të ndërtesës duhet të analizohet përshtatshmëria e këtyre materialeve me karakterin e ndërtimeve në këto zona.

Forma e objektit preferohet të jetë formë gjeometrike Katrore.

Forma e kulmit duhet të jetë dy ose me shumë ujor, Strehët e kulmit duhet të jenë me gjatësi deri në një metër, kjo për arsye të mbrojtjes së dritareve nga rrezet e diellit gjatë periudhës së verës dhe mbrojtjes së mureve anësore nga lagështia gjatë reshjeve atmosferike.

Në kulme lejohet nxjerrja e baxhave me qëllim të përfitimit të ndriçimit tek nën kulmet, jo më shumë se 20% e sipërfaqes së kulmit.

Ballkonet, lozhat dhe tarracat me qëllim të mënjanimit të rrezeve te diellit në hapësirat e brendshme gjatë verës, duhet të ndërtohen mbi dritaret e vendosura në pjesën jugore, jug-lindore dhe jug-perëndimore të katit përfund duke krijuar strehë.

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit**

Në të gjitha zonat e banimit, me përjashtim të atij rural, peizazhi minimal i pranueshëm për çdo 15.00 m lineare të frontit të rrugës (ose pjesë e tyre, duke zbritur gjerësinë e rrugës) është:

a. Një pemë minimalisht 1.6 m të lartë.
b. Lloje të shkurreve sipas specifikimeve në seksionin për shkurret.
c. Zona e mbetur të trajtohet me mbulesë tokësore (p.sh., bar, gur natyror, apo/dhe shkurre me gjelbërim të përhershëm).

Drunjtë <9.00 metra sugjerohen për mbjellje në zonat e banimit qendrore të qytetit ku hapësira e tokës është e kufizuar. Drunjtë e vegjël apo të mesëm ofrojnë zgjedhje të mira për mbjellje pranë një oborri, ose në zona të ekspozuara ndaj erërave të mundshme. Asnjë parakusht për tolerancën mjedisore nuk është vendosur për këtë kategori. Megjithatë, cilësia e rrënjëzimit dhe disponueshmëria e dritës do të jenë ende shumë të rëndësishme për përzgjedhjen e specieve të përshtatshme.

- Të mesme (10-15m) mbillen në distancë prej 8 m;
- Të vogla (<10m) mbillen në distancë prej 4-6 m.

Në një hapësirë / trotuar më të ngushtë se 1.00m nuk mbillen drunj që në pjekuri arrijnë një diametër trungu >30 cm;

Për llojet halore vlen distanca prej 1.8-2.00 m mes pemëve në vetvete.

Nuk ka rregullore për mbjelljen e pemëve shumë pranë linjës së pronës së banimit apo distance të caktuar. Është përgjegjësi e pronarit të pronës të mirëmbajë pemët në mënyrë që ato të mos prekin banorët ngjitur. Çdo mosmarrëveshje me pronat e banimit kalon në çështje civile. Kërkesa për hapësirën mesatare për njësi familjarë të vetme bazohet në pamjen totale lineare të rrugës për të gjithë projektin dhe **jo në bazë të gjerësive të pjesëve individuale.**

Në zonat e banimit, me strukturë kryesisht **shtëpi në varg**, pemët mbillen përgjatë çdo linje të brendshme të pronës që ngjitet me kufirin e zonës për të siguruar një "ekran" efektiv, përveç rasteve të specifikuara më poshtë:

- Mesatarisht një (1) pemë do të mbillet për çdo 6 m të kësaj linje të brendshme pronësore
- Pemë të tilla duhet të pajisen me sipërfaqe të mjaftueshme për llojin e pemës dhe zonën përreth.

Aty ku kërkohet gjelbërimi i vazhdueshëm, lloj "ekrani", zbatohen kushtet e mëposhtme:

- Një rresht shkurresh me gjelbërim të përhershëm që do të rriten për të formuar një mbrojtje të vazhdueshme, të paktën 1.20 m të lartë brenda dy viteve nga mbjellja; ose
- Një "mur" dheu i kombinuar me lloje me gjelbërim të përhershëm ose një gardh që formon një mbulesë atraktive dhe që gjithashtu shërben si mbrojtës zhurme, të paktën 1.80 m të lartë brenda dy viteve të vendosjes.

Drunjë të madhësisë së vogël	Drunjë të madhësisë së mesme
Kumbulla e kopshtit (Prunus cerasifera)	Shelgu i përkulur (Salix babylonica)
Dëllinja (Juniperus Hibernica)	Qarrziu (Quercus trojana)
Panja (Acer pseudosieboldianum)	Mështekna (Betula pendula)
Lajthia (Corylus avellana)	Tilia parvifolia

Përcaktimi i numrit të drunjve brenda parcelës, bëhet varësisht modelit të mbjelljes së adoptuar; qoftë drejtkëndëshe apo katrore. Teorikisht, përdorimi më i mirë i dritës, ujit, lëndëve ushqyese dhe hapësirës nga bima individuale ndodh kur bimët janë në distancë të barabartë nga njëra tjetra në të gjitha drejtimet. Në zona banimi sipas specifikimeve, kryesisht mbillen fidane <10m. Në llogaritje janë marrë parasysh bimë me kurorë piramidale që mbillen më dendur **1.8-2.00 m** dhe hasen më shpesh në oborret e shtëpive, me një distance prej **2.40 m** mes rreshtave. Lidhur me këtë rregull, numri i përafërt i fidanëve për parcelë kadastrale, sipas kategorizimit sipërfaqe suburbane dhe urbane e përgjithshme**.**

Tabela 14 Përcaktimi i fidanëve për zonat e banimit me një njësi

Kategoria	Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	Përqindja e gjelbërimit (%)	Nr. i fidaneve
Ndërtesa të veçanta	300	65%	45
Ndërtesa dyshe	240	60%	33
Ndërtesa në varg	200	55%	25

Sipërfaqja mesatare që merr secila pemë 4.32 m^2- në këtë rast rreth 4.00 m^2 sipërfaqe rreth trungut të drurit duhet të jetë e lirë dhe e pashtruar në mënyrë që shiu ose uji për ujitje dhe ajri të depërtojnë në tokë për të ruajtur shëndetin e rrënjës.

Kur sipas llogaritjeve dhe standardeve kërkohet të mbillen më shumë se 15 pemë për të përmbushur standardet, sugjerohet një përzierje speciesh. Numri i specieve që do të mbillen ndryshon në varësi të numrit të përgjithshëm të pemëve që kërkohen të mbillen.

Tabela 15 Numri i kërkuar i fidanëve si dhe numri minimal i species për zonat e banimit me një njësi

Nr. i kërkuar i fidaneve	Nr. minimal i species
16-30	2
31-45	3
46-60	4
61-75	5
76-90	6
91+	7

- Bimët shumëvjeçare të gjata 0.70-1.00 m mbillen në dendësi 3-6 bimë/m^2
- Bimët me gjatësi mesatarisht 0.50-0.70 m mbillen në dendësi 9-12 bimë/m^2 dhe
- Bimë të ulëta deri në 50 cm, mbillen në dendësi 20-25 bimë/m^2.

▪ Parkingjet

Parkingu përgjatë rrugës publike dhe parkingjet e përbashkëta të cilat i kemi shprehur si :

Aty ku është e nevojshme përgjatë rrugës të ketë parkingje dhe ku paraqitet nevoja të ketë parkingje të përbashkëta këto duhet të punohen sipas normave të planifikimit hapësinorë të specifikuara për parkingje përgjatë rrugës dhe parkingje të përbashkëta.

Tabela 16 Kushtet ndërtimore për zonat e banimit me një njësi ZB-1

Kushtet ndërtimore	ZB-1		
Lloji i strukturës së ndërtuar	**Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët**		
Lloji i ndërtesës	**Ndërtesa të veçanta**	**Ndërtesa dyshe**	**Ndërtesë në varg**
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar
Vija Ndërtimore nga Vija Rregulluese	6m	6m	6m
Katësia	B+P+1	B+P+1	B+P+1
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')	9	9	9
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me fqinjët	2L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	2m	2m (përgjatë njërës anë)	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2L/1GJ	2L/1GJ	2L/1GJ
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	2m	2m (përgjatë njërës anë)	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale për ndërtesat dyshe dhe në varg	Nuk lejohet	2L/1GJ (Përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)	2L/1GJ (Vlen për ndërtesën e parë apo te fundit të vargut përgjatë njërës anë)
ISHPKZh	10-20%	12-24%	13-25%
% e gjelbërimit	80% deri 60%	78% deri 66%	78% deri 65%
SNP	80%	80%	80%
ISN	0.20	0.24	0.25
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db (A)	08:00-22:00=45db (A)	08:00-22:00=45db (A)
	22:00-08:00=35db (A)	22:00-08:00=35db (A)	22:00-08:00=35db (A)
Dendësia banimore për hektar	25	35	50
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	1,000	900	800
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	25	22.50	20

Tabela 17 Kushtet ndërtimore për zonat e banimit me një njësi ZB-2

Kushtet ndërtimore	**ZB-2**		
Lloji I strukturës së ndërtuar	**Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë**		
Lloji I ndërtesës	**Ndërtesa të veçanta**	**Ndërtesa dyshe**	**Ndërtesë në varg**
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar
Vija Ndërtimore nga Vija Rregulluese	6m	6m	6m
Katësia	B+P+2	B+P+2	B+P+2
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')	12	12	12
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me fqinjët	2L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale për ndërtesat dyshe dhe në varg	Nuk lejohet	2L/1GJ (përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)	2L/1GJ (Vlenë për ndërtesën e parë apo te fundit të vargut përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2L/1GJ	2L/1GJ	2L/1GJ
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
ISHPKZh	10%	15%	25%
% e gjelbërimit	80%	75%	65%
SNP	80%	80%	80%
ISN	0.30	0.45	0.75
Kërkesat minimale për vendparkingje të sipërfaqes bruto të ndërtuar. Por jo më pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës së banimit.	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m² por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore nga zhurma	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db (A)	08:00-22:00=45db(A)
	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db (A)	22:00-08:00=35db(A)

Dendësia banimore për hektar	25	35	50
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	1,000	800	600
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	25	20	15

Tabela 18 Kushtet ndërtimore për zonat e banimit me një njësi ZB-3

Kushtet ndërtimore	**ZB-3**		
Lloji I strukturës së ndërtuar	**Sipërfaqe Sub-Urbane**		
Lloji I ndërtesës	**Ndërtesa të veçanta**	**Ndërtesa dyshe**	**Ndërtesë në varg**
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar
Vija Ndërtimore	6m	6m	6m
Katësia	B+P+2	B+P+2	B+P+2
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')	12	12	12
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me fqinjët	2L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale për ndërtesat dyshe dhe në varg	Nuk lejohet	2L/1GJ (përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)	2L/1GJ (Vlenë për ndërtesën e parë apo te fundit të vargut përgjatë njërës anë në të cilën nuk ka marrëveshje)
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2L/1GJ	1.5L/1GJ	1.5L/1GJ
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4L/1GJ	Nuk lejohet	Nuk lejohet
ISHPKZh	25%	30%	35%
% e gjelbërimit	65%	60%	55%
SNP	80%	80%	80%
ISN	0.75	0.90	1.00
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m^2 por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m^2 por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi	2 VP/100 m^2 por jo më pak se 1 VP për çdo njësi banimi
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m^2K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3

	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db (A)	08:00-22:00=45db(A)
	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db (A)	22:00-08:00=35db(A)
Dendësia banimore për hektar	30	75	105
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	300	240	200
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	15	12	10

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit:

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.1.2. ZONAT E BANIMIT ME SHUMË NJËSI (ZB-4, ZB-5 dhe ZB-6)

Gjatë procesit të zonimit është paraqitur nevoja e precizimit, zgjerimit dhe ndarjes së zonave në nënzona për shkak të kushteve specifike që janë zhvilluar nga një zonë në tjetrën. Por, në tërësi, zona e banimit me shumë njësi është ndarë sipas kushteve të veçanta zhvillimore në 3 zona vijuese:

Tabela 19 Zonat e banimit me shumë njësi

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i strukturës së ndërtuar	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZB-4	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi	5.10
ZB-5	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi	48.47
ZB-6	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi	12.53

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

Ndërtesa banimit me shumë njësi - ku në këtë lloj të objekteve bëjnë pjesë, Ndërtesat e banimit me shumë njësi, të Veçanta, Ndërtesat në Varg dhe Ndërtesat Terracore.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

Shërbim kulturor, Shërbim shëndetësor dhe shoqëror, Tregti me pakicë, Riparimi i automjeteve, mallrave personale dhe shtëpiake, Shërbim financiar dhe i sigurimit, Shërbim teknik profesional dhe shkencor, Shërbime të informimit dhe komunikime, Shërbim administrativ dhe mbështetës. Infrastrukturë e transportit rrugor, Bujtinë, Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

Shërbim argëtues, Hapësirë e hapur rekreative, Kamping, Hotel, Infrastrukturë e telekomunikacionit.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi, pas së cilës largohen plotësisht janë:

Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna).

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Funksionet dhe aktivitet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të zonave të banimit me shumë njësi për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme, të cilat nuk janë të përfshira në:

Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

Tabela 20 Kushtet zhvillimore të zonave të banimit me shumë njësi

Hilucs2	ZB4	ZB5	ZB6
Prodhim primarë			
Bujqësi	N	N	N
Pylltari	N	N	N
Lloji i funksioneve dhe aktiviteteve			
Minierë dhe gurore	N	N	N
Akuakulturë dhe peshkim	N	N	N
Prodhim dytësor			
Industri e lëndës së parë	N	N	N
Industri e prodhimeve të rënda	N	N	N
Industri e prodhimeve të lehta	N	N	N
Prodhim i energjisë	N	N	N
Prodhim tjetër dytësorë	N	N	N
Prodhim tretësor			
Shërbim tregtar	LD	LD	LD
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	LD	LD	LD
Shërbim i komunitetit	LD	LD	LD
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	LD	LD	LD
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike			
Rrjetet e transportit	LD	LD	LD
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	LD	LD	LD
Banim			
Banim i përhershëm	L	L	L
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	L	L	L
Banim tjetër	L	L	L
L-lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar			

Kushtet ndërtimore në zonën këto Zona janë në pajtueshmëri me nenin 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (nr. 04/L-174) i cili kërkon përcaktimin e kushteve sipas trajtës dhe elementeve në vijim:

- **Etazhiteti:**

Në ZB-4 numri i etazheve të lejuara është gjashtë, përkatësisht B+P+5.

Në ZB-5 numri i etazheve të lejuara është tetë, përkatësisht B+P+7.

Në ZB-6 numri i etazheve të lejuara është tetë, përkatësisht B+P+8.

- **Vija rregullative:**

Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikuar publike.

Në raste të planifikimit të rrugëve të reja tek të cilat duhet të caktohen gjerësitë e rrugëve si dhe vija rregulluese, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor si :

Tabela 21 Vija rregulluese sipas profileve të rrugëve të planifikuara

GJËRËSIA E RRUGËS	VIJA RREGULLUESE
Rrugë të rrjetit nacionale apo regjionale- 23,00 m	11.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët transite Urbane – 21,00m	10.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët Transite nëpërmjet vendbanimeve – fshatrave – 9,50 m.	4.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët përmbledhëse / shpërndarëse – 10,5 m	5.25 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët Servisore – 9,00m	4.50 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët banesore- 8,50 m	4.25 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët industriale – 10,00 m	5.00 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët qaseshe / dykahëshe – 5,50 m	2.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.
Rrugët qaseshe / njëkahëshe – 3,50m	1.75 m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës, në të dyja anët e rrugës.

Në raste kur zbatimi i profilit të planifikuar të rrugës publike bëhet i pamundur për arsyeje objektive, atëherë Vija rregulluese përcaktohet ashtu siç është 50% i vijës rregulluese i rrugës ekzistuese.

Autoriteti përgjegjës komunal është i obliguar që fillimisht të provoj zbatimin e vijës rregulluese të planifikuar përmes procedurave të shpronësimit dhe mekanizimit të bonuseve të zoonimit dhe në raste kur dëshmohet se këta mekanizma nuk mund të zbatohen për arsyeje objektive, atëherë mund të filloj me zbatimin e parimit të 50% të vijës rregulluese ekzistuese.

- **Vija ndërtimore**

Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike në ZB-4 është 7m nga Vija Rregulluese.

Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike në ZB-5 dhe ZB-6 është 10m në ndërtesa të veçanta, ndërsa në ndërtesa dyshe dhe në varg është 6-8m nga Vija Rregulluese.

Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën ndërtimore të planifikuar.

- **Lartësia e lejuar**

Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale matet si raporti ndërmjet gjatësisë nga kufiri anësor dhe i prapmë i parcelës kadastrale dhe lartësisë së ndërtesës. Ky raport nuk mund të jetë më i vogël se 0.5L/1GJ dhe më i madh se 3L/1 GJ, ku GJ është distanca mes ndërtesës dhe kufiri të parcelës kadastrale dhe L është lartësia e ndërtesës. Mirëpo, në rast se parashtruesi/ja i/e kërkesës për leje ndërtimore ka siguruar marrëveshje paraprake me pronarët e tokave fqinje për të arritur distancën 4m në mes të ndërtesave atëherë raporti maksimal i lejuar për:

- **Ndërtesë të veçantë është:**

  2.00m nga kufiri i parcelës me marrëveshje me fqinjë që edhe ai të ketë minimum të njëjtën distancë nga kufiri i parcelës për të formuar distancën minimale në mes të ndërtesave 4m dhe në fasadat të cilat përdorin këtë raport nuk lejohen të kenë hapësira të jashtme si logja, ballkonet, tarracat, kopshtet dhe atriumie, apo hapje në hapësira për banim si: dhoma e ditës, dhoma gjumi, apo dhoma për shumë qëllime, dhoma, tryezaria dhe kuzhina.

- **Ndërtesë dyshe:**

  Në këto ndërtesa kemi dy mundësi për distance nga kufiri I parcelave fqinje, kufiri nga parcela kadastrale me të cilën nuk lejohet bashkimi por duhet të përdoret raporti 2L/1GJ referoju nënkapitullit 2.1, si dhe kufiri me parcelën fqinje deri në bashkim të ndërtesave referoju nënkapitullit 2.2.

- 2.1. Në njërën anë distanca nga kufiri i parcelës llogaritet duke përdorur raportin 2L/1GJ me parcelën kadastrale fqinje me pronarin e të cilës nuk lejohet marrëveshja për bashkim të ndërtesave;
- 2.2. Në njërën anë ku lejohet ndërtimi i mureve të jashtme në largësi 10cm nga kufiri i parcelës kadastrale, (pjesa ku është siguruar marrëveshja me pronarin e parcelës fqinje për bashkim të ndërtesave) nuk mund të kenë hapje apo konzollë dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri, gjersa në fasadat ballore ngjitur me këtë mur hapjet, logjat, ballkonet, tarracat, kopshtet, atrium dhe konzollat duhet të largohen së paku 1.5m nga kufiri i parcelës për të cilën është arritur marrëveshja me fqinjët;

Te ky tip i ndërtesave është e domosdoshme që me njërën parcelë kadastrale anësore fqinje të respektohet rregulli 2.1 si dhe në anën tjetrën 2.2.

- **Ndërtesë në varg :**

  Në këtë tipologji të ndërtesave lejohet bashkimi i ndërtesave në të dy anët me parcelat fqinje, gjithmonë me marrëveshje në mes fqinjëve, rregulli I bashkimit të ndërtesave në mes vete vlen si në nënkapitullin 3.1.

  - 3.1. Lejohet ndërtimi i mureve të jashtme në largësi 10cm nga kufiri i parcelës kadastrale anësore, nuk mund të kenë hapje apo konzollë dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri, gjersa në fasadat ballore ngjitur me këtë mur hapjet, logjat, ballkonet, tarracat, kopshtet, atriumet dhe konzollat duhet të largohen së paku 1.5m nga kufiri i parcelës për të cilën është arritur marrëveshja me fqinjët. Numri i maksimal i lejuar i ndërtesave në varg është 8 ndërtesa.

Distanca minimale ndërmjet ndërtesës dhe kufirit anësor dhe të pasmë të parcelave kadastrale, me kthina primare në fasada, në rast të pamundësisë të zbatimit të kushteve të përmendura më lart, në zona veç më të ndërtuara (të mbushura me ndërtim më shumë se 60%), është së paku një e katërta (1/4) e lartësisë të ndërtesës më të lartë.

- **Lartësite maksimale të lejuara brenda zonës:**
  - Në ZB-4, lartësia maksimale është 22m.
  - Në ZB-5, lartësia maksimale është 27m.
  - Në ZB-6, lartësia maksimale është 30m.

- **Ndërhyrjet e lejuara në lartësi**

Elementet dhe struktura e mëposhtme lejohen të ndërhyjnë në kufizimet e zonës për lartësi maksimale ;

1. Kambanarët, majat, sahat kullat ose kullat e kambanave, kupolat, ose shtizat e flamujve;
2. Oxhaqet ose pirgjet;
3. Antenat e radios, televizionit ose telekomunikimit;
4. Pajisjet ndihmëse për navigim;
5. Kullat ose shtyllat e tensionit të lartë;
6. Konstruksionet e rezervuarve të ujit;
7. Hangarët, siloset, furrat, mullinjtë me erë, hambarët e drithërave;
8. Kullat e ashensorëve ose nën-kulmet mekanike që zënë jo më shumë se 10 për qind të sipërfaqes së kulmit të një ndërtese në të cilën ndodhet.

- **Distancat në mes ndërtesave të banimit në raport me zona të tjera:**

1. Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore është jo me e vogël se 1.5 herë lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat si më lartë.
2. Në sipërfaqet e mbrojtura, zonat mbrojtëse, zonat e veçanta, zonat e veçanta të mbrojtura duhet të respektohen me ligjet si dhe rregulloret sektoriale. Në çdo rast distancat ndërmjet ndërtesave nuk duhet të jenë më të vogla sesa ekzistuese.

3. Distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4 metra i gjerë dhe 5 metra i lartë.
4. Distancat minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në raport me lumenjtë në raste kur është i përcaktuar brezi i gjelbër mbrojtës 10m i lumit është së paku një e katërta (1/4) e lartësisë të ndërtesës nga brezi mbrojtës dhe vlen për zonat brenda kufirit të zonës urbane, në raste kur nuk kemi të përcaktuar brezin mbrojtës përgjatë lumit, distanca nga kufiri i parcelës së lumit duhet të jetë minimum 10m. Për zonat rurale distancat duhet të ruhen sipas Ligjit Nr. 04/L – 147 për ujërat e Kosovës.

- **Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)**

Në **ZB-4,** përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e Veçantë 30% ,
- Ndërtesë Dyshe 35%,
- Ndërtesë në Varg 40%,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është:

- Ndërtesë e Veçantë 40% ,
- Ndërtesë Dyshe 30%,
- Ndërtesë në Varg 20%.

Në **ZB-5**, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e Veçantë 30% ,
- Ndërtesë Dyshe 35%,
- Ndërtesë në Varg 40 %,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është:

- Ndërtesë e Veçantë 40% ,
- Ndërtesë Dyshe 30%,
- Ndërtesë në Varg 20%.

Në **ZB-6**, përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës është:

- Ndërtesë e Veçantë 30% ,
- Ndërtesë Dyshe 35%,
- Ndërtesë në Varg 40 %,

Ndërsa përqindja sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale është:

- Ndërtesë e Veçantë 40% ,
- Ndërtesë Dyshe 35%,
- Ndërtesë në Varg 30%.

Përqindja e sipërfaqes nëntokësore të parcelës (SNP) maksimale nuk është më shumë se 80% nga sipërfaqja e përgjithshme në prerje ortogonale e parcelës kadastrale në të gjitha zonat e banimit.

Në kuadër të ISN – ve lejohet shfrytëzimi i 20% të ISN për shfrytëzime të lejuara dytësore, të lejuara të veçanta dhe të lejuara të përkohshme, të cilat janë të përcaktuara më sipër.

- **Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)**

Në ZB-4, indeksi e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, (ISN) është:

- Ndërtesa të Veçanta 1.70,
- Ndërtesa Dyshe 2.00 dhe
- Ndërtesa në varg 2.40.

Shërbim i mbrojtjes dhe sigurisë sociale	LV	LV		
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike				
Rrjetet e transportit	LD	LD		
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	LV	LV		
Shërbim publik	LV	LV		
Shërbime teknike profesionale dhe shkencore	LD	LD		
Banim				
Banim i përhershëm	N	N		
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LV	LV		
L-lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar				

- **Vija rregullative**

Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikuar publike.

Në raste të planifikimit të rrugëve të reja tek të cilat duhet të caktohen gjerësitë e rrugëve si dhe vija rregulluese, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor si:

Tabela 36 Vija rregulluese sipas profileve të rrugëve të planifikuara.

GJËRËSIA E RRUGËS	VIJA RREGULLUESE
Rrugë të rrjetit nacionale apo regjionale- 23,00m.	11.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët transite Urbane – 21,00m.	10.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës
Rrugët Transite nëpërmjet vendbanimeve – fshatrave – 9,50m.	4.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët përmbledhëse / shpërndarëse – 10,50m.	5.25m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët Servisore – 9,00m.	4.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët banesore- 8,50m.	4.25m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët industriale – 10,00m.	5.00m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët qaseshe / dykahëshe – 5,50m.	2.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët qaseshe / njëkahëshe – 3,50m.	1.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Plotësim	Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën rregulluese të planifikuar konform Rregullores për Bonuse të zonimit.

- **Etazhiteti**
  - Në ZK-1, numri i etazheve të lejuara është dy, përkatësisht B+P+1.
  - Në ZK-2, numri i etazheve të lejuara është dy, përkatësisht B+P+1.

- **Vija ndërtimore**

Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike është 8m.

Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zoonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën ndërtimore të planifikuar.

- **Ndërhyrjet e lejuara në lartësi**

Elementet dhe struktura e mëposhtme lejohen të ndërhyjnë në kufizimet e zonës për lartësi maksimale ;

1. Kambanarët, majat, sahat kullat ose kullat e kambanave, kupolat, ose shtizat e flamujve;
2. Oxhaqet ose pirgjet;
3. Antenat e radios, televizionit ose telekomunikimit;
4. Pajisjet ndihmëse për navigim;
5. Kullat ose shtyllat e tensionit të lartë;
6. Konstruksionet e rezervuarve të ujit;
7. Hangarët, siloset, furrat, mullinjtë me erë, hambarët e drithërave;
8. Kullat e ashensorëve ose nën-kulmet mekanike që zënë jo më shumë se 10 për qind të sipërfaqes së kulmit të një ndërtese në të cilën ndodhet.

- **Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)**

1. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale (ISHPKZh) për ZK-1 është 50%;
2. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale (ISHPKZh) për ZK-2 është 50%.

- **Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)**

1. Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar ISN për ZK-1 është 1.0;
2. Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar ISN për ZK-2 është 1.0;

- **Kërkesat minimale për vend-parkingje**

Parkingu përgjatë rrugës publike dhe parkingjet e përbashkëta të cilat i kemi shprehur si:

Aty ku është e nevojshme përgjatë rrugës të ketë parkingje dhe ku paraqitet nevoja të ketë parkingje të përbashkëta këto duhet të punohen sipas normave të planifikimit hapësinorë të specifikuara për parkingje përgjatë rrugës dhe parkingje të përbashkëta.

Tabela 37 Kërkesat minimale për vend – parkingje ne zona komerciale ZK

Komerciale	Shitje me pakicë	4VP/100m² të hapësirës shitëse
	Treg	3VP/100m²të hapësirës shitëse
	Depo dhe shitje me shumicë	1VP/100m² të hapësirës shitëse
	Artizanale	2VP/100m² të hapësirës shitëse

- **E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese ndaj ndërtesave të banimit**

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese të banimit. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën 11 dhe vlenë për ndërtesat të cilat janë fqinje me ndërtesat e banimit.



Figura 8 Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°

- **Qasja adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike**

Secila ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sjellët Situacioni që përmban infrastrukturën teknike ekzistuese.

Të gjitha ndërtesat duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas standardeve që i përgjigjen nevoja të personave me aftësi të kufizuara.

- **Kufizimet ndaj zhurmës**

Kufizimet e depërtimit të zhurmës në mjedis të hapur dhe mjedise të mbyllura fqinje janë sipas intervaleve kohore:

- 08:00-22:00 = 45db (A); dhe
- 22:00-08:00 = 35db (A).

- **Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore**

Nëse brenda zonës ka zona të tilla atëherë masat për mbrojtjen e tyre janë precizuar në kuadër të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

- **Kërkesa tjera për rregullim të hapësirës gjatë përcaktimit të kushteve ndërtimore**

Parcela zhvillimore minimale për zhvillim është 1,000m^2.

▪ **Formësimi arkitektonik dhe estetik**

Fasadat si elemente kryesore me rëndësi estetike dhe formësuese tek ndërtesat, duhet të jenë në harmoni të plotë me ndërtesat tjera ekzistuese të zonës, kjo për arsye të kontekstualizmit në arkitekturë.

1. **Në raste të zonave të reja ku nuk kemi ndërtesa tjera apo zona nuk ka formuar kontekstin arkitektonik dhe urban, ndërtesat duhet ti zbatojnë këto kushte për formësim arkitektonik.**

   Në Zona Komerciale, fasada duhet te jete ngjyre e bardhë me sipërfaqe prej 60%, lejohet përdorimi i tullave të fasadës me sipërfaqe prej 40%, kornizat e dritareve duhet të jetë nga druri ose PVC me teksturë druri apo ngjyrë të zezë, ngjyra e tjegullave të kulmeve duhet të jetë e kuqe, apo hiri e mbyllur.

   - **Dizajn i Diversifikuar:**

     Fasadat duhet të kenë një dizajn të larmishëm për të krijuar një ndjesi dinamike dhe tërheqëse vizuale. Përdorimi i ngjyrave, materialeve dhe formave të ndryshme mund të kontribuojë në një identitet të fortë vizual për çdo ndërtesë.

   - **Vitrinat dhe Ndriçimi Natyror:**

     Fasadat me dritare të mëdha dhe vitrina lejojnë ndriçimin natyror të depërtojë brenda ndërtesave, duke përmirësuar përvojën e blerësve dhe duke reduktuar nevojën për ndriçim artificial. Kjo jo vetëm që kursen energji, por gjithashtu krijon një ambient më të shëndetshëm.

   - **Elementet e Fasadeve të Gjelbra:**

     Integrimi i kopshteve vertikale dhe bimëve të varura për të krijuar një lidhje me natyrën dhe për të përmirësuar mikroklimën urbane. Fasadat e gjelbra gjithashtu ndihmojnë në reduktimin e ndotjes akustike dhe rregullimin e temperaturës.

     Forma e kulmit duhet të jetë dy ose me shumë ujor, Strehët e kulmit duhet të jenë me gjatësi deri në një metër, kjo për arsye të mbrojtjes së dritareve nga rrezet e diellit gjatë periudhës së verës dhe mbrojtjes së mureve anësore nga lagështia gjatë reshjeve atmosferike.

     Në zona ku 80% e ndërtesave është aplikuar kulmi i rrafshët (me Atikë) mund të përdoret edhe në ndërtesat e reja.

2. **Kulmet e Gjelbra dhe të Përdorshme:**

   Kulmet e gjelbra dhe ato të përdorshme (rooftop gardens) mund të shfrytëzohen për të krijuar hapësira sociale, si kafene, restorante apo zona rekreative. Këto kulme ndihmojnë në menaxhimin e ujërave të shiut dhe përmirësojnë izolimin termik.

   - **Kulmet Fotovoltaike:**

     Integrimi i paneleve diellore në kulme për të prodhuar energji të pastër. Kjo mund të ndihmojë në reduktimin e kostove të energjisë dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë mjedisore.

   - **Kulmet e Dizajnuara Estetikisht:**

     Përdorimi i dizajnëve inovative për kulmet, si forma të pjerrëta, kulme të valëzuara apo struktura të mbuluara me material reflektues, mund të shtojë interes vizual dhe të kontribuojë në identitetin e zonës.

3. **Materiale të Qëndrueshme:**

Përdorimi i materialeve të riciklueshme dhe të qëndrueshme si druri i certifikuar, betoni i ricikluar dhe çeliku i qëndrueshëm. Këto materiale kanë një ndikim të ulët mjedisor dhe ndihmojnë në krijimin e ndërtesave ekologjike.

Tekstura dhe Ngjyrat:

Zgjedhja e materialeve me tekstura dhe ngjyra të ndryshme për të krijuar fasada tërheqëse dhe që reflektuar identitetin e brendshëm të hapësirave komerciale. Ngjyrat e gjalla dhe të qeta mund të përdoren për të krijuar atmosferë të ndryshme sipas llojit të biznesit.

Teknologjitë Inovative:

Implementimi i materialeve vetë-pastruese, si dhe panele fotovoltaike të integruara në ndërtesa (BIPV) për të maksimizuar efikasitetin energjetik dhe për të reduktuar kostot e mirëmbajtjes.

Formësimi arkitektonik dhe estetik i zonave komerciale duhet të balancojë funksionalitetin dhe tërheqjen vizuale për të krijuar mjedise të qëndrueshme dhe të këndshme. Duke integruar fasada tërheqëse, kulme inovative dhe materiale të qëndrueshme, si dhe duke krijuar hapësira publike të menduara mirë, zonat komerciale mund të shndërrohen në qendra të gjalla të jetës urbane që ofrojnë një përvojë të pasur për të gjithë përdoruesit.

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit**

Të gjithë shiritat e gjelbër përgjatë rrugëve duke i përfshirë edhe ata që kane karakter mbrojtës duhet të jenë me bimë – drunjtë të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për peizazhe atraktive dhe rregullatorë të mjedisit.

Tabela 38 Përcaktimi i numrit të përafërt të llojeve gjetherënëse për zonat komerciale

	ZK-1	ZK-2
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	1000	1000
Përqindja e gjelbërimit (%)	50%	50%
Nr. i fidanëve	8	8

Tabela 39 Përcaktimi i numrit të përafërt të llojeve të përhershme për zonat komerciale

	ZK-1	ZK-2
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	1000	1000
Përqindja e gjelbërimit (%)	50%	50%
Nr. i fidanëve	11	11

Tabela 40 Kushtet ndërtimore për Zonat Komerciale (ZK)

Kushtet ndërtimore	**ZK-1**	**ZK-2**
Vija Ndërtimore	8m	8m
Vija rregullative nga Vija Rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar
Etazhiteti	B+P+1	B+P+1
ISHPKZh	50%	50%
% e gjelbërimit	50%	50%
SNP	80%	80%
ISN	1.0	1.0
Koeficienti minimal I përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore nga zhurma	08:00-22:00= 45db (A)	08:00-22:00= 45db (A)
	22:00-08:00 = 35db (A)	22:00-08:00 = 35db (A)
Madhësia e parcelës kadastrale për zhvillim	Min : 10 ari	Min : 10 ari
Gjatësia e pjesës së përparme të parcelës kadastrale për zhvillim	Min. 20 m	Min. 20 m
Lartësia maksimale e ndërtesave	13m	13m

- **Bonuset e zonimit**

Komuna e Vitisë do miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit sipas UA mbi Normat teknike të planifikimit hapësinor.

Bonuset e zonimit janë stimulime që do të jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik. Bonuset e zonimit janë brenda udhëzimit administrativ për norma teknike të planifikimit hapësinor dhe përfshijnë si më poshtë;

Bonuse t e zonimit te cilat jepen për zonat komerciale duhet të jenë konformn normave teknike te planifikimit dhe udhëzimit administrativ për zonën përkatëse në kapitllin IV të normave teknike te planifikimit hapësinor.

- Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
- Zvogëlim apo lirim nga taksat për leje ose tarifat për infrastrukturë;
- Zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi;
- Rritje e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmërisë së shputës në raport me parcelën kadastrale;
- Rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës;
- Rritje të dendësisë; dhe
- Stimulim i propozuar nga zhvilluesi ose komuna për të integruar dhe përmirësuar vendbanimet joformale;

Komuna do të përdore bonuset e zonimit vetëm për projekte te interesit publik, këto projekte konsiderohen si bazë për të ofruar bonuset e zonimit vetëm në raste kur Komuna nuk e ka zbatuar projektin bazuar ne planin e veprimit per zbatim ne mungese te buxhetit.

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.4. ZONAT INDUSTRIALE (ZI-1 DHE ZI-2)

Zonat industriale shënohen me kodin ZI dhe janë të ndara sipas përmbajtjes në tri kategori kryesore si : ZI-1 dhe ZI-2

Tabela 41 Zonat Industriale

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Struktura e ndertuar	HILUCS 1	HILUCS 2	HILUCS 3	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZI-1	Zonë Industriale	Sipërfaqe sub-urbane	Prodhim dytësor	Industri e prodhimeve të lehta	Prodhim i produkteve tjera te lehta	197.35
ZI-2	Zonë Industriale	N/A	Prodhim dytësor	Prodhim i energjisë	Prodhim i energjisë së ripërtëritshme	409.84

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në kuadër të **ZI-1** shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet në vijim:

- Industri e lëndës së parë, industri e prodhimeve të rënda, industri e prodhimeve të lehta, prodhim i energjisë, shërbim tregtar, Shërbim profesional financiar dhe i informacionit si dhe Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ.

Në kuadër të **ZI-2** shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet në vijim:

- Shërbim tregtar, prodhim i energjisë së ripërtëritshme, prodhim i energjisë së bazuar në biomasë.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në kuadër të **ZI-1** shfrytëzime të lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Infrastrukturë e transportit rrugor, infrastrukturë e transportit hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, shërbim arsimor, infrastrukturë e telekomunikacionit.

Në kuadër të **ZI-2** Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Infrastrukturë e transportit rrugor, infrastrukturë e transportit hekurudhor, infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike dhe elektrike, infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, infrastrukturë e telekomunikacionit.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të **ZI-1 dhe ZI-2**, por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të ZI-1 dhe ZI-2 por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZI-1 dhe ZI-2** pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak dhe Mbledhje e produkteve natyrore, pylltari, miniera dhe gurore, energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna, ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore, paraprakisht kërkohet të bëhet një plan fizibiliteti për potencialet energjetike për energji të ripërtrishme).

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Funksionet dhe aktivitet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të zonave industriale për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone janë të gjitha zonat të cilat nuk janë të përfshira në: Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

Tabela 42 Kushtet zhvillimore për Zone Industriale (ZI)

Lloji i funksioneve dhe aktiviteteve	Kushtet e shfrytëzimit		Hilucs3	
Hilucs2	**ZI-1**	**ZI-2**	**LV**	**N**
Prodhim primarë				
Bujqësi	LP	LP		
Pylltari	LP	LP		
Minierë dhe gurore	LP	LP		
Akuakulturë dhe peshkim	LP	N		
Prodhimtari parësore tjetër	LP	LP		
Prodhim dytësor				
Industri e lëndës së parë	L	N		
Industri e prodhimeve të rënda	L	N		
Industri e prodhimeve të lehta	L	N		
Prodhim i energjisë	L	L		
Prodhim tjetër dytësorë	L	L		
Prodhim tretësor				
Shërbim tregtar	L	L		
Shërbim profesional financiar dhe i informacionit	L	LD		
Shërbim i komunitetit	LD	LV		
Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	L	LD		
Shërbim tjetër	LD	LD		
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike				
Rrjetet e transportit	LD	LD		
Shërbim i logjistikës dhe magazinimit	LD	LD		
Shërbim publik	LD	LD		
Banim				
Banim i përhershëm	N	N		
Banim me funksione të tjera në pajtueshmëri	LV	LV		
L-lejuar; LD-Lejuar Dytësore; LV-Lejuar e Veçantë; LP-Lejuar e Përkohshme dhe N-Ndaluar				

- **Etazhiteti**

Numri maksimal i etazheve të lejuara mbi nivelin më lartë të rrugës publike që shërben për qasje kryesore në parcelë në:

- Në ZI-1, numri i etazheve të lejuara është dy, përkatësisht B+P+1,
- Në ZI-2, numri i etazheve nuk aplikohet pasi që është Zonë Industriale për prodhimin e energjisë solare.

- **Vija rregullative**

Vija rregullative është e definuar nga profili i rrugës së planifikuar publike.

Në raste të planifikimit të rrugëve të reja tek të cilat duhet të caktohen gjerësitë e rrugëve si dhe vija rregulluese, duhet të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor si:

Tabela 43 Vija rregulluese sipas profileve të rrugëve të planifikuara

GJËRËSIA E RRUGËS	VIJA RREGULLUESE
Rrugë të rrjetit nacionale apo regjionale- 23,00m.	11.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët transite Urbane – 21,00m.	10.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës
Rrugët Transite nëpërmjet vendbanimeve – fshatrave – 9,50m.	4.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët përmbledhëse / shpërndarëse – 10,50m.	5.25m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët Servisore – 9,00m.	4.50m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët banesore- 8,50m.	4.25m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët industriale – 10,00m.	5.00m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët qaseshe / dykahëshe – 5,50m.	2.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Rrugët qaseshe / njëkahëshe – 3,50m.	1.75m nga Vija Aksiale Qarkulluese e Rrugës.
Plotësim	Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën rregulluese të planifikuar konform Rregullores për Bonuse të zonimit.

- **Vija ndërtimore**

Vija ndërtimore përgjatë rrugës publike është 8m.

Autoriteti përgjegjës komunal mund edhe të aplikoj bonuset e zoonimit gjatë përpjekjeve për të zbatuar vijën ndërtimore të planifikuar.

- **Distanca në mes të një objekti Industrial dhe një ndërtese jo Industriale**

Distancat në mes objekteve industriale përcaktohen në përputhje me rregullat e sigurisë së ndërtesës dhe aktiviteteve që zhvillohen në to, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Distanca në mes të një objekti industrial dhe një ndërtese jo industriale nuk duhet të jetë më pak se lartësia maksimale mbi tokë e ndërtesës më të lartë fqinje.

- **Ndërhyrjet e lejuara në lartësi**

Elementet dhe struktura e mëposhtme lejohen të ndërhyjnë në kufizimet e zonës për lartësi maksimale ;

1. Kambanarët, majat, sahat kullat ose kullat e kambanave, kupolat, ose shtizat e flamujve;
2. Oxhaqet ose pirgjet;
3. Antenat e radios, televizionit ose telekomunikimit;
4. Pajisjet ndihmëse për navigim;
5. Kullat ose shtyllat e tensionit të lartë;
6. Konstruksionet e rezervuarve të ujit;
7. Hangarët, siloset, furrat, mullinjtë me erë, hambarët e drithërave;
8. Kullat e ashensorëve ose nën-kulmet mekanike që zënë jo më shumë se 10 për qind të sipërfaqes së kulmit të një ndërtese në të cilën ndodhet.

- **Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh)**

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale (ISHPKZh) për ZI-1 është 45%;

Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale (ISHPKZh) për ZI-2 nuk aplkohet - Zonë Industriale për prodhimin e energjisë solare.

- **Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar (ISN)**

Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar ISN për ZI-1 është 0.9;

Indeksi i sipërfaqes së ndërtuar ISN për ZI-2 nuk aplkohet - Zonë Industriale për prodhimin e energjisë solare.

- **Kërkesat minimale për vend-parkingje**

Kërkesat minimale për vend-parkingje në zona industriale **ZI** janë:

Industriale	Ndërtesat e industrive	1VP/100m² të hapësirës shitëse
	Ndërtesat e zanateve	2VP/100m² të hapësirës shitëse

- **E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese ndaj ndërtesave të banimit**

Ndriçimi natyror për dritaret paraqet rregullin e rrafshit imagjinar në kënd prej 45° për të siguruar ndriçim natyror dhe diellosje për strukturat ekzistuese. Rrafshi imagjinar është i projektuar për të siguruar dritë dhe ajër në nivelin e dritares më të ulët të ndërtesave te propozuara dhe ekzistuese. Ky kusht ndërtimor është i paraqitur në mënyrë figurative në figurën:



Figura 9 Shembulli i llogaritjes së lartësisë për bazuar në këndin 45°

- **Qasja adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike**

Secila ndërtesë duhet të gëzojë qasje në infrastrukture teknike dhe atë publike, duke mos penguar fqinjët, apo infrastrukturën teknike ekzistuese.

Si pjesë e dokumentacionit për aplikim për Kushte dhe Leje ndërtimore duhet të sjellët Situacioni që përmban infrastrukturën teknike ekzistuese.

Të gjitha objektet e banimit duhet të dizajnohen dhe ndërtohen sipas standardeve që i përgjigjen nevoja të personave me aftësi të kufizuara.

- **Kufizimet ndaj zhurmës**

Kufizimet e depërtimit të zhurmës në mjedis të hapur dhe mjedise të mbyllura fqinje janë sipas intervaleve kohore:

- 08:00-22:00 = 45db (A), dhe
- 22:00-08:00 = 35db (A).

- **Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore**

Nëse brenda zonës ka zona të tilla atëherë masat për mbrojtjen e tyre janë precizuar në kuadër të ligjeve dhe udhëzimeve administrative.

- **Kërkesa tjera për rregullim të hapësirës gjatë përcaktimit të kushteve ndërtimore**

Parcela zhvillimore minimale për zhvillim është 1,000m^2.

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit**

Të gjithë shiritat e gjelbër përgjatë rrugëve duke i përfshirë edhe ata që kane karakter mbrojtës duhet të jenë me bimë – drunjtë të cilët kanë aftësi dhe kapacitete për peizazhe atraktive dhe rregullatorë të mjedisit.

- **Formësimi arkitektonik dhe estetik**

Fasadat si elemente kryesore me rëndësi estetike dhe formësuese tek ndërtesat, duhet të jenë në harmoni të plotë me ndërtesat tjera ekzistuese të zonës, kjo për arsye të kontekstualizmit në arkitekturë.

1. **Në raste të zonave të reja ku nuk kemi ndërtesa tjera apo zona nuk ka formuar kontekstin arkitektonik dhe urban, ndërtesat duhet ti zbatojnë këto kushte për formësim arkitektonik.**
   - **Fasadat e Gjelbra:**
     Integrimi i kopshteve vertikale dhe muraleve të gjelbra jo vetëm që përmirëson estetikën, por edhe përmirëson cilësinë e ajrit dhe redukton efektin e ngrohjes urbane. Bimësia e zgjedhur duhet të jetë autoktone dhe e qëndrueshme ndaj kushteve lokale klimatike.
   - **Fasadat e Transparente dhe Përdorimi i Xhamit:**
     Përdorimi i xhamit të dyfishtë ose të trefishtë për të rritur izolimin termik dhe akustik. Fasadat transparente mund të lejojnë ndriçimin natyror dhe të krijojnë një ndjesi hapësire dhe transparence.
   - **Materiale të Avancuara:**
     Përdorimi i materialeve moderne si panele metalike të përpunuara, alumini dhe çeliku të qëndrueshëm. Këto materiale ofrojnë një pamje industriale moderne dhe janë rezistente ndaj kushteve të vështira atmosferike.
2. **Në Zona Industriale, preferohet kulmi dyujor ose i rrafshët.**
   - **Kulmet e Gjelbra:**
     Instalimi i kulmeve të gjelbra (green roofs) për të rritur izolimin termik dhe për të krijuar hapësira të gjelbra të përdorshme. Këto kulme ndihmojnë gjithashtu në menaxhimin e ujërave të shiut dhe përmirësimin e biodiversitetit urban.
   - **Panelet Diellore:**
     Integrimi i paneleve diellore për të prodhuar energji të pastër dhe për të reduktuar varësinë nga burimet tradicionale të energjisë. Kulmet e pjerrëta ose të sheshta mund të shfrytëzohen për të maksimizuar ekspozimin ndaj diellit.
   - **Izolimi Efikas:**
     Përdorimi i materialeve të izoluara si poliuretani ose materiali i ricikluar për të siguruar izolim termik dhe për të reduktuar humbjet e energjisë. Kjo ndihmon në mbajtjen e një klime të brendshme të qëndrueshme dhe në reduktimin e kostove të ngrohjes dhe ftohjes.
3. **Përdorimi i Materialeve:**
   - **Materiale të Qëndrueshme dhe të Riciklueshme:**
     Përdorimi i materialeve që kanë një cikël jete të gjatë dhe që mund të riciklohen në fund të përdorimit të tyre, si druri i certifikuar, betoni i ricikluar dhe çeliku i përpunuar. Këto materiale reduktojnë ndikimin mjedisor dhe promovojnë qëndrueshmërinë.

- **Tekstura dhe Ngjyrat:**

  Zgjedhja e teksturave dhe ngjyrave që harmonizohen me peizazhin lokal dhe që krijojnë një identitet vizual të veçantë për zonën industriale. Ngjyrat e qëndrueshme dhe materialet rezistente ndaj ndryshkut dhe korrozionit janë të rëndësishme për mbajtjen e pamjes së ndërtesave.

- **Inovacionet në Materiale:**

  Implementimi i teknologjive të reja si panele fotovoltaike të integruara në ndërtesa (BIPV) dhe materiale vetë-pastruese që reduktojnë nevojat për mirëmbajtje dhe rrisin efikasitetin energjetik.

  Integrimi i fasadave të gjelbra, kulmeve inovative dhe materialeve të qëndrueshme në dizajnin e zonave industriale krijon një mjedis që është funksional, efikas dhe estetikisht i këndshëm. Kjo qasje promovon një model të ri për zhvillimin industrial që është në harmoni me natyrën dhe nevojat moderne të shoqërisë, duke përmirësuar cilësinë e jetës për punonjësit dhe komunitetin përreth.

▪ **Mbjellja e bimëve/drunjëve të Rrugës**

Në përputhje me kërkesat themelore të zonës, një bimë/dru rruge, ekzistuese ose i mbjellë rishtas, duhet të sigurohet për çdo 6 metra ballë rruge të zonës. Pjesët e barabarta ose më të mëdha se gjysma që rezultojnë nga kjo llogaritje duhet të kenë një bimë/dru. Këto bimë/drunjë duhet të mbillen në intervale afërsisht të barabarta përgjatë gjithë gjatësisë së parcelës pranë rrugës.

Shënim:

Aty ku Drejtoria përgjegjëse e Komunës përcakton që një mbjellje e tillë do të ishte e pamundur pranë zonës, ose në zona historike ku përcaktohet që një mbjellje e tillë e pemëve nuk do të ishte në karakter me zonën, bimët/drunjtë duhet të mbillen në një vend alternativ, që do të zgjidhet nga Drejtoria përgjegjëse e Komunës, përveç nëse Drejtoria përgjegjëse e Komunës përcakton që asnjë vend alternativ nuk është i disponueshëm, ose nëse asnjë vend alternativ nuk ofrohet brenda 30 ditëve nga aplikimi në Drejtorinë përgjegjëse të Komunës.

Në rast të pamundësisë për mbjellje të një bimë/druri të përcaktuar nga Drejtoria përgjegjëse e Komunës, ose në rast se mbjellja nuk mund të përfundojë për shkak të sezonit, fonde ekuivalente me koston e mbjelljes së një bime/druri, mund të depozitohet në një llogari të Komunës. Fonde të tilla do t'i kushtohen mbjelljes së bimëve/drunjëve në rrugë nga Komuna në një vendndodhje alternative ose, në rastin e një depozite jashtë sezonit, në sezonin e ardhshëm të duhur të mbjelljes.

Llojet dhe madhësia e bimëve/drunjëve të rrugës do të përcaktohen nga Drejtoria përgjegjëse e Komunës, dhe të gjitha bimët/drunjtë e tilla do të mbillen në përputhje me standardet e mbjelljes së bimëve/drunjëve në rrugë të Drejtorisë përgjegjëse të Komunës.

	ZI-1	ZI-2
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	1000	Zonë Industriale për prodhimin e energjisë solare.
Përqindja e gjelbërimit (%)	55%	
Nr. i fidaneve	9	

Tabela 44 Kushtet ndërtimore për Zonat Industriale (ZI) ZI-1 dhe ZI-2:

Kushtet ndërtimore	**ZI-1**	**ZI-2**
Vija Ndërtimore	8m	Zonë Industriale për prodhimin e energjisë solare.
Vija rregullative	Profili i rrugës së planifikuar	
Etazhiteti	P+1	
ISHPKZh	45%	
% e gjelbërimit	55%	
SNP	80%	
ISN	0.9	
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m²	
Koeficienti minimal I përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	
	Kulmi 0.3	
	Dyshemeja 0.5	
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00 = 45db (A)	
	22:00-08:00 = 35db (A)	
Madhësia e parcelës kadastrale për zhvillim	Min. : 15 ari	
Gjatësia e pjesës së përparme të parcelës kadastrale për zhvillim	Min. : 30 m	
Lartësia maksimale e ndërtesave	8m	

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.5. ZONAT REKREATIVE-TURISTIKE (ZrT)

Zonat Rekreative-Turistike shënohen me kodin **ZrT-1, ZrT-2 dhe ZrT-3** dhe janë sipërfaqe të dedikuara për pushim, rekreacion, argëtim, turizëm natyror, rural, kulturor dhe zhvillim të aktiviteteve përcjellëse që lidhen me vlerat natyrore, peizazhore, kulturore dhe historike të komunës.

Në kuadër të Hartës Zonale Komunale të Vitisë, këto zona janë përcaktuar në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal të Vitisë 2023–2031, i cili e njeh turizmin natyror, rural, kulturor dhe shëndetësor si potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal.

Sipas PZHK-së, potencialet kryesore për turizëm natyror dhe rural lidhen sidomos me zonat e Debelldehut, Kabashit, Letnicës, Sllatinës, Stubëllës së Epërme, Smirës dhe Tërpezës, ndërsa potencialet për turizëm kulturor lidhen me lokalitetet dhe vendbanimet me trashëgimi kulturore, historike dhe shpirtërore, si Letnica, Binça, Gërnçari, Pozherani, Smira, Stublla, Tërpeza dhe vendbanime të tjera me vlera të ngjashme.

Qëllimi i këtyre zonave është krijimi i kushteve për zhvillim të kontrolluar të turizmit, rekreacionit dhe aktiviteteve përcjellëse, duke ruajtur vlerat natyrore, peizazhore, kulturore dhe mjedisore të hapësirës. Zhvillimi në këto zona duhet të jetë në harmoni me karakterin e lokacionit, kapacitetin mbajtës të mjedisit, infrastrukturën ekzistuese dhe të planifikuar, si dhe me objektivat e PZHK-së për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe ruajtje të resurseve natyrore.

Tabela 45 Zonat Rekreative Turistike

Zona bazë	Kodi bazë	Destinimi	Kodi identifikues i zonës	Sipërfaqe për zhvillim (ha)
Zonë rekreative-turistike	ZrT	Sport – Rekreacion / Komplekse sportive	ZrT-1	19.73
Zonë rekreative-turistike	ZrT	Park, shesh, hapësirë publike rekreative	ZrT-2	4.81
Zonë rekreative-turistike	ZrT	Turizëm natyror, rural, kulturor dhe rekreacion	ZrT-3	16.18

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në të gjitha **ZrT-1** funksionet dhe aktivitete të lejuara janë :

- Infrastrukturë sportive:

  Stadiume, fusha sportive, salla sportive, palestra, pishina, terrene të hapura sportive, komplekse sportive dhe infrastruktura tjera sportive.

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Hapësira të hapura për rekreacion, terrene rekreative, shtigje për ecje/vrapim, hapësira për aktivitete fizike në natyrë.

- Shërbim tjetër rekreativ:

  Shërbime dhe hapësira tjera rekreative që nuk përfshihen në kategoritë tjera, por janë në funksion të sportit dhe rekreacionit.

Në të gjitha **ZrT-2** funksionet dhe aktivitete të lejuara janë :

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Parqe publike, sheshe, hapësira të gjelbra, hapësira publike rekreative, shtigje për këmbësorë, zona pushimi dhe rekreacion në ajër të hapur.

- Shërbim kulturor:

  Hapësira për aktivitete kulturore në ambient të hapur, ekspozita publike, aktivitete artistike, promovuese dhe edukative.

- Shërbim tjetër rekreativ:

  Aktivitete tjera rekreative publike që nuk përfshihen në kategoritë tjera, por janë në funksion të parkut, sheshit dhe hapësirës publike.

Në të gjitha **ZrT-3** funksionet dhe aktivitete të lejuara janë :

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Bujtina, shtëpi pritëse rurale, njësi të vogla akomoduese, fshat turistik, vend kampingu, restorant, bar dhe shërbime ushqimore në funksion të turizmit.

- Shërbim kulturor:

  Hapësira për promovim të trashëgimisë kulturore, vende historike, muze të vegjël, ekspozita kulturore, aktivitete edukative dhe interpretuese.

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Hapësira rekreative në natyrë, shtigje për ecje, çiklizëm, pushim, piknik, rekreacion në pyje, male, fusha, lumenj dhe hapësira natyrore.

- Shërbim tjetër rekreativ:

  Aktivitete të tjera rekreative që nuk përfshihen në klasat e tjera, por që janë në funksion të rekreacionit, turizmit natyror, rural dhe kulturor.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në **ZrT-1** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Kafiteri, bufe, pika ushqimore dhe shërbime të pijeve/ushqimit në funksion të kompleksit sportiv-rekreativ.

- Shërbim tregtar me pakicë:

  Dyqane të vogla për pajisje sportive, suvenire, produkte për vizitorë dhe shërbime të vogla tregtare të lidhura me sportin/rekreacionin.

- Shërbim administrativ dhe mbështetës:

  Administrim, menaxhim, mirëmbajtje, sigurim, recepcion dhe shërbime mbështetëse për funksionimin e kompleksit sportiv.

- Shërbim shëndetësor dhe shoqëror:

  Pika të ndihmës së parë, shërbime mjekësore sportive dhe mbështetje shëndetësore për përdoruesit e kompleksit.

Në **ZrT-2** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Pika të vogla për pije, ushqim të lehtë, kafiteri të vogla dhe shërbime të kufizuara në funksion të përdoruesve të hapësirës publike.

- Shërbim tregtar me pakicë:

  Kioska të vogla, stenda për produkte lokale, shitje sezonale dhe shërbime të vogla tregtare në funksion të hapësirës publike.

- Shërbim administrativ dhe mbështetës:

  Mirëmbajtje, menaxhim, informim, sigurim dhe shërbime mbështetëse për funksionimin e parkut/sheshit.

- Shërbim tjetër i komunitetit:

  Aktivitete komunitare dhe shërbime të vogla publike që mbështesin përdorimin social të hapësirës, pa e zëvendësuar funksionin rekreativ.

Në **ZrT-3** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

- Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë:

  Shitje e produkteve vendore, artizanale, bujqësore, suvenireve dhe produkteve të lidhura me turizmin, vetëm si funksion mbështetës.

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Kafiteri, pika ushqimore, shërbime të vogla gastronomike dhe hapësira pritëse për vizitorë.

- Shërbim administrativ dhe mbështetës:

  Shërbime të menaxhimit, mirëmbajtjes, administrimit, orientimit turistik dhe mbështetjes së aktiviteteve rekreative.

- Shërbim kulturor:

  Hapësira informuese, ekspozuese dhe promovuese për trashëgimi kulturore, natyrore dhe historike.

- Infrastrukturë e transportit rrugor.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Në të gjitha **ZrT-1,** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Shërbim argëtues:

  Aktivitete argëtuese të lidhura me sportin dhe rekreacionin, vetëm kur janë në funksion plotësues të kompleksit dhe nuk e cenojnë destinimin bazë.

- Shërbim kulturor:

  Ngjarje kulturore, ekspozita, aktivitete promovuese dhe manifestime në kuadër të kompleksit sportiv, kur janë të lidhura me funksionin publik/rekreativ.

- Shërbim arsimor:

  Programe trajnimi, edukimi sportiv, kampe edukative sportive dhe aktivitete mësimore në funksion të sportit dhe rekreacionit.

Në të gjitha **ZrT-2,** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Shërbim argëtues:

  Aktivitete argëtuese publike, manifestime, programe festive dhe ngjarje të hapura, vetëm kur nuk e kufizojnë përdorimin publik të hapësirës.

- Infrastrukturë sportive:

  Pajisje të lehta sportive, terrene të vogla të hapura, fusha rekreative dhe elemente sportive në hapësirë publike, vetëm kur janë në harmoni me parkun/sheshin.

- Shërbim arsimor:

  Aktivitete edukative në hapësirë të hapur, programe mjedisore, aktivitete me nxënës/studentë dhe edukim komunitar.

Në të gjitha **ZrT-3,** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Objekte akomoduese turistike me kapacitet më të madh, fshat turistik ose kamping i organizuar, vetëm me kushte shtesë dhe pa cenuar karakterin e zonës.

- Shërbim kulturor:

Ndërhyrje ose aktivitete në afërsi të lokaliteteve me vlera kulturore, historike apo arkeologjike, vetëm me pëlqime përkatëse.

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Zhvillime rekreative në hapësira natyrore, pyjore, bujqësore ose pranë ujërave, vetëm nëse nuk dëmtojnë mjedisin dhe peizazhin.

- Shërbim tjetër rekreativ:

  Aktivitete rekreative të organizuara që kërkojnë kushte shtesë për qarkullim, siguri, mjedis ose infrastrukturë.

- Mbledhje e produkteve natyrore:

  Mbledhje e produkteve natyrore si aktivitet tradicional, edukativ ose turistik, vetëm kur lejohet me rregulla përkatëse dhe nuk dëmton ekosistemin.

▪ **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZrT-1**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Infrastrukturë sportive:

  Gara sportive, turne, aktivitete sportive sezonale, trajnime dhe ngjarje sportive të përkohshme.

- Shërbim tjetër rekreativ:

  Aktivitete rekreative të përkohshme, ditë sportive, aktivitete komunitare rekreative dhe shfrytëzime sezonale.

- Shërbim tregtar me pakicë:

  Stenda të përkohshme për shitje gjatë ngjarjeve sportive, panaire sportive dhe aktivitete të ngjashme sezonale.

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Shërbime të përkohshme të ushqimit dhe pijeve gjatë organizimeve sportive/rekreative.

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZrT-2**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Shërbim kulturor:

  Ekspozita të përkohshme, ngjarje kulturore, aktivitete artistike, promovime dhe manifestime publike.

- Shërbim argëtues:

  Aktivitete argëtuese sezonale, programe festive, shfaqje, koncerte të vogla dhe aktivitete publike të përkohshme.

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Aktivitete rekreative të përkohshme në park/shesh, lojëra, sporte të lehta dhe aktivitete komunitare në ambient të hapur.

- Shërbim tregtar me pakicë:

  Tregje sezonale, panaire lokale, stenda të përkohshme dhe shitje të kufizuara gjatë manifestimeve.

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Shërbime të përkohshme për ushqim dhe pije gjatë ngjarjeve publike.

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZrT-3**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Shërbim kulturor:

  Manifestime kulturore, ekspozita të përkohshme, aktivitete për promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike.

- Hapësirë e hapur rekreative:

  Ecje të organizuara, aktivitete rekreative sezonale, piknik, çiklizëm dhe aktivitete në natyrë.

- Shërbim tjetër rekreativ:

Festivale, ngjarje rekreative, aktivitete turistike sezonale dhe aktivitete të ngjashme të përkohshme.

- Shërbim i akomodimit dhe ushqimit:

  Shërbime të përkohshme të ushqimit dhe pijeve gjatë aktiviteteve të organizuara.

- Shërbim tregtar:

  Panaire sezonale për produkte vendore, artizanale, bujqësore dhe suvenire.

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Në **ZrT-1**, **ZrT-2** si dhe **ZrT-3**, kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë të gjitha zonat të cilat nuk janë të përfshira në:

- Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

Ndalohen ndërtime të larta, krijimi i deponive për mbeturina si dhe aplikimi i të gjitha strukturave dhe infrastrukturës e cila është jashtë Normave dhe Standardeve të lejuara dhe përcaktuara sipas dokumenteve të Planifikimit Hapësinor.

Të gjitha aktivitetet dhe funksionet, përkatësisht çdo ndërtim në kuadër të kësaj zone duhet të dizajnohet dhe ndërtohet sipas kërkesave dhe standardeve që respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

- **Kushtet Ndërtimore për zonën ZrT-1**

Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative përbëhet nga Hapsirat për rekreacion dhe komplekse sportive **ZrT-1**, të cilat kanë kushte specfike dhe rregullohen sipas rregulloreve dhe normave specifike të projektimit. Sa i përket institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative, normat e planifikimit japin këto kushte:

Tabela 46 Kushtet Ndërtimore për zonën ZrT-1

Kushtet ndërtimore	ZrT-1 Zonë Rekreative (Sport – Rekreacion / Komplekse sportive)			
Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës se institucioneve sportive dhe fushave rekreative	≤ 5000 banorë 2.50 m²/banorë	≥5001- 20000 banorë 4.50 m² / banorë	> 20001 banorë 5.00 m² / banorë	
Distanca optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore	800m			
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db(A)
	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db(A)
Lloji I strukturës së ndërtuar	Sipërfaqe Rurale e Përgjithshme			
Lloji I ndërtesës	Sipërfaqe e hapur rekreative	Sipërfaqe e mbyllur rekreative	Tregti me pakicë - lokale	
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	
Vija Ndërtimore nga Vija Rregulluese	6m	6m	6m	
Etazhiteti maksimal		P+0	P+1	
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')		6	7	
H/L nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike		2.5L/1GJ	2.5L/1GJ	
Distanca minimale nga kufiri anësor i parcelës kadastrale	4m'	4m'	4m'	
ISHPKZh	25%	25%	60%	
% e gjelbërimit	40%	40%	50%	
SNP	80%	80%	80%	
ISN	0.25	0.25	0.25	
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m²	2 VP/100 m²	2 VP/100 m²	
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5	
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	
Dendësia maksimale banorë/ha	1-5/ha	1-5/ha	1-5/ha	
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	700	700	700	
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	20	20	20	

- **Kushtet Ndërtimore për zonën ZrT-2**

Në kuadër të zonës **ZrT-2**, hyjnë funksione dhe aktivitete me përmbajtje të larmishme, Park, shesh, hapësirë publike rekreative për të cilat kushtet ndërtimore janë specifike dhe rregullohen sipas rregulloreve specifike për normat e projektimit.

Sa i përket parqeve, normat e planifikimit japin këto kushte:

- Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.

Të gjitha aktivitetet dhe funksionet, përkatësisht çdo ndërtim në kuadër të kësaj zone duhet të dizajnohet dhe ndërtohet sipas kërkesave dhe standardeve që respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit**

Infrastruktura e institucioneve të sportit dhe rekreacionit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
- Në lokacion të rrafshët pranë burimeve dhe pasqyrave ujore.

Të gjitha aktivitetet dhe funksionet, përkatësisht çdo ndërtim në kuadër të kësaj zone duhet të dizajnohet dhe ndërtohet sipas kërkesave dhe standardeve që respektojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit**

Norma prej 8 m²/banorë sipërfaqe gjelbërimi për zonat deri në 10.000 banorë dhe 17 m²/banorë për zonat me mbi 10.000 banorë, **për sipërfaqet e gjelbra në zona rikrijuese, parqe në periferi, objekte çlodhëse, kulturore dhe sportive.**

Sipërfaqet e gjelbra në zona rikrijuese mund të përfshijnë gjithashtu struktura të shërbimit publik për aktivitete argëtuese, kulturore, sportive, sheshe të ndryshme lojërash, rrugë të destinuara për këmbësorë, etj. Sipërfaqja e asfaltuar dhe/apo e zënë më struktura përbën jo më shumë se 5% të sipërfaqes së përgjithshme të zonës apo hapësirës.

Lëndinat - sipërfaqe bari të kositura për qëllime estetike**:**

- Lëndinë dekorative:

  Lartësia maksimale e barit 5-7 cm
- Lëndinë e zakonshme:

  Lartësia maksimale e barit 15 cm

Tabela 47 Kushtet ndërtimore për zonën ZrT-2

Kushtet ndërtimore	ZrT-2 Zonë Rekreative-Turistike (Park, shesh, hapësirë publike)
Lloji I ndërtesës	Tregti me pakicë
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar
Vija Ndërtimore nga Vija Rregulluese	6m
Etazhiteti maksimal	P
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')	4
H/L nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5L/1GJ
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me pronarët e parcelave kadastrale fqinje	3L/1GJ
Distanca minimale nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me pronarët e parcelave kadastrale fqinje, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4m’
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2L/1GJ
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4m’
ISHPKZh	25%
% e gjelbërimit	50%
SNP	80%
ISN	0.25
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m²
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5
	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5
Dendësia maksimale banorë/ha	1-5/ha
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m²)	700
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	20
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db(A)
	22:00-08:00=35db(A)

- **Kushtet Ndërtimore për zonën ZrT-3**

Në kuadër të Zonës **ZrT-3** – Turizëm natyror, rural, kulturor dhe rekreacion përfshihen hapësirat me potencial për zhvillimin e turizmit natyror, rural dhe kulturor, si dhe aktiviteteve rekreative që mbështeten në vlerat natyrore, peizazhore, kulturore dhe historike të zonës. Kjo zonë ka për qëllim zhvillimin e kontrolluar të turizmit dhe rekreacionit, duke ruajtur karakterin natyror dhe rural të hapësirës, si dhe duke mbrojtur vlerat kulturore, mjedisore dhe peizazhore.

Ndërtimet dhe ndërhyrjet në kuadër të zonës ZrT-3 duhet të jenë në funksion të turizmit, rekreacionit, promovimit të vlerave natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Këto ndërhyrje duhet të përshtaten me karakterin e mjedisit përreth, konfiguracionin e terrenit, peizazhin, strukturën ekzistuese të vendbanimeve rurale dhe kapacitetin mbajtës të hapësirës..

Tabela 48 Kushtet ndërtimore për zonër ZrT-3

Kushtet ndërtimore			
Lloji I strukturës së ndërtuar – Sipërfaqe rurale e përgjithshme			
Lloji I ndërtesës	Vila	Bujtina	Shtëpiza malore
Vija rregulluese	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar	Profili i rrugës së planifikuar
Vija Ndërtimore nga Vija Rregulluese	6m	6m	6m
Etazhiteti maksimal	B+P+1	B+P+1	P+1
Lartësia maksimale e ndërtesave (m')	8	8	8
H/L nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5L/1GJ	2.5L/1GJ	2.5L/1GJ
L/GJ nga kufiri anësor i parcelës kadastrale pa marrëveshje me paraprake me pronarët e parcelave kadastrale fqinje	3L/1GJ	3L/1GJ	3L/1GJ
Distanca minimale nga kufiri anësor i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me pronarët e parcelave kadastrale fqinje, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4m’	4m’	4m’
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale	2L/1GJ	2L/1GJ	2L/1GJ
L/GJ nga kufiri i pasmë i parcelës kadastrale me marrëveshje paraprake me fqinjët, në të cilën fasadë nuk lejohen hapje për hapësira banimi apo hapësira të jashtme.	4m’	4m’	4m’
ISHPKZh	25%	25%	25%
% e gjelbërimit	40%	40%	50%
SNP	80%	80%	80%
ISN	0.25	0.25	0.25
Kërkesat minimale për vendparkingje	2 VP/100 m²	2 VP/100 m²	2 VP/100 m²
Koeficienti minimal i përçueshmërisë termike (U-value [W/m²K])	Muri 0.5	Muri 0.5	Muri 0.5
	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3	Kulmi 0.3
	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5	Dyshemeja 0.5
Kufizimet e ndotjes mjedisore	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db(A)	08:00-22:00=45db(A
	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db(A)	22:00-08:00=35db(A
Dendësia maksimale banorë/ha	1-5/ha	1-5/ha	1-5/ha
Madhësia minimale e parcelës kadastrale (m^2)	700	700	700
Gjatësia minimale e pjesës së përparme të parcelës (m')	20	20	20

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.6. ZONAT E KOMUNIKACIONIT - TRANSPORTIT (ZkT-1, ZkT-2 DHE ZkT-3)

Zona e komunikacionit dhe transportit shënohet me kodin ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3 janë zona që shërbejnë për qëllime të transporti, mallrave, shërbimeve, informatave dhe udhëtarëve. Rregullat e shfrytëzimit dhe ndërtimit në kuadër të kësaj zonë rregullohen sipas legjislacionit dhe rregulloreve specifike të kësaj fushe dhe dominojnë ndaj rregullave të HZKom-it.

Tabela 49 Zonat e komunikacionit dhe transportit

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZkT-1	Rrugë	201.45
ZkT-2	Stacion i Autobusëve	0.33
ZkT-3	Parkingje Publike	0.39

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3** shfrytëzimet e lejuara janë funksionet dhe aktivitetet si në vijim:

- Infrastrukturë e transportit rrugor, Infrastrukturë e transportit hekurudhor, Infrastrukturë e transportit ajror dhe të gjitha formave të tjera të transportit.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3** shfrytëzimet e lejuara dytësore janë funksionet dhe aktivitetet, të cilat janë në varësi të shfrytëzimeve të lejuara dhe mund të jenë pjesë përbërëse e së njëjtës parcelë me shfrytëzimet e lejuara. Shfrytëzimet e lejuara dytësore janë si në vijim:

- Infrastrukturë e shpërndarjes së gazit dhe energjisë termike elektrike, Infrastrukturë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza-atmosferike.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Funksionet dhe aktivitetet të cilat janë në pajtueshmëri me shfrytëzimet e lejuara në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2, dhe ZkT-3** por të cilat i nënshtrohen kushteve plotësuese dhe kërkesës për leje të veçantë për shfrytëzim janë:

- Infrastrukturë për trajtimin i mbeturinave, shërbim tregtar me shumice dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3** pas së cilës largohen plotësisht janë:

- Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore.
- Shfrytëzimet aktuale-ekzistuese, Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna).

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Funksionet dhe aktivitet të cilat në mënyrë specifike janë të ndaluara në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3** për shkak që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në kuadër të kësaj zone, janë të gjitha zonat të cilat nuk janë të përfshira në: Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

- **Kushtet Ndërtimore**

Të gjitha karakteristikat lidhur me kërkesat për kushtet ndërtimore në kuadër të **ZkT-1, ZkT-2 dhe ZkT-3** janë subjekt i legjislacionit, rregulloreve dhe eurokodeve specifike të fushës së ndërtimit dhe transportit dhe komunikacionit. Gjithashtu sa i përket kushteve ndërtimore për këto zona, janë të paraqitura në kapitullin 7 Infrastruktura Rrugore.

Për parkingjet publike të cilat do të kenë sipërfaqe edhe nëntokësore por edhe mbitokësore të cilat janë pjesë e **ZkT– 3,** rekomandojme që kushtet ndërtimore të rrjedhin si rezultat i analizave mbi kërkesën për vendparkingje si dhe studimit të fizibilitetit e më pastaj të përcaktohen kushte ndërtimore si ISN, ISHPKZH, Etazhiteti etj...

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.7. ZONAT BUJQËSORE (Zb)

Zona Bujqësore shënohen me kodin **Zb** dhe është kryesisht sipërfaqe e mbuluar me tokë bujqësore të kualitetit të lartë. Ky grup paraqet tokën e kualitetit më të mirë e cila ka kufizime të menaxhueshme mjedisore. Ka përdorime intensivë bujqësore apo për hortikulturë që duhet mbrojtur në mënyrë të rreptë për shfrytëzim bujqësor. Përderisa zbatohet një standard i lartë, gjasa që ky lloj i shfrytëzimit të tokës të shkaktoi dëme minimale mjedisore.

Këto sipërfaqe janë të përshtatshme për prodhim të drithërave, perimeve pemëve dhe lloje të tjera intensive të industrive bujqësore, varësisht nga kushtet lokale, qasja dhe parametrat e tokës.

Në tokat bujqësore janë përcaktuar shfrytëzimet në të cila shfrytëzime janë përcaktuara edhe aktivitetet e lejuara të cilat janë radhitur si më poshtë:

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në **Zb** funksione dhe aktivitete e lejuara janë:

Kultivimi i drithërave, i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore, Kultivimi i perimeve, Pjepra dhe Shalqin, Bimë rrënjore, Tuberoze, Kultivimi i kallamsheqerit, Kultivimi i duhanit, Kultivimi i hardhive, Kultivimi në serë, Kultivimi i frutave me bërthamë dhe frutave me farë, Kultivimi i frutave të tjera pëmore, Arra dhe Lajthi, Shumimi i bimëve, Kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare, Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në **Zb** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

Shërbimet tregtare në të mirën e bujqësisë, Kultivimi i erëzave, Bimëve aromatike, Farmaceutike dhe Mjekësore, Veprimtaritë ndihmëse për prodhimet bimore, Veprimtarit e pas korrjes së bimëve, pas vjeljes së pemëve, shfrytëzimi i mineraleve sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe shfrytëzimit të drurit.

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Në **Zb** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

Infrastruktura bujqësore (fermat), ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesat për përpunim, ruajtje dhe konservim të mishit, aktivitetet për nxjerrjen e pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore, kampingu, Bletaria.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **Zb-**së, pas së cilës largohen plotësisht janë:

Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore, paraprakisht kërkohet të bëhet një plan fizibiliteti për potencialet energjetike për energji të ripërtrishme), (Shfrytëzimet e lejuara të përkohshme për energji të ripërtrishme që mund të aplikohen për tokat bujqësore, vlejnë për tokat me kulturë të klasës 5 e më lartë sipas përcaktimit aktual me legjislacion në fuqi për tokat bujqësore). Mbledhje e produkteve natyrore, promovimi dhe shitja e produkteve bujqësore sipas periudhave të caktuara, shfrytëzimi i kullosave për kullotje të bagëtisë.

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Në **Zb** të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lejuara, të lejuara dytësore, lejuara të veçanta, lejuara përkohshme konsiderohen të ndaluara.

- **Kushtet Zhvillimore për zonat bujqësore Zb**

Në vijim janë përcaktuar kushtet zhvillimore për zonat bujqësore që niveli qendror i ka përcaktuar për tu përdorur ekskluzivisht vetëm për veprimtari bujqësore, me qellim të ruajtjes së tokave bujqësore.

Përderisa Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar kufijtë ndërtimor të fshatrave përtej të cilave nuk lejohet ndërtimi i ndërtesave, si dhe përcaktimin e tokave bujqësore. Për të mbrojtur tokat bujqësore përreth këtyre vendbanimeve, harta zonale përcakton kushtet e shfrytëzimit dhe kufizon zhvillimet te cilat do të ndikonin në dëmtimin dhe tjetërsimin e këtyre zonave të përshtatshme për zhvillimin ekonomik të vendit.

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ për HZK, kushtet zhvillimore vijuese për zonat bujqësore janë përcaktuar në bazë të kritereve dhe zonimeve vijuese:

1. Kushtet zhvillimore sipas përshtatshmërisë së tokës bujqësore për klasat 1 – 8-të,
2. Kushtet zhvillimore sipas zonimit agro-ekologjik,
3. Kushtet zhvillimore sipas mënyrës së shfrytëzimit të tokës bujqësore,
4. Kushtet zhvillimore për ndërtesat mbështetëse.

- **Kushtet zhvillimore sipas përshtatshmërisë së tokës bujqësore për klasat 1 – 8-të**

Kjo pjesë përcakton kushtet zhvillimore për shfrytëzimin e tokës sipas përshtatshmërisë së tokës bujqësore të cilat janë kushte plotësuese që duhen të përmbushen krahas kushteve të përcaktuar sipas ligjit për tokat bujqësore 02/L-26 dhe zonimit agro-ekologjik. Bazuar në klasifikimin e përshtatshmërisë së tokës bujqësore nga niveli qendrore, në komunën tonë janë identifikuar sipërfaqet vijuese për klasat 1-8:

- Zb-K1, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 1 janë gjithsejtë 5288.70 ha;
- Zb-K2, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 2 janë gjithsejtë 4280.30 ha;
- Zb-K3, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 3 janë gjithsejtë 4216.00 ha;
- Zb-K4, zonë bujqësore të përshtatshmëri e tokës bujqësore klasës 4 janë gjithsejtë 1761.30 ha;
- Zb-K5, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 5 janë gjithsejtë 4084.40 ha;
- Zb-K6, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 6 janë gjithsejtë 6652.70 ha;
- Zb-K7, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 7 janë gjithsejtë 476.00 ha;
- Zb-K8, zonë bujqësore të përshtatshmëria e tokës bujqësore klasës 8 janë gjithsejtë 234.30 ha.

Në vijim janë paraqitur kushtet zhvillimore për secilën klasë të përshtatshmërisë së tokave bujqësore që shtrihen në komunën tonë.

- **Kushtet zhvillimore për tokat klasa 1-4**

Mbase lloji më i rëndësishëm në kuadër të kornizës së shfrytëzimit të tokës. Kjo është tokë intensive bujqësore apo për hortikulturë që duhet mbrojtur në mënyrë të rreptë për shfrytëzim bujqësor. Ky grup paraqet tokën e kualitetit më të mirë në e cila ka kufizime të menaxhueshme mjedisore. Përderisa zbatohet një standard i lartë, ka gjasa që ky lloj i shfrytëzimit të tokës të shkaktoi dëme minimale mjedisore. Këto sipërfaqe janë të përshtatshme për prodhim të perimeve, drithërave dhe lloje të tjera intensive të industrive bujqësore, varësisht nga kushtet lokale, qasja dhe parametrat e tokës.

Në tokat e klasës 1-4 kemi caktuar edhe shfrytëzimet të cilat janë të lejuara dhe në kundërshtim me zhvillimet e këtyre tokave dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të lejuara apo të ndaluara, e këto janë:

- Tokat e kategorisë 1-4 lejohen të shfrytëzohen për zhvillim bujqësorë të përcaktuara në shfrytëzimet e lejuara për zona bujqësore;
- Lejohet infrastruktura bujqësore konform kushteve të veçanta zhvillimore për përcaktimin e hapësirave për vendosjen e fermave dhe objekteve përcjellëse të përcaktuara me kushte zhvillimore të veçanta për zona bujqësore;
- Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i tokës bujqësore për nxjerrjen e lendeve industriale, mineraleve sipërfaqësore dhe nëntokësore konform dispozitave ligjore;
- Lejohet rregullimi i tokave bujqësore konform dispozitave ligjore UA Nr. 09/2007;
- Lejohet servituti sezonal për qasje në parcelat bujqësore sipas dispozitave ligjore;
- Lejohen shfrytëzimet e përkohshme të përcaktuara me shfrytëzimet e lejuara të përkohshme për zona bujqësore;
- Lejohet dhenja e tokave bujqësore klasa 1-4 me qira vetëm për qëllime bujqësore;

- Lejohet energjia e ripërtrishme deri në 10 MW me pëlqimin e Komuna), sipas dispozitave ligjore LIGJI Nr. 04/L – 110 PËR NDËRTIM.
- Ndalohet shfrytëzimi i tokave bujqësore 1-4 për qëllime të tjera jo bujqësore të përcaktuara me kushte zhvillimore të ndaluara për zona bujqësore;
- Ndalohet largimi i shtresave humusore apo shtesave të punueshme nga tokat bujqësore;
- Ndalohet përdorimi i lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme të cilat dëmtojnë strukturat e tokave bujqësore;
- Ndalohet ndërrimi i destinimit për tokat bujqësore në komasacion dhe sistem të ujitjes përveç rasteve me rendësi të veçanta publike.

▪ **Kushtet zhvillimore për tokat klasa 5-6**

Përfshijnë një varg të gjerë të kualitetit të tokës, ka pengesa relativisht të qëndrueshme për kultivim lavërtarë si kufizimet nga erozioni, uji nëntokësorë apo biodiversiteti, nuk mund të lehtësohen me teknika të thjeshta të menaxhimit të tokës. Në shumicën e rasteve, kualiteti i tokës është mesatar, dhe shpesh ka ndjeshmëri mjedisore. Kjo tokë është e përshtatshme për një përzierje komplekse të kulturave vjetore dhe të përhershme, vegjetacion natyror dhe zona të lokalizuara të kultivimit intensiv lavërtarë.

Në tokat e klasës 5-6 kemi caktuar edhe shfrytëzimet të cilat janë të lejueshme dhe në kundërshtim me zhvillimet e këtyre tokave dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të lejuara apo të ndaluara, e këto janë:

- Tokat e kategorisë 5-6 lejohen të shfrytëzohen për zhvillim bujqësorë apo zhvillime tjera konform dispozitave ligjore;
- Lejohet infrastruktura bujqësore konform kushteve të veçanta zhvillimore për përcaktimin e hapësirave për vendosjen e fermave dhe objekteve përcjellëse të përcaktuara me kushte zhvillimore të veçanta për zona bujqësore;
- Lejohen shfrytëzimet e përkohshme të përcaktuara me shfrytëzimet e lejuara të përkohshme për zona bujqësore;
- Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i tokës bujqësore për nxjerrjen e lendeve industriale, mineraleve sipërfaqësore dhe nëntokësore konform dispozitave ligjore;
- Lejohet rregullimi i tokave bujqësore konform dispozitave ligjore UA Nr. 09/2007;
- Lejohet servituti sezonal për qasje në parcelat bujqësore sipas dispozitave ligjore;
- Lejohet dhënja e tokave bujqësore klasa 5-6 me qira vetëm për qëllime bujqësore;
- Lejohet shfrytëzimi i kullotave duke respektuar dispozitat ligjore të përcaktuara me UA NR. 09/2007 për shfrytëzim të kullotave;
- Lejohet energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore), sipas dispozitave ligjore LIGJI Nr. 04/L – 110 PËR NDËRTIM.
- Ndalohet shfrytëzimi i tokave bujqësore 5-6 për qëllime të tjera jo bujqësore të përcaktuara me kushte zhvillimore të ndaluara;
- Ndalohet largimi i shtresave humusore apo shtesave të punueshme nga tokat bujqësore;
- Ndalohet përdorimi i lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme të cilat dëmtojnë tokat bujqësore;
- Ndalohet ndërrimi i destinimit për tokat bujqësore në komasacion dhe sistem të ujitjes përveç rasteve me rendësi të veçanta publike.

▪ **Kushtet zhvillimore për tokat klasa 7-8**

Këto sipërfaqe bujqësore shpesh përmbajnë zona të vegjetacionit natyror. Përbehen nga kulturat vjetore dhe të përhershme me rendiment të ulët, së bashku me kullosat të përshtatshme për bagëti dhe vegjetacion natyror. Disa nga këto sipërfaqe janë shumë të pjerrëta, gjë që rrit shpenzimet e përfshira në zhvillim, por sidoqoftë janë sipërfaqe bujqësore që duhet zhvilluar nëse toka e një kualiteti më të mirë duhet të ruhet.

Në tokat e klasës 7-8 kemi caktuar edhe shfrytëzimet të cilat janë të lejueshme dhe në kundërshtim me zhvillimet e këtyre tokave dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të lejuara apo të ndaluara, e këto janë:

- Tokat e kategorisë 7-8 lejohen të shfrytëzohen për zhvillim bujqësorë apo zhvillime tjera jo bujqësore konform dispozitave ligjore;

- Lejohet infrastruktura bujqësore konform kushteve të veçanta zhvillimore për përcaktimin e hapësirave për vendosjen e fermave dhe objekteve përcjellëse të përcaktuara me kushte zhvillimore të veçanta për zona bujqësore;
- Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i tokës bujqësore për nxjerrjen e lendeve industriale, mineraleve sipërfaqësore dhe nëntokësore konform dispozitave ligjore;
- Lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i tokës bujqësore për nxjerrjen e lendeve industriale, mineraleve sipërfaqësore dhe nëntokësore konform dispozitave ligjore;
- Lejohet rregullimi i tokave bujqësore konform dispozitave ligjore;
- Lejohet servituti sezonal për qasje në parcelat bujqësore sipas dispozitave ligjore;
- Lejohet dhënja e tokave bujqësore klasa 7-8 me qira vetëm për qëllime bujqësore apo qëllime tjera të përcaktuar nga komiteti planifikues i komunës;
- Lejohet shfrytëzimi i kullotave duke respektuar dispozitat ligjore të përcaktuara me UA NR. 09/2007 për shfrytëzim të kullotave;
- Lejohet energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore), sipas dispozitave ligjore LIGJI Nr. 04/L – 110 PËR NDËRTIM.
- Ndalohet përdorimi i lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme të cilat dëmtojnë tokat bujqësore;



Figura 10 Përshtatshmëria e tokave bujqësore

▪ Kushtet zhvillimore për tokat bujqësore sipas klasifikimit të zonimit agro-ekologjik

Zonimi Agro-ekologjike (ZAE) i referohet ndarjes së një sipërfaqe të tokës në zona të vogla, të cilat kanë karakteristika të ngjashme të lidhura me përshtatshmërinë e tokës bujqësore, prodhimin potenciale dhe ndikimin në mjedis. ZAE i referohet klasifikimit të përshtatshmërinë e tokës si input bazë, si dhe përdor një grup të gjerë të të dhënave në analizën e saj.

- **Zonimi agro-ekologjik:**
- Nuk nënkupton që duhet të kultivohen kulturat bujqësore sipas parimeve të prodhimtarisë organike (bio).
- Është një planifikim sipas kushteve zhvillimore të cilat përcaktojnë rendimente më të larta për kulturat bujqësore duke u mbështetur në analizat e përparësive vijuese klimatike, fiziko-kimike, mjedisore dhe natyrore të tokave të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.
- Nuk është obligativ, nuk detyron dhe nuk ndëshkon shfrytëzuesin e tokës që ka vendosur të zhvillojë kultura tjera bujqësore mbi zona e përcaktuara agro-ekologjike në këtë Hartë Zonale.

Në Komunën tonë, Harta Zonale ka përcaktuar sipërfaqet vijuese sipas kulturave bujqësore të cilat janë më të leverdishme për të u kultivuar në to, bazuar në formën dhe përmbajtjen unike të tokës bujqësore, karakteristikat klimatike, vetit fizike dhe kimike të tokës.

Faktorët kryesorë dhe kushtet agro-ekologjike të cilat luajnë rolë të rëndësishëm në kultivimin, zhvillimin dhe prodhimin e kulturave bujqësore mund të radhiten:

- Lloji i përshtatshmërisë së tokës bujqësore;
- Pedologjia (lloji i tokës);
- Intensiteti i ujërave nëntokësorë dhe mbitokësorë;
- Ekspozicioni ndaj djellit;
- Lartësia mbidetare dhe pjerrtësia e terrenit;
- Kushtet klimatike (temperatura, lagështia, reshjet);
- Periudha e rritjes, (periudha e diellosjes LGP);
- Sasia e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në dispozicion për ujitje; dhe
- Kërkesat për lëndë ushqyese.

Tabela 50. Zonat bujqësore sipas shfrytëzimit të planifikuar

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
Zb-1	Drithëra	4920.28
Zb-2	Perime	2437.10
Zb-3	Fruta	1692.65
Zb-4	Livadhe dhe Kullosa	1099.58

Zonimi agroekologjik në komunën e Vitisë ndahet në 4-i zona agro-ekologjike Zb-1- Drithëra, Zb-2 - Perime, Zb-3- Fruta dhe Zb-4- Livadhe dhe Kullosa për të cilat janë dhëne kushte zhvillimore në vazhdim.

- **Kushtet zhvillimore për kultivimin e drithërave në zonat agro- ekologjike të përcaktuara.**

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për kultivimin e drithërave:

- Kërkesa për tokë: tokat më të përshtatshme për kultivimin e drithërave janë tokat e pëlleshme dhe të thella me reaksion të lehtë acidik si dhe me lagështi relative;
- Kërkesat ndaj faktorëve të mjedisit: Temperatura 18 - 22 °C; Ujë/ujitje 500 - 700 mm;
- Kërkesat për lëndë ushqyese kg/ha: Azot: 150 -180; Fosfor 90 - 100; Kalium 160 - 200;
- Lloji, sasia dhe mënyra e mbjelljes së farës e përshtatshëm për atë tokë.

▪ Kushtet zhvillimore për kultivimi e frutave

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për kultivimin dhe rritjen e pemëve frutore janë:

- Kërkesa për tokë: Sasia e ujit në tokë, Përmbajtja e elementeve ushqyese (mikro dhe makro elementeve), pH tokës 6.5 – 7.5, Thellësia dhe drenazhimi i tokës;
- Kërkesat ndaj faktorëve të mjedisit: Temperatura e ajrit (17 – 25 °C), Lagështira ajrore dhe tokësore 50 – 70%, Djellosja 235 ditë vegjetacion, Ajrimi, Erërat (në raste të erërave të forta të krijohen breza mbrojtës);
- Lartësia mbidetare: > 700 m (produktivitet më i lartë), < 700 m (produktiviteti më i ulët).

▪ Kushtet zhvillimore për kultivimi e perimeve

Më prodhimin e përgjithshëm të perimeve nënkuptohet kultivimi i perimeve qoftë në fushë të hapur apo në mjedise të mbrojtura (serra), Për kultivimin dhe zhvillimi e prodhimit perimtare (lavërtar) janë dhënë disa kushte mbi zgjedhjen e tokave apo zonave për kultivim:

Tabela 51 Vend-parkimet për qëllime të veçantë

Ekologjike (tokësorë)	3. Klimatikë:	Ekonomike:
Tipi i tokës (lloji i përshtatshëm i tokës për zhvillim)	Temperatura	Fuqia Punëtore
Pjerrtësia e terrenit (0.16 – 6.0 shkallë)	Drita (intensiteti i ndriçimit dhe gjatësia e dritës)	Materiali reprodukues
Ekspozicioni ndaj dritës	Lagështia (sasia e ujit	Pajisjet (makineria)
Niveli i ujit nëntokësor	Cilësia e ajrit	Plasmani (tregu)
Infektimi me baroja	Erërat	
Reaksioni i tokës		

▪ Kushtet zhvillimore për ndërtimin e serrave në zonat e përcaktuara për zhvillim

Kushtet e përgjithshme të cilat duet të marrim për bazë gjatë ngritjes dhe shfrytëzimit të serave janë paraqitur në vazhdim:

- Zgjedhja e vendit ku do të ndërtohet serra:
  - Preferohen sipërfaqet të cilat i eksponohen së paku 8 ore gjatë sezonit vegjetativ dhe 4 orë diellosje gjate stinës së dimrit;
  - Të zgjidhen zonat me vlera më të larta të temperaturës minimale ;
  - Shmangia e zonave me temperaturë maksimale shumë të lartë si dhe atyre shumë të ftohta;
  - Të ndërtohen pranë burimeve energjetike (mundësi e qasjes në energji elektrike);
  - Jo shumë larg rrugëve kryesore qe të mund të kemi transport të shpejt të mallit;
  - Të vendosura së paku 2 – 4 km, larg nga ndotësit industrialë.
  - Të kemi ajrim efektiv, dritaret duhet të përfaqësohen në masën 18 – 25% të sipërfaqes së serrës;
  - Të zvogëlohet humbja e energjisë;
  - Të këtë volume (shfrytëzim) sa më të madhe që të jetë e mundur;
  - Të lejojnë instalimin e pajisjeve për ngrohjen e serrës gjatë natës;
  - Rritja e standardeve të kontrollit të mikroklimës në serrë;
  - Zgjedhja dhe shfrytëzimi i materialeve plastike më të përshtatshëm për kërkesat për dritë dhe temperaturë;
  - Instalimi i sistemit të ujitjes me efektivitet të lartë (Sistemi pikë-pikë apo edhe sisteme tjera të përshtatshme).

Zhvillimi apo ndërtimi i serrave mund të bëhet në ato zona ku sipas ZAE është përcaktuar për kultivimin e perimeve Zb-3, por duhet pasur parasysh kushtet e përmendura me lart për ndërtimin e serrave para se të përcaktohet lokacioni.

- **Kushtet e përgjithshme për kultivimin e rrushit**

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për kultivimin e rrushit:

- Kërkesa për tokë: Toka të thella shkriftë, me lagështi të mjaftueshme dhe të afta për tu ajrosur, Përmbajtja e elementeve ushqyese (mikro dhe makro elementeve), pH tokës 6.5 – 7.5, Thellësia dhe drenazhimi i tokës;
- Kërkesat ndaj faktorëve të mjedisit: Periudha vegjetative 120 - 250 ditë, Temperatura e ajrit (22 – 25 °C), Lagështira ajrore dhe tokësore 60 – 70 %, Ajrimi, Erërat (në raste të erërave të forta të krijohen breza mbrojtës).
- Kërkesat për lëndë ushqyese: Azot 90 - 130, Fosfor: 40 - 50, Kalium: 60 - 140, Hekur: 1 - 2, Magnez: 30 - 40;
- Lartësia mbidetare: > 700 m (produktivitet më i lartë), < 700 m (produktiviteti më i ulët).

- **Kushtet zhvillimore për kultivimin e bimëve foragjere (jonxha, tërfili, bari anglez, misri për silazh)**

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për kultivimin e bimëve foragjere janë:

- Kërkesa për tokë:
  Toka të thella shkriftë, me lagështi të mjaftueshme dhe të afta për tu ajrosur, Përmbajtja e elementeve ushqyese (mikro dhe makro elementeve), pH tokës 6.5 – 7.5, Thellësia dhe drenazhimi i tokës;
- Kërkesat ndaj faktorëve të mjedisit:
  Periudha vegjetative 35 - 50 ditë për kositje, Temperatura e ajrit (22 – 25 °C), Lagështira ajrore dhe tokësore si dhe kërkesat për ujë 60 – 70 %, 300 - 400 mm reshje, Erërat (në raste të erërave të forta të krijohen breza mbrojtës);
- Kërkesat për lëndë ushqyese kg/ha:
  Azot 100- 120, Fosfor: 80 - 100, Kalium: 110 - 130.

- **Kushtet zhvillimore për kultivimin e kullotave**

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për shfrytëzimin e kullosave:

- Të bëjë shfrytëzimin racional të kullotave,
- T'u mundësoj shfrytëzuesve tjerë kalimin, afrimin dhe dërgimin e bagëtisë në kullota dhe në fusha, si dhe caktimin e vendit për dhënien ujë bagëtisë;
- Të bëjë vazhdimisht meliorimin dhe mirëmbajtjen me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe shtimit të kapaciteteve të kullotave dhe
- Të zbatojë masat e mbrojtjes së kullotave nga shfrytëzimi i tepërt dhe jodestinues.
- Të respektoj kërkesat të cilat dalin nga UA NR. 09/2007 për shfrytëzimin e kullosave.

- **Kushtet e nevojshme për mundësin e aplikimit të peshkimit dhe akuakultures**

Kushtet dhe kërkesat zhvillimore për kultivimin e peshkut, këto kushte janë të specifikuara edhe me Ligjin nr.02/L-83 për peshkim dhe akuakulturë.

- **Kriteret për peshkim rekreativ**

Të merret leja për peshkim sportiv rekreativ

- Një ditore dhe
- Një vjeçare.

Mjetet dhe pajisjet për peshkim rekreativ sportiv

- Rrjeta për kapjen – nxjerrjen e peshqve;
- Rrjeti për ruajtjen e peshqve;
- Grepi për tërheqjen e gjahut.

▪ **Kushtet e nevojshme për mundësin e aplikimit dhe zhvillimit akuakulturës**

1. Aktivitetin e akuakulturës mund ta zhvillojnë personat fizik apo juridik të regjistruar dhe të licencuar për akuakulturë si dhe shfrytëzuesit e resurseve ujore nëse një gjë të tillë kanë planifikuar me program në regjionin apo zonën për të cilën e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit.
2. Personat fizik apo juridik mund të zhvillojnë aktivitetin e akuakulturës pasi të kenë marrë licencë nga ministria duke i plotësuar këto kushte:
    - nëse personi fizik apo juridik ka përgatitje profesionale apo ka të punësuar profesional,
    - kur zbatimi i projektit nuk shkakton efekte negative ndaj mjedisit,
    - kur zhvillimi i aktivitetit nuk bie ndesh me interesat e sektorëve tjerë që merren me menaxhimin ujërave,
    - kur ndryshimi i destinimit të tokave është në përputhje me ligjin e tokave,
    - kur shfrytëzimi i tokave në pronësi shtetërore rregullohet sipas procedurave të autoriteteve që menaxhojnë me tokat,kompetente,
    - kur e drejta e shfrytëzimit të ujërave është rregulluar sipas ligjit për koncesione.



Figura 11. Zonimi Agro-Ekologjik

▪ Mënyra e shfrytëzimit të tokës bujqësore

Mënyra e shfrytëzimit të tokës përcakton dhe orienton zhvillimin e zonave të cilat janë të përshtatshme për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore për një sipërfaqe të përcaktuara bujqësore të cilat sjellin rendimente të larta, mirëpo sa i përket leverdisë ekonomike të zhvillimit të këtyre kulturave pa dyshim që varet nga faktorët ekonomik të tregjeve vendore, regjionale apo ndërkombëtare.

Mënyra e shfrytëzimit të tokës është përcaktuar si udhë rrëfyes për shfrytëzuesit e tokës dhe drejtorin komunale të bujqësisë për të përgatitur programin e kulturave bujqësore që do të subvencionohen për secilin vite radhas nga 2026 – 2034.

Drejtoria komunale do të përcaktoj në programin e tyre cilat kultura bujqësore do të subvencionohen duke u bazuar në vlerën monetare të tyre në treg duke përzgjedhur rendimentet më të leverdishme për secilin vit radhazi duke u bazuar në sipërfaqet e përcaktuara për kultivimin e tyre.

Kushtet e shfrytëzimit të këtyre zonave është përshkruar në kapitujt e sipërm, gjersa mënyra e shfrytëzimit të tokës përcakton kulturat më të përshtatshme për kultivim në të ardhmen.

▪ Mënyra e përdorimit - Lista e kulturave

Lloji i përdorimit:

Tabela 52. Lista e kulturave

Drithëra Zb-1:	Perime Zb-2:	Fruta Zb-3:	Livadhe dhe kullosa Zb-4:
Misër	Domate	Mollë	Jonxhë
Grurë	Tranguj	Dardhë	Tërfili
Tërshërë	Spec	Kumbull	Tërfili Kuq
Thekër	Qepë	Pjeshkë	Bari Anglez
Elb	Hudhër	Mjedër	
Tritikale	Shalqin	Manaferrë	
	Pjepër	Dredhëz	
	Lakër	Lajthi	
	Patate	Arrë	
	Majdanoz	Vishnje	
	Karrot	Qershi	
	Sallat	Dredhëz	
	Spinaq		

▪ Klasifikimi i sistemeve të ujitjes dhe kushtet zhvillimore

Sistemet e ujitjes të tokave bujqësore sipas UA Normat dhe standardet teknike të planifikimit hapësinor i klasifikojnë sipas kategorive në vazhdim, komuna e Vitisë nuk posedon sistem të ujitjes, kushtet zhvillimore për zhvillimin e sistemit të ujitjes janë përcaktuar në vazhdim.

U.A nr. 08/2017 NTP ka përcaktuar klasifikimin e tokave bujqësore sipas sisteme të ujitjes në vazhdim:

- Tokë bujqësore me sistem të ujitjes në sipërfaqe- brazda;
- Tokë bujqësore me sistem të ujitjes me spërkatje;
- Tokë bujqësore me sistem të ujitjes me pika;
- Tokë bujqësore me sistem të ujitjes nëntokësor;
- Tokë bujqësore me sistem të ujitjes të kombinuar ujitjes.

Sistemi i ujitjes në sipërfaqe- brazda - Kjo metodë e ujitjes është e përshtatshme kur toka ka një pjerrësi të vogël. Kur rregulloni brazdat, duhet të kihet parasysh se distanca midis tyre, gjerësia e tyre, gjatësia dhe thellësia e prerjes varen nga pjerrësia, shkalla e ujitjes dhe lloji i tokës. Në tokë të rëndë kjo distancë bëhet e barabartë me rreth 1 metër. Në tokat e lehta, brazdat prehen në një distancë më të shkurtër - rreth 0,5 metra. Kjo duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos dëmtojë rrënjët e bimëve.

Varësi të pjerrësisë së terrenit, thellësia e brazdës mund të ndryshojë nga 1,20 në 2,50 metra. Për më tepër, sa më e vogël të jetë pjerrësia, aq më të thella janë brazdat. Një pengesë e rëndësishme e kësaj metode është përdorimi joracional i tokës. Përveç kësaj, shumë ujë konsumohet për ujitje të sipërfaqeve të kultivuara.

Sistemi i ujitjes me spërkatje - Kjo metodë e ujitjes mund të përdoret me pothuajse çdo sipërfaqe apo kulturë bujqësore, mundëson kontrollimin e sakt të kërkesave për ujë, dhe lagështia uniforme të tokës. Përveç kësaj, me një ujitje të tillë rritet lagështia e ajrit.
Varësisht prej terrenit, sipërfaqeve dhe kulturave te cilat do të ujiten, analizohen dhe sugjerohen lloji i sistemit që do të përdoret.
Llojet e sistemit të ujitjes me spërkatje:
1. Spërkatësit tërheqës;
2. Spërkatësit për ujitje në distanca të largëta;
3. Spërkatësit rrethor;
4. Spërkatësit rain bird;
5. Spërkatësit pro-spray.

Sistemi i ujitjes me pika - Sistemi i ujitjes pikë-pikë aplikohet kryesisht në sipërfaqe të mbrojtura (serra, pemishte) por edhe me gjer. Ky sistem aplikohet në dy forma: sistem mbi tokësor dhe nën tokësor.

Kushtet kryesore në përdorimin e sistemit pikë-pikë janë:

1. Gjendja e tokës (pjerrtësia e tokës, madhësia e sipërfaqes);

2. Lloji i kulturës që do të mbillet;

3. Hapësira dhe distanca e mbjelljes;

4. Gjendja, lartësia e burimit të ujit;

5. Cilësia e ujit;

6. Cilësia teknike e materialit që do të përdorët;

7. Kushtet ekonomike.

Duke pasur parasysh kushtet e përdorimit të radhitura më lart dhe pasi që të jenë analizuar këto kushte vendosin mbi llojin dhe mënyrën e shfrytëzimit të këtij sistemi.

Sistemi i ujitjes nëntokësor - Sistemi i ujitjes nën tokësore është mënyrë më e përshtatshme për ujitjen e tokave bujqësore. Ky sistem kupton vendosjen e gypave të ujit nën tokë, gypa varësisht prej sipërfaqes së ujitur përcaktohen dimensionet dhe vendosja e tyre në dhe. Gypat primar të ujitjes së paku duhet të vendosen 0.40 - 0.60 metra nën tokë ndërsa ata sekondar 0.20 - 0.30 metra.

Përveç vendosjes së gypave duhet të kemi parasysh edhe pajisjet mbështetëse të sistemit si: Pompat për pompim të ujit, Rezervarët për deponim të ujit, Rregullatorët presues të ujit, Filtrat dhe Llojet e spërkatësve.

Të gjithë gypat primar dhe sekondar si dhe pajisjet mbështetëse të sistemit varësisht prej sipërfaqes së ujitur dhe kulturës qe do të ujitet përcaktohen llojet e gypave dhe pajisjeve mbështetëse.

Sistemi i ujitjes të kombinuar - Sistemi i kombinuar i ujitjes duhet të jetë i lidhur me një sistem qendror të furnizimit me ujë ose me një burim të përhershëm të ujit. Në rastin e parë, nuk ka nevojë për të integruar një sistem filtrimi në njësinë e kontrollit të ujitjes. Në rast të shfrytëzimit të burimeve (puseve) për ujitje atëherë ky sistem duhet të jetë i automizuar në mënyrë që të funksionoj ky lloje sistemi i ujitjes.

- **Kushtet e veçanta të nevojshme për përcaktimin e hapësirës për vendosjen e fermave dhe objekteve përcjellëse**

Në tokën bujqësore lejohet ndërtimi i ndërtesave për mbarështimin komercial të kafshëve dhe shpezëve, si dhe objekteve ndihmëse, përderisa plotësojnë kushtet vijuese:

- Madhësia e sipërfaqes (hapësirës) ku do të vendoset ferma apo objektet përcjellëse (parcela jo më pak se 0.50 ha).
- Vetitë gjeologjike – pedologjike të hapësirës ku do të vendoset objekti,
- Kushtet klimatike dhe meteorologjike (sidomos erërave),
- Sigurimi i ujit të mjaftueshëm (mundësia e qasjes së fermës në burimet e ujit),
- Mbrojtjen e ambienti (mbrojtja e natyrës nga fekalet dhe mbetjet e tjera),
- Ndikimi i ndërtimit përreth lokacionit.
- Sigurimi i ushqimit për të gjithë vitin.

Ndërtimi i fermave të cilat kanë karakter komercial që tejkalojnë mbi 10 krerë gjedhe apo 30 krerë dele, dhi apo 30 krerë derra apo 1,000 copë shpend lejohet në tokën bujqësore, përderisa ato plotësojnë kushtet vijuese:

- Distancat nga kufiri ndërtimor i vendbanimeve:
  - 150-200 metra minimalia;
  - 200-250 metra optimale;
  - 250-300 metra standarte.

(varësisht nga pozita hapësinore, kushtet zhvillimore dhe teknike duhet të përdoren distancat e përcaktuara, preferohet gjithmonë të rrespektohen distanca standardet për arsye te mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimit të ndotjes, ndërsa për numer me të vogël të krereve të përcaktuara që konsiderohen për konsum vetanak apo ndikim të vogël mjedisore duhet të merren pelqime nga komuniteti përreth dhe të zbatohen standartet e projektimit dhe kushtet tjera të percaktuara me këtë dokument në rastin e ndërtimit të objekteve për mbarshtimin e kafshëve).

- Të jenë 100 metra larg nga autostradat dhe rrugët nacionale;
- Distanca anësore të mureve të jashtme të fermës duhet të jenë së paku 10 metra nga kufijtë e parcelës;
- Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje të drejtpërdrejt ndaj një rruge publike ose private apo përmes të servitutit kalimtar në një parcelë fqinje.
- ISHPKZh-ja është 25%;
- ISN është 0.24;
- Etazhiteti është P+NK;
- Lartësi maksimale e lejuar është 2 m lartësi maksimale 7m, duke përjashtuar siloset e grurit, dhe objekte tjera me karakter të njëjtë të zhvillimit.
- Materiali ndërtimor: dru, gur, tulla, metal dhe fasada.
- Lidhja infrastrukturore - Para që të fillojë zhvillimi i parcelës duhet të sigurohet lidhja me rrjetet e infrastrukturës të inxhinierive.
- Ndërtimi i gropave septike sipas kritereve të përcaktuara me poshtë sipas llojit të fermës.

- **Kushtet për ndërtimin e objekteve për mbarështimin e gjedheve**

Për ngritjen e objekteve për lopë qumështore duhet të kemi parasysh këta faktorë, rregullat për ndërtimin e objekteve për lopë qumështore

- Shtrati/boksi (vendpushimi): gjerësia; 100 - 120 cm, gjatësia: 140 – 200 cm;
- Shufrat e ndarjes së shtretërve: pjesa e parë 35 – 45 cm ndërsa pjesa e dytë 60 – 80 cm;
- Korridori në mes: 220 – 300 cm (në gjerësinë e korridorit nuk llogariten grazhdet);
- Korridori pas shtretërve: 120 – 150 cm;
- Hapësira për ushqim (Grazhdi): gjerësia: 0.40 – 0.60 cm, lartësia - 0.20 – 0.40 cm;
- Kanali për largimin e plehut : 20 – 30 cm;
- Deponim plehut krerë: 5m^3 pleh i lëngët dhe 1,5 m^2 për atë të ngurtë.

<u>Nëse lopët mbahen në sistem të lirë:</u> për çdo lopë duhet siguruar nga një shtrat me madhësi si më lartë dhe stalla duhet të ketë madhësi që siguron së paku 10 m²/lopë.

Nëse stalla ka padok (hapësirë për shëtitje të kafshëve), madhësia duhet të jetë e tillë që siguron së paku 4,5 m²/lopë.

▪ Kushtet për ndërtimin e objekteve për dhen dhe dhi

Hapësira minimale të objekteve për mbajtje të kafshëve sipas kategorisë:

- Lartësia e fermës: 2.50 – 3.00 m;
- Korridori në mes: 2.20 – 2.50 m;
- Lugjet: lartësia 0.25 – 0.35 cm, gjatësia 1.85 – 2.5 m;
- Dyert duhet të jenë dykrahëshe me lartësi 2.80 – 3.00 m dhe gjerësi 2.00 – 2.50 m.

Tabela 53 Hapësirë m2 për krerë/kafshë

Lloji i kafshëve	Dele	Dash	Qengjë	Cjap	Dhi	Ftuja dhe ftujak
m^2/krerë	1.50	3.00	0.50 – 0.70	2.50 – 3.00	1.80 – 2.20	0.60 – 0.80

▪ Kushtet për ndërtimin e objekteve për pula vojëse

Standardet për pula vojse në kafaz:

Kushtet minimale teknike të kafazeve të përmirësuar (sipas standardeve të BE-së) për pula vojse:

- Sipërfaqja minimale e kafazit së paku 2000 cm^2;
- 750cm^2/pulë vojse nga e cila 600 cm me lartësi 45 cm, me fole/strofull, me pjesën e shtruar për shpurdhje dhe çukitje dhe 15 cm shkop (purtekë) /pulë për qëndrim, e vendosur mbi pjesën e shtruar;
- Qasja në ushqim së paku 12 cm për pulë;
- Korridori në mes të baterive minimum 90 cm;
- Në mes të dyshemesë dhe fundit të kafazeve duhet të mbetet një hapësirë prej 35 cm;
- Deponim plehut 5 m^3 për 1000 pula.

Për pula vojse dhe për broilerë të mbajtur në dysheme:

- Dendësia maksimale për broiler: 33 kg peshë e gjallë/m^2;
- Dendësia maksimale për pula vojse: nëntë (9) pula/m^2.

Si dhe të plotësohen kushtet vijuese:

- Pajisjet lineare për ushqim të sigurojnë të paktën 10 cm për pulë/zog, kurse ato rrethore të paktën 4 cm për pulë/zog;
- Govatat lineare të ujit të pijshëm duhet të sigurojnë së paku 2,5 cm për pulë ose govatat rrethore 1 cm për pulë. Kur furnizimi me ujë është me pikatore, për çdo 10 pula/zogj = 1 pikatore.

Vetëm për pula vojse:

- Të paktën një fole për çdo shtatë pula;
- Nëse përdoren fole grupore, për 120 pula duhet siguruar së paku 1,2 m^2**;**
- 15 cm shkopinj (purteka)/pulë, pa tehe të mprehta, të ngritur mbi shtrojë dhe distanca horizontale mes tyre duhet të jetë së paku 30 cm, ndërsa distanca në mes të shkopinjve dhe murit duhet të jetë së paku 20 cm;
  Të paktën 250 cm^2 shtrojë për pulë, shtroja zë të paktën një të tretën e sipërfaqes së dyshemesë.

▪ Ndriçimi

Për broilerë dhe pula vojse të mbajtura në dysheme, madhësia e dritareve të stallës duhet të jetë së paku sa 3% e sipërfaqes së dyshemesë.

▪ Kushtet për ndërtimin e objekteve për derra

Të gjitha fermat e derrave duhet t'i përmbushin kërkesat minimale si më poshtë:

Sipërfaqja e lirë e dyshemesë në dispozicion për çdo derrkuc apo derra për mbarështim të cilët mbahen në grup, përveç derrave femra të reja pas shërbimit dhe dosave, duhet të jetë të paktën sipërfaqen minimale të dyshemesë varësisht prej masës së kafshës:

Tabela 54 Kushtet për ndërtimin e objekteve për derra

Masa e kafshës (kg)	Deri në 10	> 10 - 20	> 20 - 30	>30 - 50	>50 - 85	>85 - 110	>110
Sipërfaqja (m^2)	0.15	0.20	0.30	0.40	0.55	0.65	1.00

Sipërfaqja e përgjithshme e lirë e dyshemesë në dispozicion për çdo derr femër e re pas shërbimit dhe për çdo dose kur femrat e reja dhe/ose dosat mbahen në grupe duhet të jetë së paku 1,64 m^2 dhe 2,25 m^2 për dosë. Kur këto kafshë mbahen në grup me pak se gjashtë kafshë, zona e lirë e dyshemesë duhet të rritur për 10%. Kur këto kafshë mbahen në grupe prej 40 ose më shumë, sipërfaqja e lirë e dyshemesë mund të zvogëlohet për 10%.

- **Kushtet për ndërtimin e objekteve për përpunim dhe konservim të mishit (thertoret)**

Ndërtimet e objekteve përpunimi dhe konservimi i mishit dhe mishit të shpezëve (thertore) duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Ndërtimet e objekteve për thertore duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Vetitë gjeologjike - pedologjike të vendit.
- Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkaloje intensitetin e ndërtimit prej 1 m3/m2;
- 10 metër nga kufijtë e parcelës;
- 300 metër nga qendrat e banuara;
- 25 metër nga rrugët nacionale dhe autostradave;
- Të parashikohet ndërtimi i hapësirës për trajtimin e mbetjeve nga thertorja.

- **Kushtet e nevojshme për ndërtimin e objekteve ndihmëse në bujqësi**

Ndërtimet e objekteve për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshire dhe ato për tharjen e trajtimin paraprak te produkteve bujqësore, duhet te plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Objektet për grumbullimin e produkteve bujqësore:

- Vëllimi maksimal i objektit të mos tejkaloje intensitetin e ndërtimit prej 1 m3/m2;
- Te respektojnë distancat minimale 7 metër nga kufijtë e parcelës;
- Të respektojë distancën 10 m nga objektet të tjera;
- Të ndërtojë hapësira për trajtimin e mbeturinave që vijnë nga përpunimi i produkteve bujqësore.

- **Kushtet e nevojshme për ndërtimin e objekteve të agro-turizmit**

Zonat e agro-turizmit përfshijnë ato zona të cilat lejohet aktivitetet e zhvillimit bujqësor, banimit dhe shërbimeve në të mirën e zhvillimit të turizmit rural.

Zonat e agroturizmit nënkupton të gjitha ato hapësira që plotësojnë kushte për zhvillimin e kësaj veprimtarie të orientuara me Planin Zhvillimor Komunal por të cilat plotësojnë këto kushte:

- Kanë aktivitete bujqësore të zhvilluara apo potenciale për zhvillim;
- Kanë aktivitete bujqësore të ndërlidhura me peizazhin natyrore dhe rural;
- Mundëson zhvillimin e infrastrukturës turistike por e cila ruan dhe promovon karakterin rural të zonës (akomodim, aktivitete rekreative dhe edukuese);
- Gëzon një ndërlidhje me infrastrukturën por nuk përjashton mundësi të tjera agroturizmi në zonë.

Kushtet ndërtimore të objekteve për zhvillim të agroturizmit janë si vijon:

- Madhësia minimale e parcelës 0.50 ha
- Distanca anësore të ndërtesës 10 metra nga kufijtë e parcelës;
- Aksesi në parcelë - Parcela duhet të ketë mundësi hyrje/dalje ndaj një rruge publike ose private në mënyrë të drejtpërdrejt ose me anë të servitutit kalimtar në një parcelë fqinje.
- ISHPKZh-ja është 10%;
- ISN është 0.40%;
- Etazhiteti është P+1;
- Lartësi maksimale e lejuar - 8 metra;
- % e sipërfaqes së ndërtimit sipas përdorimit: 50% banim 50% shërbim;

- Vija ndërtimore: 5-6 metra;
- Materiali ndërtimor: dru, gur, tulla, metal;
- Vendparkingjet: 2 VP/100 m²
- Lidhja infrastrukturore - Para që të fillojë zhvillimi i parcelës duhet të sigurohet lidhja me rrjetet e infrastrukturës inxhinierive.

▪ **Kushtet e nevojshme për bletari**

Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit, burim i prodhimit natyral me vlerë të lartë ushqimore, dietik e mjekësore. Bletët ndikojnë në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullosave duke ripërtërirë natyrën si hallkë të zinxhirit ekologjik.

Kushtet për vendosjen dhe transportimin e bletores duhet të bazohen në LIGJIN PËR BLETARI NR. 02/L-111.

▪ **Mbrojtja e tokave bujqësore**

Në bazë të udhëzimit administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor është kërkuar që tokat bujqësore të mbrohet nga faktorët mjedisor dhe social.

- Erozioni;
- Fragmentimi;
- Vërshimet dhe
- Ndërtimi.

▪ **Erozioni**

Me qëllim të mbrojtjes së tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmbytjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundër-erozive si në mbrohen dhe zhvillohen duke i pasur parasysh këta faktorë:

- Ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lërimit të livadheve dhe kullotave dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore vjetore;
- Prezantimi i kulturave bujqësore në rotacion;
- Kultivimin e plantacioneve shumëvjeçare;
- Ngritjen e ndërtesave specifike përkatëse;
- Përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore;
- Ngritjen dhe kultivimin e brezave mbrojtës bujqësor apo mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare;
- Ndalimi i kullotjes së bagëtive në një kohë të caktuar ose kufizimi i numrit të kafshëve që mund të lirohen në hapësira të caktuara;
- Ndalimi i prerjes se pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar;
- Masa të tjera mbrojtëse.

▪ **Mbrojtja nga fragmentimi**

Masat kundër-fragmentuese janë:

- Toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ≤ 1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela. Kjo masë mbrojtjeje duhet të respektohet në dokumentet e planifikimit hapësinor;
- Toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja e se cilës është ≤ 0.50 ha, të mos mund të fragmentohet tutje, kjo masë mbrojtjeje mund të përcaktohet në dokumentet e planifikimit hapësinor.

▪ **Mbrojtja e tokës bujqësore nga Vërshimet**

Masat dhe rekomandimet që duhet të ndërmerren për parandalimin e vërshimeve në toka bujqësore:

- Ndërtimi i rezervuarëve ose trupave ujor artificial në ujë mbledhësit për të qetësuar rrjedhat e përmbytjeve;
- Ndërtimi i skelave dhe brigjeve kundër përmbytjes rreth pronave të rëndësishme për të parandaluar përmbytjen;
- Zgjerimi i kanaleve ekzistuese ose lumenjve për të zvogëluar nivelin e përmbytjes ose për të përmirësuar regjimin e rrjedhës;
- Ndërtimi i kanaleve anësore për shmangie artificiale të përmbytjeve;
- Nxitja e zonimit të fushave lymore me masat përcjellës të planifikimit;
- Zbatimi i masave inxhinierive për kullim, gjegjësisht ruajtja e ujërave dhe objektet e pompimit
- Praktika e ruajtjes së tokës dhe masat përforcuese për brigje të lumenjve;
- Organizimi i planifikimit të emergjencës, masave dhe mobilizimit të mjeteve dhe materialeve;
- Përmirësimi i parashikimit të përmbytjes me sistemin e paralajmërimit.

▪ **Mbrojtja e tokave bujqësore nga ndërtimi**

Në zonave bujqësore është e ndaluar çdo aktivitet më karakter jo bujqësor si ndërtesa banimi, ndërtesa industriale, komerciale dhe aktivitete tjera me karakter jo bujqësor.

▪ **Rregullimi i tokës bujqësore**

Aspekti i rregullimit të tokës bujqësore është i përcaktuar me ligj ku janë disa kategori të rregullimit të tokave bujqësore. Rregullimi i tokës bujqësore bëhet nëpërmjet:

- Konsolidimit;
- Përmirësimi i pjellorisë së të tokës bujqësore përmes meliorimit.

▪ **Rregullimi nëpërmjet konsolidimit**

Rregullimi i tokës bujqësore nëpërmjet konsolidimit bëhet në rastet e mëposhtme:

- Kur për shkak të fragmentimit të lartë dhe të formave të parregullta të parcelave kadastrale, toka bujqësore nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë të arsyeshme;
- Kur të bëhet ndërtimi i sistemeve të kullimit ose të ujitjes;
- Kur të bëhet ndërtimi i rrjetit të rrugëve fushore;
- Kur të behet ndërtimi i infrastrukturës dhe ndërtesave të mëdha- rrugëve publike, hekurudhave, rezervuarëve, etj.;
- Kur të bëhet rregullimi i rrjedhave ujore dhe zgjerimi i tokave ndërtimore;
- Kur të bëhen punë dhe masa kundër-erozive.

▪ **Rregullimi nëpërmjet meliorimit**

Rregullimi i tokës bëhet për këto qëllime:

- Grupimi i tokës për shfrytëzim më racional dhe ekonomik;
- Krijimi i parcelave me formë të rregullt gjeometrike;
- Përmirësimin e tokës përmes zbatimit të masave agro-teknike, agro-melioruese dhe hidromelioruese;
- Përmirësimi i infrastrukturës duke përfshirë qasjen në infrastrukturën teknike si dhe shërbimeve publike;
- Ripyllëzimi i tokës të cilësisë më të dobët ose tokës së ndotur;

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.7. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.8. ZONË PYJORE (ZP)

Zona Pyjore shënohen me kodin **ZP** dhe është kryesisht sipërfaqe e mbuluar me pyje të larta dhe shkurre.

Tabela 55 Zonat Pyjore

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZP	Zona Pyjore	12,243.73

- **Shfrytëzimet e lejuara**

Në **ZP** funksione dhe aktivitete e lejuara janë :

Kultivimi i pyjeve bazuar në rotacion të shkurtër, pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë, pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme, kultivimi pyjeve (drunjtëve), melorizimi i pyjeve, mbledhja e frutave natyrore, prerja sanitare e pyjeve.

- **Shfrytëzimet e lejuara dytësore**

Në **ZP** funksione dhe aktivitete dytësore dhe vartëse nga shfrytëzimi parësor i lejuar në zonë që mund të gjenden edhe në të njëjtën parcelë me shfrytëzimin e lejuar janë:

Mbledhja e frutave natyrore, prerja sanitare e pyjeve, bletaria, shfrytëzimit të masës drusore (drurit teknik dru zjarri).

- **Shfrytëzimet e lejuara të veçanta**

Në **ZP** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

Infrastruktura bujqësore, ndërtesat mbështetëse të fermave dhe objektet për grumbullimin dhe trajtimin e produkteve bujqësore, ndërtesat për ruajtje dhe konservim të mishit, kullosat, aktivitetet për nxjerrjen e pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore, kampingu, bujtinat, gjuetia dhe prerja e pyjeve, kultivimi dhe mbjellja e fidanëve dhe ripyllëzimi.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **ZP**, pas së cilës largohen plotësisht janë:

Prodhim bujqësor për konsum vetjak, Mbledhje e produkteve natyrore, ndërtimi i objekteve për qëllime të pylltarisë, blegtorisë dhe gjuetisë, Energjia e ripërtrishme (deri në 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep Komuna, ndërsa mbi 10 MW lejen dhe pëlqimin e jep institucionet qendrore, paraprakisht kërkohet të bëhet një plan fizibiliteti për potencialet energjetike për energji të ripërtrishme).

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Në **ZP** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë të gjitha zonat të cilat nuk janë të përfshira në:

Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

- **Kushtet zhvillimore për lëndinat natyrore, semi-natyrore, kaçubat dhe vendet e hapura**

Rekomandimet e mëposhtëm japin specifika për menaxhimin e vendeve të hapura, lëndinat dhe zonat që nuk janë pyllëzuar, por i takojnë kategorisë së vegjetacionit semi-natyror, në ruajtjen e peizazhit, zvogëlimin e erozionit të pyjeve dhe funksioneve shoqërore rekreative.

- Të identifikohen zonat e habitateve ekzistuese që mund të jenë me rëndësi të lidhshmërisë së lartë, pavarësisht nga rëndësia e drejtpërdrejtë e biodiversitetit të tyre. Për shembull, parqet, hekurudhat e pashfrytëzueshme, kanalet dhe lumenjtë në zonat urbane mund të mbajnë pak specie ose habitatet të rëndësishme, por mund të sigurojnë migrim të rëndësishëm, përhapje ose përmes ushqimit të kafshëve;
- Të identifikohen zonat prioritare në rrjetin ekologjik që mund të jetë cak për menaxhim të habitateve, zgjerim ose restaurim përmes skemave bujqësor-mjedisore;
- Të përmirësohet lidhshmëria funksionale e rrjetit (ekologjik) të habitateve në mjedis më të gjerë;

- Të ruhen copat e habitatit semi-natyror në peizazh (p.sh. lëndinë semi-natyrore dhe shkurret në habitatet bujqësore, drunjtë e tharë dhe pjesët moçalore në pyje);
- Nga elementet e lidhshmërisë, të nxitet, menaxhimi i favorshëm për botën shtazore (p.sh. rrethoja e gardhit, kanalet) si mjet për përmirësim të vitalitetit të përgjithshëm të peizazhit;
- Të identifikohen zonat e prioritetit të habitatit të matricës për restaurim për të shtuar përshkueshmërinë e peizazhit në lëvizje të specieve;
- Të identifikohen opsionet për përshtatje të skemave agro-mjedisore në të ardhmen dhe mekanizmat e përdorur për të synuar përmirësimin e vazhdimësisë ndërmjet habitateve bujqësore dhe jobujqësore;
- Të nxitet kositja e lëndinave semi-natyrore për të ruajtur cilësinë e tij, por të respektohen datat e nevojshme për rritje të bimëve dhe rritje të shpezëve (1 prill – 1 gusht, data duhet të konfirmohet nga autoriteti përkatës në vend);
- Të nxitet menaxhimi i matur dhe i kujdesshëm i bagëtisë/kullotave dhe të shmanget tejkullotja dhe erozioni rezultues;
- Të nxitet ri-mbjellja e barit në tokë të brishtë kodrinore ose malore, duke e lënë atë të mbjellët në verë të hershme dhe duke e lënë bagëtinë ta shkelin dhe pastaj e lëni për shira; rishkelja nga bagëtia në shpatet që shikojnë nga veriu, pjesët ku bie dielli dhe ato të zhveshura sa më shumë në verë të thatë;
- Kullota me presion të ulët/bagëti afatshkurtër që ka në cak vetëm zonat me kullotë cilësore nga e cila pastaj largohet bagëtia për t'i ikur tejkullotjes së lëndinës dhe kullotja dhe shkelja e vegjetacionit natyror;
- Ndalohet ose kufizohet kullotja gjatë periudhave të rritjes së bimëve natyrore dhe që pason menjëherë;
- Pastrimi minimal i vegjetacionit dhe trazimi i tokës;
- Të krijohet toka me druaj dhe toka me kaçuba, ku drunjtë janë të dobishëm për hije dhe strehim të bagëtisë, si dhe u ofron banim veshtullave (parazit bimësh), zogjve dhe insekteve;
- Vegjetacioni bregor përgjatë përroskave, i cili është i vlefshëm për furnizim dhe cilësi të ujit, si dhe për peshq, insekte dhe bimë akustike vendore;
- Zonat moçalore (kullojset, moçalet, hurdhat e fermave), të cilat janë të vlefshme për kullota dhe ujë të bagëtive, duke u ofruar habitat zogjve, insekteve dhe peshqve vendas;
- Aty ku ka nevojë për punime tokësore, të merret parasysh ruajtja e ndërgjegjshme e shtigjeve dhe shfrytëzimi i makinave të përshtatshme (gërmuesi, buldozeri i vogël) për të ulur trazimin dhe erozionin e tokës;
- Të krijohet mozaiku i moshave të ndryshme të vegjetacionit nëpër ngastrat e ofruara semi-natyrore.

- **Kushtet zhvillimore për menaxhimin e pyjeve për ekonomi ose bio-energji**

Zonat pyjore ose me vegjetacion natyror zakonisht vazhdojnë të jenë në zonat më malore, në tokë shkëmbore jopjellore dhe në zonat shpesh të përmbytura. Pavarësisht pjellorisë së dobët të përgjithshme, shumë pyje janë të përshtatshme për krijimin e plantacioneve për tregti. Një nga arsyet kryesore për prerjen e paligjshme të pyjeve është varësia tradicionale për dru si lëndë djegëse për ngrohje dhe për këto arsye më poshtë kemi cekur disa rekomandime për mbrojtjen dhe zhvillimin e këtyre zonave.

- Plan për Administrimin e Pyjeve duhet të jetë pjesë integrale për prodhimin e biomasës;
- Pyjet e degraduara, me vlerë të ulët mund të përdoren për bio-energji si pjesë e përmirësimit të qëndrimit për rigjenerim dhe shndërrim në lloje më të dëshirueshme;
- Plantacionet që kultivojnë drunjë apo fidane, rreth 25-45% të biomasës së pyllit lihet në vend, kur drunjtë me vlerë të lartë priten për drunjtë e prerë me sharrë ose drunjë të butë. Ky prodhim i 'mbeturinave' mund të përdoret për prodhim të bio-energjisë. Kjo përmirëson rendimentin e punëve pyjore dhe zvogëlon rreziqet nga zjarri;
- Duhet të nxiten FMP-të e përbashkëta, që të mund të përmirësoj fitimin ekonomik dhe të zvogëlojnë dëmtimin e mjedisit, duke harmonizuar menaxhimin e infrastrukturës së pyjeve dhe masave;
- Duhet të nxitet konsolidimi i pronësisë së pyjeve;
- Zonat pyjore me shkurre/kaçuba të dendura (të ulëta) të kthehen në zona pyjore ekonomikisht dhe ekologjikisht të qëndrueshme;

- Kurdo që është e mundur për prodhimin e energjisë duhet të kultivohen drunjtë që rriten shpejtë, të cilët janë të përshtatshëm për klimën dhe tokën lokale (disa nga llojet kryesore janë: plepi, plepi i egër, Liquidambar styraciflua dhe shelgu).

▪ Kushtet zhvillimore për mbrojtjen e tokave pyjore nga erozioni

Pasi rreziku nga erozioni i tokës po rritet, ngjashëm shtohet edhe rëndësia e zvogëlimit të këtyre rreziqeve. Në zonat pyjore kudo që konsiderohet se ka rrezik mjaft të lartë të erozionit duhet të sigurohen masat për zvogëlimin e erozionit dhe si rezultat i saj kemi dhen disa rekomandime se si të mbrohemi nga erozioni në tokë pyjore.

- Të ruhet mbulesa ekzistuese e tokës, nëse mbulesa është larguar për çfarëdo arsye, atëherë shkorret, hasra ose mbrojtja tjetër e përkohshme për sipërfaqen e tokës;
- Mos të ngjiten veturat apo makineria elektrik lart e poshtë shpateve për shkak se mund të kanalizohet nëpër shtigje rrjedhja e shtuar;
- Duhet pasur kujdes të veçantë gjatë punëve të rrallisjes së pyjeve në tokë të ndjeshme, zonat e ndjeshme në erozion dhe zonat punët mund të çojmë në erozion të tepërt të tokës sidomos në afërsi të ujë-rrjedhave.
- Duhet shmangur teknikat e papërshtatshme të tilla si lëvrimi i thellë i tokës, para mbjelljes, dhe përdorimi i makinerisë së papërshtatshme;
- Aty ku toka tashmë është rëndë e gërryer, duhet të krijohen masa të veçanta teknike anti-erozive sa më shpejt të jetë e mundur, sepse erozioni i thellë mund të shkaktojë ndikim serioz ekonomik në infrastrukturën e afërt. Këto masa përfshijnë tarracimin, duke përforcuar shpatet me gurë, rrjeta metalike ose çimento, duke e shtuar lartë shtresën e punueshme dhe duke krijuar një mbulesë të trashë bari;

▪ Mbrojtja e tokave pyjore

Pyjet janë resurse kombëtare, duhet të zhvillohen dhe mbrohen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Udhëheqja e pyjeve do të marrë parasysh gjithashtu edhe interesat të tjera publike.

Mbrojtja dhe zhvillimi i tokave pyjore është i rregulluar me ligjin për pyjet nr. 2003/3 dhe U.A nr. 05/2010 që rrjedhin nga ky ligj, në kuadër të ligjve janë përcaktuar mënyrat e mbrojtjes së tokave pyjore si:

- Mbrojtja nga prerja e pa kontrolluar e pyjeve dhe dëmtimeve tjera;
- Mbrojtja nga ndërrimi i destinimit;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jo-drusore;
- Mbrojtja nga zjarri.

▪ Mbrojtja nga prerja e pa kontrolluar e pyjeve dhe dëmtimeve tjera

Me qëllim të mbrojtjes së pyjeve dhe tokave pyjore, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, aktivitetet në vijim ndalohen:

- Shkretërimi i pyjeve;
- Prerja e pastër e pyjeve;
- Prerja e pyjeve e cila nuk është në harmoni me planin e menaxhimit afatgjatë të pyjeve;
- Prerja e drunjëve të llojeve të rralla dhe të mbrojtura, përveç nëse nevojiten për arsye sanitare;
- Prerja e drunjëve pa damkë pyjore dhe pa shënjim paraprak të trungjeve për prerje;
- Prerja e llojeve të rralla dhe të rrezikuar, pemëve të egra si dhe prerja e drunjëve në grumbujt farorë, përveç nëse është paraparë me planet e menaxhimit të këtyre grumbujve;
- Shfrytëzimi i dheut, humusit, gurëve, zhavorrit dhe lëndëve tjera minerale pa pëlqimin e Agjencisë ose të pronarit të pyjeve private;
- Dëmtimi i fidanishteve dhe fidanëve;

- Dëmtimi dhe zhdukja e shenjave pyjore, tabelave, udhërrëfyeseve dhe vijave kufitare;
- Kullotja, ose mbledhjet komerciale të frutave pyjorë, kërpudhave, myshqeve, likeneve, rrëshirës, bimëve mjekuese, vendosja e koshereve dhe tendave pa lejen Agjencisë apo pronarit të pyjeve private;
- Ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës tjetër në pyje, pa lejen e Agjencisë ose pronarit të pyjeve private;
- Deponimi dhe hedhja e mbeturinave dhe materialeve toksike në pyje dhe toka pyjore përveç për deponime të përkohshme të materialeve që përdoren për trajtim fitosanitar të pyllit të njëjtë;
- Ndezja e zjarrit të hapur në pyje dhe toka pyjore;
- Uzurpimi i pyjeve dhe tokave pyjore;

- **Mbrojtja nga ndërrimi i destinimit**

Ndërrimi i destinimit të tokave pyjore mund të bëhet duke respektuar dispozitat ligjore si në vazhdim**:**

- Pyjet dhe tokat pyjore duhet të përdoren vetëm për qëllime pyjore sipas ligjit dhe përjashtimisht mund të përdoret edhe për qëllime tjera vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj;
- Toka pyjore e klasit 1 deri 4, përcaktohet si tokë pyjore dhe ndalohet ndërrimi i destinimit përveç rasteve të veçanta të përcaktuara me ligj;
- Toka pyjore e klasit 5-6, përcaktohet si tokë pyjore dhe përjashtimisht mund të përdoret për qëllime tjera sipas kushteve të përcaktuara me ligj;
- Toka pyjore e klasit 7-8, mund të përdoret edhe për qëllime tjera sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar me ligj;
- Kërkesa për ndërrimin e destinimit të pyllit privat bëhet nga pronari dhe dorëzohet tek organi kompetent komunal, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligj;
- Ndërrimi i destinimit të pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore mund të bëhet nëse është paraparë me planin e menaxhimit;
- Kur një aprovim i tillë jetë bërë, menaxhuesi i pyllit ka heq dorë nga kërkesat që drunjtë të shënjohen para prerjes dhe pronarit të pyllit i jepet leja, të transportoj drunjtë e prerë;
- Ministra me akt nënligjor përcakton kushtet dhe mënyrën e ndërrimit të destinimit.

- **Mbrojtja dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jo-drusore:**

- Asnjë person s'mund të shfrytëzojë produktet pyjore jo drunore për qëllime komerciale prej tokës nën administrim të Agjencisë Pyjore, pa licencë;
- Ministria me rregullore vendosë kufirin e sasisë të produkteve jodrunore pyjore, dhe çfarëdo shfrytëzimi mbi këto sasi në një vit kalendarik do të konsiderohet të jetë për qëllime komerciale;
- Agjencia pyjore lëshon licenca për shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrunore në rast të konkludimit se shfrytëzimi është në pajtim me shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyllit;
- Agjencia Pyjore autorizon njësitë e veta në Komuna për të lëshuar licenca sipas këtij neni personave fizik dhe juridik;
- Qeveria, me propozim të Ministrisë, me rregulla mund të vendosë taksat për licenca për shfrytëzimin e produkteve jodrunore të tokave pyjore, bazuar mbi produktet specifike dhe sasitë e shfrytëzuara, plus një pagesë për të mbuluar shpenzimet e lëshuarjes së licencës;
- Lejohet vjelja, grumbullimi dhe shfrytëzimi i produkteve pyjore jodrunore si: frutave pyjore, bimëve mjekuese, kërpudhave, farërave dhe prodhimeve tjera për qëllime jo komerciale deri në 2 kilogram, nëse nuk rrezikohet ripërtëritja dhe nuk u shkaktohen dëme pyjeve;
- Grumbullimi i gurëve, zhavorrit, rërës, humusit dhe dheut, kullotja, mund të bëhet vetëm në vendet ku nuk ndotet mjedisi, nuk bëhet rrëshqitja, erozioni, apo ku nuk i shkaktohet dëm pyllit dhe tokës pyjore;
- Shfrytëzimi komercial i produkteve jo-drusore mund të bëhet komfor ligjit, me leje të Agjencisë për rastet e pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore, dhe me lejen e pronarit të pyjeve dhe tokave pyjore private apo asociacionit të tyre;
- Leja për shfrytëzim lëshohet në harmoni me projektin e shfrytëzimit të produkteve pyjore jodrunore;

- Mënyra, kushtet, përmbajtja dhe çmimi i lejes për grumbullimin e produkteve pyjore jodrunore, si dhe llojet e shfrytëzimeve përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

- **Mbrojtja e pyjeve nga zjarri**

Rekomandimet në bazë të ligjit:

- Asnjë person pa leje paraprake s'mund të ndezë zjarr të hapur në pyjet ose tokat pyjore.
- Duhet të merret leje nga Agjencia Pyjore për ndezjen e hapur të zjarreve, kur një veprim i tillë është në përputhshmëri me shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyllit;

Rekomandime shtesë për mbrojtje të pyjeve nga zjarret:

- Ndalohet ndezja e zjarrit të hapur në pyje, toka pyjore, toka bujqësore dhe vende të tjera të hapura që gjenden më afër se 500 m nga pylli;
- Brenda pyllit dhe tokës pyjore, ndezja e zjarrit lejohet vetëm për qëllime të menaxhimit në periudhat ku nuk ka paralajmërime për rrezik të lartë të zjarrit dhe në vende të posaçme të pyllit që janë të destinuara për piknik në natyrë;
- Agjencia harton planin për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri në nivel të njësisë menaxhuese apo të Komunës, për periudhën 10-vjeçare.

- **Mbrojtja e pyjeve nga ndotja**

- Ndalohet ndotja e pyllit, tokës pyjore me hedhurina, mbeturina të ndryshme, mjete kimike, vajra, materiale tjera toksike, djegie gome dhe mbetjeve të tjera;
- Përdorimi i produkteve kimike për mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit, mund të bëhet nga lista e produkteve për mbrojtjen e bimëve, të miratuara nga Ministria;
- Ministria siguron monitorim periodik të gjendjes së shëndetit pyjor në nivel kombëtar, në përputhshmëri me metodologjinë standarde të Programit për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ICP);

- **Mbrojtja e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit**

- Agjencia dhe pronarët e pyjeve private janë të obliguar që të monitorojnë gjendjen e shëndetit të pyjeve dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve që rrezikojnë pyjet;
- Planet për mbrojtjen e pyjeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit miratohen nga Agjencia;
- Agjencia, në bashkëpunim me institucionet tjera siguron realizimin e aktiviteteve për mbrojtjen e shëndetit të pyjeve;
- Nëse masat e pronarëve të pyjeve private nuk janë të mjaftueshme në rastet kur shëndeti pyjor është rrezikuar shumë, Agjencia duhet të ndërmarrë masat e duhura shtesë për mbrojtjen e këtyre pyjeve.

Për kushte zhvillimore dhe ndërtimore për përfitimin e energjisë së ripërtritshme referojuni kapitullit :

9.6. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME.

5.9. SIPËRFAQE UJORE (SU,SU-1)

Bazuar në U.A. MMPH-NR. 08/2017 sipërfaqet ujore përfshijnë të gjithë ujërat sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore. Hapësirat në të cilat ndodhen burimet ujore duhet të mbrohen nga ndotja e qëllimshëm apo aksidentale dhe ndikimet e tjera të cilat mund të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërinë e burimit dhe përbërjen natyrore të ujit në burim. Sipërfaqet ujore në Komunën e Vitisë përfshijnë rrjedhat ujore, trupat ujore dhe brezat mbrojtës përkatës, të cilët paraqesin resurse të rëndësishme natyrore, ekologjike, hidrologjike dhe peizazhore për territorin e komunës. Në kuadër të Hartës Zonale Komunale, sipërfaqet ujore trajtohen me kodin SU-1 – Sipërfaqe ujore - Lum, në përputhje me klasifikimin e zonave bazë dhe me përcaktimet e PZHK-së dhe HZK-së. Këto sipërfaqe lidhen kryesisht me Lumin Morava e Binçës, si rrjedha kryesore ujore në territorin e Komunës së Vitisë, si dhe me rrjedhat tjera më të vogla që derdhen në të.

Lumi Morava e Binçës paraqet elementin kryesor hidrografik të komunës dhe ka rëndësi të veçantë për ekosistemin, kullimin natyror të territorit, mbrojtjen nga vërshimet, peizazhin dhe balancën mjedisore. Përgjatë rrjedhës së tij dhe rrjedhave përcjellëse duhet të sigurohen brezat mbrojtës, të cilët paraqiten edhe në pjesën hartografike të HZK-së si zona mbrojtëse të lumenjve.

Tabela 56 Sipërfaqet Ujore

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
SU-1	Sipërfaqe ujore - Lum	127.75

Përcaktimi i mbrojtjes sanitare bëhet për burimet e ujerave:

1. Nëntokësore- burimet akuiferet dhe minerale, termike dhe termike-minerale;
2. Sipërfaqësore- liqenet, akumulimet dhe ujë-rrjedhat.

Sipërfaqet ujore në komunën e Vitisë ndahen në një kategori si:

- **SU-1** Është tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekzistues;

▪ Shfrytëzimet e lejuara

Në **SU-1** lejohen vetëm shfrytëzimet që janë në funksion të mbrojtjes, mirëmbajtjes dhe menaxhimit të rrjedhave ujore, si:

Ruajtja dhe mbrojtja e shtratit të lumit, mirëmbajtja dhe pastrimi i rrjedhave ujore, mbrojtja nga vërshimet dhe erozioni, rehabilitimi ekologjik i brigjeve, vendosja e brezave mbrojtës përgjatë trupave ujore, monitorimi i cilësisë së ujit, qasja teknike për mirëmbajtje dhe intervenime emergjente, ura, kalime dhe elemente infrastrukturore të domosdoshme, vetëm me kushte dhe pëlqime përkatëse.

▪ Shfrytëzimet e lejuara dytësore

Në **SU-1** funksione dhe aktivitete dytësore mund të lejohen vetëm ato që nuk e cenojnë funksionin primar të sipërfaqes ujore, si:

Shtigje këmbësore ose rekreative përgjatë brezit të lumit, jashtë shtratit dhe zonës së rrezikut, gjelbërim mbrojtës dhe peizazhor, sinjalistikë informuese për mbrojtjen e ujërave, pika vrojtimi ose hapësira të lehta rekreative, vetëm nëse nuk dëmtojnë rrjedhën ujore dhe brezin mbrojtës.

▪ Shfrytëzimet e lejuara të veçanta

Në **SU-1** funksionet dhe aktivitetet të cilat janë të lejuara me kushte plotësuese dhe me kërkesë të veçantë janë:

Rregullimi i shtratit të lumit, ndërtimi i urave, tombinove dhe kalimeve teknike, ndërhyrje për mbrojtje nga vërshimet, kaptimi ose shfrytëzimi i burimeve ujore, vetëm sipas lejeve përkatëse, ndërhyrje në burime natyrore, burime të kaptuara ose ujëra termominerale, projekte për rehabilitim ekologjik ose menaxhim të ujërave, akuakulturë, peshkim profesional, rekreacion, kamping, bujtinat.

- **Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht**

Funksionet dhe aktivitet e lejuara përkohësisht në kuadër të **SU-1** pas së cilës largohen plotësisht janë:

Punime emergjente për mbrojtje nga vërshimet, pastrim dhe mirëmbajtje sezonale e shtratit dhe brigjeve, ndërhyrje të përkohshme për sanim të dëmtimeve, matje, monitorim, hulumtime hidrologjike dhe mjedisore, vendosje e përkohshme e pajisjeve për punime teknike ose mirëmbajtje.

- **Shfrytëzimet e ndaluara**

Në **SU-1** kemi edhe shfrytëzimet e ndaluara, të cilat i kemi përcaktuar si funksione dhe aktivitete që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruar në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë:

Ndërtimet banimore, komerciale, industriale dhe objektet e përhershme brenda shtratit të lumit dhe brezit mbrojtës, mbushja, betonimi ose devijimi i rrjedhave ujore pa leje, deponimi i mbeturinave, materialeve ndërtimore ose ndotësve, shkarkimi i ujërave të ndotura pa trajtim, dëmtimi i brigjeve, prerja e gjelbërimit mbrojtës dhe ndërhyrjet që rrisin rrezikun nga vërshimet, shfrytëzimet që bien në kundërshtim me PZHK-në, HZK-në dhe legjislacionin për ujërat dhe mjedisin.

- **Kushtet Ndërtimore**

Në **SU-1** përkatësisht në të gjitha rrjedhat ujore lejohet ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse ujore, lejohet ndërtimi i infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe shtigjeve të ecjes, përkatësisht lejohet ndërtimi i urave që janë pjesë përbërëse e transportit tokësor.

Nuk lejohen aktivitete si djegia e mbeturinave të çfarëdo lloji në zonat e banimit, të sistemit natyror apo në brigjet e burimeve ujore.

Përdorimet industriale janë të ndaluara të vendosën në brigjet ujore, në zonat të mbrojtura natyrorë pavarësisht kategorive, në zonat që mbrohen nga legjislacioni për monumentet e kulturës, përfshirë zonat buferike apo brezat mbrojtës të këtyre zonave/objekteve

- **Mbrojtja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore**

Për të arritur objektivat për ujë të pijshëm dhe te sigurt për të gjitha burimet e ujerave Komuna do të ndërmerr gjitha masat mbrojtëse sipas dispozitave dhe ligjeve ne fuqi për mbrojtjes ujerave sanitare, përmes tre zonave të mbrojtura sanitare vijuese:

1. Zona e I-rë:
   Zona e Kufizimit përcaktohet me qëllim të mbrojtjes së burimit dhe objekteve ujë marrëse si dhe zonës së drejtpërdrejt të tyre nga çfarëdo dëmtimi, ndotje ose ndikime tjera të dëmshme të rastësishme ose të që qëllimshme.
2. Zona e II-të:
   Zona e Kontrollimit përcaktohet me qëllim të parandalimit të kontaminimit dhe rrezikut të ndotjes nga mikroorganizmat ose materiet tjera të dëmshme për cilësinë e ujit.
3. Zona e III-të:
4. Zona e Mbikëqyrjes përcaktohet me qëllim mbrojtjes së burimit nga ndotja me materie të rrezikshme ndotëse që vështirë zbërthehen dhe për pasojë dëmtojnë në afat të gjatë shfrytëzimin e ujit të burimit.

- **Zonat mbrojtëse për burimet nëntokësore në akuifer intergranular**

Zona e I-rë e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer intergranular

Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtura sanitare të një burimi nëntokësor në akuifer intergranular paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujë marrëse dhe objekteve përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit, në të cilën ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë, në cilën lejohet vetëm :

Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit;

Punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, me ç' rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

- **Zona e II-të e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer intergranular**

Territori i zonës së II-të përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë deri te vija prej së cilës ujit nëntokësorë i nevojiten së paku 50 (pesëdhjetë) ditë për të arritur te vepra ujë marrëse. Kufiri i zonës së II-të të mbrojtur për burime dhe puse duhet të jetë së paku 100 (njëqind) metra nga zona e I-rë e mbrojtur, në të cilën ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, si vijon:

1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara të kanalizimit;[1]
2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj.);
3. Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
4. Përpunimi deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
5. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
6. Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
7. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
8. Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
9. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i varrezave ekzistuese;
10. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.
11. Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
12. Përdorimi i pesticideve, herbicideve, dhe insekticideve;
13. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
14. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
15. Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
16. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme;
17. Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
18. Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
19. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

[1] UA per Zonat e Mbrojtura Sanitare

- **Zona e III-të e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer intergranular**

Territori i zonës së III-të të mbrojtura për burimet në akuifer intergranular përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogjeologjik. Në rastet kur kufiri hidrogjeologjik nuk është i njohur, zona e III-të përfshin hapësirën deri te kufiri prej të cilit ujit nëntokësor i nevojiten së paku 200 (dyqind) ditë për të arritur te vepra ujë marrëse. Kufiri i zonës së III-të duhet të jetë së paku 500 (pesëqind) metra nga vepra ujë marrëse në të cilën ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit, dhe në mënyrë specifike :

1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara të kanalizimit;
2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj.);
3. Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
4. Përpunimi deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
5. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
6. Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
7. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
8. Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
9. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i varrezave ekzistuese;
10. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

- **Zonat mbrojtëse për burimet nëntokësore në akuifer karstik**

Zona e I-rë e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer karstik

Kufiri i Zonës së I-rë të mbrojtura të një burimi nëntokësor në akuifer karstik paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar 20 (njëzet) metra nga vepra ujë marrëse. Kjo zonë duhet të përfshijë edhe të gjitha objektet përcjellëse që shërbejnë për shfrytëzimin e burimit të ujit, në të cilën ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë dhe lejohet vetëm:

1. Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe materieve tjera që mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit;
2. Punimi i rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit, energjisë për nevojat e procesit të marrjes dhe trajtimit të ujit nga burimi, me ç'rast me zgjidhjet e elaboratit dhe zbatimit të punimeve duhet të sigurohet që mos të rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

- **Zona e II-të e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer karstik**

Territori i zonës së II-të sanitare për burimet e ujit ne akuifer karstik përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së I-rë të mbrojtura deri te vija prej së cilës ujit nëntokësorë i nevojiten së paku 24 (njëzet e katër) orë për të arritur deri në veprën ujë marrëse, me ç'rast ky kufi nuk mund të jetë më afër së 500 (pesëqind) metra prej veprës ujë marrëse, në të cilën ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, në mënyrë specifike:

1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara të kanalizimit;
2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj.);
3. Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
4. Përpunimi deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
5. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
6. Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
7. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
8. Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
9. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i varrezave ekzistuese;
10. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.
11. Përdorimi i plehrave kimike dhe atyre të kafshëve;
12. Përdorimi i pesticideve, herbicideve, dhe insekticideve;
13. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
14. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
15. Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
16. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme;
17. Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
18. Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
19. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

- **Zona e III-të e Mbrojtur Sanitare për burimet nëntokësore në akuifer intergranular**

Territori i zonës së III-të sanitare për burimet në akuifer karstik përfshin hapësirën jashtë kufirit të zonës së II-të deri te vija prej të cilës ujit nëntokësor i nevojiten së paku 20 (njëzet) ditë për të arritur te vepra ujëmarrëse. Kufiri i zonës së III-të sanitare duhet të jetë së paku 1000 (njëmijë) metra larg veprës ujëmarrëse në drejtim të rrjedhjes së ujit, në të cilën ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit, dhe në mënyrë specifike :

1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara të kanalizimit;
2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare me teknologji të papastër të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera të dëmshme për ujin (reaktorë nuklear, industri petrokimike dhe kimike, reparte të përpunimit të metaleve, industri e lëkurave etj.);
3. Deponimi i përkohshëm ose i përhershëm i mbeturinave;
4. Përpunimi deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
5. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;

6. Ndërtimi i autoudhëve, aeroporteve, parkingjeve, ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimit të tyre në recipient;
7. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gaz tokësor dhe materie tjera të dëmshme për ujin, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujërat nëntokësore;
8. Deponimi i hapur dhe aplikimi i substancave kimike të dëmshme dhe të rrezikshme për ujin që shfrytëzohen për mbrojtjen e bimëve;
9. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimi i varrezave ekzistuese;
10. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit qoftë në kuptim sasior apo cilësor.

- **Zonat mbrojtëse për burimet sipërfaqësore: Akumulacione e Liqene**

Zona e I-rë e Mbrojtur Sanitare për burimet sipërfaqësore: akumulacione e liqene

Zona e I-rë e përfshin:

1. Liqenin respektivisht akumulacionin dhe brezin mbrojtës përgjatë akumulacionit me gjerësi 10 (dhjetë) metra nga kufiri i nivelit më të lartë të ujit;
2. Veprën ujëmarrëse dhe objektet tjera përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit.
3. Në zonën e I-rë të mbrojtura sanitare të liqeneve dhe akumulacioneve ndalohet:
4. Kryerja e punimeve, ndërtimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike, përpos atyre për marrjen, trajtimin, dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit;
5. Përdorimi i plehrave dhe preparateve për mbrojtjen e bimëve;
6. Shkarkimi i ujërave të ndotura nga objektet prodhuese dhe të ujërave që përdoren për pastrimin e pajisjeve për trajtimin e ujit;
7. Shfrytëzimin e të gjitha llojeve të mjeteve të lundrimit me mjete motorike;
8. Sportet e ujit, peshkimi sportiv dhe kultivimi i peshkut;
9. Mbajtja dhe furnizimi me ujë i kafshëve;
10. Qarkullimi publik i automjeteve dhe këmbësorëve
11. Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimtarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
12. Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikat e mira të bujqësisë;
13. Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
14. Transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta, dhe materieve tjera të rrezikshme;
15. Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
16. Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
17. Stacionet e riciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
18. Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacion.

- **Zona e II-të e Mbrojtur Sanitare për burimet sipërfaqësore: Akumulacione e Liqene**

Territori i zonës së II-të të mbrojtura për akumulacione përfshinë:

1. Brezin e gjerësisë prej 200 (dyqind) metra prej kufirit të zonës së I-rë të mbrojtura përgjatë gjithë liqenit ose akumulacionit;
2. Brezin e gjerë prej 50 (pesëdhjetë) metra në të dy anët e ujë rrjedhave që derdhen në liqe dhe akumulacion në tërë gjatësinë e pellgut të akumulacionit.

Në zonën e II-të të mbrojtura për akumulacione cilën ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, në mënyrë specifike:

1. Deponimi i mbeturinave;
2. Shkarkimi i ujërave të ndotura të papërpunuara;
3. Ndërtimi i objekteve për deponim, transport, manipulim dhe përpunim të materieve radioaktive dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për ujin përfshirë objektet për deponimin e naftës dhe derivateve të naftës;
4. Ndërtimi i rrugëve pa objektet për grumbullimin e vajrave dhe yndyrave dhe të atyre për trajtimin e ujërave atmosferike;
5. Eksploatimi i rërës, zhavorrit, dhe argjilës.
6. Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimtarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
7. Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikat e mira të bujqësisë;
8. Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
9. Transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta, dhe materieve tjera të rrezikshme;
10. Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
11. Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
12. Stacionet e riciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
13. Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacion Ndërtimi dhe shfrytëzimi i puseve dhe objekteve tjera për marrjen e ujit të cilat nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
14. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
15. Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale;
16. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme;
17. Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajrave dhe materieve tjera të rrezikshme;
18. Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
19. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

- **Zona e III-të e Mbrojtur Sanitare për burimet sipërfaqësore: Akumulacione e Liqene**

Territori i zonës së III-të të mbrojtura për liqene dhe akumulacione shtrihet jashtë kufijve të zonës së II-të të mbrojtura dhe përfshinë tërë gjerësinë e pellgut natyror që derdhet në akumulacion ose liqe, në të cilën ndalohen kryerja e punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit, dhe në mënyrë specifike:

1. Deponimi i mbeturinave;
2. Shkarkimi i ujërave të ndotura të papërpunuara;
3. Ndërtimi i objekteve për deponim, transport, manipulim dhe përpunim të materieve radioaktive dhe materieve tjera të rrezikshme dhe të dëmshme për ujin përfshirë objektet për deponimin e naftës dhe derivateve të naftës;
4. Ndërtimi i rrugëve pa objektet për grumbullimin e vajrave dhe yndyrave dhe të atyre për trajtimin e ujërave atmosferike;
5. Eksploatimi i rërës, zhavorrit, dhe argjilës.

- **Zonat mbrojtëse për burimet sipërfaqësore: Ujë rrjedhat e hapura**

Zona e I-rë e Mbrojtur Sanitare për burimet sipërfaqësore: ujë rrjedhat e hapura

Zona e I-rë sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujë rrjedhat përfshinë territorin përreth veprës ujë marrëse në largësi së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujë marrëse dhe të gjitha objekteve përcjellëse që shërbejnë për marrjen, trajtimin dhe deponimin e ujit si: stacioni i pompave, impianti për trajtimin e ujit, objektet për ruajtjen e burimit, në cilën ndalohet :

1. Kryerja e të gjitha llojeve të punimeve dhe aktiviteteve, përpos atyre për marrjen, trajtimin, dhe transportimin e ujit në sistemin e ujësjellësit ;
2. Përdorimi i plehrave dhe prepparateve për mbrojtjen e bimëve.

- **Zona e II-të e Mbrojtur Sanitare për burimet sipërfaqësore: Ujë rrjedhat e hapura**

Zona e II-të e mbrojtura sanitare në rastet e burimeve të ujit nga ujë rrjedhat e hapura përcaktohet në bazë të elaboratit për mbrojtjen e burimit të ujit me ç 'rast kufiri i kësaj zone nuk duhet të jetë më i vogël se 1000 (njëmijë) metra nga vepra ujë marrëse në rrjedhën e sipërme të ujë rrjedhës duke përfshirë ujë rrjedhën dhe brezin prej 30 metrash në të dyja anët e ujë rrjedhës. Ku ndalohet:

1. Kultivimi i produkteve bujqësore përpos në rastet e prodhimtarisë ekologjike pa përdorimin e plehrave;
2. Prodhimtaria e bagëtisë përpos për nevojat e bujqësisë respektivisht fermat deri 20 (njëzet) krerë me masat mbrojtëse në pajtim me praktikat e mira të bujqësisë;
3. Ndërtimi i të gjitha objekteve për prodhimin, deponimin dhe transportimin e materieve të rrezikshme;
4. Transporti rrugor i materieve kimike, karburanteve të lëngëta, dhe materieve tjera të rrezikshme;
5. Ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve magjistrale dhe hekurudhave;
6. Ndërtimi i varrezave dhe zgjerimi i tyre;
7. Stacionet e riciklimit dhe të ngarkimit të mbeturinave;
8. Ndërtimi i objekteve tjera të cilat mund ta rrezikojnë cilësinë e ujit në akumulacion.[2]

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit**

Për hapësirat lineare përgjatë lumenjve, preferohen linja të pandërprera të drunjve me qëllim izolimin e shtigjeve nga trafiku. Mbjelljet mund të përfshijnë kombinim të drunjve të mëdha gjetherënëse, pemëve të vogla gjetherënëse, pemëve me gjelbërim të përhershëm dhe shkurreve. Për peizazh ekologjik, mbillen bimë tolerante ndaj ujit në peizazhin e burimit ujor, higrofite dhe bimë lundruese përgjatë lumit.

Këto zona kërkojnë mbarështim me intensitet më të ulët: kositja e barit dy herë në vit, pastrimi i bimësisë së tejrritur apo të degëve që varen mbi rrugë.

Norma prej 1.5 m^2/banorë sipërfaqe gjelbërimi për zonat deri në 10.000 banorë dhe 2.5 m^2/banorë për zonat me mbi 10.000 banorë, për sipërfaqet e gjelbra përgjatë rrugëve, bulevardeve dhe **brigjeve ujore**.

[2] UA për zonat e mbrojtura sanitare

5.10. ZONAT USHTARAKE TË SIGURISË (ZuS)

Tabela 57 Zona Ushtarake e Sigurisë

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i shfrytëzimit	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZuS	Zonë Ushtarake	Camp. Bondsteel	80.975

Zona ushtarake-sigurisë shënohet me kodin ZuS, e cila është një zonë e destinuar kryesisht për aktivitete ushtarake dhe të sigurisë.

- **Kushtet Ndërtimore**

Të gjitha karakteristikat lidhur me kërkesat për kushtet ndërtimore në kuadër të ZuS-së janë subjekt i legjislacionit dhe rregulloreve specifike të sigurisë dhe çështjeve ushtarake, dhe nuk determinohen nga ky dokument i planifikimit hapësinor.

5.11. ZONË E MBROJTUR (ZM)

Zona Mbrojtur shënohen me kodin **ZM** dhe është kryesisht sipërfaqe e cila ka veçori natyrore të dedikuara për mbrojtje dhe konservim. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore janë pjesë të territorit të cilat përmbajnë karakteristikat dhe vlera të posaçme historike, artistike, trashëgimisë kulturore dhe mjedisore urbane. Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtur përcaktojnë mbrojtjen afat-gjate dhe konservimin e një zonë gjeografike me karakteristika të veçanta të trashëgimisë arkitekturale dhe arkeologjike, peizazhet kulturore me potencial të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit.

Në territorin e Komunës së Vitisë, aktualisht nuk janë identifikuar apo shpallur zona të mbrojtura në kuptimin e Ligjit për Zonat e Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039).

Megjithatë, kjo kategori përfshihet në kuadër të Hartës Zonale Komunale si kategori potenciale dhe rezervë planifikuese, me qëllim që të mundësohet mbrojtja dhe menaxhimi i hapësirave të cilat në të ardhmen mund të identifikohen si zona me vlera të veçanta.

5.12. ZONA TË VEÇANTA TË MBROJTURA - ZvM

Janë kategori hapësinore të cilat në detaje janë të përshkruara në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe shënohen me kodin ZVM dhe janë të ndara në tri grupe me karakteristika të ndryshme.

- Grupi i I-rë – zona, kufiri i së cilës është përcaktuar përmes hartave.
- Grupi II-të – zona e cila e ka një bufer zonë prej 100m^2 nga perimetri i tyre
- Grupi i III-të – zona e cila e ka një bufer zonë prej 50m^2 nga perimetri i tyre.

Në kuadër të territorit të PNMSH, sipas Ligjit për ZvM në Komunën e Vitisë, është i regjistruar monumenti - zonë e veçantë e mbrojtur dhe ajo është (i takon bufer zonës prej 100m^2 nga perimetri i saj) dhe ajo është:

- Manastiri i Binaçit, Buzovik, Viti.

Tabela 58 Zonë e Veçantë e Mbrojtur

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZvM-1	Zonë e Veçantë e Mbrojtur	16,41

▪ Shfrytëzimet e lejuara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura

Të gjitha aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara i referohen Ligji Nr. 03/L-039 për ZvM.

Ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve tranzite në zonat rurale;

Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit. në zona rurale dhe ndërtimeve që bëjnë shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit të asaj zone.

▪ Shfrytëzimet e Kufizuara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura

Të gjitha aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara i referohen Ligjit Ligjit Nr. 03/L-039 për ZvM.

Ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri/ kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet; ndërtimi i rrugëve; ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hotele-ve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale;

Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike dhe Urbanizimi i tokës bujqësore.

- **Shfrytëzimet e ndaluara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura (ZvM)**

Të gjitha aktivitetet e ndaluara dhe të kufizuara i referohen Ligjit Nr. 03/L-039 për ZvM.

Funksionet dhe aktivitetet që nuk janë në pajtueshmëri me kushtet e zbatueshme në zonë dhe i kemi deklaruara në mënyrë specifike si të pa lejuara, e këto janë të gjitha zonat të cilat nuk janë të përfshira në: Shfrytëzimet e lejuara, Shfrytëzimet e lejuara dytësore, Shfrytëzimet e lejuara të veçanta dhe Shfrytëzimet e lejuara përkohësisht.

Aktivitetet e ndaluara janë si në vijim:

- Ndërtimet apo zhvillimet industriale, si gërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i pendëve, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite;
- Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit
- Strukturat ose godinat më të larta se monumenti kulturor që duhet të mbrohet;
- Ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, 'supermarket'-eve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër; tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; transformimi i tokës bujqësore.

Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura ndalohet ndërtimi i deponisë për mbeturina. Në lokacionin ku ndërtohet apo planifikohet deponia e mbeturinave, paraqitet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zonat e veçanta të mbrojtura.

- **Kushtet Ndërtimore**

Kushtet ndërtimore në kuadër të kësaj zone janë subjekt i ligjit të natyrës, planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura apo planeve të tjera. Zhvillimet në kuadër të ZM-ve, duhet të jenë në harmoni me kërkesat që dalin nga Ligji për Zonat e Mbrojtura (Ligji nr. 03/L-039), në të cilin janë të listuara aktivitetet që lejohen ose ndalohen brenda zonës.

6. ZONAT MBISHTRESORE DHE KUSHTET ZHVILLIMORE

6.1. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR ZONAT MBISHTRESORE (ZMSH)

Në territorin e Komunës janë identifikuar disa zona të cilat cenojnë jetën dhe pronën, shëndetit dhe sigurisë, destabilizimin e tregtisë dhe të shërbimeve komunale, si dhe mund të krijojnë shpenzime të jashtëzakonshme publike për mbrojtjen nga përmbytjet, dhe ndikojnë negativisht në shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e përgjithshme publike.

Me qëllim të mbrojtjes së jetës së qytetarëve dhe pasurisë publike, private, natyrore apo kulturore, pas analizave dhe hulumtimeve të ndërmarra, Harta Zonale e Komunës ka identifikuar disa Zonat Mbishtresore për të cilat përcaktojnë kushte zhvillimore plotësuese për sipërfaqet e cenuara nga zhvillimet ekzistuese apo të planifikuara, kushtet natyrore apo me vlera për Komunën, Kosovë ose rajonin.

Zonat Mbishtresore përcaktojnë sipërfaqe të komunës ku cenohet mirëqenia e qytetarit, andaj nevojitet trajtim i veçantë këtyre zonave duke përcaktuar kushte shtesë të cilat synojnë të sigurojnë mirëqenien e qytetarëve dhe investimet brenda Komunës tonë.

Përpos kushteve të përgjithshme zhvillimore, kushteve zhvillimore për secilën zonë dhe kushteve ndërtimore të përcaktuara sipër, çdo zhvillim brenda zonave mbishtresore do të i plotësojë kushtet plotësuese të përcaktuara në përmbajtjen e këtij kapitulli, të cilat kanë për qëllim:

- Të kufizojnë ose parandalojnë dukuritë që janë të rrezikshme për shëndetin, sigurinë ose pronën private publike;
- Të sigurojnë shfrytëzim të qëndrueshëm dhe të papengueshëm nga rreziqet natyrore; dhe
- Të ndalojnë ose kufizojnë zhvillime që do rrisin dëmet nga fatkeqësitë natyrore.

Zonat mbishtresore vendosen mbi një apo disa zona bazë për të cilat janë përcaktuar kushte zhvillimore, krahas këtyre kushteve bazë, në zona mbishtresore janë vendosur kushte apo masa plotësuese, të cilat duhet të përmbushen gjatë shfrytëzimit të tokës.

Në rastet kur janë përcaktuar kushte që janë në kundërshtim në mes të zonës bazë dhe zonës mbishtresore atëherë kushtet e zonës mbishtresore kanë përparësi ndaj atyre të zonës bazë.

Zonat mbishtresore përdoren për vendosjen e kushteve zhvillimore më strikte, dhe masa mbrojtëse shtesë në disa hapësira specifike gjeografike, kur:

- Përcaktohen masa mbrojtëse për resurset kulturore, historike, ekonomike, turistike, bujqësore të cilat nuk janë adresuar me zonën bazë;
- Përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për Sipërfaqet e Mbrojtura, Zonat e Veçanta, Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse;
- Përcaktohen masa mbrojtëse për resurset lokale natyrore, si: mbrojtja e natyrës, e sipërfaqeve ujore, klimës, pyjeve, dhe tjera të cilat nuk janë të adresuara me zonën bazë;
- Përcaktohen masa mbrojtëse për ndikimet në mjedis, si: ndotja e ajrit, zhurma, etj.;
- Përcaktohen masa mbrojtëse dhe parandaluese për sipërfaqet me rrezikshmëri nga zjarri, nga përmbytja, sipërfaqet sizmike, erozive, rrëshqitja e gurëve, ortekëve, tërmetet, e të tjera; dhe
- Standarde të caktuara që nuk janë të nevojshme për të u zbatuar në gjithë territorin e Komunës.

6.1.1. PARIMI I VENDOSJES SË ZONAVE MBISHTRESORE

Zonat Mbishtresore (ZmSh) janë zona me kushte zhvillimore shtesë që vendosen mbi zonat bazë të përcaktuara në Hartën Zonale të Komunës.

Ato aplikohen në territore ku ekzistojnë:

- Rreziqe natyrore;
- Resurse strategjike;
- Kufizime mjedisore;
- Kushte gjeoteknike të veçanta.

Zonat mbishtresore nuk e ndryshojnë destinimin bazë të tokës, por vendosin kushte shtesë të detyrueshme për zhvillim.

6.1.2. HIERARKIA E ZBATIMIT TË KUSHTEVE

Në rast se ekziston mospërputhje ndërmjet:

- Kushteve të zonës bazë, dhe
- Kushteve të zonës mbishtresore,

atëherë kanë përparësi kushtet e zonës mbishtresore.

Kushtet e ZmSh konsiderohen masa mbrojtëse të interesit publik dhe janë të detyrueshme për zbatim

6.1.3. PROCEDURA ADMINISTRATIVE

1. Çdo aplikim për leje ndërtimore brenda Zonave Mbishtresore duhet të identifikohet qartë nga autoriteti komunal.
2. Aplikuesi është i obliguar të sigurojë:
   - Studimet teknike të kërkuara për zonën përkatëse;
   - Dëshmitë e përputhshmërisë me standardet përkatëse;
   - Mendimet profesionale kur kërkohen.
3. Drejtoria përgjegjëse për Urbanizëm verifikon përputhshmërinë e projektit me kushtet e ZmSh para lëshimit të lejes ndërtimore.

6.1.4. PARIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Projektuesit, mbikëqyrësit dhe investitorët janë përgjegjës për:

- Zbatimin korrekt të standardeve teknike;
- Sigurinë strukturore;
- Stabilitetin e terrenit;
- Mbrojtjen mjedisore.

Mosrespektimi i kushteve të Zonave Mbishtresore përbën shkelje të legjislacionit në fuqi.

6.1.5. REFERENCA NORMATIVE

Zbatimi i Zonave Mbishtresore bazohet në:

- Ligjin për Ndërtim në Republikën e Kosovës;
- Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligjin për Ujërat;
- Ligjin për Miniera dhe Minerale;
- Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore;
- Eurokodet e aplikueshme (EN 1990, EN 1997, EN 1998);
- Aktet nënligjore përkatëse.

6.2. KUSHTET ZHVILLIMORE PLOTËSUESE PËR ZONAT MBISHTRESORE SEIZMIKE – ZMSH - A1

6.2.1. QËLLIMI I ZONËS

Zona Mbishtresore Seizmike – ZmSh-A1 përfshin territorin me rrezik sizmik shumë të lartë (Intensiteti IX), ku kërkohen masa të shtuara sigurie për mbrojtjen e jetës, pronës dhe infrastrukturës.

6.2.2. FUSHA E ZBATIMIT

Këto kushte zbatohen për të gjitha zhvillimet e reja, rindërtimet dhe ndërhyrjet strukturore brenda territorit të përcaktuar si ZmSh-A1 në Hartën Zonale të Komunës.

6.2.3. KATEGORITË E NDËRTIMIT

Ndërtimet brenda kësaj zone klasifikohen sipas Ligjit për Ndërtim në Kosovë në:

- Kategoria I;
- Kategoria II;
- Kategoria III.

6.2.4. KUSHTET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Të gjitha ndërtimet duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me:
    - EN 1998-1 (Eurocode 8 – Projektimi sizmik);
    - EN 1997-1 (Eurocode 7 – Projektimi gjeoteknik);
    - EN 1990 (Bazat e projektimit strukturor).
2. Për objektet e Kategorisë II dhe III është i detyrueshëm studimi gjeomekanik i tokës.
3. Projektimi duhet të marrë në konsideratë:
    - Parametrat sizmikë të zonës;
    - Kategorinë e tokës;
    - Stabilitetin global të objektit.
4. Objektet e Kategorisë III duhet të dëshmojnë performancë të shtuar sizmike përmes analizës strukturore të detajuar.

6.2.5. REFERENCA LIGJORE

- Ligji për Ndërtim në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore;
- Eurokodet e aplikueshme.

6.3. KUSHTET ZHVILLIMORE PLOTËSUESE PËR ZONAT MBISHTRESORE SEIZMIKE – ZMSH - A2

trafikut duhet të bazohet në kritere teknike që sigurojnë siguri, efikasitet dhe qarkullim të pandërprerë, duke përfshirë:

- Gjeometrinë e rrethrrotullimit (diametrin e jashtëm, diametrin e ishullit qëndror, gjerësinë e korsive të trafikut, ishujt kahëzues etj.);
- Kapacitetin dhe rrjedhshmërinë e trafikut;
- Numrin e kyçjeve;
- Dukshmërinë - Duhet të sigurohet që drejtuesit e mjeteve të kenë shikueshmëri të mirë për të parë automjetet që hyjnë në rrethrrotullim;
- Siguria dhe aksesueshmëria;
- Shpejtësia e qarkullimit: Duhet të kufizohet në 30-40 km/h për të rritur sigurinë;
- Këmbësorët dhe çiklistët: Duhet të ketë vendkalime të sigurta jashtë rrethrrotullimit për të shmangur ndërprerjet e trafikut;
- Përshtatja për automjete të mëdha;
- Faktorët mjedisorë dhe urbanistikë.

Me qëllim të përmirësimit të qarkullimit dhe sigurisë në trafik, kushtet e përgjithshme teknike për projektim dhe ndërtim të rrugëve të reja në nivel lokal

- Për shkak të sigurisë së lëvizjes, në pjesët e rrugës jashtë vendbanimit të projektohen shtigjet për çiklist të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës qarkulluese, ndërsa në vendbanime, nëse nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për shteg të ndarë për çiklist, atëherë të projektohet korsi e shënuar për çiklist në sipërfaqen qarkulluese të rrugës;
- Shtegu për këmbësorë me gjerësi minimale 1.20 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për këmbësorë, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të zvogëlohet, por nuk duhet të jetëmë e vogël se 0.80m.
- Korsi/shteg për çiklist në të dy anët e rrugës me gjerësi minimale 1,50 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për çiklist, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të jetë 1.00 m.
- Nëse korsia/shtegu për çiklist projektohet vetëm në njërën anë, atëherë gjerësia e korsisë duhet të jetë me gjerësi 2.0m - 2.5 m.
- Nëse në pjesën e rrugës është e nevojshme qetësimi i trafikut (në afërsi të shkollave ose institucioneve tjera arsimore), duhet të vendosen masat për qetësimin e trafikut dhe sinjalizimi përkatës për reduktimin e shpejtësisë në 20-30km/h (zonë 30 km/h).
- Pjesët e rrugëve të cilat shtrihen në vendbanim duhet të jenë të ndriçuara sipas normave teknike për ndriçimin e rrugëve publike.
- Gjatë projektimit, projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet me largpërçuesit, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit si dhe instalimet tjera që janë trupin e rrugës, brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të rrugës dhe kyçjet e objekteve rreth rrugës. Për të gjitha instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, projektuesi duhet të ofroj zgjidhje teknike për dislokimin eventual si dhe paramasat me parallogaritë.
- Rënia tërthore e rrugës nëdrejtim, duhet të jetë në të dy anët e rrugës, min. 2.50%, ndërsa në kthesa horizontale në njërenanë të rrugës (varësishtnga rrezja e kthesës).

- Zgjidhja e largimit të ujërave nga rruga duhet të jetë kryesisht tipi i mbyllur (kanalizim atmosferik) për pjesën urbane dhe pjesërisht tipi i hapur (kanale atmosferike)për pjesën rurale.
- Dimensionimi i konstruksionit të rrugës të bëhet duke u bazuar në kategorinë e tokës, kategorinë e rrugës, numrit të parashikuar të automjeteve dhe ngarkesave boshtore prej 115KN.
- Strukturat (ura dhe objekte tjera inxhinierike) duhet të projektohen sipas normave Evropiane EURO COD.
- Në segmente të caktuara hapësira e lirë nga niveleta e re e përvetësuar e rrugës deri te pika më e ultë e strukturave duhet të jetë min. 4.80m.
- Projektimi i vend-ndaljeve për autobus, të bëhet në përputhje me standardet e projektimit, duke marrë parasysh karakterin e rrugës;
- Kualiteti i të gjitha materijaleve të cilat përdoren për ndërtim, si dhe dimensionet e shtresave të konstruksionit të rrugës, duhet të jenë në përputhje me standardet dhe normat bashkëkohore për ndërtimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD, EN), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim;
- Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore të jenë në përputhje të plotë me UA 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

▪ **Brezi mbrojtës rrugor**

Sipas normave teknike të planifikimit hapësinor, brezi mbrojtës rrugor është një hapësire e vazhdueshme tokësore, në të dy anët e rrugës, distanca e të cilit kalkulohet nga cepi përfundimtar i brezit mbrojtës rrugor, dhe shërben përveç për mbrojtjen e rrugës dhe trafikut qe realizohet nëpër të, gjithashtu edhe për kufizimin e llojit dhe shtrirjes se zhvillimit në të (Fig.12).



Figura 12 Brezi mbrojtës rrugor[5]

[5] UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore, janë sipas tabelës më poshtë.

Tabela 60 Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore[6]

Kategoria e rrugës		Brezi i gjelbër[1]	Brezi mbrojtës	Brezi mbrojtës rrugor[5]		Ngareksa boshtore
				Distanca 1[2]	Distanca 2[3]	
Autoudhë		35 m	2 m	100 m	40 m	11.50 t
Rrugë nacionale		35 m	2 m	60 m	20 m	
Rrugë regjionale		22 m	2 m	40 m	10 m	
Rrugë të rrjetit primar	Rrugë tranzite urban	10 m	1 m	30 m	10 m	6 t
	Rrugë tranzite rurale					
	Rrugë përmbledhëse					
Rrugë sekundare	Rrugë servisore	8 m				
	Rrugë industriale					
	Rrugë banesore	/	1 m	/	/	
	Rrugë qasëshe	/	1 m	/	/	
Shtigjeve për çiklist		3 m				
Vendparkimet		2.5 m				
Shtigje për këmbësorë				0.75 m[4]		

1. Përjashtimisht, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, ky kusht nuk është obligues.
2. Distanca 1:

   Ndalon hapjen e minierave, ndërtimin e liqeneve artificiale, fabrikave dhe ndërtesave të tjera të ngjashme.
3. Distanca 2:

   Ndalon ndërtimin e ndërtesave të banimit, administrative, hapjen e puseve të ujit dhe hapjen e gropave septike, ngritjen e instalimeve të transmetuesve elektrikë dhe të ngjashme.
4. Përgjatë shtigjeve për këmbësorë, korsive të rrugëve, dhe vend parkimeve jashtë rrugore.
5. Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.

7.5. RRUGËT LOKALE – PËRMIRËSIMI I ELEMENTEVE GJEOMETRIKE

Rrjeti rrugor në Komunën e Vitisë përbëhet nga rrugë me gjerësi të ndryshme. Në kuadër të PZHK-së përpos ndërtimit të rrugëve të reja është paraparë edhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese.

Sipas normave teknike të Planifikimit Hapsinor, rrugët lokale janë rrugët që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat, me përjashtim të atyre që zyrtarisht janë kategorizuar si rrugë nacionale apo regjionale.

Në përputhje me Normat e Planifikimit Hapësinor, me rastin e përmirësimit të rrugëve ekzistuese, rrjeti i infrastruktures rrugore duhet të plotësojë normat e planifikimit si në vijim:

- ≤ 40km/h, gjerësiaekorsisëështë: 2.75 m;
- ≤ 60km/h, gjerësiaekorsisëështë: 3.00 m;

Numri i korsive përcaktohet në baze të intensitetit të rrjetit.

[6] UDHËZUES PËR HARTIM DHE MIRATIM TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS, 2017.

Minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane që do të shërbejnë gjatë përcaktimit të vijave rregulluese që përcaktojnë profilin e infrastrukturës rrugore publike janë:

- Rrugëtransitenëpërmjetvendbanimeve-fshatrave- 9, 50 m;
- Rrugëpërmbledhëse/shpërndarëse-10,50m;
- Rrugëservisore-9,00 m;
- Rrugëbanesore-8, 50m;
- Rrugëindustriale-10,00 m;
- Rrugëqasëshe/dykahëshe-5, 50 m; dhe
- Rrugëqasëshe/njëkahëshe - 3.50 m.

Në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal, Komuna e Vitisë ka planifikuar ndërtimin e rrugëve të reja dhe përmirësimin e rrugëve ekzistuese, që lidhin shumë vendbanime brenda pjesës urbane dhe në tërë territorin e Komunës.



Figura 13 Minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane

Më në hollësi, projekti duhet të përfshijë:

- Numri i korsive përcaktohet në baze të intensitetit të rrjetit;
- Trotuar për këmbësorë dhe korsi për biçikleta.

Projekti për rrugët e reja në nivel lokal duhet të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Në përputhje me normat e planifikimit dhe me qëllim të përmbushjes së strukturës dhe kërkesave për qarkullim rrugët duhet të plotësojnë këto kritere teknike:

- Varësisht nga kategoria e rrugëve, minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane duhet të jetë në përputhje me normat teknike të planifikimit[7].

[7,12] Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor.

- Në pjesët jasht vendbanimeve, shpejtësia duhet të kufizohet në varësi të gjerësisë së korsisë së trafikut dhe kushteve të sigurisë, ndërsa në pjesën e vendbanimit kufizimi i shpejtësisë maksimale është 50km/h, ndërsa me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik, në pjesë të caktuara të rrugës me shenjë të trafikut shpejtësia mund të përcaktohet ndryshe;
- Shtegu për këmbësorë me gjerësi minimale 1.20 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegut për këmbësorë, atëherë në pjesë të caktuara të rrugës, gjerësia mund të zvogëlohet, por nuk duhet të jetë më e vogël se 0.80 m;
- Për shkak të sigurisë së lëvizjes, në pjesët e rrugës jashtë vendbanimit të projektohen shtigjet për çiklist të ndara fizikisht nga pjesa e rrugës qarkulluese, ndërsa në vendbanime, nëse nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme për shteg të ndarë për çiklist, atëherë të projektohet korsi të shënuara për çiklist në sipërfaqen qarkulluese të rrugës;
- Korsi/shteg për çiklist në të dy anët e rrugës me gjerësi minimale 1, 50 m. Nëse gjatë projektimit paraqiten probleme të shtrirjes së shtegutpër çiklist, atëherë në pjesë të caktuara tërrugës, gjerësia mund të jetë1.00 m;
- Nëse korsia/shtegu për çiklist projektohet vetëm në njërën anë (për lëvizje dykahore të biçikletave), atëherë gjerësia e korsisë duhet të jetë min. 2.0m;
- Nëse në pjesën e rrugës është e nevojshme qetësimi i trafikut (në afërsi të shkollave ose institucioneve tjera arsimore), duhet të vendosen masat për qetësimin e trafikut dhe sinjalizimi përkatës për reduktimin e shpejtësisë në 20-30km/h (zonë 20 -30km/h);
- Për të gjitha rrugët, duhet të vendoset sinjlaizimi adekuat horizontal dhe vertikal i cili mundëson informimin, orientimin dhe sigurinë e lëvizjes për të gjithë pjesëmarrësve në trafik;
- Pjesët e rrugëve të cilat shtrihen në vendbanim duhet të jenë të ndriçuara sipas normave teknike për ndriçimin e rrugëve publike;
- Brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore duhet të jenë në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor[8] (Tabela 2- Kërkesat për brezat mbrojtës, brezat e gjelbër, brezat mbrojtës rrugorë si dhe kërkesat për ngarkesat boshtore rrugore);
- Brezi mbrojtës rrugor nuk vlen për rrugët urbane brenda vendbanimeve.
- Gjatë projektimit, projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet me largpërçuesit, rrjetin e telefonisë, rrjetin e ujësjellësit si dhe instalimet tjera që janë trupin e rrugës, brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të rrugës dhe kyçjet e objekteve rreth rrugës. Për të gjitha instalimet nëntokësore dhe mbitokësore, projektuesi duhet të ofroj zgjidhje teknike për dislokimin eventual si dhe paramasat me parallogaritë.
- Ndërtimi i rrugëve kryesisht duhet të bëhet konformë PZHU-së të Komunes. Në pjesët e rrugës kur hasë në zgjerimin e rruges, projektuesi duhet të propozoj zgjidhje alternative e cila do t'i prezantohet Komisionit për aprovim.
- Elementet (horizontale) kryesore të trasesë së rrugës në Planin e Situacionit (kthesat horizontale, kaluese, drejtimet), elementet (vertikale) në profilin gjatësor (kthesat vertikale, pjerrtësitë gjatësore, përdredhjet e rrugës, rëniet tërthore) dhe profilet tërthore, duhet të punohen në bazë të rregulloreve për projektimin e rrugëve.
- Rënia tërthore e rrugës në drejtim, duhet të jetë në të dy anët e rrugës, min. 2.5 %, ndërsa në kthesa horizontale në njëren anë të rrugës (varësisht nga rrezja e kthesës).
- Zgjidhja e largimit të ujërave nga rruga duhet të jetë kryesisht tipi i mbyllur (kanalizim atmosferik) për pjesën urbane dhe pjesërisht tipi i hapur (kanale atmosferike)për pjesën rurale.
- Dimensionimi i konstruksionit të rrugës të bëhet duke u bazuar në kategorinë e tokës, kategorinë e rrugës, numrit të parashikuar të automjeteve dhe ngarkesave boshtore prej 115 KN.
- Strukturat (ura dhe objekte tjera inxhinierike) duhet të projektohen sipas normave Evropiane EURO COD.

- Në segmente të caktuara hapësira e lirë nga niveleta e re e përvetësuar e rrugës deri te pika më e ultë e strukturaveduhettë jetëmin. 4.80m.
- Projektimi i vend-ndaljeve për autobus, të bëhet në përputhje me standardet e projektimit, duke marrë parasysh karakterin e rrugës;
- Kualiteti i të gjitha materijaleve të cilat përdoren për ndërtim, si dhe dimensionet e shtresave të konstruksionit të rrugës, duhet të jenë në përputhje me standardet dhe normat bashkëkohore për ndërtimin e rrugëve. Projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD, EN), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

  Në pozicionet për të cilat në Republikën e Kosovë nuk ka standarde të aprovuara, projektuesi mund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-se (EURO COD), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

  Në hartimin e projektit duhet të merren parasysh të gjitha normat dhe standardet e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbërit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

7.5.1. KRITERET PËR VENDOSJEN E UDHËKRYQEVE SIPËRFAQËSORE DHE UDHËKRYQEVE NË DISNIVEL

Për funksionimin e mirë dhe funksional të udhëkryqeve sipërfaqësore, është e nevojshme ndarja e fluksit të trafikut në hyrje të udhëkryeve (drejt, majtas, djathtas). Në hyrje të udhëkryqeve me sipërfaqe të mjaftueshme dhe me qarkullim më të madh të automjeteve, rrjedha e qarkullimit të trafikut mund të ndahet fizikisht (përmes ishujve kahëzues) me qëllim të zvogëlimit të pikave të konfliktit. Pjesa funksionale e udhëkryqeve sipërfaqësore duhet të përmbajë: zonat e perceptimit, rrjeshtimit, konfliktit dhe nxitimit.

7.5.2. RREZJA E RRUMBULLAKËSIMIT (HARKU) NË UDHËKRYQE SIPËRFAQËSORE

Me qëllim të akomodimit të të gjitha automjeteve (varësisht nga struktura e automjeteve) dhe plotësimit të kritereve të sigurisë gjatë lëvizjes nëpër udhëkryqe sipërfaqësore, në udhëkryqe duhet të plotësohen kritert minimale teknike për rrezet e rrumbullakësimit.

Tabela 61 Vlerat minimale të rrezes së rrumbullakësimit (harkut) në udhëkryqe

Lloji i automjeteve	Rrezja e rrumbullksimit R (m)		
	Kthimi majtas	Kthimi djathtas	
		Me ishull ndarës	Pa ishull ndarës
Automjetet	6	10	6
Kamiona dhe BUS	10	12	10
Kamionat me rimor.	12	15	12
Autobusët e mëdhenj	15	25	15

7.5.3. KRITERET PËR NDRIÇIM

Ndriçimi i rrugëve duhet të projektohet në atë mënyrë që të siguroj:

- Dukshmëritë mirëdhe ngasjetësigurt nëkushtet enatës,
- Vërejtjenmekohëtë rrezikutpotencial,orientimtëmirëdhe siguritëpërgjithshmepërkëmbësorë,
- Të gjithë pjesëmarrësve në trafik, vërejtje të sipërfaqeve të nevojshme dhe detale të rëndësishme të mjedisit gjatëlëvizjes.

Niveli i ndriçimit të rrugëve duhet të jetë në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit, Ligjin për rrugët dhe aktet nënligjore për ndriçimin e rrugëve. Projektuesimund të rekomandojë edhe përdorimin e standareve të reja, për përafrimin menormat e BE-se (EN -The European Norm for Road Lighting), si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

7.5.4. KUSHTET PËR KUFIZIMIN E SHPEJTËSISË NË RRUGËT LOKALE

Është e rëndësishme që të menaxhohet rrjedha e trafikut duke përdorur kontrollin e menaxhimit të shpejtësisë së trafikut për të përmirësuar sigurinë e trafikut për të gjithë pjesëmarrësit në trafik Duke marrë parasysh, gjerësitë e ndryshme të rrugëve në Komunën e Vitisë, për rrugët lokale rekomandohet kufizimi i shpejtësisë së lëvizjes duhet në varësi të gjerësisë së rrugëve dhe strukturës së qarkullimit.



Figura 14 Kushtet për kufizimin e shpejtësisë në rrugët lokale

7.5.5. KLASIFIKIMI FUNKSIONAL I RRJETIT RRUGOR

Aktualisht, infrastruktura e transportit në Viti është e përbërë nga një strukturë dhe klasifikimi jo funksional të rrjetit rrugor. Kyçjet e shpeshta dhe të pakontrolluara në aspektin hijerarkik të rrugëve, me ç`rast rrugët e rangut më të ulët kyçen direkt në rrugët e rangut më të lartë, kanë ndikuar direkt në zvogëlimin e kapacitetit të lëvizjes dhe uljen e nivelit të shërbimit të infrastrukturës rrugore.

Nevoja për përmërësimin e strukturës dhe klasifikimin hijerarkik të rrjetit rrugor mbetet opcioni i vetëm për përmirësimin e kapacitetit, sigurisë në trafik dhe nivelit të shërbimit të rrjetit rrugor.

Me rastin e klasifikimit funksional të rrjetit rrugor në nivel lokal, duhet pasur parasysh kyçjet e rrugëve varësisht hijerarkisë dhe funksionit të tyre. Më rastin e kyçjes në rrjetin rrugor, te merren në konsideratë kriteret e sigurisë, si:

Për rrjetin rrugor primar:

- Rrugët mbledhëse (nga rrjeti rrugor sekundar) të kçet në rrugët kryesore urbane (rrjetin rrugor primar).

Për rrjetin rrugor sekundar:

- Rrugët për çasje të kyçen në rrugë lokal,
- Rrugët lokale të kyçen në rrugët mbledhëse.



Figura 15 Klasifikimi funksional i rrjetit rrugor

7.6. RRUGËT PUBLIKE JO TË MOTORIZUARA

Këmbësorët dhe çiklistët përbëjnë aktualisht numrin më të madh të pjesëmarrësve në strukturen e përgjithshme të trafikut. Sa i përket zhvillimit të një rrjeti të ri të trotuareve për këmbësorë dhe çiklistë bazuar në PZHK-në e Vitisë, vëmendja është përqendruar në përmirësimin dhe ndërtimin e shtigjeve të reja të cilësisë së infrastrukturës për lëvizje të këmbësorëve si dhe çiklistëve si dhe për të promovuar një kulturë të re për trafik të pamotorizuar, paraprakisht duhet të krijojohen kushtet për lëvizje të lirë dhe të sigurt.

▪ Sipërfaqet për lëvizje të këmbësorëve

Për përmirësimin e nivelit të shërbimit dhe shkallës së sigurisë për këmbësorë, duhet respektuar këto kritere:

- Shtegu i këmbësorëve nënkupton sipërfaqen e rregulluar për lëvizjen e këmbësorëve dhe duhet të jetë i ndarë nga korsitë automobilistike,
- Koncepti i rrjetit të shtigjeve për këmbësorë duhet të formojë një rrjet funksional të rrugëve pa pengesa;
- Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për një kahe (varg) të këmbësorëve duhet të jetë min.0.80 m,
- Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë për lëvizje në dy kahe duhet të jetë min. 1.60 m,
- Për të siguruar lëvizjen e papenguar të personave me aftësi të kufizuara, gjerësia e shtigjeve për këmbësorë duhet të jetë të paktën 1.80 m, përjashtimisht 1.50 m, ndërsa gjerësia e kalimeve ndërmjet pengesave fikse duhet të jetë të paktën 0.90 m.

Rampat për qasje të personave me aftësi të kufizuara në hapësire janë të ndërlidhura dhe të përshtatura për orientimin, dhe me pjerrësi të cilat nuk mund të jenë me të mëdha se 5%, përjashtimisht 8%.



Figura 16 Gjerësia minimale e shtegut për këmbësorë

▪ Vendkalimet për këmbësorë

Vendkalimet për këmbësorë janë vende kritike në të cilat kryqëzohen lëvizjet e këmbësorëve dhe qarkullimi i automjeteve. Prandaj, në procesin e vendosjes së vendkalimeve për këmbësorë, nga projektuesi duhet të verifikohen:

- Arsyeshmëria e vendkalimit për këmbësorë;
- Përshatshmëria e lokacionit;
- Sinjalizimi adekuat për vendkalimin e këmbësorëve.

▪ Kushtet për vendosjen e lokacioneve për vendkalime të këmbësorëve

Për shënimin e vendkalimeve për këmbësorë, duhet të plotësohen kushtet si në vijim:

- Sigurimi adekuat i dukshmërisë;
- Gjerësia minimale e vendkalimit për këmbësorë duhet të jetë 3.0 m, ndërsa në pjesët e rrugëve në të cilat kërkesa për kalimin e rrugës është e madhe (lëvizjet grupore), atëherë gjerësia duhet të jetë 5.0 m.
- Nëse në afërsi të vendkalimeve për këmbësorë janë të vendosuara parkingjet gjatësore në rrugë, atëherë me qëllim të sigurimit të dukshmërisë, në vendkalim të këmbësorëve duhet të ngushtohet rruga për gjerësinë e parkingut gjatësorë;
- Disatnaca nga vendkalimi tjetër të jetë më e madhe se 100 m;
- Në pjesët e rrugës në të cilat ka frekuentim të më të madh të këmbësorëve, vendkalimet për këmbësorë të projektohen me ndriçim të vendkalimit dhe të përdoret sinjlaizimi me dritë vezulluese në gjysmëportal, i cili paralajmëron ngasësit për ngritje të vemendjes në afërsi të vendkalimit për këmbësorë.
- Vendkalimet për këmbësorë duhet të sigurojnë çasje të lehtë dhe të sigurt personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e projektimit për këtë kategori.

Kriteret teknike dhe të sigurisë për vendndodhjen e vendkalimeve për këmbësorë janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 62 Distanca dhe vendndodhja e vendkalimeve për këmbësorë varësisht nga kategoria e rrugëve

Emërtimi	Lloji i udhëkryqit	Distanca min. (m) ndërmjet udhëkryqeve	Rregullimi i kthimit majtas	Tipi i kalimit të këmbësorëve	Kalimi i këmbësorëve
Rrugë urbane- Arterie	Në disnivel	300	E ndaluar në rrafsh	Në disnivele ose me semafor	Në kryqëzim
Rrugë kryesore urbane-përmbledhëse	Udhëkryqe sipërfaqësore-të organizuara në rrafsh	100	E kontrolluar	Me semafor ose me zebra	Në kryqëzim ose në pjesë të rrugës
Rrugë servisore-banesore	Udhëkryqe sipërfaqësore-të organizuara në rrafsh	100	E kontrolluar ose me rregulla të qarkullimit	Me zebra	Në kryqëzim ose në pjesë të rrugës
Rrugë lokale-qasëshe	Të paorganizuar	-	E lejuar	Me zebra	-

▪ Kriteret për përzgjedhjen formës së vendkalimit për këmbësorë

Projektimi, ndërtimi, funksionimi dhe mirëmbajtja e cilësisë së infrastrukturës për këmbësorë është një element thelbësor në krijimin e një ambienti miqësor për këmbësorët. Një pjesë e rëndësishme e planifikimit të paraqitjes së ardhshme të rrugëve është parashikimi i gjerësisë dhe numrit të korsive dhe vëllimi i përgjithshëm i trafikut që mund të ndikojë në nivelin e lëvizshmërisë së këmbësorëve.

Rregullimi dhe projektimi i vendkalimeve për këmbësorë me nevojat e përdoruesve të ndryshëm, të rrugës, mbështetet në kritere teknike të sigurisë, të cilat janë në varësi të: madhësisë së qarkullimit të trafikut të automjeteve motorike (trafiku mesatar ditor vjetor – TMDV), numri i korsive të trafikut, shpejtësisë maksimale, shkallës së sigurisë së trafikut etj.



Figura 17 Kriteret për përzgjedhjen e vendkalimit optimal për këmbësorë Korsitë dhe shtigjet për biçikleta

- **Korsitë dhe shtigjet për biçikleta**

Në kuadër të Udhëzimit administrativ të MMPH për normat teknike të planifikimit hapsinor, sipërfaqet e dedikuara për lëvizje të biçikletave, ndahen në korsi dhe shtigje për biçikleta (Figura 20).

Korsitë për biçikleta janë pjesë e rrugës, e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e shënuar me shenja përkatëse të komunikacionit. Korsitë për biçikleta planifikohen në rrugë ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve nuk kalon 50 km/h.

Shtigjet për biçikleta janë hapësire qarkulluese e destinuar për qarkullimin e biçikletave, e zbatuar ndaras nga profili tërthor i rrugës i shënuar me shenjat e duhura të komunikacionit. Shtegu mund të jetë i përbashkët për biçikleta dhe këmbësor.



Figura 18 Shtegu dhe korsia për biçikleta

Sipas standardeve të projektimit dhe normave të planifikimit (Udhëzimit administrativ të MMPH) për përmirësimin e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave në rrugët ekzistuese dhe për rrugët e reja të planifikuara, duhet që :

- Shtigjet për biçikleta jashtë vendbanimeve duhet të planifikohen si të ndara, me një brez të gjelbër të gjerësisë adekuate dhe pa pengese mbrojtëse, nga profili i tërthor i rrugës. Përjashtimisht, për shkak të mungesës së hapësirës për planifikim të një brezi të gjelbër, shtegu për biçikleta duhet të sigurohet me një pengesë mbrojtëse nga çeliku.
- Gjerësia optimale/minimale dhe lartësia e shtegut për biçikleta jashtë vendbanimit: shteg njëdrejtimësh, në të dyjaanët e rrugës:
    - Me gjerësi: 1.50/1.00 m,
    - Me lartësi: 2.50 m.

Për arsye të sigurisë nuk rekomandohet zbatimi i korsive për biçikleta jashtë vendbanimeve.

Në pjesët e rrugëve në të cilat shpejtësia e lëvizjes planifikohet të jetë më e madhe se 50 km/h, atëherë duhet të planifikohet edhe brezi mbrojtës.

Gjerësia minimale e brezit mbrojtës të korsive dhe shtigjeve për biçikleta duhet të jetë: ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me korsi të rrugës, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur dhe ≥ 0.75 m përgjatë kufizimit me shtigje për këmbësor apo vend-parkingje gjatësore, por vetëm nëse ajo është e ndare me sipërfaqe të ngritur, të gjelbër apo me elemente standarde ose të ngjashme.

Parkimi i biçikletave duhet të vendoset ashtu që të mos pengojë qarkullimin e këmbësorëve si dhe aty ku mund të sigurohet kontrolli.

Kriteret teknike për vendosjen e sipërfaqeve për parkim të biçikletave të jenë në përputhje me normat teknike të planifikimit dhe standardet teknike,

Vend-parkimet për biçikleta duhet të përbehen nga: hapësira e vend-parkimit prej 1.20 m²/ biçiklete dhe hapësira qasëshe ne vend-parkim, me gjerësi: 1.50/ 1.80 m.

Në vendet ku ka mundësi të vendosjes së parkingjeve për biçikleta, të respektohen normat dhe standardet teknike për parkingje të biçikletave.

Tabela 63 Numri i vend-parkingjeve për biçikleta

Përshkrimi i përmbajtjes së ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve për biçikleta (VPB)
Përmbajtjet tregtare dhe komunale	5 VPB/ 100 m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për vizitor
Përmbajtjet e bizneseve dhe publike	1 VPB/ 100 m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN) për të punësuar
Përmbajtjet arsimore	1 VPB/ 5 nxënës, për vizitor + 1 VPB/ 10 të punësuar
Përmbajtjet kulturore- teatro dhe muze	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor
Përmbajtjet shëndetësore- spitale	10 VPB/ 100 shtretër, për vizitor
Përmbajtjet sportive dhe rekreative	10 VPB/ 100 ulëse, për vizitor

- **Kriteret për planifikimin e infrastrukturës për biçikleta**

Me rastin e planifikimit ose përmirësimit të infrastruktures ekzistuese për biçikleta në kushte urbane, duhet të merren parasysh kriteret teknik dhe të sigurisë për infrastrukturen për biçikleta. Kriteret teknike për përdorimin, respektivisht mospërdorimin e sipërfaqes së përbashkët nga këmbësorët dhe çiklistët.

Në tabelën në vazhdim, janë dhënë kriteret për planifikimin e infrastrukturës për biçikleta dhe mundësinë/ pamundësinë e ndarjes së shtegut së bashku me këmbësorë.

Tabela 64 Kriteret për shfrytëzimin e infrastrukturës së përbashkët nga çiklistët dhe këmbësorët

Këmbësorë/h	Planifikimi i shtegut
< 100	Sipërfaqe e përbashkët
100-160	Vetëm ndarje vizuale
160 – 200	Ndarje vizuale dhe ndarje në nivel
>200	Nuk mund të shfrytëzohet sipërfaqja e njejtë (përbashkët)

Tabela 65 Gjerësia e sipërfaqeve për lëvizje të biçikletave

Lloji i sipërfaqes për biçikleta	Optimale	Minimale
Korsia për biçikleta	1, 50	1, 00
Shtegu njëkahorë për biçikleta	2, 00	1, 50
Shtegu dykahorë për biçikleta	2, 50	2, 00
Rruga për biçikleta	3, 50	2, 50

7.7. NDËRTESAT DHE SIPËRFAQET PËR TRANSPORT PUBLIK URBAN DHE RURAL

Transporti i udhëtarëve në komunën e Vitisë realizohet në tri nivele:

- Transporti ndërurban dhe ndërkombëtar (i cili lidhë Vitinë me qytetet tjera të Kosovës dhe jashtë Kosovës),
- Transporti urbano-periferik (i cili lidhë qytetin e Vitisë me fshatrat brenda Komunës) dhe
- Në kudër të PZHK-së është paraparë rregullimi i stacionit të autobusëve dhe vendndaljeve për autobus.

Rivitalizimi dhe rregullimi i një stacioni të autobusëve duhet të përmbushë një sërë kushtesh teknike për të siguruar funksionalitetin, sigurinë dhe komoditetin për udhëtarët dhe operatorët e transportit. Më poshtë janë disa nga kushtet kryesore teknike:

- Qasje e lehtë nga rrugët kryesore dhe lidhje e mirë me rrjetin e transportit publik.
- Sipërfaqe e mjaftueshme për terminalet, vendparkimet dhe zonat ndihmëse.
- Ndikimi mjedisor i vlerësuar për ndotjen akustike, ajrore dhe menaxhimin e mbetjeve.
- Platforma për autobusët me gjerësi dhe gjatësi të përshtatshme për manovrimin e sigurt.
- Vendparkime për autobusë në pritje, me hapësira të përcaktuara qartë.
- Rrugë hyrëse dhe dalëse për të shmangur përplasjet dhe vonesat.
- Objektet dhe shërbimet e nevojshme për pasagjerët
- Qasje për persona me aftësi të kufizuara sipas standardeve ndërkombëtare.

Me qëllim të përmirësimit dhe funksionalizimit të transportit publik masat prioritare për autobusë dhe vendndaljet e përmirësuara të autobusëve janë si në vijim:

- Përmirësimet e sistemeve të informacionit për shërbimet e autobusëve në vendndalje për autobus/kabinat e autobusëve dhe destinacionet kyçe (p.sh. zonat tregtare / qendrat kryesore të punësimit).
- Futja e informacioneve në kohë reale për pasagjerë dhe futja e njoftimeve dhe ekraneve brenda në automjete do të rrisë cilësinë e udhëtimit për përdoruesit.
- Zhvillimi i vendndaljeve për autobusë, duke përfshirë përmirësimin e qasjes në vendndalje për autobusë, shtigje të gjera për këmbësorë dhe elemente të reja si streha, ulëset, ndriçimit dhe informacioni.

Komuna do të caktoj pikat e ndaljes së transportit publik, kryesisht në vendet më të frekuentuar duke pasur parasysh kritetret e vendosjes sëstacionevedhe të sigurojë për to infrastrukturën e nevojshme.

▪ Ndërtimi i vend ndaljeve për autobusë komunal

Elementet teknike minimale për ndërtimin e vendndaljeve për autobusë janë dhënë në tabelat më poshtë.

Tabela 66 Elementet teknike minimale horizontale në varësi të shpejtësisë së hyrjes

Shpejtësia hyrëse (km/h)	a (m)	b' (m)	a' (m)	b' (m)	l (m)	R1 (m)	R2 (m)	R3 (m)	R4 (m)
30	16.00	15.00	3.80	4.00	3.10	40.00	30.00	20.00	40.00
40	17.00	15.00	5.30	4.00	3.10	60.00	40.00	20.00	40.00
60	25.00	15.00	4.80	4.00	3.60	80.00	60.00	20.00	40.00

Tabela 67 Gjatësia e vendndaljes dhe zona e pritjes së autobusit në varësi të shpejtësisë së hyrjes, llojit të autobusit dhe numrit të autobusëve që ndalojnë në ndalesë në të njëjtën kohë.

Shpejtësia hyrëse (km/h)	30, 40, 50, 60	30		40		60	
Gjatësia (m)	La	L	L'	L	La	L	L'
Një autobus	13.00	44.00	51.80	45.00	13.00	44.00	51.80
Dy autobus	26.00*	57.00	64.80	58.00	26.00*	57.00	64.80

Shënim: * Është marrur parasysh distanca 1.00 m ndërmjet dy autobusëve të cilët qëndrojnë në vendndalje të autobusëve



Figura 19 Elementet teknike minimale horizontale të vendndaljes së autobusit

7.8. SIPËRFAQET PUBLIKE PËR VENDPARKIM

Sipas normave të planifikimit hapsinor, janë katër llojet themelore të parkimit:

- **Vendparkim rrugor,** nënkupton vend-parkimin në rruge dhe mund tëjetë vend-parkim në formë gjatësore, të pjerrët dhe tërthore;
- **Vendparkim jashtërrugor publik,** nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor, por të qasshëm si edhe rrugët publike;
- **Vendparkim jashtërrugor privat**, nënkupton vend-parkimin si pjesë përbërëse e një ndërtese, të një qendre biznesiosekomerciale;
- **Vendparkim jashtërrugor privat për banor,** nënkupton vend-parkimin jashtë rrjetit rrugor të ndërlidhur me ndërtesat e banimit individual dhe nëbashkëpronësi. Vendparkimi rrugor për automjete

Vendparkimi rrugor është pjese e profilit tërthor rrugor të vendbanimeve. Vend-parkimet rrugore mund të planifikohen në format në vijim:

- Parkimii automjeteve për nevoja të ndërtesëssë banimit projektohet me dokumentet e planifikimit hapësinor si hapësirë nëntokësore, mbitokësore I hapur ose I mbuluar, në kuadër të objektit garazhe ose I kombinuar.
- Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë e banimit duhet të jetë minimum një vend parkim për një banesë.
- Numri i vend parkimit të automjeteve për njësitë afariste, në kuadër të ndërtesës, duhet të jetë minimum një vend parkim për 30 m2 neto sipërfaqe afariste, nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.
- Largësia nga vend parkimi i fundit deri te hyrja e ndërtesës duhet të jetë jo me shume se 100 m nëse me dokumente të planifikimit hapësinor nuk parashihet ndryshe.

Dimensionet minimale për hapësirat e parkimit në varg për automjete motorike standarde do të jenë si më poshtë:

- Vendparkimi në 90º - 250 cm x 455cm;
- Vendparkimi në 60º - 250 cm x 485 cm;
- Vendparkimi në 45º - 250 cm x 485 cm ;
- Vendparkiminë 30º - 250 cm x 425 cm;
- Vendparkimi paralel -215cm x 640 cm;
- Vendparkim i irrethuar - 270 x 550cm
- Varësisht nga pozita e
- Vend-parkimet për qëllime të veçanta iu përkasin vend-parkimeve të rezervuara për qasje të personave me aftësi të kufizuara :
- Vendparkimet për qasje të personave me aftësi të kufizuara, përveç hapësirës normale për parkim të automjetit, duhet të përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/dalje nga automjeti;
- Së paku 5% e numrit të gjithmbarshëm të parkingjeve duhet të jenë për qasje të personave me aftësi të kufizuara;
- Vendparkimi duhet të jetë i vendosur me afër hyrjes në ndërtesë dhe duhet të plotësoj këto kushte:
- Dimensionet bazë të vendparkimit, gjatësor, në pjerrësi dhe pingul, për një automjet janë:3.70x 5.00 m;
- Dimensionet bazë të vendparkimeve, gjatësore, në pjerrësi dhe pingul, për dy automjete janë: 5.90 x 5.00 m, me një distancë vend-kalim shtesë për hyrje-dalje ndërmjet tyre prej 1.50 m;
- Vendkalimi shtesë për hyrje-dalje nga vendparkimi në shtigjet e këmbësorëve të siguruar me gurin skajor nuk lejohet të ketë pjerrtësi më të madhe se 10% dhe gjerësi më të vogël se 1.20 m.
- Vendparkimet për qasje të fëmijëve në automjete transportuese të veçanta:
- Vendparkimet për qasje te fëmijëve të vegjël deri në 6 vjeç në automjete transportuese të veçanta, shënohen në mënyre që të ju lehtësojnë prindërve marrjen e fëmijëve dhe të pajisjes së tyre. Përveç hapësirës normale për parkimtë automjetit, këto vend-parkime përmbajnë edhe hapësirë shtesë për hyrje/dalje nga automjeti;
- Gjerësia shtesë në të dyja anët e vend-parkimit është nga 1.00 m, apo 2.00/2.30 m në tërësi.
- Standardet numrin e vendparkimeve, varësisht nga përmbajtja, janë dhënë në tabelën vijuese:

Tabela 68 Numri i vendparkimeve varësisht nga përmbajtja

Numri i vend-parkimeve për automjete në varësi nga përmbajtja			
Përmbajtja	Lloji i ndërtesës, përshkrimi i përmbajtjes se ndërtesës	Numri minimal i vend-parkimeve (VP) apo vendeve për garazhin për 100 m² të bruto sipërfaqes se ndërtuar (BSN)	
Banimi	Ndërtesat e banimit të mesëm dhe të lartë/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m², por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Nga numri i obligueshëm i VP, se paku 20% duhet të jetë për shfrytëzim publik, ndërsa gjatë hartimit të planeve operative, për pjese të pa ndërtuara, të planifikohen edhe se paku 10% për shfrytëzim publik
	Ndërtesat e banimit të ulët/ ndërtesat e banimit dhe biznesit	2 VP/ 100 m², por jo me pak se numri i njësive të banimit për pjesën e ndërtesës se banimit	Gjatë hartimit të planeve operative për pjese të pa-ndërtuara, domosdoshmërish të planifikohet

			edhe 1 VP/ 1 ndërtese të banimit të ulet
	Ndërtesat e banimit të ulet- vilat (deri në 4 njësi maksimal)	3 VP/ njësi banimi	-
Hoteleria dhe turizmi	Ndërtesat e hoteleve deri në 3*	0.2 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 4*	0.5 VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e hoteleve me 5*	0.75VP/ një shtrat	-
	Ndërtesat e restoranteve, kafeneve dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	4 VP/ 100 m²	-
Tregtia dhe përmbajtjet komunale	Ndërtesa e tregtisë	4 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesa/ hapësirat e tregjeve	3 VP/ 100 m² të hapësirës shitëse	-
	Ndërtesat e depove	1 VP/ 100 m²	-
Biznes dhe publik	Ndërtesat e bizneseve	4 VP/ 100 m²	Për sipërfaqe me të vogla se 100 m², të sigurohen se paku 2 VP
	Ndërtesat administrative (publike)	2 VP/ 100 m²	
Industria dhe zanatet	Ndërtesat e industrive	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e zanateve	2 VP/ 100 m²	-
Kultura dhe arsimi	Ndërtesat e kopshteve/ çerdheve të fëmijëve	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e shkollave fillore	0.5 VP/ 100 m²	Për ndërtesat e sallave të sporteve në kompleks të shkollës, kalkulohet vetëm hapësira e sallës
	Ndërtesat e shkollave të mesme	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e fakulteteve dhe instituteve	1 VP/ 100 m²	Për sipërfaqet e kompleksëve, nr. i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta, përkatësisht me plane operative.
	Ndërtesat e kinemave, teatrove, sallave për mbledhje publike	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat religjioze- xhamitë, kishat, etj	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e muzeve, galerive dhe bibliotekave	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat/ sallat e kongreseve	1 VP/ 100 m²	-
Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	Ndërtesat e spitaleve, klinikave, qendrave të rehabilitimit dhe të përmbajtjeve të tjera të ngjashme	1 VP/ 100 m²	-
	Ndërtesat e ambulancave, poliklinikave dhe shtëpive të shëndetit	3 VP/ 100 m²	Numri i VP duhet të jetë jo me i vogël se numri i ambulancave
	Shtëpitë për të moshuar	0.5 VP/ 100 m²	-
Sporti dhe rekreacioni	Ndërtesat e sporteve në shërbim të ndërtesave të banimit (fushat sportive dhe fushat e lojës të hapura për fëmije)	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta
	Ndërtesat e sporteve të hapura dhe të mbyllura pa spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.

	Ndërtesat e sporteve dhe fushave sportive me spektator	-	Numri i VP përcaktohet në përputhje me rregulloret e veçanta.
Terminalet e udhëtareve	Ndërtesat e terminaleve të autobusëve	-	Për ndërtesat e terminaleve duhet të hartohet projekti i teknik i trafikut, me kalkulimin e numrit të VP, në veçanti për: Vendqëndrimet (ngarkim / shkarkim); parkim afat-shkurtë; parkim afat-gjatë
	Ndërtesat e terminaleve të trenit	-	
	Ndërtesat e terminaleve të aeroporteve	-	



Figura 20 Vend-parkimet për qëllime të veçanta

8. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2023 – 2031, planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese kjo pjesë përcakton kushtet zhvillimore për infrastrukturën e planifikuar publike dhe sociale, duke specifikuar llojin, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim të:

1. Parqeve publike dhe hapësirave të hapura;
2. Fushave sportive dhe hapësirave rekreative;
3. Hapësirave dhe ndërtimet për shërbime mjekësore;
4. Ndërtesat për shërbime sociale;
5. Ndërtesat e institucioneve parashkollore;
6. Shkollat dhe universitetet;
7. Qendrat administrative;
8. Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike.

Në zonën urbane, te blloqet pjesërisht të hapura (që paraqesin inversin e blloqeve të mbyllura)- duhet të përmbajnë këto veçori: pjesët e brendshme të bllokut duhet të janë në shfrytëzim të hapësirave publike si: parqet, hapësirat për kohezion shoqëror, fushë-lojërat për fëmije, hapësirat për sport dhe rekreacion, etj. Këto kërkesa minimale hapësinore janë përcaktuar duke marrë parasysh shërbimet ekzistuese dhe funksionalitetin e tyre, kërkesat për shërbime të reja si dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

Tabela 69 Zonat e Shërbimeve

Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Sipërfaqet për zhvillim (ha)
ZSH-1	Shërbim i komunitetit – Varreza	57.15
ZSH-2	Shërbim fetar	12.42
ZSH-3	Shërbim shëndetësor dhe shoqëror	4.66
ZSH-4	Shërbim arsimor	35.95
ZSH-5	Shërbim i komunitetit	2.45
ZSH-6	Deponi e përkohshme e mbeturinave	

Kushtet për zhvillimin e infrastrukturës publike dhe sociale janë të parashtruara në vijim.

8.1. PARQET PUBLIKE DHE HAPËSIRAT E HAPURA PUBLIKE

Në kuadër të parqeve publike dhe hapësirave të hapura publike, përfshihen:

1. Sheshet publike;
2. Hapësirat e lira për shfrytëzim nga këmbësorët ose çiklistët;
3. Fushat e hapura sportive dhe rekreative;
4. Parqet publike në kuadër të lagjes;
5. Parqet publike në kuadër të vendbanimit;
6. Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve;
7. Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore.

- **Kushtet zhvillimore për parqet publike dhe hapësirat e hapura publike të planifikuara**

Në vijim janë të përcaktuara kushtet zhvillimore për parqet publike dhe hapësirat e hapura publike të planifikuara :

Lloji:	**Ndërtimi i hapësirave gjelbëruese publike**
Lokacioni:	Viti, Smirë, Vërban, Gërmovë, Remnik, Budrikë, Goshicë dhe Drobesh
Kapaciteti (shikues):	N/A
Etazhiteti:	N/A
ISHPKZh:	N/A

Lloji:	**Ndërtimi i hapësirave gjelbëruese publike**
Lokacioni:	Pozheran, Sllatinë e Epërme, Sodovinë e Çerkezve dhe Sodovinë e Jerlive
Kodi:	N/A
Etazhiteti:	N/A
ISHPKZh:	N/A

Lloji:	**Ndërtimi i parkut të qytetit**
Lokacioni:	Viti
Kapaciteti (km):	N/A
Etazhiteti:	N/A
ISHPKZh:	N/A

- **Kushtet zhvillimore për parqet publike dhe hapësirat e hapura publike e reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen**

Përpos investimeve kapitale për parqet publike dhe hapësirat e hapura publike të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e parqeve publike dhe hapësirave të hapura publike**

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e parqeve publike dhe hapësirave të hapura publike duhet jetë në:

1. Afërsi të zonave të banimit;
2. Afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik.

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni duhet të përzgjidhet duke mos tejkaluar kriterin minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore për fusha të hapura sportive prej 800 m, respektivisht 1,600m nga fusha hapura sportive ekzistuese.

Bazuar në infrastrukturën ekzistuese, kushtet e sipërme zhvillimore dhe numrit të planifikuar të banorëve, përmes bonuseve të zonimit, Komuna do të përcaktojë sipërfaqet e nevojshme për zhvillimin e hapësirave të hapura publike brenda kompleksеve urbane.

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e parqeve publike dhe hapësirave të hapura publike**

Kërkesat minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e parqeve publike dhe hapësirave të hapura publike janë si vijon:

- 1.00 m²/banor për parqe publike në kuadër të lagjes;
- 2.00 m²/banor parqe publike në kuadër të vendbanimit;
- 1.00 m²/banor për breza të gjelbër përgjatë rrugëve;
- 2.00 m²/banor për breza të gjelbër përgjatë rrjedhave ujore.

- **Rregullat për zhvillimin e peizazhit.**

Theks i veçantë duhet t'i kushtohet ofrimit të një shumëllojshmërie parqesh, shtigjesh dhe mundësish të hapësirës së hapur që u shërbejnë banorëve të të gjitha moshave dhe aftësive dhe që janë të aksesueshme nga një sërë vendndodhjesh brenda komunitetit.

Peizazhi duhet të jetë i përshtatshëm për përdorimin dhe funksionin e zonës dhe të përfshijë:

- Lloje të pemëve;
- Shkurre;
- Mbulesë tokësore të bimëve të gjalla;
- Sistem ujitjeje efikas për pjesët e peizazhuara.

Madhësia e pemëve:

Të gjitha pemët, përveç pemëve të rrugës, duhet të jenë të paktën 3m të larta dhe të kenë një kaliper minimal prej 5 cm në kohën e mbjelljes, përveç se 30% e kërkesës për pemë mund të plotësohet nga speciet vendase me një lartësi minimale prej 2.5 m dhe një kaliper minimal prej 3.5 cm në kohën e mbjelljes.

Shkurret:

Të gjitha shkurret duhet të jenë të paktën 45 cm në lartësi menjëherë pas mbjelljes. Kur përdoren në formë gardhi apo për çështje vizuale, shkurret mbillen në një distancë maksimale mesatare prej 75 cm në qendër ose nëse mbillen në një lartësi minimale prej 90 cm, preferohet të kenë një mesatare hapësire prej 1.20 m në qendër, për të formuar gardhin solid brenda një viti pas mbjelljes.

Klasifikimi sipas lartësisë:

- Gardhe me bimë xhuxhe: deri 0.5 m; p.sh. Bushi (*Buxus*)
- Gardhe të ulët, me lartësi 0.5–0.7 m, për ndarjen e zonave të ndryshme, me shkurre me formë të rregullt; p.sh. Bushi (*Buxus*), Ashja, Tuja (*Thuja*), lloje të gjinisë *Cotoneaster*
- Gardhe me lartësi mesatare 0.7-1 m, si sfond për bimët që lulëzojnë; Oleandri (*Nerium oleander*), Jargavani (*Syringa vulgaris*), Tuja (*Thuja*), Fotinia (*Photinia*), Trëndafili (*Rosa*), Spirea kineze *(Spiraea x vanhouttei)*, etj.

Në rastet kur përdoren gardhe apo mure të forta ngjitur me hapësirën e hapur, parqet dhe shtigjet, maksimumi i lartësisë është 4 m, për të mos kufizuar qasjen apo prezencën e parkut.

Hapësira lineare përgjatë lumenjve ose rrugëve:

- Këto hapësira bëjnë lidhjet me elementet e tjera dhe preferohet të përdorin linjat e pandërprera të drunjve për të izoluar shtigjet nga trafiku
- Projektimi i thjeshtë, jo i komplikuar, me fare pak lule/shkurre dekorative, preferohen speciet autoktone të bimëve
- Këto zona kërkojnë mbarështim me intensitet të ulët: kositja e barit dy herë në vit, pastrimi i bimësisë së rritur tepër apo të degëve që varen mbi rrugë

8.2. FUSHAT SPORTIVE DHE HAPËSIRAT REKREATIVE

Në kuadër të fushave sportive dhe hapësirave rekreative, përfshihen:

1. Ndërtesat e stadiumeve;
2. Ndërtesat e sallave sportive;
3. Ndërtesat sportive shume- funksionale;
4. Fushat sportive- rekreative shume- funksionale;
5. Shtigjet për gara motorike;
6. Shtigjet për kalërim;
7. Shtigjet për ngjitje dhe marshim alpin;
8. Shtigjet për çiklizëm;
9. Shtigjet për skijim;
10. Shkëmbinjtë natyror dhe artificial për ngjitje;
11. Fushat e golfit.

- **Kushtet zhvillimore për fushat sportive dhe hapësirat rekreative të planifikuara**

Në vijim janë të përcaktuara kushtet zhvillimore për fushat sportive dhe hapësirat rekreative të planifikuara:

Lloji:	**Ndërtimi i fushave sportive**
Lokacioni:	Zhiti, Tërpezë, Tërstenik, Vërban, Smirë, Beguncë, Gërmovë, Gjylekarë dhe Ramnishtë
Kapaciteti (shikues):	N/A
Etazhiteti:	N/A
ISHPKZh:	80%

Lloji:	**Ndërtimi i fushave sportive**
Lokacioni:	Stubëll të Epërme, Budrikë, Sodovinë e Çerkezve, Remnik, Radivojc, Goshicë
Kapaciteti (shikues):	N/A
Etazhiteti:	N/A
ISHPKZh:	80%

Kushtet zhvillimore për fushat sportive dhe hapësirat rekreative e reja që synohen të zhvillohen në:

- **Kushtet zhvillimore për fushat sportive dhe hapësirat rekreative e reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen**

Përpos investimeve kapitale për fushat sportive dhe hapësirat rekreative të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e fushave sportive dhe hapësirave rekreative**

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e fushave sportive dhe hapësirave rekreative duhet të jetë në:

1. Lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
2. Lokacion të rrafshët pranë burimeve dhe pasqyrave ujore.

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni duhet të përzgjidhet duke mos tejkaluar kriterin minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore për fusha të hapura sportive prej 800 m, respektivisht 1,600m nga fusha e hapur sportive ekzistuese.

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e fushave sportive dhe hapësirave rekreative**

Kërkesat minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e fushave sportive dhe hapësirave rekreative janë si vijon:

- 2.50 m²/banor për vendbanime me numër të banorëve nën 5,000;
- 4.50 m²/banor për vendbanime me numër të banorëve 5,000 – 20,000;
- 5.00 m²/banor për vendbanime me numër të banorëve mbi 20,001.

Indeksi maksimal i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) të ndërtesave sportive është 60%.

8.3. HAPËSIRAT DHE NDËRTIMET PËR SHËRBIME SHËNDETËSORE

Në kuadër të hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore nivelit parësor, përfshihen:

1. Ndërtesat e qendrave kryesore të mjekësisë familjare (QKMF);
2. Ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare (QMF);
3. Ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare (PMF).

Kushtet për zhvillimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore nivelit parësor janë të parashtruara në nënkapitujt vijues.

- **Kushtet zhvillimore për hapësirat dhe ndërtimet për shërbime shëndetësore e reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen**

Përpos investimeve kapitale për hapësirat dhe ndërtimet për shërbime shëndetësore të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

Ndërtimi i Qendrave Mjekësore Familjare duhet të i plotësojë kërkesat hapësinore dhe teknike të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. – 08-2017 – Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) apo me ndonjë akt tjetër nënligjor i cilin në të ardhmen mund të shfuqizojë këtë udhëzim administrativ si dhe kushtet e përcaktuara në vijim.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore**

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore duhet të jetë në:

1. Parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
2. Lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
3. Lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erëra te forta;
4. Afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
5. Largësi nga lokacionet e ndotura;
6. Largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore);

7. Largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore-vërshimet;
8. Largësi më të madhe se 100 m nga lokacionet me ndërtesa te garazheve;
9. Largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni duhet përzgjidhet duke mos tejkaluar kriterin minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore për hapësirat dhe ndërtimet për shërbime shëndetësore si vijon:

- 1 km për ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare, respektivisht 2 km nga hapësira dhe ndërtimi ekzistuese për shërbime shëndetësore.
- 3 km për ndërtesat e punkteve ë mjekësisë familjare, respektivisht 6 km nga hapësira dhe ndërtimi ekzistuese për shërbime shëndetësore.

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore**

Kërkesa minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore është 0.20 m²/banor të vendbanimit/ve të cilat i shërben.

Indeksi maksimal i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) për hapësirat dhe ndërtimet për shërbime shëndetësore është 50 %.

Në bazë të normave teknike të planifikimit zona urbane dhe rrethina e Komunës së Vitisë është e mbuluar mirë me objekte qe ofrojnë shërbime shëndetësore si QKMF, QMF dhe AMF.

Rregullat për zhvillim të peizazhit

Kemi të bëjmë me gjelbërimin shoqëror të kufizuar që i referohet sipërfaqeve të gjelbra me përdorim publik, kryesisht për përdorim nga përdoruesit e institucioneve. Mbarështimi dhe rregullimi peizazhor ka për qëllim ofrimin e ndryshimeve pozitive në komunitetin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

Pemët e përshtatshme për kopshtet do të kenë të paktën një karakteristikë të dukshme dekorative dhe zakonisht do të jenë të vogla ose të mesme me madhësi maksimale 15m (kujdes i shtuar për zgjedhjen e drunjve dhe shkurreve për mbrojtjen nga erërat)**.** Përjashtimisht, një pemë me rritje të ngadaltë me përmasa të mëdha (potenciale) mund të përfshihet në këtë kategori.

Është shumë e rëndësishme që peizazhi të jetë në përputhje me përdorimin e hapësirës (kopsht, shkollë, qendër mjekësore, etj.)

Gjatë projektimit merret në konsideratë:

- T'i jepet përparësi sigurisë dhe qasjes së lehtë për përdoruesit (veçanërisht fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar);
- Dizajni i peizazhit duhet të përfshijë praktika të qëndrueshme siç janë përdorimi i bimëve vendase, grumbullimi i ujit të shiut dhe ndriçimi me efikasitet energjetik;
- Zonat me bar mbillen me specie të përshtatura mirë për kushtet lokale të rritjes dhe qëllimet e dizajnit. Ato mund të pastrohen, të mbyllen, të mbulohen, të përdoren mulçe organike ose të mbjellen me farë, përveç zonave të ekspozuara nga erozioni përdoren shtresat e biodegradueshme;
- Për gjelbërimin në oborre (zakonisht të rrethuara), kur strukturat nuk lejojnë, mbjelljet bëhen në mbajtëse prej betoni ose druri;
- Hapësira minimale që u ekspozohen shkeljeve intenzive;
- Ujitja dhe plehërimi periodik;
- Inkurajohen gropa të vazhdueshme për mbjelljen e pemëve (kur është e mundur), sidomos kur përfshihen bimë grupore;
- Bimët grupore: Mbjellja e bimëve në grup preferohet për shkak të përfitimeve të pemëve kur gjenden në afërsi, duke përfshirë maksimizimin e hijes, më pak ngjeshje të tokës, më pak nxehtësi të thithur nga një pemë e vetme, etj.

Hapësirat/parqet me përdorim intensiv

- Përdoren specie vendase, të përshtatshme (kushtet e tokës, regjimi vendor i ujit, dielli dhe hija), në vend të bimëve njëvjeçare (që kërkojnë zëvendësime të vazhdueshme)
- Drunjtë mund të rriten në kushte të hapura, me kurorë të plotë ose në grupe
- Drunjtë e vjetër duhet të hiqen– rrezik shkulje, thyerje degësh, rrezikojnë vizitorët

8.4. NDËRTESAT PËR SHËRBIME SOCIALE

Në kuadër të ndërtimeve për shërbime sociale, përfshihen:

1. Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare;
2. Ndërtesat e institucioneve për përkujdesje sociale ndaj personave me nevoja të veçanta;
3. Ndërtesat e institucioneve të komunitetit.

- **Kushtet zhvillimore për ndërtesat për shërbime sociale të planifikuara**

Në vijim janë të përcaktuara kushtet zhvillimore për ndërtesat për shërbime sociale të planifikuara:

Lloji:	**Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit për personat me aftësi të kufizuar**
Lokacioni:	Viti
Kapaciteti:	30 Persona
Etazhiteti:	P
ISHPKZh:	30%

- **Kushtet zhvillimore për ndërtesat për shërbime sociale e reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen**

Përpos investimeve kapitale për ndërtesat për shërbime sociale të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e për ndërtesat për shërbime sociale**

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e ndërtesave për shërbime sociale duhet të jetë në:

1. Terren të rrafshët;
2. Afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
3. Largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
4. Largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore).

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore**

Kërkesa minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e hapësirave dhe ndërtimeve për shërbime shëndetësore është:

- 0.25 m²/banor për ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare;
- 0.20 m²/banor për ndërtesat e institucioneve të komunitetit.

8.5. NDËRTESAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Në kuadër të ndërtesave të institucioneve arsimore, përfshihen:

1. Infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor;
2. Infrastruktura e institucioneve të arsimit para-universitar;
3. Infrastruktura e institucioneve të arsimit të lartë dhe të hulumtimeve shkencore.

Kushtet për zhvillimin e ndërtesave të institucioneve arsimore janë të parashtruara në nënkapitujt vijues.

- **Kushtet zhvillimore për ndërtesat e institucioneve arsimore të reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen**

Përpos investimeve kapitale për ndërtesat për shërbime sociale të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

Përpos kushteve zhvillimore vijuese dhe kushteve ndërtimore, përderisa ato nuk shfuqizohen nga Udhëzues tjerë të ri të gjitha shkollat e reja duhet të përmbushin kushtet zhvillimore të projektimit dhe ndërtimit të përcaktuara nga MASHT apo me ndonjë udhëzues i cili në të ardhmen mund të shfuqizojë këtë udhëzim në:

- Udhëzuesin Për Normat Dhe Standardet E Ndërtesave Shkollore Udhëzimet E Përgjithshme, Vëllimi 1, Dhe
- Udhëzuesin Për Normat Dhe Standardet E Ndërtesave Shkollore Udhëzimet Specifike, Vëllimi 2.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e kopshteve/çerdheve të fëmijëve**

Infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor shërbejnë fëmijët të grupmoshave deri në moshën pesë vjeçare, respektivisht deri në nivelin e arsimit parafillor të arsimit bazik themelor.

Institucionet parashkollore përbëhet nga:

1. Ndërtesat e çerdheve për fëmijë: grupmoshat ≤ 3 vjet;
2. Ndërtesat e kopshteve për fëmijë: grupmoshat 3- 5 vjet.

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e kopshteve/çerdheve të fëmijëve duhet të jetë në:

1. Kuadër të zonës së banimit;
2. Lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
3. Lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
4. Afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
5. Largësi nga lokacionet e ndotura;
6. Largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
7. Largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
8. Largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
9. Largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni për zhvillimin e kopshteve të fëmijëve duhet te përzgjidhet sipas kriterit minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezes optimale shërbyese në vijë ajrore duke mos tejkaluar:

- 300 m në zonë urbane;
- 300 m në zonë rurale.

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni për zhvillimin e kopshteve të fëmijëve duhet te përzgjidhet sipas kriterit minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezes optimale shërbyese në vijë ajrore duke mos tejkaluar:

- 500 m në zonë urbane;
- 900 m në zonë rurale.

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e çerdheve/kopshteve të fëmijëve**

Kërkesa minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e hapësirave dhe ndërtimeve për kopshtet/çerdhet e fëmijëve është:

- 0.30 m²/banor për ndërtesat e çerdheve:
- 1.00 m²/banor për ndërtesat e kopshteve.

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e çerdheve duhet të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve sipas grupeve vijuese:

- Për një grup: 30 m²/fëmijë;
- Për dy grupe: 25 m²/fëmijë;
- Për tri grupe: 25 m²/fëmijë;
- Për katër grupe: 20 m²/fëmijë;
- Për dhjetë grupe: 40 m²/fëmijë;
- Për njëzet grupe: 30 m²/fëmijë.

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e kopshteve duhet të zhvillohen në lokacione që përmbushin kërkesat e Normave Teknike për parcelë kadastrale sipas numrit fëmijëve sipas grupeve vijuese:

- Nga një deri në dy grupe: 24- 32 m²/fëmijë;
- Nga tri deri në katër grupe: 20- 25 m²/fëmijë;
- Nga pesë deri në gjashtë grupe: 18- 22 m²/fëmijë.

Kopshtet/çerdhet e fëmijëve nuk lejohet të tejkalojnë indeksin maksimal të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) si vijon:

- 30% për ndërtesa të çerdheve;
- 25% për ndërtesa të kopshteve:

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta**

Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për zhvillimin e shkollave fillore dhe shkollave të mesme të ulëta duhet të jetë në:

1. Afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
2. Kuadër të zonës së banimit në vendbanime rurale;
3. Lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
4. Lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
5. Afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
6. Largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë;
7. Largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
8. Largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
9. Largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
10. Largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.

Në zonat e planifikuara për banim, lokacioni për zhvillimin e shkollave fillore dhe shkollave të mesme të ulëta, duhet të përzgjidhet duke mos tejkaluar kriterin minimal të distancës optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore:

- 600 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë urbane;
- 600 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë urbane;
- 1500 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë urbane;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave fillore në zonë rurale;
- 1900 m për ndërtesat e shkollave të mesme të ulëta në zonë rurale;
- 4700 m për ndërtesat e shkollave të mesme të larta në zonë rurale.

- **Kushtet zhvillimore për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta**

Kërkesa minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e shkollave fillore, shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta është:

- 1.60 m²/banor për shkolla fillore;
- 1.20 m²/banor për shkolla të mesme të ulëta;
- 1.00 m²/banor për shkolla të mesme të larta.

Shkollat fillore, shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta nuk lejohet të tejkalojnë indeksin maksimal të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) si vijon:

- 40% për shkolla fillore;
- 40% për shkolla të mesme të ulëta;
- 60% për shkolla të mesme të larta.

Rregullat për zhvillim të peizazhit:

Kemi të bëjmë me gjelbërimin shoqëror të kufizuar që i referohet sipërfaqeve të gjelbra me përdorim publik, kryesisht për përdorim nga përdoruesit e institucioneve. Mbarështimi dhe rregullimi peizazhor ka për qëllim ofrimin e ndryshimeve pozitive në komunitetin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

Pemët e përshtatshme për kopshtet do të kenë të paktën një karakteristikë të dukshme dekorative dhe zakonisht do të jenë të vogla ose të mesme me madhësi maksimale 15m (kujdes i shtuar për zgjedhjen e drunjve dhe shkurreve për mbrojtjen nga erërat)**.** Përjashtimisht, një pemë me rritje të ngadaltë me përmasa të mëdha (potenciale) mund të përfshihet në këtë kategori.

Është shumë e rëndësishme që peizazhi të jetë në përputhje me përdorimin e hapësirës (kopsht, shkollë, qendër mjekësore, etj.)

Gjatë projektimit merret në konsideratë:

- T'i jepet përparësi sigurisë dhe qasjes së lehtë për përdoruesit (veçanërisht fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar);
- Dizajni i peizazhit duhet të përfshijë praktika të qëndrueshme siç janë përdorimi i bimëve vendase, grumbullimi i ujit të shiut dhe ndriçimi me efikasitet energjetik;
- Zonat me bar mbillen me specie të përshtatura mirë për kushtet lokale të rritjes dhe qëllimet e dizajnit. Ato mund të pastrohen, të mbyllen, të mbulohen, të përdoren mulçe organike ose të mbjellen me farë, përveç zonave të ekspozuara nga erozioni përdoren shtresat e biodegradueshme;
- Për gjelbërimin në oborre (zakonisht të rrethuara), kur strukturat nuk lejojnë, mbjelljet bëhen në mbajtëse prej betoni ose druri;
- Hapësira minimale që u ekspozohen shkeljeve intenzive;
- Ujitja dhe plehërimi periodik;

- Inkurajohen gropa të vazhdueshme për mbjelljen e pemëve (kur është e mundur), sidomos kur përfshihen bimë grupore;
- Bimët grupore: Mbjellja e bimëve në grup preferohet për shkak të përfitimeve të pemëve kur gjenden në afërsi, duke përfshirë maksimizimin e hijes, më pak ngjeshje të tokës, më pak nxehtësi të thithur nga një pemë e vetme, etj.

Hapësirat/parqet me përdorim intensiv

- Përdoren specie vendase, të përshtatshme (kushtet e tokës, regjimi vendor i ujit, dielli dhe hija), në vend të bimëve njëvjeçare (që kërkojnë zëvendësime të vazhdueshme);
- Drunjtë mund të rriten në kushte të hapura, me kurorë të plotë ose në grupe;
- Drunjtë e vjetër duhet të hiqen– rrezik shkulje, thyerje degësh, rrezikojnë vizitorët.

8.6. QENDRAT ADMINISTRATIVE

Në kuadër të qendrave administrative, përfshihen ndërtesat e institucioneve të administratës publike.

▪ Kushtet zhvillimore për qendrat administrative të reja që synohen të zhvillohen në të ardhmen

Përpos investimeve kapitale për qendrat administrative të përshkruara sipër, Komuna mund të krijojë edhe hapësira të reja shtesë përmes investimeve komunale, granteve, donacioneve apo bonuseve të zonimit duke i përmbushur kërkesat e parashtruara në vijim.

▪ Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për qendrat administrative

Infrastruktura e institucioneve administrative, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. Në pjesën / pjesët qendrore të vendbanimeve;
2. Në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
3. Në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
4. Në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
5. Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
6. Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore - vërshimet.

▪ Kushtet për përcaktimin e sipërfaqeve për zhvillimin e qendrave administrative

Kërkesat minimale sipërfaqësore të parcelave kadastrale për krijimin e fushave sportive dhe hapësirave rekreative janë si vijon:

- 0.62 m²/banor për ndërtesat e institucioneve të administratës publike (me përjashtim te burgjeve);

Indeksi maksimal i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) të ndërtesave te institucioneve të administratës publike (me përjashtim te burgjeve) është 80%.

Rregullat për zhvillim të peizazhit

Kemi të bëjmë me gjelbërimin shoqëror të kufizuar që i referohet sipërfaqeve të gjelbra me përdorim publik, kryesisht për përdorim nga përdoruesit e institucioneve. Mbarështimi dhe rregullimi peizazhor ka për qëllim ofrimin e ndryshimeve pozitive në komunitetin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

Pemët e përshtatshme për kopshtet do të kenë të paktën një karakteristikë të dukshme dekorative dhe zakonisht do të jenë të vogla ose të mesme me madhësi maksimale 15m (kujdes i shtuar për zgjedhjen e drunjve dhe shkurreve për mbrojtjen nga erërat)**.** Përjashtimisht, një pemë me rritje të ngadaltë me përmasa të mëdha (potenciale) mund të përfshihet në këtë kategori.

Është shumë e rëndësishme që peizazhi të jetë në përputhje me përdorimin e hapësirës (kopsht, shkollë, qendër mjekësore, etj.)

Gjatë projektimit merret në konsideratë:

- T'i jepet përparësi sigurisë dhe qasjes së lehtë për përdoruesit (veçanërisht fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar);
- Dizajni i peizazhit duhet të përfshijë praktika të qëndrueshme siç janë përdorimi i bimëve vendase, grumbullimi i ujit të shiut dhe ndriçimi me efikasitet energjetik;
- Zonat me bar mbillen me specie të përshtatura mirë për kushtet lokale të rritjes dhe qëllimet e dizajnit. Ato mund të pastrohen, të mbyllen, të mbulohen, të përdoren mulçe organike ose të mbjellen me farë, përveç zonave të ekspozuara nga erozioni përdoren shtresat e biodegradueshme;
- Për gjelbërimin në oborre (zakonisht të rrethuara), kur strukturat nuk lejojnë, mbjelljet bëhen në mbajtëse prej betoni ose druri;
- Hapësira minimale që u ekspozohen shkeljeve intenzive;
- Ujitja dhe plehërimi periodik;
- Inkurajohen gropa të vazhdueshme për mbjelljen e pemëve (kur është e mundur), sidomos kur përfshihen bimë grupore;
- Bimët grupore: Mbjellja e bimëve në grup preferohet për shkak të përfitimeve të pemëve kur gjenden në afërsi, duke përfshirë maksimizimin e hijes, më pak ngjeshje të tokës, më pak nxehtësi të thithur nga një pemë e vetme, etj.

Hapësirat/parqet me përdorim intensiv

- Përdoren specie vendase, të përshtatshme (kushtet e tokës, regjimi vendor i ujit, dielli dhe hija), në vend të bimëve njëvjeçare (që kërkojnë zëvendësime të vazhdueshme)
- Drunjtë mund të rriten në kushte të hapura, me kurorë të plotë ose në grupe
- Drunjtë e vjetër duhet të hiqen– rrezik shkulje, thyerje degësh, rrezikojnë vizitorët

8.7. NDËRTESAT E INSTITUCIONEVE KULTURORE

Kushtet zhvillimore për ndërtimin e institucioneve të planifikuara të hapësirat kulturore janë:

Lloji:	**Ndërtimi i sallës së teatrit**
Lokacioni:	Viti
Kapaciteti (vizitor):	200
Etazhiteti:	B+P+2
ISHPKZh:	60%

- **Kushtet zhvillimore për ndërtimin e institucioneve kulturore**

Komuna do të sigurojë së paku sipërfaqe të parcelave kadastrale për ndërtesat e institucioneve kulturore, si vijon:

- 0.25 m²/banor për bibliotekë;
- 0.20 m²/banor për teatro; dhe
- 0.20 m²/banor për kinema.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit për ndërtimin e institucioneve kulturore**

Infrastruktura e institucioneve kulturore, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- Në pjesën/ pjesët qendrore të vendbanimeve;
- Në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
- Në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;

- Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
- Në largësi më të madhe se 100 m nga ndërtesat e garazheve.

- **Kushtet zhvillimore për ndërtimin e institucioneve kulturore**

Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

Normat minimale të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore duhet të plotësojnë kërkesën minimale pret 0.65 m²/banor, për numrin e prognozuar të banorëve të cilat synohet të i shërbejnë.

Indeksit te shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) të ndërtesave te institucioneve të kulturore është:

- 60% për bibliotekë;
- 80% m²/banor për teatro; dhe
- 80% m²/banor për kinema.

- **Kushtet zhvillimore për ndërtimin e institucioneve kulturore përmes bonuseve të zonimit**

Në zona të caktuara zhvillimi i institucioneve të qendrave kulturore të cilat nuk e kanë të përcaktuar pronësinë, Komuna do të do të negocioj me aplikuesin përmes bonuseve të zonimit, që të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme për zona të caktuara duke respektuar kushtet zhvillimore vijuese në përputhje me Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor:

- Normat minimale të parcelës së infrastrukturës së institucioneve kulturore duhet të plotësojnë kërkesën minimale prej 0.65 m²/banor, për numrin e prognozuar të banorëve të cilat synohet të i shërbejnë.
- Në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;
- Në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
- Në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;
- Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet.

Rregullat për zhvillim të peizazhit

Kemi të bëjmë me gjelbërimin shoqëror të kufizuar që i referohet sipërfaqeve të gjelbra me përdorim publik, kryesisht për përdorim nga përdoruesit e institucioneve. Mbarështimi dhe rregullimi peizazhor ka për qëllim ofrimin e ndryshimeve pozitive në komunitetin dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit.

Pemët e përshtatshme për kopshtet do të kenë të paktën një karakteristikë të dukshme dekorative dhe zakonisht do të jenë të vogla ose të mesme me madhësi maksimale 15m (kujdes i shtuar për zgjedhjen e drunjve dhe shkurreve për mbrojtjen nga erërat)**.** Përjashtimisht, një pemë me rritje të ngadaltë me përmasa të mëdha (potenciale) mund të përfshihet në këtë kategori.

Është shumë e rëndësishme që peizazhi të jetë në përputhje me përdorimin e hapësirës (kopsht, shkollë, qendër mjekësore, etj.)

Gjatë projektimit merret në konsideratë:

- T'i jepet përparësi sigurisë dhe qasjes së lehtë për përdoruesit (veçanërisht fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar);
- Dizajni i peizazhit duhet të përfshijë praktika të qëndrueshme siç janë përdorimi i bimëve vendase, grumbullimi i ujit të shiut dhe ndriçimi me efikasitet energjetik;
- Zonat me bar mbillen me specie të përshtatura mirë për kushtet lokale të rritjes dhe qëllimet e dizajnit. Ato mund të pastrohen, të mbyllen, të mbulohen, të përdoren mulçe organike ose të mbjellen me farë, përveç zonave të ekspozuara nga erozioni përdoren shtresat e biodegradueshme;
- Për gjelbërimin në oborre (zakonisht të rrethuara), kur strukturat nuk lejojnë, mbjelljet bëhen në mbajtëse prej betoni ose druri;

- Hapësira minimale që u ekspozohen shkeljeve intenzive;
- Ujitja dhe plehërimi periodik;
- Inkurajohen gropa të vazhdueshme për mbjelljen e pemëve (kur është e mundur), sidomos kur përfshihen bimë grupore;
- Bimët grupore: Mbjellja e bimëve në grup preferohet për shkak të përfitimeve të pemëve kur gjenden në afërsi, duke përfshirë maksimizimin e hijes, më pak ngjeshje të tokës, më pak nxehtësi të thithur nga një pemë e vetme, etj.

Hapësirat/parqet me përdorim intensiv

- Përdoren specie vendase, të përshtatshme (kushtet e tokës, regjimi vendor i ujit, dielli dhe hija), në vend të bimëve njëvjeçare (që kërkojnë zëvendësime të vazhdueshme)
- Drunjtë mund të rriten në kushte të hapura, me kurorë të plotë ose në grupe
- Drunjtë e vjetër duhet të hiqen– rrezik shkulje, thyerje degësh, rrezikojnë vizitorët

8.8. VARREZAT

Bazuar në gjendjen ekzistuese, identifikimin dhe realizimin e përparësive dhe mundësive, identifikimin dhe tejkalimin e dobësive dhe kërcënimeve të infrastrukturës sociale, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, Plani Zhvillimor Komunal 2020 - 2028 ka përcaktuar Qëllimin vijues për zhvillimin e varrezave:

Varrezat duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

- Në afërsi të zonave të banimit;
- Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
- Në afërsi jo më të vogël se 300 m nga zona e banimit; dhe
- Në largësi jo më të madhe se 15 km nga vendbanimi.

- **Kushtet zhvillimore për ndërtimin e varrezave**

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së varrezave janë si në vijim:

- 1.50 m²/banor.
- Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.
- Indeks i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) për varreza është 40%.

Ndonëse varrezat nuk janë trajtuar me PZHK por:

- Hapësirat e destinuara dhe të cilat shfrytëzohen për varreza duhet menaxhuar dhe mirëmbajtur,
- Pajisur me përmbajtje të cilat mundësojnë ceremoni cilësore,
- Specifiko zonat ku duhet hapësira plotësuese.

9. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimorë Komuna dhe Planit Zhvillimor Urban të Vitisë por edhe duke marr parasysh gjendjen ekzistuese të sistemit të ujësjellësit, HZK-së në udhëzimin administrativ ka parashikuar planifikimin e infrastrukturës teknike si:

- **Kapacitetin dhe shtrirjen e rrjetit:**
  Identifikimi i nevojave për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke siguruar lidhjen e zonave urbane dhe rurale me objektiva afatgjata për mbulueshmëri të plotë
- **Ndërtesat përcjellëse:**
  Përfshirja e objekteve mbështetëse, si stacionet e pompimit, rezervuarët dhe strukturat ndihmëse për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit
- **Shiritat mbrojtës:**
  Planifikimi i zonave mbrojtëse për të siguruar ruajtjen e rrjetit dhe për të parandaluar dëmet apo ndërhyrjet nga faktorë të jashtëm
- **Pajisjet për rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit:**
  Furnizimi dhe instalimi i pajisjeve moderne për monitorimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, duke përfshirë hidrantët, valvulat, matësit inteligjentë dhe pajisje të tjera teknologjike
- **Impiantet për trajtimin e ujerave te zeza:**
  Hartimi dhe ndërtimi i impianteve moderne për trajtimin e ujërave të ndotura, me kapacitete të përshtatshme për nevojat aktuale dhe ato të parashikuara në të ardhmen, duke respektuar standardet mjedisore
- **Drenazhimi:**
  Përmirësimi i sistemit të drenazhimit për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe parandalimin e përmbytjeve, veçanërisht në zonat me risk të lartë.

Këto masa jo vetëm që synojnë përmirësimin e kushteve aktuale, por edhe krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme dhe efikase që i përshtatet nevojave të komunitetit dhe mbështet zhvillimin ekonomik dhe mjedisor të zonës. Planifikimi i detajuar do të bazohet në një analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave teknike dhe gjeografike, duke përfshirë konsultimet me palët e interesuara për të siguruar zbatimin efektiv.

9.1. INFRASTRUKTURA E UJËSJELLËSIT

Infrastruktura e ujësjellësit përbëhet nga:

- Burimet e ujit - mbitokësore dhe nëntokësore;
- Stacionet e pompimit;
- Ndërtesat (fabrikat) për përpunimin e ujit;
- Rezervuarët e ujit të pijshëm;
- Rrjeti i ujësjellësit- primar, sekondar dhe terciar.

9.2. KUSHTET ZHVILLIMORE PËR RRJETIN E UJËSJELLËSIT

Kushtet zhvillimore të përcaktuara për Infrastrukturën e ujësjellësit, përfshirë burimet e ujit bazohen në Udhëzimin Administrativ për Hartën Zonale Komunale.

Më tejë këto dokumente përcaktojnë kushte dhe sigurojnë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës dhe kornizën institucionale për administrimin e resurseve ujore.

Në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) të komunës së Vitisë janë identifikuar lokacionet dhe hapat kryesorë për rritjen e resurseve ujore, duke adresuar nevojat emergjente dhe afatgjata të komunitetit. Për të përmbushur kërkesat e popullsisë dhe ekonomisë së komunës, janë parashikuar masat e mëposhtme:

Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Vitisë do të nevojiten burime të reja dhe rritje te kapaciteteve te ujit dhe rezervuarëve të konsiderueshme.

Për mbulimin e këtyre nevojave janë planifikuar zhvillimi i resurseve të reja ujore si vijon:

- **Rritja e kapaciteteve prodhuese të ujit:**

  Shtimi i burimeve të reja dhe optimizimi i burimeve ekzistuese për të siguruar furnizim të qëndrueshëm.

- **Zgjerimi i kapaciteteve të rezervuarëve:**

  Përmirësimi i kapacitetit të rezervuarëve ekzistues dhe ndërtimi i rezervuarëve të rinj për akumulim të ujit.

- **Ndërtimi i rezervuarëve të rinj:**

  Vendosja e rezervuarëve në zonat e reja të zhvillimit urban dhe rural, duke përfshirë përkufizimin e lokacioneve dhe vëllimit të nevojshëm për secilin rezervuar.

- **Hapja e puseve të reja:**

  Zhvillimi i puseve në zonat rurale për të shtuar kapacitetin e furnizimit me ujë.

- **Ndërtimi i stacioneve të pompave:**

  Instalimi i stacioneve të reja për të përmirësuar shpërndarjen dhe presionin në rrjet.

- **Zgjerimi i rrjeteve të furnizimit me ujë:**

  Ndërtimi dhe përmirësimi i rrjeteve në zonat urbane dhe fshatra, duke përfshirë zonat ku rrjeti mungon.

- **Krijimi i zonave DMA (District Metered Areas):**

  Organizimi i rrjetit në zona dhe nën-zona për matjen dhe menaxhimin e konsumit dhe humbjeve teknike e financiare të ujit.

- **Mbrojtja e burimeve ujore:**

  Garantimi i sigurisë për burimet ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore përmes masave mbrojtëse dhe planifikimit të qëndrueshëm.

Këto masa synojnë përmirësimin e cilësisë dhe kapacitetit të furnizimit me ujë, duke garantuar një menaxhim efikas të resurseve ujore për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të komunës së Vitisë.



9.2.1. FURNIZIMI ME UJË - KAPACITETI

Furnizimi me ujë për qytetin e Vitisë, si dhe për disa prej fshatrave që janë të lidhur me këtë sistem, realizohet përmes Fabrikës së Ujit në Letnicë. Kjo fabrikë trajton ujin e marrë nga kaptazha në Letnicë, duke siguruar cilësi të lartë dhe siguri në furnizim. Pas trajtimit, uji transportohet përmes një gypi gravitacional me diametër DN 350 mm dhe gjatësi prej afërsisht 12 kilometrash deri në qytetin e Vitisë.

Megjithëse ky gyp është instaluar para dy deri në tre vitesh, procesi i funksionalizimit të tij ka qenë i shoqëruar me sfida dhe probleme teknike të konsiderueshme, të cilat janë trajtuar deri në vendosjen e tij në funksion të plotë. Pavarësisht këtyre vështirësive, tani gypi është një pjesë kyçe e infrastrukturës së furnizimit me ujë për këtë qytet. Për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm dhe të pandërprerë, është planifikuar shfrytëzimi i rezervuarit ekzistues me kapacitet V = 650 m³. Ky rezervuar do të mbushet me rrjedhë të lirë gravitacionale, duke lejuar që uji të përcillet më tej drejt qytetit të Vitisë.

Kapaciteti i rezervuarve të ujit në komunën e Vitisë

Aktualisht situata e kapaciteteve te rezervuarve te ujit ne komunen e Vitisë qendron si ne vijim:

Nr.	Emri i rezervuarit	Koordinatat (X, Y, Z)	Vëllimi i rezervuarit (m^3)	Lloji i Rezervuarit
1	Rezervuari Letnicë	7536912.079; 4685324.040; 584.00	360	Rez. Nëntokësor
2	Rezervuari Letnicë		560	Rez. Mbitokësor
3	Rezevuari Pozheran	7527978.952; 4694263.768, 489.00	1000	Rez. Mbitokësor
Total V:			**1920**	

Llogaritja e Vëllimit Operativ ($V_{Operativ}$)

Për të llogaritur vëllimin e nevojshëm të rezervuarit për Komunën e Vitisë me **35,566 banorë**, do të përdorim metodologjin, duke marrë parasysh tre komponentët kryesorë të vëllimit të rezervuarit:

Llogaritja e Vëllimit Operativ ($V_{Operativ}$)

Q_{ditor}=35,566×150=5,335,000 litra ose 5,335 m^3

Llogaritja e Vëllimit të Rezervës për Emergjenca ($V_{emergjencë}$)

Zakonisht, rezerva emergjente është 30% e konsumit ditor**:**

$V_{emergjence}$=0.3×Q_{ditor}=1,600 m^3 -

Llogaritja e Vëllimit të Rezervës për Zjarrfikje (V_{zjarr})

Për mbrojtjen nga zjarri, llogarisim një furnizim **për 2 orë** me një rrjedhë prej **30 l/s**:

V_{zjarr}=30×3600×2=216,000 litra=216 m^3

Llogaritja e Vëllimit Total të Rezervuarit

V_{total}=$V_{operativ}$+$V_{emergjence}$+V_{zjarr}

Për Komunën e Vitisë me **35,566 banorë**, rekomandohet që rezervuari i ujit të ketë një kapacitet prej:

- **Afërsisht 7,200 m^3** nëse furnizimi me ujë bëhet për **24 orë**.

Përgjatë kësaj traseje, gypi furnizon gjithashtu fshatin Ramjan, i cili ndodhet në periferi të qytetit të Vitisë, duke përmbushur nevojat e këtij komuniteti për ujë të pijshëm cilësor.



Figura 21 Skema hidraulike Njesia Operative ne Viti

Në planet zhvillimore sektoriale dhe PZHK-së së Vitisë, Komuna ka bërë llogaritjen dhe analizën e shpenzimeve dhe kapacitetit të nevojshëm të ujit të pijshëm për banorët e zonës, e cila do të jetë në harmoni me kërkesat për furnizim me ujë të pijshëm për të gjitha vendbanimet e komunes se Vitisë për periudhën 2024-2032

Bazuar në Raportin Vjetor për vitin 2023 të publikuar nga KRU Hidromorava shihet se prodhimi i pikave prodhuese për vitin 2023 është si vijon:

Pikat e prodhimit te ujit, njësia operative në Viti- 2023	Njesia	Sasia e ujit te prodhuar
Fabrika e ujit në Letnicë	m^3	914810
Sistemi i ujësjellësit për 5 fshatrat (Sadovinë e Jerlive, Sadovinë e Çerkezëve, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme dhe Tërsteniku)	m^3	30995
Sistemi në Pozhoran	m^3	274960
Sistemi në Letnicë	m^3	11973
TOTALI	**m^3**	**1232738**

Tabela 70 Prodhimi i ujit sipas Raportit Vjetor per vitin 2023 te KRU Hidromorava

Prodhimi ujit për zonën e shërbimit të Vitisë	m^3/vit	m^3/muaj	m^3/ditë	l/s
Sipas **Raportit Vjetor per vitin 2023**	**1232738**	102728.2	3368.14	39.0

9.2.2. KËRKESA PËR UJË

Sipas **UA MMPH – Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor** (Kapitulli IV, Neni 14), janë përcaktuar kërkesat për ujë për banor në bazë të madhësisë së vendbanimit:

- Vendbanime ≥ 100,001 banorë: ≥ 300 l/banor/ditë;
- Vendbanime 20,001 – 100,000 banorë: 250–300 l/banor/ditë;
- Vendbanime 10,001 – 20,000 banorë: 200–250 l/banor/ditë;
- Vendbanime 5,001 – 10,001 banorë: 150–200 l/banor/ditë;
- Vendbanime ≤ 5,000 banorë: 100–150 l/banor/ditë.

Këto standarde përcaktojnë nevojat minimale për ujë për qëllime konsumuese, duke përfshirë ujë për pije dhe amvisëri, dhe ndihmojnë në planifikimin e kapaciteteve të sistemeve të furnizimit me ujë.

Kërkesa për ujë mund të përkufizohet si konsumi total i ujit të një zone për njësi të kohës. Në mënyrë tipike, ne e shprehim atë në termat e përdorimit të përditshëm ose të përdorimit mesatar të ujit për sekondë. Për ta llogaritur afërsisht kërkesën për ujë, ne mund të shumëzojmë kërkesën mesatare ditore të ujit për person me numrin e popullsisë që jeton në zonë ose ne rastin tonë për komunen e Vitisë.

9.2.2.1. KËRKESA MESATARE

Kërkesa mesatare është konsumi total i ujit nga një vendbanim në një vit pjesëtuar me numrin e ditëve në një vit. Ai jep një ide të përgjithshme të kërkesës për ujë për një komunitet, por nuk merr parasysh ndryshimet në kërkesën ditore ose sezonale. Kërkesa mesatare mund të vlerësohet nga popullsia dhe përdorimi i ujit për frymë të një komuniteti, ose nga të dhënat e matura të sistemeve të furnizimit me ujë.

Formula e përdorur për kërkesën mesatare për ujë:

Pt=P0*(1+r)^t

Ku:

P_t= Popullsia e parashikuar pas t- viteve

P_0= Popullsia aktuale (në vitin bazë)

r= Norma vjetore e rritjes së popullsisë (shprehur si përqindje/100)

t= Numri i viteve për të cilat parashikohet rritja

$$Q_{mes\ dit.} = Q_{l/banor} * P_t + (10\% \times P_t)$$

ku:

$Q_{mes\ ditore}$ - Kërkesa mesatare ditore për ujë;

$Q_{l/banor}$ - Sasia e ujit litër për banor në ditë

10% - Humbja e mundshme e ujit në sistemin e ujësjellësit

P_t - Madhësia e popullsisë

9.2.2.2. KËRKESA MAKSIMALE

Kërkesa maksimale është konsumi më i lartë i ujit nga një komunitet në një periudhë të caktuar, si një ditë, një muaj ose një vit. Ai pasqyron kërkesën maksimale për ujë që duhet të jetë në gjendje të përmbushë një sistem furnizimi me ujë. Kërkesa maksimale mund të llogaritet duke shumëzuar kërkesën mesatare me një faktor piku, i cili varet nga madhësia dhe karakteristikat e komunitetit, klima dhe modelet e përdorimit të ujit.

- Kërkesa maksimale ditore për ujë- Kapaciteti maksimal i ujit që duhet te jetë i disponueshëm në një ditë:
  $$K_{max.\ ditore} = 1.4 \times K_{mes.\ ditore}$$
- Kërkesa maksimale orare për ujë- Kapaciteti maksimal i ujit që duhet te jetë i disponueshëm në një sekondë:
  $$K_{max.\ orare} = 2.3 \times K_{max.\ ditore}$$

Tabela 71 Faktoret dhe vlerat tipike të kërkesës për ujë

Kushtet	Faktoret e kerkeses per uje	Vlera tipike
Mesatarja ditore ne maksimumin mujor	1.10- 1.50	1.20
Mesatarja ditore ne maksimumin javor	1.20- 1.60	1.40
Kerkesa maksimale ditore	1.50- 3.00	1.80
Kerkesa maksimale orare	2.00- 4.00	3.25
Kerkesa minimale orare	0.20- 0.60	0.30

Kërkesa maksimale ditore për ujë i referohet nivelit më të lartë të përdorimit të ujit gjatë një periudhe tipike 24-orëshe në një sistem të caktuar furnizimi me ujë. Zakonisht matet në litra në ditë dhe mund të ndryshojë në varësi të faktorëve të tillë si klima, dendësia e popullsisë dhe lloji i përdorimit të ujit në zonë. Për të vlerësuar kulmin e kërkesës ditore për ujë, mund të përdorni një "faktor të pikut" që përfaqëson raportin e kërkesës maksimale me mesataren ditore. Faktori i pikut mund të ndryshojë në varësi të sistemit specifik të furnizimit me ujë dhe faktorëve që ndikojnë në kërkesën për ujë, por zakonisht është midis 1.5 dhe 3.0.

Bazuar në të dhënat finale të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë gjatë dhjetorit 2024, Komuna e Vitisë numëron 35,566 banorë. Duke u bazuar në këtë numër dhe në parashikimin e rritjes së popullsisë për një periudhë 8-vjeçare, institucionet përgjegjëse, përkatësisht Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) Hidromorava në bashkëpunim me Komunën e Vitisë, janë të obliguara, sipas Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 08/2017, të sigurojnë një sasi ditore prej 265 litrash ujë për frymë.

Kjo përkthehet në një kërkesë totale mesatare prej 12,147,165.70 litrash ujë në ditë, ose afërsisht 232.40 litra për sekondë (l/s), si vëllimi maksimal i ujit që mund të nevojitet të shpërndahet brenda një sekonde.

Bazuar në Raportin Vjetor për vitin 2023, Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) Hidromorava ka një kapacitet furnizimi me ujë prej vetëm 49 l/s, një sasi që është larg nga përmbushja e kërkesave të qytetarëve.

Tabela 72 Kërkesa për ujë sipas projeksionit të popullsisë

Numri i popullsisise aktuale (b), sipas ASK-s	Projeksioni I (Pt) me rritje apo zvogelim te popullsis + 8 vite Pt=P0x(1+r)^t	Projeksioni I popullsise(b) + 10% humbja e mundeshme e ujit	Kerkesa per koke banori (l/d)	Kerkesa mesatare per uje (l/ditë)	Kof. per pikun e dite	Kerkesa max ditore(l/ditë)	Kof. per pikun e orës	Kerkesa max (l/s)
5,566	**41,671**	**45,838**	**265**	**12,147,165.7**	**1.40**	**17,006,032.0**	**2.30**	**232.40**

Tabela 73 Kërkesa për ujë sipas projeksionit të popullsisë dhe vendebanimeve

KOMUNA (Vendbanimet)	Nr. popullsisise aktuale (b), sipas ASK-s	Projeksioni I aprovuar (Pt) me rritje apo zvogelim te popullsis + 8 vite Pt=P0x(1+r)^t	Projeksioni I aprovuar i popullsise(b) + 10% humbja e mundeshme e ujit	Kerkesa per koke banori (l/b/d)	Kerkesa mesatare per uje (l/ditë)	Koficienti per pikun e dite	Kerkesa max ditore(l/ditë)	Koficienti per pikun e orës	Kerkesa per uje (l/s)
Ballancë	321	376	414	100	41,371.3	1.4	57,919.8	2.3	1.1
Beguncë	1,528	1,790	1,969	200	393,865.0	1.4	551,411.0	2.3	10.5
Binçë	800	937	1,031	100	103,106.0	1.4	144,348.4	2.3	2.7
Budrikë e Epërme	581	681	749	100	74,880.8	1.4	104,833.1	2.3	2.0
Buzovik	322	377	415	100	41,500.2	1.4	58,100.2	2.3	1.1
Çifllak	83	97	107	100	10,697.3	1.4	14,976.2	2.3	0.3
Debelldeh	53	62	68	100	6,830.8	1.4	9,563.1	2.3	0.2
Devajë	191	224	246	100	24,616.6	1.4	34,463.2	2.3	0.7
Drobesh	1,716	2,011	2,212	200	442,324.8	1.4	619,254.8	2.3	11.8
Gërmovë	665	779	857	100	85,706.9	1.4	119,989.6	2.3	2.3
Goden i Madh	0	-	-	-	-	1.4	-	2.3	-
Gushicë	741	868	955	100	95,502.0	1.4	133,702.7	2.3	2.5

Gjylekar	1,509	1,768	1,945	200	388,967.5	1.4	544,554.5	2.3	10.4
Kabash	1,783	2,089	2,298	200	459,595.1	1.4	643,433.2	2.3	12.2
Letnicë	168	197	217	100	21,652.3	1.4	30,313.2	2.3	0.6
Lubishtë	1,056	1,237	1,361	150	204,149.9	1.4	285,809.9	2.3	5.4
Mjak	0	-	-	-	-	1.4	-	2.3	-
Novosellë	473	554	610	100	60,961.4	1.4	85,346.0	2.3	1.6
Podgorc	276	323	356	100	35,571.6	1.4	49,800.2	2.3	0.9
Pozharan	3,323	3,893	4,283	220	942,208.6	1.4	1,319,092.1	2.3	25.1
Radivojc	933	1,093	1,202	100	120,247.4	1.4	168,346.4	2.3	3.2
Ramjan	652	764	840	100	84,031.4	1.4	117,644.0	2.3	2.2
Ramnishtë	351	411	452	100	45,237.8	1.4	63,332.9	2.3	1.2
Remnik	990	1,160	1,276	100	127,593.7	1.4	178,631.2	2.3	3.4
Sadovinë e Çerkezve	987	1,156	1,272	100	127,207.1	1.4	178,089.9	2.3	3.4
Sadovinë e Jerlive	872	1,022	1,124	100	112,385.6	1.4	157,339.8	2.3	3.0
Sllatinë e Epërme	1,849	2,166	2,383	200	476,607.6	1.4	667,250.6	2.3	12.7
Sllatinë e Poshtme	801	938	1,032	100	103,234.9	1.4	144,528.9	2.3	2.7
Smirë	2,344	2,746	3,021	200	604,201.3	1.4	845,881.8	2.3	16.1
Stubëll e Epërme	448	525	577	100	57,739.4	1.4	80,835.1	2.3	1.5
Stubëll e Poshtme	36	42	46	100	4,639.8	1.4	6,495.7	2.3	0.1
Shashare	42	49	54	100	5,413.1	1.4	7,578.3	2.3	0.1
Tërpezë	1,298	1,521	1,673	200	334,579.1	1.4	468,410.7	2.3	8.9
Tërstenik	604	708	778	100	77,845.0	1.4	108,983.1	2.3	2.1
Vërban	1,549	1,815	1,996	200	399,278.1	1.4	558,989.3	2.3	10.6
Vërnakollë	2	2	3	100	257.8	1.4	360.9	2.3	0.0
Vërnez	1	1	1	100	128.9	1.4	180.4	2.3	0.0
Viti	5,780	6,772	7,449	250	1,862,352.6	1.4	2,607,293.6	2.3	49.6
Zhiti	438	513	565	100	56,450.5	1.4	79,030.8	2.3	1.5

Bazuar në Raportin Vjetor për vitin 2023, njësia operative në Viti ka nivelin më të lartë të humbjeve të ujit në rrjet, krahasuar me njësitë operative në Gjilan dhe Kamenicë. Shkalla e humbjeve arrin në 67.9%, një përqindje jashtëzakonisht e lartë dhe shqetësuese, sidomos në krahasim me objektivat që KRU Hidromorava dhe Komuna e Vitisë duhet të përmbushin për menaxhimin e qëndrueshëm të furnizimit me ujë.

Kjo përqindje e lartë përfshin si humbjet fizike, që ndodhin për shkak të dëmtimeve ose rrjedhjeve në rrjetin e furnizimit, ashtu edhe humbjet administrative, të cilat lidhen me problemet e matjes dhe faturimit të ujit të shpenzuar. Për të adresuar këtë situatë, është e domosdoshme që KRU Hidromorava dhe Komuna e Vitisë të zhvillojnë një strategji të mirëkoordinuar dhe të fokusuar në reduktimin e humbjeve.

Disa masa që mund të ndërmerren për të zvogëluar humbjet përfshijnë:

1. **Përmirësimi i infrastrukturës**:
   Zëvendësimi i tubacioneve të vjetra dhe riparimi i rrjedhjeve ekzistuese në rrjet për të reduktuar humbjet fizike.
2. **Implementimi i teknologjive të avancuara**:
   Përdorimi i sistemeve të monitorimit dhe detektimit të rrjedhjeve për të identifikuar problemet në kohë reale.
3. **Matja e saktë dhe kontrolli i konsumit**:
   Instalimi i matësve të rinj dhe mirëmbajtja e rregullt e atyre ekzistues për të minimizuar gabimet administrative.
4. **Edukim dhe ndërgjegjësim publik**:
   Fushata për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi rëndësinë e menaxhimit të ujit dhe raportimin e shpejtë të rrjedhjeve apo problemeve në rrjet.
5. **Hartimi i zonave të menaxhimit të veçantë**:
   Krijimi i zonave specifike për monitorimin dhe analizimin e humbjeve për të përcaktuar me saktësi vendndodhjen e problemeve më të mëdha.

Qasja ndaj këtij problemi kërkon një angazhim serioz dhe bashkëpunim të ngushtë midis institucioneve përgjegjëse dhe komunitetit. Vetëm përmes një strategjie të integruar dhe veprimeve konkrete mund të arrihet ulja e nivelit të humbjeve dhe përmirësimi i efikasitetit të furnizimit me ujë për qytetarët e Vitisë.

9.2.3. ZGJERIMI I KAPACITETEVE TË FURNIZIMIT ME UJË PËR KOMUNËN E VITISË

Realizimi i investimeve të mëdha në infrastrukturën e ujësjellësit është i domosdoshëm për rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, duke garantuar një furnizim të qëndrueshëm dhe efikas me ujë për banorët e Komunës së Vitisë. Për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ujit për Komunën e Vitisë, janë parashikuar këto projekte:

ZGJERIMI I KAPACITETEVE TË REZERVUARËVE TË UJIT NË KOMUNËN E VITISË

Aktualisht situata e kapaciteteve te rezervuarve te ujit ne komunen e Vitisë qendron si ne vijim:

Nr.	Emri i rezervuarit	Koordinatat (X, Y, Z)	Vëllimi i rezervuarit (m^3)	Lloji i Rezervuarit
1	Rezervuari Letnicë	7536912.079; 4685324.040; 584.00	360	Rez. Nëntokësor
2	Rezervuari Letnicë		560	Rez. Mbitokësor
3	Rezevuari Pozheran	7527978.952; 4694263.768, 489.00	1000	Rez. Mbitokësor
Total V:			**1920**	

Llogaritja e Vëllimit Operativ ($V_{Operativ}$)

Për të llogaritur vëllimin e nevojshëm të rezervuarit për Komunën e Vitisë me **35,566 banorë**, do të përdorim metodologjin, duke marrë parasysh tre komponentët kryesorë të vëllimit të rezervuarit:

Llogaritja e Vëllimit Operativ ($V_{Operativ}$)

Q_{Ditor}=35,566×150=5,335,000 litra ose 5,335 m^3

Llogaritja e Vëllimit të Rezervës për Emergjenca ($V_{Emergjencë}$)

Zakonisht, rezerva emergjente është **30% e konsumit ditor**:

Vemergjence=0.3×Qditor=1,600 m^3

Llogaritja e Vëllimit të Rezervës për Zjarrfikje (V_{Zjarr})

Për mbrojtjen nga zjarri, llogarisim një furnizim **për 2 orë** me një rrjedhë prej **30 l/s**:

$V_{Zjarr}=30\times3600\times2=216{,}000$ litra$=216$ m^3

Llogaritja e Vëllimit Total të Rezervuarit

$V_{Total}=V_{Operativ}+V_{Emergjence}+V_{Zjarr}$

Për Komunën e Vitisë me **35,566 banorë**, rekomandohet që rezervuari i ujit të ketë një kapacitet prej:

- **Afërsisht 7,200 m³** nëse furnizimi me ujë bëhet për **24 orë**.

Zgjerimi i kapaciteteve prodhuese të ujit në Fabrikën e Ujit në Letnicë

Në Komunën e Vitisë është një projekt i planifikuar prej kohësh, i cili është konkretizuar së fundmi në kuadër të programit FLOWS të Bankës Botërore. Ky projekt është finalizuar si projekt i detajuar dhe pritet të fillojë zbatimi në kuadër të investimeve të planifikuara nga ky program.

Projekti parasheh zgjerimin e kapaciteteve të fabrikës së përpunimit të ujit në Letnicë, duke krijuar hapësira shtesë për trajtimin e ujit. Ky zgjerim do të mundësojë rritjen e kapacitetit të trajtimit të ujit nga 40 l/s, sa është aktualisht, në 100 l/s.

Megjithatë, duke marrë parasysh kërkesën në rritje për ujë në të ardhmen, jo vetëm për qytetin, por edhe për fshatrat përreth, si dhe për të përmbushur kërkesat afatgjata të furnizimit me ujë për Komunën e Vitisë, është e domosdoshme të shqyrtohen edhe alternativa të tjera përveç burimit ekzistues në Letnicë. Dy alternativa me karakter rajonal janë propozuar, të cilat do të ofronin një zgjidhje afatgjatë për problemin e furnizimit me ujë.

Ndërtimi i një akumulacioni në Shushtë, Komuna e Vitisë.

Lokacioni me potencial të lartë për shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore është Lumi Morava e Binçës, veçanërisht në rrjedhën e saj të sipërme, në zonën e njohur si Shushtë-Binçë, e cila ndodhet në komunën e Vitisë. Ky lumë ofron një burim të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm të ujit gjatë gjithë vitit, duke pasur një rrjedhje dhe prurje të madhe e konstante.



Për shkak të këtyre karakteristikave hidrologjike, Lumi Morava e Binçës paraqet një zgjidhje ideale dhe afatgjatë për furnizimin me ujë. Ai mund të plotësojë jo vetëm nevojat për ujë të komunës së Vitisë, por edhe të komunave përreth, si Gjilani, Kllokoti, Parteshi dhe Ranillugu.

Përdorimi i këtij burimi sipërfaqësor do të kërkonte ndërtimin e infrastrukturës përkatëse, përfshirë impiante moderne për trajtimin e ujit, rezervuarë dhe rrjetin e nevojshëm të shpërndarjes. Një qasje e tillë do të siguronte një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë, duke përmbushur kërkesat në rritje për ujë të pijshëm dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të rajonit.

Furnizimi me ujë nga lumi Lepenc përmes ndërtimit të akumulacionit të Firajës në Shtërpcë.

Së fundmi, Banka BERZH ka prezantuar një alternativë të re për furnizimin me ujë të qytetit të Vitisë dhe Gjilanit, që përfshin ndërtimin e një pende në Firajë, komuna e Shtërpcës, si pjesë e projektit Ibër-Lepenc. Ky propozim ka dalë nga studimi i fizibilitetit të këtij projekti dhe përfshin instalimin e një tubacioni me diametër DN 800 mm, që do të furnizojë qytetin e Vitisë dhe do të arrijë deri në hyrje të Gjilanit, me kapacitet 430 l/s.



Skema e propozuar siguron furnizim të qëndrueshëm përmes gravitetit nga Rezervuari i Gaçkës, duke mundësuar një shpërndarje efikase të ujit. Tubacionet kryesore do të shërbejnë për furnizimin e qyteteve Vitia dhe Gjilani, duke përmbushur nevojat në rritje të këtyre zonave dhe të komunave përreth.

Kjo zgjidhje rajonale përfshin gjithashtu lidhjen e FTU-ve ekzistuese dhe krijimin e një rrjeti të integruar furnizimi, duke siguruar sasi të mjaftueshme të ujit për nevojat urbane dhe rurale të këtyre dy komunave.

9.2.4. KUSHTET E TJERA TEKNIKE

UJI I PALLOGARITUR

Kjo i referohet ujit të humbur ose të pa matur në një sistem furnizimi me ujë. Mund të përfshijë ujin e humbur për shkak të rrjedhjeve në sistem apo edhe përdorimit të paautorizuar. Përqindja e ujit të pallogaritur mund të ndryshojë në varësi të sistemit specifik të furnizimit me ujë dhe vendndodhjes. Megjithatë, ndërmarrjet e ujësjellësit synojnë qe ne raste ideale të mbajnë ujin e pallogaritur nën 25% ose edhe më të ulët. Megjithatë, përqindja mund të jetë shumë më e lartë në disa zona me infrastrukturë të vjetëruar ose nivele të larta të humbjes së ujit. Më tej, mirëmbajtja e rregullt e infrastrukturës së furnizimit me ujë, instalimi i matësve të ujit për të matur përdorimin e ujit dhe miratimi i teknologjive të zbulimit të rrjedhjeve për të identifikuar dhe riparuar rrjedhjet në sistem janë masat e marra për të reduktuar ujin e pallogaritur.

KËRKESA MAKSIMALE DITORE PËR UJË

Faktorët tipikë të kërkesës për ujë:

Tabela 74 Kushtet për kërkesen max. për ujë

Kushtet	Faktorët e kerkesës për ujë	Vlera tipike
Mesatarja ditore në maksimumin mujor	1.10- 1.50	1.20
Mesatarja ditore në maksimumin javor	1.20- 1.60	1.40
Kerkesa maksimale ditore	1.50- 3.00	1.80
Kerkesa maksimale orare	2.00- 4.00	3.25
Kerkesa minimale orare	0.20- 0.60	0.30

Lejet për zhvillime të projekteve të energjisë së rinovueshme që mund të kenë efekt negativ në ruajtjen e trashëgimisë përfshirë këtu Zona të Veçanta të Mbrojtjes, Trashëgimi Natyrore, Kulturore, etj., u jepen vetëm pas një vlerësimi që përshkruan se integriteti i objektit apo vendit nuk ndikohet negativisht.

- Paneli diellor FV nuk duhet të jetë i dukshëm nga rruga nëse ndodhet brenda një zone të konservuar ose një zone të trashëgimisë.
- **Çmontimi dhe asgjësimi i sistemit solar**

Në përshkrimin e kërkesave për vendin e çmontimit, në mënyrë specifike të kërkohet heqja e infrastrukturës, asgjësimi i çdo komponenti dhe ri-vegjetimi i zonës. Është shumë me rëndësi rikthimi i zonës në gjendjen që ka qenë para se të instalohet sistemi solar.

9.6. RRJETI I SHPËRNDARJES LOKALE ME ENERGJI ELEKTRIKE

Duke marr për bazë Planin Zhvillimor Komunal të Vitisë dhe gjendjen ekzistuese të rrjetit energjetik dhe të telekomit është bërë analizë e plotë dhe janë nxjerrë përfundimet për nevojat në intervenim në rrjetin ekzistues si dhe shtimi i kapaciteteve të reja në Komunën e Vitisë.

Bazuar edhe nga planet zhvillimore të kompanive të lëmisë, rekomandimet kyçe nga fusha e energjisë elektrike janë:

- Kalimi nga rrjeti distributiv 10 kV në rrjetin 20 kV
- Zëvendësimi i TS 10/0,4 kV me TS 20/0,4 kV
- Zëvendësimi i linjave ajrore 230/400 V, në linja kabllore me bistek ose kabllo nëntokësore
- Zbatimi i rregulloreve IEC, IEEE dhe ANSI në projektet e reja
- Realizimi paralel i rrjetit të energjisë elektrike bashkë me rrjetin e telekomunikimit

9.6.1. SHTRIRJA E RRJETIT ENERGJETIK DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE

Ndërtesat me rëndësi të veçantë për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë në Republikën e Kosovës janë largpërçuesit dhe nënstacionet. Në territorin e Komunës së Vitisë kalojnë linjat e tensionit si në vijim:

- LP400kV nr L403 Ferizaji 2 – Shkupi 5 (në zonën malore të fshtatit Verban)
- LP110kV nr L141 Gjilani 5 – Vitia
- LP110kV nr L142 Vitia – Sharri (këto dy linja shërbejnë si furnizim për NS Vitia)
- LP110kV nr L153 Ferizaji 2 – Gjilani 5 (kjo linjë kalon nëpër territorin e Komunës së Vitisë në gjatësi 8.58 km)

Nënstacionet me rëndësi në Komunën e Vitisë janë:

- NS Vitia 110/35 kV
- NS Rrafshina 35/10(20) kV

Korridoret e linjave dhe hapësirat e nënstacioneve sipas këtij dokumenti do të merren në konsideratë duke pasur parasysh:

- Plotësimin e kritereve tekniko-teknologjike
- Parandalimin e ndikimeve negative në mjedis

Vlen të theksohet se në masë të madhe linja 110 kV kalon nëpër periferinë e vendbanimeve dhe vetëm në segmente të caktuara ka ndërtime dhe lëvizje të qytetarëve, e njejta gjë mund të thuhet për linjën 35 kV Rrafshinë – Kllokot - Lladovë

9.6.2. KAPACITETET EKZISTUESE

Furnizimi me energji elektrike në Komunën e Vitisë aktualisht bëhet nga nënstacioni 110/35 (kV) Vitia me fuqi të instaluar 20 MVA dhe 31.50 MVA, prej nga furnizohen në rrjetin 35 kV dy transformator 35/10 kV me fuqi nga 8 MVA në NS 35/10 Vitia dhe dy transformator me nga 8 MVA në Kllokot ku një pjesë e daljeve në këtë nënstacion furnziojnë fshatrat e Komunës së Vitisë.

Në tabelë janë paraqitur linjat ajrore 35 kV, gjatësia e tyre, trafostacionet dhe daljet 10 kV nga këto nënstacione.

Tabela 80 Linjat ajrore 35 kV

Linjat 35 kV			
Linja Rrafshinë – Kllokot Linja Kllokot - Lladovë			4.93 km 11.50 km
Nënstacionet 35/10 kV			
NS Vitia 35/10 kV T1+T2 (8+8)MVA			
Rrjeti 10(20) kV – Linjat ajrore dhe kabllore			
Stublla	Gërmova	Vitia	6 dalje 10 kV, me linja ajrore dhe kabllore, fuqia e instaluar 37.84 MVA
Smira	Binça	Begunca	
Rrjeti 10(20) kV nga Kllokoti			
Sllatina	Stacionari	Industriali	8 dalje 10 kV, me linja ajrore dhe kabllore, fuqia e instaluar 42.24 MVA
Tërpeza	Jeta	Pozherani	
VINEX-i	Kllokoti		

9.6.3. RRITJA E KAPACITETEVE ENERGJETIKE NË NIVELIN 110 KV DHE 35 kV NË KOMUNËN E VITISË

Pajisjet energjetike në rrjetin transmetues në Komunën e Vitisë kanë kapacitet të mjaftueshëm transmetues, por një pjesë e tyre është e vjetërsuar siç është rasti i transformatorit 110/35 kV me fuqi 20 MVA, i cili është nga viti 1964 dhe i njejti do të ndërrohet duke u zëvendësuar me një transformator 110/35/10 kV me kapacitet 40 MVA, i cili do të ndikojë edhe në rrjetin 35 kV, ku aktualisht transfomatorët 35/10 kV në pronësi të KEDS-it janë të tejngarkuar, bazuar në raportet nga operatorit të shpërndarjes, transformatorët 35/10 kV janë të ngarkuar në vlerën 98.5% të kapacitetit nominal. Me vendosjen e transformatorit 110/35/10 kV do të rritet kapaciteti transformues dhe NS 35/10 kV Vitia të shërbejë në funksion të plotësimit të kriterit N-1, ku në rast të mospunës së transformatorit 110/35/10 kV, qytetarët të furnizohen me tension përmes rrjetit 35 kV. Ky projekt që ka ndikim në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike dhe rritjen e parametrave të cilësisë së energjisë, në këtë fazë nuk ka implikime hapësinore pasiqë do të vendoset në vend të transformatorit ekzistues 110/35 kV, 20 MVA.

9.6.4. NGRITJA E KAPACITETEVE TRANSFORMUESE NË RRJETIN 10(20) kV

Aktualisht, rrjeti i tensionit 10 kV përballet me vështirësi të operimit, kjo vije kryesisht për shkak të rrjetit të vjetërsuar i cili nuk është zhvilluar paralelisht me cilësinë e jetës së qytetarëve, e cila ka ndikuar në rritjen e konsumit të energjisë. Kështu, një pjesë e transformatorëve 10/0.4 kV janë të mbingarkuar, linjat e tensionit 10kV janë me përçues Al/Çe 35-50 mm^2, kjo ndikon në rënie të tensionit dhe cilësi të ulët të furnizimit me energji elektrike, ndërprerje të shpeshta dhe humbje të mëdha në nivelin e shpërndarjes së energjisë.

Edhe me planet zhvillimore, operatori i shpërndarjes ka planifikuar rritjen e kapaciteteve transformuese në rrjetin 10 kV, njëkohësisht përmes këtyre investimeve rrjeti energjetik bëhet gati për të kaluar në nivelin 20 kV të operimit. Në tabelën e paraqitur janë dhënë kapacitetet aktuale të instaluara energjetike në Komunën e Vitisë. Për shkak të ndërlidhjes territoriale dhe energjetike në tabelë të dhënat përfshijnë edhe Komunën e Kllokotit.

Nënstacioni	Nënstacioni	Dalja	1600	1250	1000	630	400	315	250	160	100	50	30	Transformator për dalje	Fuqia e instaluar në dalje (MVA)
110/35 kV	35/10 kV	10k V	kVA												
Vitia	Vitia 35/10 kV	Stublla				5	1		5	6	7	1	1	26	6.54
		Gërmova		1	1	1	6		12	9	6	3		39	10.47
		Smira					7		3	6	1	1		18	4.66
		Binça			2	2	2		3					9	4.81
		Begunca					2		4	4	3			13	2.74
		Vitia			3	5	4		2	2		1		17	8.62
	Kllokoti 35/10 kV	Sllatina				1	3		12	6	4	2		28	6.29
		Stacionari	1		2	4	1		1			1		10	6.82
		Industriali				2	2		6	8	10	9		37	6.29
		Tërpeza				1	1		6	6	7	3		24	4.34
		Jeta				1								1	0.63
		Pozherani			1	1	3		10	7	5	5		32	7.20
		VINEX-i				3				1				4	2.05
		Skifteraj			2	2	3	1	9	5	8			30	8.625
	Totali i transformatorëve		1	1	11	28	35	1	73	60	51	26	1	288	80.085

Përmes daljeve 10 kV të sipërshënuara ose të reja do të rriten kapacitetet transformuese në rrjetin distributiv të Komunës së Vitisë, rritja e kapaciteteve bëhet për disa arsye, ndër to rritja e numrit të ekonomive familjare, zhvillimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike, rritja e cilësisë së jetesës, një element që ka ndikim negativ në rritjen e kërkesës për energji është edhe shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje, një element për të cilin, komunat duhet të krijojnë mekanizma që t'a reduktojnë dhe për ngrohje me energji elektrike të përdoren vetëm kondicioneret inverterë.

Duke marrë për bazë gjendjen ekzistuese, numrin e banorëve, rritjen vjetore të konsumit të energjisë për 1.5(%), në tabelën e mëposhtme do të shohim se në cilat drejtime është e nevojshme të bëhet zgjerimi i rrjetit 10(20) kV. Meqenëse faktor të ndryshëm si migrimi, përcaktimi i zonave ekonomike, skenarët e ndryshëm mbi natalitetin ndikojnë drejtpërdrejt në rezultatet e gjendjes në rrjetin distributiv, duke u bazuar në gjendjen ekzistuese të sektorit të amvisërisë është paraqitur gjendja aktuale e rrjetit dhe nevojat për planifikim në varësi të numrit të popullsisë.

Nr.	Vendbanimi	Nr.i banorëve (2020)	10/0.4 kV (numri – fuqia e instaluar)		Nr.i banorëve (2030)	Kërkesa për energji në viti 2030	Dallimi (+/-)
1	Viti	5,019	11	7,200	5,317	3,669.00	3,531.00
2	Çifllak	92	1	100	98	67.62	32.38
3	Debëlldeh	346	2	200	367	254.30	-54.30
4	Devaj	298	1	160	316	219.00	-59.00
5	Goden	82	1	100	87	60.30	39.70
6	Letnicë	272	2	320	288	188.50	131.50
7	Mjak	0	0	0	0	0	0
8	Ramishtë	446	3	570	473	327.80	242.20
9	Podgorc	386	2	260	409	283.40	-23.40
10	Stubëll e Poshtme	78	1	100	83	57.50	42.50
11	Shashare	149	1	100	158	103.30	-3.30
12	Vërnakollë	12	1	100	14	9.70	90.30
13	Vërnez	1	0	0	2	1.50	-1.50
14	Ballancë	643	2	410	681	471.90	-61.90
15	Budrikë	915	3	810	969	671.50	138.5
16	Buzovik	531	2	210	563	390.20	-180.20
17	Gërmovë	903	3	810	957	625.80	184.20
18	Gushicë	817	2	410	866	600.10	-190.10
19	Novosellë	557	3	510	590	408.90	101.10
20	Ramjan	912	4	820	966	670.00	150.00
21	Tërstenik	784	3	510	831	575.90	-65.90
22	Zhiti	615	3	460	652	451.80	8.20
23	Binçë	1,149	3	420	1,219	844.70	-424.70
24	Drobesh	1,880	4	1,060	1,992	1,380.50	-320.50
25	Lubishtë	1,473	2	410	1,561	1,081.80	-671.80
26	Radivojcë	1,269	3	1,590	1,344	931.40	658.60
27	Remnik	1,880	6	1,235	1,992	1,302.80	-67.80
28	Sadovinë e Çerkezve	1,286	3	720	1,352	937.00	-217.00
29	Sadovinë e Jerlive	1,122	3	900	1,189	824.00	76.00
30	Sllatinë e Poshtme	1,200	4	760	1,271	880.80	-120.80
31	Stubëll e Epërme	1,150	6	1,170	1,219	844.80	325.20
32	Tërpezë	1,853	4	1,220	1,963	1,360.40	-140.40
33	Beguncë	2,174	5	1,160	2,303	1,596.00	-436.00
34	Gjylekar	2,547	4	1,160	2,698	1,869.00	-709.00
35	Kabash	2,369	4	1,300	2,510	1,739.50	-439.50
36	Pozheran	4,329	11	3,390	4,586	3,178.10	211.90
37	Sllatinë e Epërme	2,362	5	1,310	2,502	1,733.90	-423.90

38	Smirë	3,947	6	1,320	4,181	2,897.50	-1,577.50
39	Vërban	2,047	5	1,010	2,169	1,503.10	-493.10

Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike gjatë hartimit të projekteve përfundimtare do të bëjë përcaktimin e saktë të kapaciteteve të aseteve që do t'i montojë, ndërsa tabela e mësipërme shërben si bazë orientuese për nevojën mbi zgjerimin e kapaciteteve të rrjetit. Në nivelin e tensionit 10(20) kV për të mbuluar kërkesat për furnizim me energji elektrike duhet të rriten kapacitetet transformuese. Në zona të caktuara duhet të zëvendësohen përçuesit ekzistues me përçues me seksion më të madh në mënyrë që rrjeti të përballojë rritjen e ngarkesës, një pjesë e daljeve të cilat janë të mbingarkuara duhet të kryqëzohen apo të lidhen në unazë me daljet e tjera, pak të ngarkuara duke mundësuar kështu furnizimin e dyanshëm dhe rritjen e cilësisë së energjisë me të cilën furnizohet konsumatori fundor.

9.6.5. RRJETI AJROR DHE KABLLOR 10(20) KV

Rritja e kapaciteteve transformuese në nënstacionin 110/35/10 kV Vitia do të krijojë mundësinë për krijimin e daljeve të reja dhe në ato dalje ku ngarkesa është më e madhe të bëhet shpërndarja e ngarkesës, kjo do të bëhet në bazë të analizave dhe raporteve të Operatorit të Shpërndarjes (KEDS) me qëllim që të vije te balancimi i ngarkesës në dalje dhe reduktimi i humbjeve në linja, si dhe zvogëlimi i rënieve të tensionit te konsumatori fundor, por pjesa më e madhe e rrjetit me nënstacionet e reja të planifikuara do të realizohet duke u kyqur në gjatësinë e rrjetit ekzistues.

Në zonat pranë linjave ajrore kjo kyqje do të bëhet përmes kabllove të shtrira përmes gypave plastikë ku nga linja ajrore bëhet kalimi në kabllo dhe furnizimi i transformatorëve, duke krijuar kështu një lidhje radiale të kyqjes së re.

Në zonat urbane kyqja bëhet asisoj që përmes linjave kabllore, ku përzgjedhet kabllo adekuate, në veçanti në zonat ku parashihet të vazhdojë ndërtimi i kapaciteteve të reja, përzgjedhet kabllo për përballim të rrymave të mëdha si psh kabllo 3xXHE 48A 240 mm^2, e cila vendoset në kanale adekuate. Transformatorët vendosen në të ashtuquajturat trafo blindë, e cila duhet të ndërtohet sipas standardeve dhe të përmbajë kthina hyrëse, dalëse dhe kthinat e transformatorëve (nëse janë më shumë se një).

Kriter bazik në ndërtimin e rrjetit të ri është që të gjitha pajisjet duhet të përballojnë tensionin 20 kV në mënyrë që rrjeti të jetë i gatshëm të përballojë kalimin e planifikuar në operim me këtë nivel të tensionit.

Në tabelën e mëposhtme është përshkruar gjendja e tanishme dhe planet investive në rrjetin transmetues dhe distributiv.

Tabela 81 Projektet e planifikuara

Niveli i tensionit	Gjendja ekzistuese	Gjendja e planifikuar	Komente
110/35 kV	Transformatori T2 110/35 kV, 20 MVA i stërvjetruar	Ndërrimi i transformatorit T2 me transformator trepështjellor 110/35/10 kV	Parashihet qe projekti të realizohet në vitin 2029
35/10 kV	Dy transformatorë 35/10, 8 MVA, të mbingarkuar	Ndërrimi i transformatorit T4 35/10 kV	Rrjeti 35 kV, shërben si rezervë për furnizim me tension në rast të ndalesave në transformatorin 110/35/10 kV të KOSTT-it. Parashihet qe projekti të realizohet në vitin 2026
10 kV	Rrjeti 10 kV në daljen e Vitisë në zona të caktuara ka nevojë për intervenime	Investime në rrjetin 10 kV në daljet Smira, Begunca dhe Germova në fazën e parë, si dhe në daljet Vitia dhe Sllatina – faza e dytë	Brenda afatit të planit zhvillimor 2024-2033

9.6.6. SHIRITAT MBROJTËS RRETH STABILIMENTEVE ENERGJETIKE

Shfrytëzimi i shiritave mbrojtës rregullohet me standarde teknike, poashtu edhe me ligje përkatëse duke krijuar të ashtuquajturat zona të sigurisë të cilat nuk duhet të cenohen nga ndërtimet në mënyrë që të mundësohet ndërtimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e aseteve energjetike në vazhdimësi.

Për linjat energjetike kabllovike nëntokësore duhet të sigurohen korridoret si në vijim:

Nr	Linja kabllovikenëntokësore	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110kV	6	12
2	110kV	5	10
3	35kV	3	5
4	20kV	2	5
5	10kV	2	5

Kur largpërçuesi ndërtohet si linjë ajrore është e nevojshme të sigurohet korridori si në tabelën e mëposhtme.

Nr	Linja ajrore energjetike	Ekzistuese	Planifikuara
1	2x110kV	50	60
2	110kV	40	50
3	35kV	30	30
4	20kV	20	20
5	10kV	15	15

9.6.7. KUSHTET TEKNIKE DHE KËRKESAT TJERA

Autoriteteve komunale u takon që t'i koordinojnë aktivitetet që ndërlidhen me realizimin e projekteve dhe në varësi të planeve dhe interesave të gjithmbarshme të ofrohen zgjidhjet më të mira si në aspektin infrastrukturor ashtu edhe në atë të shfrytëzimis sa më efikas të hapësirave.

Si rrjedhojë bashkëpunimi do të ndikoj në:

- Realizim konkret të planeve;
- Shfrytëzim racional të hapësirave;
- Menaxhim më të lehtë të punëve;
- Qasje më të lehtë;
- Zvogëlimin e kostove të implementimit etj.

9.6.8. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Kushtet e mëposhtme janë bazë për ndërtimin e objekteve elektroenergjetike që duhet të respektohen me rastin e ndërtimit, rindërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës energjetike.

Para së gjithash e tërë infrastruktura energjetike e cila do të ndërtohet duhet që pa përjashtim t'i plotësojë parimet themelore si në vijim:

- Rrjeti, objektet dhe nënstacionet elektroenergjetike në tersi duhet te ndërtohen ne pajtim me normat dhe standardet teknike aktuale.
- Asnjë nga objektet energjetike ekzistuese apo të reja të mos jetë në grupin e objekteve që shkaktojnë ndotjen dhe ndikime aktive në ambient.
- Dizajnimi i stabilimenteve të reja duhet të përfshijë edhe forma të përshtatshme arkitektonike, dhe estetike ashtu që të përshtaten në ambient dhe të mos shkaktojnë efekte negative si (rrezatim elektromagnetik, zhurmë, ngrohje, zjarre, dridhje, etj).

- Të gjitha pjesët metalike konstruktive të këtyre stabilimenteve të vendosura brenda objekteve dhe jashtë tyre në hapësira publike dhe tjera duhet të përtokëzohen, që të mos paraqesin rrezik për njerëzit, shtazët, pronën dhe të tjera, nëse këta të fundit jetojnë gjithnjë ose herë pas here në afërsi të këtyre stabilimenteve.
- Ne rastet e ndërtimit te infrastrukturës energjetike duhet te zbatohen normat teknike dhe te ruhen distancat ndërmjet këtyre pajisjeve dhe infrastrukturës tjetër si rruge, ujësjellës , kanalizime , ura , kabllo telekomunikimi, ngrohje , gaz etj.
- Aplikimi i kabllove nëntokësore të linjave në nivelet 110; 20; 10; 0.4 kV do ta rrisë disa herë sigurinë e furnizimit, eliminon rrezikun e kontaktit me këtë tension dhe ndikimet vizuale në ambient, si dhe zvogëlimin e ndikimit të rrezatimit FEM (fushës elektromagnetike në ambient).
- Qe pajisjet ekzistuese dhe ato te reja te garantojnë furnizim te rregullt dhe kualitativ te kenë kapacitete te mjaftueshme për te furnizuar te gjithë konsumatorët pa kufizime.
- Vendosja e rrjetit të ri te infrastrukturës energjetike në trasetë e reja duhet të jetë aktivitet i koordinuar dhe në pajtim me planet e ndryshme komunale, gjithashtu në trasetë (korridoret) ekzistuese aktuale duhet të bëhet në pajtim me gjendjen e tanishme në varshmëri të kushteve aktuale dhe normave të tanishme dhe në bashkëpunim me organet kompetente komunale.
- Rikonstruktimi i rrjetit ekzistues duhet të bëhet në pajtim me kushtet e reja të shfrytëzimit të hapësirës dhe në bashkëpunim me organet kompetente komunale, duke siguruar zgjidhje bashkëkohore dhe funksionalitet të plot të pajisjeve.
- Zhvillimi i rrjetit dhe objekteve elektroenergjetike duhet të realizohet në pajtim me kushtet e përgjithshme të planeve komunale dhe planeve për shfrytëzimin e hapësirës. Dhe duke pasur parasysh ndikimet e tyre reciproke, duke zbatuar norma dhe rregullore sipas standardeve për infrastrukturën përkatëse dhe rregullim të hapësirës dhe ndërtimit.
- Secili objekt ndërtimor i destinuar për banim apo për shërbime të përgjithshme, duhet të kenë të siguruar qasje për furnizim me energji elektrike nga rrjeti publik energjetik dhe kyçje individuale në secilin rast pa përjashtim.
- Rreth objekteve energjetike të sigurohet një shirit me gjerësitë paktën 5 m për qasje me makina, për arsye të montimit, mirëmbajtjes dhe qasjes për shërbimet e zjarrfikës, autoambulancës, si dhe rrugët për kalim te këmbësorëve dhe mjeteve.

- **Nënstacionet 110/kV**
  - Për ndërtimin e nënstacionit të këtij lloji duhet të sigurohet një parcele me dimensione minimale, përafërsisht 100 x 60 m, dhe rreth se cilës duhet të sigurohet shiriti mbrojtës rreth e për qark, në mënyrë që të sigurohet qasje e pa penguar për transport dhe emergjenca eventuale. Përmasat definitive të parcelës duke përfshirë edhe shiritin mbrojtës rrethues, dhe do të përcaktohet nga kërkesat e ndërmarrjes përkatëse energjetike, llojit të stabilimenteve, kërkesave për shfrytëzim, ne koordinim me organet komunale përkatëse.
  - Kyçja e linjave 110 kV ne nënstacionin përkatës, duhet te jetë minimalisht e dyanshme, kjo për arsye te sigurisë se furnizimit, trasetë e këtyre linjave duhet te jenë ne pajtim me planet përkatëse komunale rregullues, zhvillimore e urbanistike.
  - Objekti i nënstacioneve duhet te jetë i ndërtuar nga materialet e forta ndërtimore si panele sandviçë, tjegullat dhe blloqet nga betoni i armuar, si dhe struktura metalike horizontale dhe vertikale me fondamente betoni, si dhe nga materialet termo dhe hidroizoluese(objektet).
  - Objekteve ndërtimore energjetike përkatëse (ndërtesave) duhet te ju sigurohet kyçja ne rrjetin e ujësjellësit, ngrohjes dhe kanalizimit.
  - Te gjitha rrugët për qasje nga dhe deri te objektet(ndërtesa) energjetik, qofshin për këmbësor apo makinave të ndërtohen prej betonit, asfaltit etj.
  - Rrethojat e objekteve energjetike-nënstacioneve duhet te rrethohen me rrethoja standarde estetike te destinuara për këto objekte, dyert dhe portat hyrëse me qasje nga rrugët publike. nuk guxojnë te hapen jashtë vijës rregulluese, dhe lartësia e tyre minimale është 2m.
  - Te gjitha hapësirat e pa shfrytëzuara dhe te pa ndërtuara ne dhe rreth nënstacioneve duhet te gjelbërohen me kultura bimore, me gjelbërim i cili nuk lejohet te rritet me shumë se sa e lejojnë normat.

- **Nënstacionet 10(20)/0.4 kV**

Me rastin e ndërtimit të nënstacioneve të tensionit 10(20)/0.4kV, dhe gjatë përcaktimit të lokacionit për NS duhet të merren në konsideratë rekomandimet si në vijim :

- Lokacioni i përcaktuar të jetë sa më afër ose edhe në qendër të konsumit (shpenzueseve), dhe aty ku është e mundur ndërtimi dhe qasja të jetë në hapësirë publike.
- Që linjat kyçëse të jenë sa më të shkurta, dhe shpërndarja e linjave të jetë sa më e thjeshtë dhe pa komplikime (improvizime) pa gërshetime të panevojshme.
- Të këtë mundësi të qasjes sa më të lehtë për montim, riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve.
- Ti kushtohet kujdes rreziqeve eventuale të mundshme, cilësitë gjeologjike të tokës si dhe kujdesi që të mos shkaktohet ndotja e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.
- Vendosja e nënstacioneve të bëhet duke marr parasysh pozicionin e instalimeve tjera sipërfaqësore dhe nëntokësore në vendin dhe rrethin ku montohet.
- Që të akomodohet edhe në aspektin estetik në peizazhin e zonës, dhe të këtë ndikim minimal në ambient.
- Largësia e nënstacionit nga objekti fqinje duhet të jetë minimalisht 3m nëse nuk ka kufizime tjera nga rregullat urbanistike.
- Nëse nënstacioni ndërtohet në brendi të objekteve për banim kolektiv, atëherë i njëjti duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet e rregullores për vendosje të nënstacioneve brenda objekteve.
- Nënstacionet ekzistuese mbesin, por edhe mund të zëvendësohen me nënstacione të reja tipike që vendosen në të njëjtin vend ose në afërsi të atyre ekzistues, në objektet banesore dhe veprimtari shoqërore, duhet të jenë në objekte të veçanta të vendosura në afërsi të atyre objekteve, ndërsa në veprimtaritë punuese mund të vendosen edhe në kuadër të objektit.

- **Linjat Energjetike Ajrore –Largpërçuesit.**

Gjatë ndërtimit të infrastrukturës-linjave energjetike duhet të merren parasysh kushtet e mëposhtme:

- Për ndërtimin e linjave energjetike, ndërmarrjet energjetike duhet t'u përmbahen rekomandimeve dhe rregulloreve teknike.
- Kur linjat ndërtohen ose kalojnë nëpër territore të komunave, ato duhet t'i njoftojnë, dhe të kërkojnë pëlqime nga organet kompetente komunale, ashtu që shiritat mbrojtës për linja të mos bien ndesh me infrastrukturën ekzistuese si dhe harmonizimin me planet komunale të asaj komune.
- Rikonstruktimi i infrastrukturës energjetike duhet të bëhet duke shfrytëzuar korridoret ekzistuese dhe ne pajtim me rregulloren teknike.
- Shfrytëzimi dhe rregullimi i hapësirës brenda shiritave (korridoreve) të mbrojtura të linjave duhet të jetë në pajtim me udhëzimet e posaçme teknike, dhe kushteve të organeve përgjegjëse ose personave juridik të autorizuar.
- Përcaktimi i traseve për linjat elektroenergjetike duhet të mos rrezikojnë objektet aktuale dhe ato te planifikuara, dhe përmbajtjeve tjera të shfrytëzimit të tokës dhe hapësirës urbane.
- Sipërfaqja tokësore dhe hapësira e ndërtimit duhet të shfrytëzohet racionalisht, duke respektuar normat, dhe duke mos penguar objektet e infrastrukturës tjetër.
- Hapësira nën largpërçues në parim nuk është e dedikuar për ndërtim të objekteve ndërtimore për banim, rekonstruktim të objekteve banesore, rritje të bimëve të larta etj.
- Në rast e rindërtimit të objekteve ndërtimore banesore – kur rritet lartësia e këtyre objekteve kjo duhet të bëhet në pajtim me normat dhe standardet teknike që të mos cenohet korridori i linjave.
- Distanca minimale e shtyllës elektrike nga lumenjtë lundruese apo kanaleve ne kryqëzim ose paralel duhet të jetë 14m, apo sipas kushteve të caktuara nga ndërmarrja kompetente e ujërave.

- **Linjat Energjetike Nëntokësore – Kabllovike.**

- Rikonstruktimi i rrjeti ekzistues dhe atij të ri duhet të ndërtohet kryesisht si rrjet kabllovik me vendosjen e tipeve të reja të kabllove XHP dhe rrjeti i rindërtuar duhet të jetë unazor me mundësi të plotësimit të kriterit (n-1).
- Kabllot e tensionit të lartë 110 kV e më lart, duhet të ndërtohen në trase përgjatë rrugëve në pjesët e tyre ku frekuenca e transportit është më e vogël, duke shmangur këmbët e urave, trotuaret etj .

- Rrjeti kabllor 10(20) kV duhet të ndërtohet unazor, me unaza të hapura, ashtu që në rast të dështimit të mund të bëhet kompensimi nga një linjë tjetër. Gjatë ndërtimit të një linje energjetike kabllore nëse kryqëzohet apo edhe ndërtohet në afërsi të infrastrukturës tjetër, atëherë duhet të respektohen normat mbi distancat përkatëse, ashtu që të mos manifestohen ndikime tjera negative.
- Linjat kobllovike mund të shtrihen si të lira direkt në kanale nëntokësore apo edhe në gypa dhe në kanale ndërsa numri dhe dimensioni i gypave fleksibil të vendosur në kanalizim kabllovik përcaktohet në varësi nga nevoja dhe definohet në projektin detal – zbatues.
- Në të gjitha rrugët e asfaltuara, e posaçërisht ne zona urbane në njërën anë të trotuarit, duhet rezervuar për ndërtimin e kanalit kabllovik për shtrirjen e linjave dhe instalimeve tjera.
- Ndërtimi mbi kanalet kabllovike të linjave është i ndaluar, përjashtimisht është i lejuar ndërtimi i parkingjeve, terreneve sportive, infrastrukturës së ulët por duke siguruar qasje të lirë për hapjen e kanaleve të të njëjtëve.
- Në vendet ku linja ajrore kalon në kabllovike, duhet të sigurohet hapësira për rreth shtyllës për vendosje të pajisjeve të TL me qasje të pa penguar në pajtim me rregulloret teknike.
- Thellësia e shtrirje së kabllove duhet të jetë jo më e vogël se 1.1m për linjat e tensioni 20 kV ndërsa 0.7 m për rrjetin e TU.
- Linjat energjetike kabllore nuk lejohet të vendosen më se paku 1m nga themeli i objektit, 1m nga auto rrugët etj. aty ku është e mundur të shtrihen në hapësira të gjelberta dhe në distancë 2m nga rendi i drunjëve.
- Linjat nëntokësore mund të shtrihen nën trotuar në thellësinë prej 1.1m në distance 0.5 m nga vija rregulluese, në hapësirën për gjelbërim apo në pjesën trotuareve rrugore në thellësi prej 0.8m apo edhe profilet rrugore në thellësi deri në 1m.
- Në korridoret e rrugëve shtetërore, kabllot që shtrihen paralel me këto rrugë duhet të shtrihen minimalisht 3m nga pika e skajshme e profilit rrugor sipas rregullores së ndërmarrjes për menaxhimin e rrugëve.
- Thellësia minimale e shtrirjes së kabllove në tuba mbrojtës (kryqëzime me rrugën) duhet të jetë 1m e matur nga pika më e lartë e rrugës, dhe pikës më të lartë të tubit.
- Nëse në të njëjtin kanal vendosen instalime publike të llojeve të ndryshme, duhet të respektohen distancat teknike ndërmjet instalimeve të ndryshme.
- Nuk lejohet shtrirja e kabllove energjetike mbi gypat e ujësjellësit dhe në gypat e kanalizimit.
- Rrjeti i Shpërndarës i Tensionit të Lartë 400/220V
- Gjatësia më e madhe e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike është në këtë nivel, pasi që rrjeti është i shpërndarë deri të secili konsumatorë.
- Në varësi nga numri dhe shpërndarja e konsumatorëve, këto rrjeta ndërtohen si ajrore, kabllovike (nëntokësore) apo edhe kombinim i këtyre dy formave.
- Rrjeti i tensionit të ulët ndërtohet duke marr në konsideratë kushte si më poshtë:
- Për ndërtimin e rrjetit kabllor të tensionit të ulët aplikohen kriteret e njëjta si për rrjetin e TM të cilin e trajtuam më lartë, por në pjesët periferike të përfshira në zonën e planifikimit urban rrjeti mund të jetë edhe ajrore –në pjesët ku shtëpitë janë të shpërndara.
- Ndërtimi i rrjetit të tensionit të ulët 0.4kVnë pjesën e planifikuar urbane dhe rurale, duhet të realizohet duke përdorur kabllo standarde XHP varësisht nga vendi dhe mënyra e shtrirjes kabllovike/ajrore.
- Rrjeti i TU i ndërtuar me kabllo ajrore të tipit bistek (tufe) vendoset në shtylla nga betoni i armuar, por kjo duhet të realizohet duke aprovuar projekte sipas një plani strategjik dhe jo si rrjet ad-hock, sepse shkakton degradimin e hapësirave dhe pamundëson realizimin e këtij plani, gjithashtu edhe vendosja e pajisjeve duhet te implemntohet duke shikuar edhe anët estetike dhe ndikimeve në ambientin e zonës.
- Duhet ti kushtohet kujdes mbrojtjes nga zjarri gjatë montimit të rrjetit, kjo sidomos në hapësirat e destinimeve të veçanta dhe atyre publike.

Investitori është i obliguar që ta siguroj dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e lejes së ndërtimit dhe të siguroj mbikëqyrjen profesionale të punimeve dhe paraqitjen e kërkesës për shfrytëzim te objektit.

9.6.9. PLANIFIKIMI I NDRIÇIMIT TË RUGËVE

Ndriçimi aktual i lagjeve nuk eshtë i kompletuar në të gjitha rrugët ashtu si duhet. Për këtë arsye duhet të parashihen të ndriçohen të gjitha rrugët dhe hapësirat publike në lagje. Duhet planifikuar që ndriçimi të bëhet me llamba ekonomike të teknologjive më të reja LED-efiçientë, të vendosura në shtylla metalike apo edhe në shtylla betoni në zonat rurale. Numri i llambave per ndriçimin e rrugëve te lagjes do tê percaktohet me projekt detal-zbatues dhe duke u bazuar në standardet ndërkombëtare për ndiçmin e rrugëve. Furnizimi i këtyre llambave do të bëhet nga nënstacionet ekzistuese dhe ato te reja të vendosura në ato lagje ku implementohet ndriçimi publik, ku edhe do të vendoset grupi i matjes së energjisë së nevojshme për ndriçim. Pajisjet për komandim të ndriçimit të jashtëm duhet të vendosen në kuadër të veçantë i nevojshëm për ndriçimin publik. Këto pajisje duhet të mundësojnë kyqjen automatike në mbrëmje dhe shkyçjen në mëngjes dhe në vende ku frekuenca e qarkullimit është e vogël pas orës 24 mundet që të zvogëlohet ndriçimi për 50 %.

9.6.10. NDËRTIMI INDRIÇIMIT PUBLIK

Realizimi i ndriçimit publik të hapësirave publike në vendbanime, bëhet në varësi të karakteristikave të permbajtjeve të veçanta(banim, ndërtesë publike, rrugë, hapësira për qarkullim, monumente të kulturës, hapësira për rekreacion etj) edhe pse hapësirat sportive dhe rekreative duhet të trajtohen me projekt të veçantë për ndriçim.

- Kushtet e ndërtimit të ndriçimit publik do të trajtohen me leje ndërtimore dhe në bazë të planeve detale rregulluese, si dhe zgjidhjeve të bazuara në kushte dhe teknologji, duke respektuar kërkesat e organeve për trashëgimi kulturore, ato komunale dhe të ndërmarjeve energjetike.
- Shpërndarja e linjave të tensionit të ulët TU të ri dhe ekzistues nuk do trajtohen por ato duhet të realizohen në bazë të lejeve të përcaktuara dhe kushteve teknike mbi zonat e sigurisë, gjithnjë ku është e mundur.
- Me këtë plan parashihet shfrytëzimi racionali burimeve shtesë si ato efiçientë apo edhe të ripërtëritshme - nëse ka, duke siguruar funksionalitet dhe akomodim të këtyre stabilimenteve në hapësira publike dhe hapësira tjera, gjithnjë duke u përshtatur me rrethinën dhe ne pajtim me normat teknike.

Ndërtimi i rrjetit te ndriçimit publik te rrugëve dhe hapësirave tjera për rreth ne zonën e planifikuar, duhet ti plotësoje parametrat fotometrik te dhine sipas normave evropiane EN 13201.

Gjatë realizimit të ndriçimit të rrugëve duhet të kihen parasysh këta faktor meritor për kualitetin e ndriçimit:

- Niveli i shkëlqimit të sipërfaqes së rrugës
- Shpërndarja e njetrajtshme e shkëlqimit gjatësor dhe tëpërgjithshëm.
- Kufizimin e verbimit momental pershkak të ndriçimit jokomfort, (zvogëlimin psikologjik te blinkimit).
- Lëvizje vizuale e trafikut.
- Aspekteve estetike dhe akomodimit të pajisjeve në hapesirat përkatëse
- Zgjedhja e llojit të ndriçimit të bëhet sipas standardit evropian në fuqi EN13201
- Llambat ndriçuese duhet të vendosen në shtyllat dy dhe tre pjesëshe të parapara për montim në themelet e betonit të përpunuara, ashtu që sipas nevojës të mund te demontohen, ndërsa furnizimi i ndriçimit duhet të bëhet me kabllo nëntokësore duke aplikuar kabllo standarde (PPOO 0.6/1 kV) për ndriçimin e rrugëve dhe hapësirave të rregulluara, seksioni i të cilave varet nga numri i trupave ndriçues, ashtu siç është paraparë në projektin kryesor.
- Gjatë projektimit të ndriçimit për hapësira të rregulluara kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pamjes estetike dhe vendosjes adekuate të ndriçimit.
- Sistemi i ndriçimit parashihet te jetë për gjithë natën, dhe me mundisi te zvogelimit të fugisë pas orës 24.00, ndërsa kujdes t'i kushtohet zgjedhjes së poçave për mirëmbajtje sa më të thjeshtë(lehtë).
- Me projekte të veçanta duhet të parashihen sisteme efiçiente të ndriçimit
- Rënia maksimale e tensionit në instalimin e ndriçimit nuk guxon të jetë më e madhe se 5% kur furnizimi bëhet nga nënstacioni.
- Gjatë realizimit të instalimit të ndriçimit duhet të aplikohen masat e mbrojtjes nga tensioni i goditjes (mbrojtja direkte dhe indirekte), me këte nënkuptohet shtrirja e pertokezuesit të perbashket të githa shtyllave të instalimit të ndriçimit me shirit tokezimi Fe -Zn 25x4 mm dhe lidhja e tij me shtylla dhe me përtokezuesin e nënstacioneve.

- Githashtu të realizohet mbrojtja selektive e secilit qark dhe e secilit poç veçanërisht.
- Të realizohen pajisje për matjen e energjisë së shpenzuar të ndriçimit si dhe komandimi(kyqje-çkyqje) të realizohen me fotorele dhe me ndërprerës rrotullues.
- Ndriçimi i rrugeve, shesheve dhe hapësirave tjera të nevojshme do të bëhet me ndriçim artificial.
- Kur jemi te rrugët, një zone trajtuar ka disa nivele te klasifikimit te rrugëve, dhe varësisht nga kjo bëhet edhe klasifikimi i ndriçimit,dhe atij për rrugët automobilistike kemi klasë:
- M5 - 0,5 cd/m2-rrugë lokale me shpejtësi të ulët 10-40 km/h.
- M1 - 2,0cd/m2 autoudhët.

Ndriçimi i ketyre hapesirave duhet te reflektojë një harmoni ndërmjet objekteve që ndriçohen, natyrës dhe ambientit përreth. Për ndriçimin sa më të njëtrajtshëm poçi do të vendoset në shtylla me lartësi të ndryshme, duke filluar nga 3m në trotuare e deri 10-12m në rruge, të shpëmdara nga njera tjetra nga 6-50 m.

Vendosja bëhet varesisht nga kërkesat për ndriçim dhe rëndesisë së rrugëve:

- Rrugët me gjerësi deri 12m ndriçuesit vendosen vetëm në njerën anë;
- Rrugët me gjerësi deri 18m ndriçuesit vendosen në mënyrë që ndriçimi i tyre të bije mbi rruge;
- Rruget me gierësi deri 40m ndriçuesit vendosen në dy anët e rrugëve.

Ndriçimi i rrugeve në kryqëzim duhet të jetë më i madh se në pjesën tjetër të gjatësisë së rrugës që kryqëzohet. Gjithashtu edhe ndriçimi i shesheve duhet të jetë më i madh se i rrugëve për 50%.

Kërkesat e përafërta për ndriçim të rrugëve janë:

- Rrugët kryesore në qytet 4-8 lux/m^2
- Për rrugë banimi 1-2 lux/ m^2.

Dukuritë e shpërndarjeve jo të njëtrajtshme pastaj reflektime, ndotje fotometrike dhe ndriçimet e deformuara duhet te evitohen. Rjeti i ndriçimit do të shtrihet përskaj rrugëve dhe do te jete pjesë e atyre projekteve ekzistuese(zgjerim), por në raste te caktuara mund të ndërtohet edhe si rrjet i veçantë.

Kyqja ne tension mund te realizohet edhe ne nënstacionet e tensionit 10(20)/0.4 kV në anën e tensionit të ulët por në fazen e ndërtimit duhet te lihen dalje rezerve per kyqje me tension 230/400 V si dhe kuadri per matjen e energjisë elektrike.

Gjithashtu në vendet ku veç ekziston rrjeti i ndriçimit ai duhet të mirëmbahet dhe të adaptohet në raport me kerkesat e këtij plani dhe të bëhen ndërhyrjet e nevojshme.

Për shtrirjen e kabllove për ndriçim vlejnë normat për shtrirjen e kabllove tjerë të tensionit të ulet ashtu që të ruhen distancat ndërmjet kabllove dhe instalimeve tjera.

9.7. INFRASTRUKTURA E PRODHIMIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

Duke u bazuar ne ligjet ne fuqi si dhe dokumentet e planifikimit hapësinor zhvillimi i energjisë së ripërtritshme duhet të jetë në përputhje me legjislacionet në fuqi si :

- Ligjin për toka bujqësore;
- Ligjin pyjet e Kosovës;
- Ligjin trashëgimi kulturore dhe natyrore;
- Ligjin për ujëra dhe të gjithë legjislacionin në fuqi i cili ka impakt direkt në këtë fushë.

Harta zonale e komunës se Vitisë planifikon që energjinë e ripertrishme të zhvilloj si shfrytëzim i përkohëshëm konform ligjeve të lartëpërmendura si dhe analizave ekonomike të nivelit qëndrorë.

- **Kushtet e përgjithshme për energji të ripërtrishme**

Intensiteti i erës:

Zonat me intensitet të lartë të erës janë më të favorshme për prodhimin e energjisë së erës.

Ndërtesat dhe ndërtime të tjera:

Ndërtesat dhe ndërtime të tjera duhet të kenë distanca të mjaftueshme nga instalimet e prodhimit të energjisë së ripertritshme, për të minimizuar interferencat dhe rreziqet potenciale.

Kushtet e diellit:

Zonat me kushte të favorshme të diellit janë më të favorshme për prodhimin e energjisë së diellit. Këto kushte përfshijnë nivelet e ndriçimit, lagështinë dhe distancën nga zona me hije.

Aksesibiliteti:

Duhet të jetë e aksesueshme dhe të mund të instalohen sisteme përkatëse të lidhjes së energjisë në rrjetin e shpërndarjes së energjisë.

Kushtet atmosferike:

Kushtet atmosferike mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë së ripertritshme. Këto kushte përfshijnë temperaturën, lagështinë dhe kushtet e ajrit.

Zonat e ndalimit të fluturimit:

Zonat ku fluturimi i aeroplanëve është i ndaluar ose i kufizuar mund të kenë rreziqe për instalimet e prodhimit të energjisë së ripertritshme nga era, dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë planifikimit të tyre.

Karakteristika gjeografike:

Kushtet gjeografike të zonës mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë së ripertritshme. Për shembull, zona në një kodër ose në një vend të thellë mund të ketë kushte të ndryshme nga zona në një lug të hapur.

Ngarkesa dhe kapaciteti i rrjetit të energjisë:

Zonat duhet të kenë kapacitetin e nevojshëm të rrjetit të energjisë dhe mundësi për lidhje në rrjetin ekzistues.

Shkalla e zhurmës dhe ndikimit në mjedis:

Sistemet e prodhimit të energjisë së ripertritshme mund të prodhojnë zhurmë dhe mund të kenë ndikim në mjedis, kështu që duhet të merret parasysh kjo gjatë planifikimit dhe instalimit të tyre, prandaj duhet të bëhet një vlerësim i ndikimit në mjedis (VNM).

Kushtet e hapësirës fizike:

Zonat duhet të kenë hapësirë fizike të mjaftueshme për instalimet dhe paisjet e nevojshme për prodhimin e energjisë së ripertritshme nga era dhe dielli.

Kushtet klimatike:

Kushtet klimatike, si sasia e lartë e dëborës, akullit dhe akullnajave mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë së ripertritshme nga era dhe dielli.

Kushtet e territorit:

Kushtet e territorit, si terreni dhe rrjedhshmëria e ujit mund të ndikojnë në prodhimin e energjisë së ripertritshme nga era dhe dielli.

Qëndrueshmëria financiare:

Prodhimi i energjisë së ripertritshme mund të jetë i kushtueshëm në kosto, kështu që është e rëndësishme që projektet e tilla të kenë qëndrueshmëri financiare dhe mbështetje për zhvillimin e tyre duke hartuar planin e fizibilitetit dhe atë të biznesit.

Rreziku nga faktorët natyrorë dhe njerëzorë:

Zonat për prodhimin e energjisë së ripertritshme nga era dhe dielli mund të jenë të prekshme nga faktorët natyrorë dhe njerëzorë si tërmetet, djegie, ndotja dhe krimi, kështu që duhet të merret parasysh këto faktor në planifikimin dhe zhvillimin e tyre.

Teknologjitë aktive diellore

Komuna e Viti-së ndodhet në zonën 4 sa i përket tabelës për potencialin e rrezatimit diellor. Vlera më e lartë e rrezatimit diellor është paraqitur në Zonën 1 ndërsa më e ulëta shfaqet në Zonën 4.

Nr.	ZONA 1	ZONA 2	ZONA 3	ZONA 4
1	Pejë	Prizren	Podujevë	Gjilan
2	Deçan	Dragash	Novobërdë	Viti
3	Gjakovë	Mitrovicë	Kamenicë	Kaçanik
4	Klinë	Skenderaj	Istog	Shtërpcë
5	Rahovec	Gllogovc	Zubin Potok	
6	Suharekë	Obiliq	Leposaviq	
7	Malishevë	Fushë Kosovë	Zveçan	
8		Lipjan	Vushtrri	
9		Shtime		
10		Prishtinë		
11		Ferizaj		

Bazuar në pozitën gjeografike dhe kushtet klimatike të Kosovës, energjia diellore mund të shfrytëzohet në masë të konsiderueshme për ngrohjen e ujit sanitar dhe për prodhim të energjisë fotovoltaike. Sa i përket furnizimit me ngrohje, sistemi i ngrohjes është i kufizuar duke çuar në mungesë të furnizimit me ujë të ngrohtë sanitarë. Komuna e Vitisë nuk ka sistem të ngrohjes qendrore, madje edhe burimet fosile për sistem të integruar të ngrohjes qendrore janë të ulëta. Kështu, është e nevojshme që të bëhet shfrytëzimi për aq sa është e mundur i burimeve diellore në mënyrë që një pjesë e ujit sanitar të ngrohet përmes sistemeve diellore.

Me anë të mekanizmave institucional duhet të stimulohet rritja e kapacaiteteve instaluese me bazë në burimet e ripërtëritshme, ku edhe komuna mund të krijojë mekanizma të nxitjes për instalimin e teknologjive diellore të prodhimit të energjisë.

- **Integrimi i teknologjive aktive diellore**

Duhet inkurajuar fuqimisht përfshirja e projekteve të energjisë së rinovueshme në zhvillimet e reja. Skemat e energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël, që përdorin teknologji të tilla si panelet diellore, lehtësisht mund të përfshihen në zhvillimet e reja ashtu edhe në disa ndërtesa ekzistuese.

Për zgjidhjet integruese të energjisë, thelbësore është përfshirja e lagjeve dhe blloqeve të ndërtesave, për të zbatuar zgjidhjet e sistemit në nivelin e duhur, p.sh. rrjete të vogla të energjisë që furnizohen nga burime tër rinovueshme. Kjo qasje mund të mbyllë hendekun midis nivelit të qytetit dhe nivelit të ndërtesës. Instalimi i duhur i këtyre sistemeve rregullohet përmes këtij dokumenti të Hartës Zonale.

Në shumicën e rasteve, standardet ekzistuese dimensionale lejojnë zhvillimin e sistemeve të energjisë diellore në shkallë të vogël, të mesme dhe të madhe. Megjithatë, nëse komuna në raste të caktuara vendos se standarde alternative të dimensioneve janë të

nevojshme për të lejuar zhvillimin e sistemeve të energjisë diellore, duke mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien publike, ajo mund t'i imponojë ato.

Kur kërkohet një aplikim planifikimi, faktorët që duhet të merren parasysh për integrimin e moduleve fotovoltaike dhe kolektorëve për ngrohjen e ujit përfshijnë:

1. Çatitë me pamje nga jugu janë ideale, mirëpo modulet mund të vendosen në çatitë nga jug-perëndimi ose jug-lindja me humbje minimale. Çatitë nga veriu dhe me shumë hije duhet të shmangen;
2. Modulet diellore duhet të jenë të orientuara në drejtim të jugut, dhe me pjerrtësi optimale nga 33°-37°;
3. Nevoja për sipërfaqe të mjaftueshme të moduleve diellore për të prodhuar energjinë e kërkuar nga sistemi;
4. Ngjyra dhe pamja e moduleve, veçanërisht nëse nuk ka një dizajn standard.

- **Kushtet për instalimet në çati**

Sistemet e energjisë diellore të montuara në çati, pavarësisht nga madhësia, lejohen për zhvillim pa pasur nevojë për një leje të posaçme, me kushtin që instalimi të mos jetë i një dizajni të pazakontë. Këto projekte nuk mund të ndalohen dhe mund të ndërtohen pasi të jetë lëshuar një leje ndërtimi. Është e rekomandueshme që për qëllime të lartësisë, këto sisteme të konsiderohen të ngjashme me oxhaqet, antenat televizive apo pajisje të tjera që zakonisht lejohen në lartësi shumë më të larta, ose mund të përjashtohen nga limitet e lartësisë.

Përzgjedhja e vendit/lokacionit:

Ky dokument dekurajon fuqimisht vendndodhjet që rezultojnë në humbje të konsiderueshme të tokës dhe burimeve natyrore, duke përfshirë tokën bujqësore dhe pyjore, dhe **inkurajon vendosjen në çati**, **si dhe lokacionet në rrethet industriale dhe tregtare**, ose në toka të zbrazëta dhe të trazuara.

- **Kushtet e instalimit të sistemeve në çati në prona banimi**

1. Vargu diellor FV nuk duhet të dalë më shumë se 200 mm mbi vijën e çatisë;
2. Për aq sa është e mundur, paneli duhet të vendoset për të minimizuar efektin në pamjen e jashtme të ndërtesës;
3. Sistemet FV përjashtohen nga llogaritjet e lartësisë kur kemi të bëjmë me çati të sheshtë, apo të kalojnë lartësinë maksimale me 1.50-3.00 metra.

- **Kushtet e instalimit të sistemeve në çati për furnizim të pronave komerciale**

1. Çatitë me pjerrësi:

   Vargu diellor FV nuk duhet të dalë më shumë se 200 mm mbi vijën e çatisë;
2. Kulmet e sheshta:

   Pjesa më e lartë e panelit FV të jetë më pak se 1.00 m më e lartë se pika më e lartë e çatisë (duke përjashtuar strukturat si oxhaku);
3. Vargu FV të vendoset mbi 1.00 m distancë nga skajet e jashtme të çatisë;
4. Për aq sa është e mundur, paneli duhet të vendoset për të minimizuar efektin në pamjen e jashtme të ndërtesës.

- **Kushtet për instalimet në Tokë**

Për sistemet e montuara në tokë, ekziston një dallim midis mënyrës se si trajtohen sistemet e shkallës së vogël, të mesme dhe të madhe dhe ku secili lejohet sipas të drejtës, nëpërmjet rishikimit të planit të vendndodhjes ose me leje të posaçme. Sisteme të montuara në tokë në shkallë të vogël, që do t'i shërbenin një shtëpie, bizneseve të vogla apo ndërtesa të vogla komunale, lejohen në të gjithë komunitetin pa një leje të veçantë. Panelet FV janë relativisht teknologji e re dhe akoma nuk dihet se si instalimet përshtaten me rregulloret ekzistuese të zonimit dhe përdorimit të tokës.

Sistemet në shkallë të gjerë ngrenë shqetësimet e përdorimit të tokës, estetike, çmontimin dhe asgjësimin. Instalimet në tokë, nuk lejohen në zona banimi pa një kontroll rregullator përmes rishikimit të planit të zonës së caktuar, për mbrojtjen e shëndetit, sigurinë dhe mirëqenien publike.

Në rastet kur planifikohet heqja e pemëve për të rritur aksesin e rrezeve të diellit, banorët në kërkesën për leje të paraqesin qartë llojet. Rritja e vegjetacioni dhe zëvendësimi duhet të merren parasysh gjatë projektimit të një sistemi FV.

- **Kushtet e instalimit të sistemeve në tokë në prona banimi**

Sisteme të montuara në tokë në shkallë të vogël, që do t'i shërbenin një shtëpie, lejohen për zhvillim nëse:

1. Modulet diellore FV të jenë jo më shumë se 4.00 m lartësi;
2. Modulet diellore FV të instalohen në distancë mbi 5.00 m nga kufiri i pronës;
3. Preferohet që madhësia e vargut diellor FV nuk duhet të kalojë 9.00 m^2.

Sistemet e montuara në tokë me sipërfaqe më të madhe se 9.00 m^2, kalojnë në kategorinë e sistemeve të mesme dhe të mëdha, për të cilat do të kërkohet rishikimi i planit të zonës.

Për sistemet e energjisë diellore të montuara në tokë që zhvillohen si struktura ndihmëse për një pronë – biznes, ndërtesë apo strukturë tjetër, duhet ofruar i njëjti fleksibilitet siç tashmë iu ofrohet "strukturave ndihmëse" (kasolle, garazha, etj.), të jenë më afër vijës së ngastrës sesa një strukturë kryesore. Këto sisteme në shkallë të vogël dhe të mesme, si aksesorë për përdorim kryesor, mund të vendosen jo më afër se 6.00 metra linja e oborrit të përparmë, anësorë ose të pasmë. Të gjitha sistemet e energjisë diellore të montuara në tokë në zonat e banuara do të instalohen ose në oborrin anësor ose të pasmë deri në masën e mundshme.

- **Kushtet e instalimit të sistemeve në tokë në prona komerciale, bujqësore dhe industriale**

1. Modulet diellore FV të jenë jo më shumë se 4.00 m lartësi;
2. Modulet diellore FV instalohen në distancë mbi 5.00 m nga kufiri i pronës;
3. Madhësia e rrjetit diellor PV nuk i kalon 9.00 m^2;
4. Paneli diellor FV nuk duhet të jetë i dukshëm nga rruga nëse ndodhet brenda një zone të konservuar ose një zone të trashëgimisë;

Meqenëse shumica e instalimeve komerciale të sistemeve diellore FV janë shumë më të mëdha se 9.00 metra katrorë, një leje e veçantë do të kërkohet për sistemet komerciale FV diellore të montuara në tokë pothuajse në të gjitha rastet.

Për sa i përket pronave të fermave, instalimet në çati janë gjithmonë të preferueshme. Nëse çatia është e pamjaftueshme, toka bujqësore jo e punueshme mbetet zgjedhja e dytë. Nëse kjo gjithashtu shihet e pamundur, toka më pak produktive të përdoret së pari për të minimizuar humbjen e produktivitetit të tokës kulturë.

Tabela 82 Përdorimet kryesore të teknologjive aktive diellore në shkallë të vogël dhe të mesme, zonat bujqësore:

	ZB1	ZB2	ZB3	ZK	ZI
Sistemet e energjisë solare në çati	L	L	L	L	L
Sistemet e energjisë diellore të montuar në tokë në shkallë të vogël	L	L	L	L	L
Sistemet e energjisë diellore të montuar në tokë në shkallë të mesme	RP	RP	RP	L	L

L = E lejueshme RP = Rishikim i Planit të Vendit

▪ **Instalimet në zona të veçanta**

Lejet për zhvillime të projekteve të energjisë së rinovueshme që mund të kenë efekt negativ në ruajtjen e trashëgimisë përfshirë këtu Zona të Veçanta të Mbrojtjes, Trashëgimi Natyrore, Kulturore, etj.) u jepen vetëm pas një vlerësimi që përshkruan se integriteti i objektit apo vendit nuk ndikohet negativisht.

- Paneli diellor FV nuk duhet të jetë i dukshëm nga rruga nëse ndodhet brenda një zone të konservuar ose një zone të trashëgimisë.

▪ **Çmontimi dhe asgjësimi i sistemit solar**

Në përshkrimin e kërkesave për vendin e çmontimit, në mënyrë specifike të kërkohet heqja e infrastrukturës, asgjësimi i çdo komponenti dhe ri-vegjetimi i zonës. Është shumë me rëndësi rikthimi i zonës në gjendjen që ka qenë para se të instalohet sistemi solar.

9.8. RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT DHE INSTALIMET E NGJASHME

Operatoret te cilët planifikojnë te ndërtojnë Stacione te Telefonisë Mobile (BTS) duhen te pajisen me Leje mjedisore Komunale:

Kushtet për marrjen e Lejes mjedisore:

1. Kërkesa;
2. Certifikata e regjistrimit te Biznesit;
3. Fleta Poseduese;
4. Kopja e planit me kordinata;
5. Raporti për LMK;

Raporti për marrjen e LMK duhet te përmbajë:

1. Përshkrimi projektit;
2. Përshkrimi i Lokacionit;
3. Përshkrimi i procesit teknologjik dhe Pajisjet;
4. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimit ne mjedis;
5. Vlera investuese e projektit;
6. Raporti i Lejes Mjedisore duhet të përmbajë të dhënat personale, emrin, mbiemrin dhe
7. Nënshkrimin e Hartuesit dhe aplikuesit.

9.8.1. NDËRTIMI, INSTALIMI DHE MBIKËQYRJA E INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

9.8.1.1. NJOFTIMI PËR PLANIFIKIMIN/PROJEKTIMIN E INFRASTRUKTURËS SË JASHTME TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Ndërmarrësi që planifikon të ndërtojë, rindërtojë, instalojë apo çinstalojë infrastrukturë të jashtme të komunikimeve elektronike është i obliguar të informojë Autoritetin dhe komunën jo më vonë se tre (3) muaj para fillimit të realizimit të aktivitetit.

9.8.1.2. DORËZIMI DHE APROVIMI I PLANIT/PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS SË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Ndërmarrësi duhet të dorëzojë planin e detajuar të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm te komuna përkatëse dhe Autoriteti duke përmbushur kërkesat minimale për përmbajtjen e planit të detajuar të ndërtimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike janë:

1. Aktivitetet e projektit;
2. Përshkrimi i Projektit;
3. Skica e përgjithshme e planit të projektit;
4. Skicat e detajuara topografike në përpjesë së paku P 1:1000;
5. Lista e materialeve dhe elementeve;
6. Plani i rikthimit të gjendjes para punimeve ndërtimore;

Skica tërthore për:

- Kalimin e rrugës me hapje të sipërfaqes së rrugës, ku paraqitet thellësia e instalimit të kabllos apo gypit në përpjesë P 1:100 ose P 1:200;
- Kalimin e rrugës me shpim, ku paraqitet thellësinë e instalimit të kabllos apo gypit në përpjesë P 1:50 ose P 1:100;
- Kalimin e lumit, ku paraqitet thellësia e instalimit të kabllos apo gypit në përpjesë P 1:100 ose P 1:200.

7. Afatet kohore të detajuara të fazave ndërtimore.

Kriteret minimale për përmbajtjen e planit të instalimeve të brendshme të objektit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike janë:

1. Përshkrimi i aktiviteteve;
2. Skica e përgjithshme e planit të projektit;
3. Lista e materialeve dhe komponentëve tjera;
4. Afatet kohore të punimeve të instalimeve të brendshme.

Ndërmarrësi që planifikon të ndërtojë, rindërtojë, ose të heq infrastrukturën e jashtme të komunikimeve elektronike duhet të marrë pëlqimin nga komuna dhe pranimin nga entitetet që posedojnë infrastrukturë nëntokësore në zonat e mbrojtjes së kabllove ku planifikohet të shtrihet ndërtimi në mënyrë që të ruhet infrastruktura e entiteteve tjera.

Ndërmarrësi që planifikon të instalojë e çinstalojë infrastrukturë të jashtme të komunikimeve elektronike duhet të marrë pëlqimin nga komuna ose nga Ministria përgjegjëse për rrugët nacionale në rast se është e domosdoshme të kufizohet trafiku rrugor në zonat e mbrojtjes së kabllove ku planifikohet të shtrihet instalimi.

Për instalimet e brendshme, ndërmarrësi duhet të marrë pëlqimin nga pronarët e pronës.
Në mungesë të standardeve kombëtare për simbolet për dizajnimin e infrastrukturës së rrjetit, skicat duhet të paraqiten përmes simboleve, të cilat duhet të sqarohen në legjendë. Skicat duhet të punohen në formën që është e përshtatshme për vendosje në Atlasin elektronik (GIS) në pajtueshmëri me sistemin koordinativ zyrtar KosovaRef01.

Komuna është e obliguar të ofrojë informata sipas kërkesës për ndërmarrësit që kanë infrastrukturë ekzistuese në zonat relevante të mbrojtjes së kabllove.
Aprovimi i planit/projektit për ndërtim dhe instalime të jashtme ka vlefshmëri jo më të gjatë se dy (2) vite.
Nëse komuna nuk pajtohet me trajektoren e shtrirjes së infrastrukturës, ajo duhet të ofrojë arsyetim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës.

9.8.2. KËRKESAT MINIMALE PËR MATERIALET DHE KOMPONENTËT

Nëse konstruksioni metalik përdoret si pjesë e infrastrukturës, ai duhet të ketë mbrojtje nga ndryshkja për së paku dhjetë (10) vjet.

Për instalimet/ndërtimet e brendshme, duhet të përdoren vetëm materialet dhe komponentët që janë specifike për instalimet/ndërtimet e brendshme.

Për instalime të brendshme, duhet përdorur vetëm kabllot e pandezshme dhe që nuk lirojnë gazra toksike.

Të gjitha kabllot duhet përdorur në pajtim me kërkesat e prodhuesit të kabllos.

Kapakët e pusetave duhet të përmbushin kërkesat në lidhje me ngarkesën (40 tonë nëse vendosen në sipërfaqe të rrugës).

Kapakët për pikat e shpërndarjes dhe dyert për kabinete të jashtme kabllore duhet pajisur me kyç.

Në ambiente të veçanta, me nivel të lartë konstant të lagështisë, materialet dhe komponentët për instalimet/ndërtimet e jashtme mund të përdoren, por jo edhe kabllot dhe materialet tjera që mund të shkaktojnë zjarr dhe gaz toksik.

9.8.3. KËRKESAT E SIGURISË DHE ZONAT E MBROJTJES SË INFRASTRUKTURËS

Ndërmarrësi është i obliguar të elaborojë dhe të publikojë rregullat e veta të sigurisë që mundësojnë mbrojtjen e stafit, konsumatorëve, pronës dhe rrjetit gjatë ndërtimit, rindërtimit, heqjes, instalimit dhe çinstalimit për kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në këtë Rregullore.

Nëse kablloja apo gypi kabllor instalohet nën trotuar, duhet vendosur një shirit paralajmërues kuq e bardhë mbi kabllo apo gypin kabllor, ku distanca ndërmjet shiritit dhe kabllos apo gypit kabllor nuk mund të jetë më e vogël 0.20 m.

Nëse kablloja apo gypi kabllor instalohet në vende që nuk janë trotuar, distanca mes sipërfaqes dhe shiritit nuk mund të jetë më e vogël se 0.40 m.

Zonat e mbrojtjes të infrastrukturës për kabllo/gyp kabllor nëntokësor:

1. Distanca e zonës së mbrojtjes së kabllove nga kablloja apo gypi i fundit (skajshëm) nuk mund të jetë më pak se 1.00 m në njërën anë dhe 1.00 m në anën tjetër, të dyja të matura horizontalisht;
2. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të kabllos dhe sipërfaqes së trotuarit nuk mund të jetë më pak se 0.80 m;
3. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit nuk mund të jetë më pak se 0.40 m;
4. Distanca minimale e thellësisë mes skajit të gypit kabllor dhe sipërfaqes së trotuarit në të gjitha rastet tjera nuk mund të jetë më pak se 0.60 m.

Nëse kalohet përmes një infrastrukture tjetër, duhet negociuar mënyra e kryqëzimit të tyre. Dimensionet e lartpërmendura mund të mos vlejnë për këtë rast. Duhet referuar në Tabelën 4 dhe Tabelën 5 të Shtojcës 4 të kësaj Rregullore për distancat minimale ndërmjet infrastrukturës së komunikimeve elektronike dhe infrastrukturave tjera.

9.8.4. KËRKESAT PËR FILLIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE INSTALIMIT

Para fillimit të punëve të ndërtimit të jashtëm dhe të punëve të instalimit të jashtëm, në rast të pengimit të trafikut, entiteti që është përgjegjës për punët ndërtimore duhet të marrë lejen nga komuna përkatëse.

Për të marrë lejen nga komuna përkatëse, ndërmarrësi duhet të dorëzojë:

1. Kopjen e projektit me të gjitha lejet e vlefshme;
2. Kopja e Aktit të Ekspertizës në rast se kërkohet me ligjet e aplikueshme nëse është e domosdoshme;
3. Kopja e marrëveshjes me pronarin e tokës, nëse toka është pronë private;
4. Orët dhe ditët se kur do të zhvillohen punimet.

Komuna nuk mund të refuzojë kërkesën për leje nëse ndërmarrësi ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara.

Komuna apo komunat duhet të njoftojnë ndërmarrësin brenda periudhës prej njëzetë (20) ditë pune në lidhje me kërkesën e ndërmarrësit për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm. Nëse brenda njëzetë (20) ditë pune ndërmarrësi nuk njoftohet, atëherë kjo do të konsiderohet si e aprovuar.
Të gjitha punimet ndërtimore duhet bërë në pajtim me Shtojcën 4 të kësaj Rregulloreje.
Nuk është e domosdoshme të kërkohet leja për të filluar instalimet e brendshme nëse është e pranueshme sipas nenit 5 të Rregullores 05/2017.

Leja për fillimin e punimeve ndërtimore të brendshme duhet të merret vetëm nga pronarët e ndërtesës.

9.8.5. INFORMATAT NË SITUATA URGJENTE

Në rast të aksidenteve, kur komponentët e infrastrukturës janë dëmtuar, operatori është i obliguar të informoj komunën për aktivitetet urgjente për të rikthyer rrjetin në funksion:

1. Nëse ndërmarrësi planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të njoftojë komunën së paku dy (2) orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit;
2. Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës por planifikon të rikthej rrjetin gjatë orarit të punës, ai duhet të informojë komunën dy (2) orë para se të fillojë aktiviteti i restaurimit;
3. Nëse ndërmarrësi ka pranuar informatën për rrjetin e dëmtuar jashtë orarit të punës dhe ka filluar punën e rikthimit të rrjetit para fillimit të orarit të punës, ai duhet të informojë komunën menjëherë me fillimin e orarit të punës.
4. Komuna duhet të përgjigjet në informacionin e pranuar jo më vonë se një (1) orë gjatë orarit të punës.

Në rastin e përshkruar në nënparagrafin 1.3, operatori mund të fillojë rikthimin e rrjetit sa më shpejtë që është e mundur.

Nëse komuna nuk kthen përgjigje, ndërmarrësi mund të fillojë punën e restaurimit.

Ky nen nuk aplikohet për punimet urgjente në rrugët për këmbësorë, rrugë dhe vende tjera ku aktivitetet urgjente për restaurimin e rrjetit nuk kufizojnë trafikun rrugor.

9.8.6. MBIKËQYRJA

Komunat duhet të sigurojnë mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit dhe instalimit të jashtëm gjatë gjithë procesit të ndërtimit në territorin komunës përkatëse.

Nëse puna ndërtimore bëhet në afërsi apo që kryqëzohet me infrastrukturën e një pronari tjetër, entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga pronarët e asaj infrastrukture.

Entiteti përgjegjës për punimet ndërtimore duhet të kërkojë mbikëqyrje nga entitetet tjera nëse kërkohet me akte të tjera ligjore.

Inspektimi i punimeve ndërtimore dhe instalimeve të jashtme bëhet nga Inspektorati Komunal.

9.8.7. PRANIMI I PROJEKTIT TË PLOTË

Pronari i infrastrukturës kërkon nga të gjitha entitetet të cilat kanë pranuar projektin, të japin opinionin për përfundimin e projektit sipas kompetencave të tyre.

Entitetet duhet të ofrojnë opinionin e tyre brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga pranimi i kërkesës me shkrim nga pronari i infrastrukturës.

Nëse edhe pas dhjetë (10) ditëve të punës nuk merret përgjigje, kjo konsiderohet si pranim nga entiteti për përfundimin e projektit.

Kompania ndërtimore që kryen punimet ndërtimore duhet të elaborojë aktet e pranimit për të gjitha punët e mbuluara ndërtimore sipas projektit, sipas Shtojcës 3 të kësaj Rregullore.

Akti për punët e mbuluara ndërtimore duhet nënshkruar nga:

1. Përfaqësuesi i kompanisë ndërtimore;
2. Përfaqësuesi i projektuesit të projektit;
3. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;
4. Përfaqësuesi komunal apo përfaqësuesi i Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën rrugore në rastin e rrugëve nacionale dhe rajonale.

Pasi të kryhen procedurat e përmendura, si dhe të pranohen nënshkrimet nga entitetet e lartpërmendura, akti i pranimit duhet të hartohet dhe të nënshkruhet nga:

1. Përfaqësuesi i pronarit të rrjetit;
2. Përfaqësuesi i projektuesit të projektit;
3. Përfaqësuesi i kompanisë së ndërtimit të rrjetit;
4. Përfaqësuesi i komunës;
5. Përfaqësuesi i pronarit, nëse prona nuk është publike.

Akti i pranimit duhet të merret jo më vonë se një (1) muaj pas pranimit të informatës nga pronari i rrjetit.

Në rast kontesti për mospranimin e punëve ndërtimore, palët mund t'i drejtohen gjykatës.

Në rast kontesti për mospranimin e punëve instaluese, palët mund t'i drejtohen Autoritetit për dhënie të opinionit.

9.8.8. INFORMATAT QË DUHET DORËZUAR NË FAZËN E NJOFTIMIT PËR PLANIFIKIMIN/PROJEKTIMIN E INFRASTRUKTURËS SË JASHTME TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Minimumi i informatave që duhet dorëzuar në fazën e njoftimit për planifikimin / projektimin e infrastrukturës së jashtme të komunikimeve elektronike janë:

1. Pronari i rrjetit;
2. Lloji i rrjetit dhe natyra e punës;
3. Territori i komunës apo komunave në të cilat planifikohet shtrirja e infrastrukturës;
4. Vendi ku punimet e ndërtimit dhe të instalimit janë planifikuar
5. Data e planifikuar e fillimit dhe përfundimit;
6. Personi kontaktues.

9.8.9. NDËRTIMET E BRENDSHME - MONTIMI I KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË HAPËSIRA TË BRENDSHME

Kabllot e komunikimit në hapësira të brendshme mund të jenë:

1. Të montuara në mure;
2. Të shtrira në gypat kabllor të instaluar në mure;
3. Të shtrira në gypa kabllor apo kuti të fiksuara në mure.

Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit duhet të montohen në mënyrë të mbyllur në:

- Dollapë të deponimit, kulme dhe kabina teknike të objekteve, kabllot instalohen në gypa nën dysheme apo pozicionohen në mbajtëse të fiksuara në konstruksion;
- Shkallë, korridore dhe vende të tjera të qasshme në objekte, kabllot e komunikimit montohen në kanale kabllore të "trungut" (kanalit vertikal) dhe rrugë horizontale të instaluara në mure e dysheme gjatë ndërtimit të objektit, të cilat lidhen me pikat shpërndarëse të përgatitura enkas. Pajisjet kabllore munden, sipas nevojës, të vendosen në ato pika shpërndarëse.

Kabllot e komunikimit duhet shtrirë paralelisht me tavanin/dyshemenë apo në pjerrësinë e shkallëve ose në kënd të drejtë me tavanin/dyshemenë.

Në lokacione të qasshme, kabllot e komunikimit montohen në lartësi prej 2.20 m mbi nivelin e dyshemesë, të instaluara në gypa mbrojtës apo konstruksione të tjera të mbyllura.

Nëse kabllot e komunikimit duhet montuar të hapura në lokacione të qasshme, atëherë në hapësirat horizontale ndërmjet mureve, kabllot e tilla montohen jo më pak se 2.20 m mbi nivelin e dyshemesë, si dhe jo më afër se 0.10 m me tavanin.

Kabllot e komunikimit duhet të kryqëzohen me kabllot tjera në drejtime pingule, duke i shtrirë në gypa të tjerë mbrojtëse.

Kabllot e komunikimit që instalohen paralelisht me kabllot e energjisë, duhet të montohen nën (më poshtë) kabllot e energjisë në distancë prej jo më pak se 25mm. Nëse kablloja nuk përmban pjesë metalike, ato mund të montohen edhe në afërsi deri në 10cm.

Kabllot e komunikimit duhet të montohen në kanale kabllore të objektit pa dëmtuar kabllot tjera të komunikimit të vendosura në to.

Në pikën shpërndarëse, pajisjet shpërndarëse të kabllove të komunikimit montohen në konstruksionet mbajtëse apo konstruksionet e murit të objektit, duke ruajtur elementet e objektit dhe kabllot e komunikimit të montuara më parë.

Kabllot e komunikimit duhet të shtrihen në drejtim horizontal dhe vertikal nën kënd të drejt (900), duke siguruar kërkesat për rrezen më të vogël të lejueshme të përkuljes për kabllot e komunikimit si dhe duke shmangur, për aq sa është e mundur, kryqëzimet me sistemet e energjisë elektrike, ujit, gazit, ngrohjes dhe me sistemet tjera inxhinierike në objekt.

Kur shtrihen disa kabllo të komunikimit, duhet të përdoret vetëm një rrugë, si dhe është e obligueshme që këto kabllo të komunikimit të fiksohen për muri dhe të mos përdridhen mes vete.

Kur montohen kabllot e komunikimit në mure apo mes dyshemeve të objekit, ato duhet vendosur në gypa mbrojtës. Kabllot e komunikimit nuk duhet të futen brenda tullave në konstruksione.

Në hapësira të brendshme, kabllot e komunikimit dhe pajisjet kabllore duhet shenjuar përgjatë "trungut" në secilin kat të objektit, në secilën pikë shpërndarëse, në secilën dhomë, si dhe në secilën prizë, ashtu që të mundësohet identifikimi i pronarit të kabllos të komunikimit.

Kutitë shpërndarëse që montohen jashtë murit në shkallët e objektit duhet instaluar në jo më pak se 2.20 m mbi nivelin e dyshemesë dhe jo më afër se 0.10 m me tavanin.

Kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, duhet instaluar në distancë prej jo më pak se 0.10 m nga këndet e mureve dhe skajeve të kornizës së dyerve, ashtu që të mos pengojnë hapjen dhe mbylljen e dyerve.

Në seksionet horizontale, kabllot e komunikimit duhet fiksuar në së paku tri (3) pika për metër, ndërsa në seksione vertikale – në së paku dy (2) pika për metër.

Në pikat e kryqëzimit të gypave të sistemeve të ndryshme inxhinierike, kabllot e komunikimit vendosen në tiplla të ngulitura në suvanë e murit nën to.

Kur kryqëzohen telat e sistemeve të ziles, sigurisë dhe alarmit të zjarrit që janë të fiksuara për muri, kabllot e komunikimit montohen mbi to.

Vendet e shpimit dhe tipllave në mure e pllaka dyshemeje ndërmjet kateve duhet mbyllur pas montimit të kabllove të komunikimit.

Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdridhen përreth boshtit gjatësor.

Në lokacionet e prizës së kabllos së komunikimit, është e detyrueshme që të sigurohet një gjatësi e caktuar rezervë e kabllos së komunikimit, ashtu që të sigurohet mundësia e montimit të mëvonshëm të një nyje.

Pas përfundimit të punës së montimit, punishtja duhet të kthehet në gjendje të rregullt.

9.8.10. NDËRTIMET E JASHTME - PUNIMET E DHEUT

Shtrimi i gypave kabllor dhe instalimi i pusetave, riparimet e tyre apo përdorimi i tyre zakonisht përfshin edhe punimet e dheut si në vijim:

1. Gërmimi dhe rivendosja e rrugëve dhe trotuareve për këmbësorë;
2. Gërmimi i gropave dhe kanaleve;
3. Punët e përforcimit për gropa e kanale;
4. Mbushja e gropave dhe kanaleve me dhe;
5. Ngjeshja e dheut;
6. Ngarkimi dhe heqja e dheut sipërfaqësor;
7. Nivelimi i dheut dhe punë të tjera me dhe.

Kryerja e punimeve të dheut në afërsi të strukturave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rrjeteve inxhinierike lejohet vetëm pas njoftimit paraprak të pronarëve të këtyre strukturave dhe rrjeteve inxhinierike ose në prani të tyre gjatë punimeve të ndërtimit.

Para fillimit të punimeve të dheut, lokacioni i vijës së ardhshme duhet shënjuar saktë sipas projektit. Kur shënjohet vija, duhet paraqitur:

1. Linja boshtore e kanalit;
2. Instalimet nëntokësore;
3. Kabllot dhe rrjetet tjera inxhinierike nëntokësore që kryqëzohen me vijën.

Kur gërmohen gropa apo kanale në zona banimi, duhet instaluar rrethoja me shenja paralajmëruese përreth punishtes. Nëse punimet bëhen në rrugë apo përgjatë rrugës, duhet pasur kujdes që punishtja të shënjohet me shenjat e duhura rrugore, rrethoja dhe shërbime orientimi, dhe gjatë natës apo në dukshmëri të zvogëluar – me drita sinjalizuese.

Para fillimit të punimeve, drunjtë dhe pusetat përgjatë rrugës duhet mbrojtur nga mbulimi me dhe si dhe nga veturat. Duhet lënë rrugë për qasje në burime zjarrfikëse për kalim të lirë të automjeteve.

Për të siguruar qarkullimin e këmbësorëve dhe të automjeteve, duhet të vendosen ura të përkohshme mbi gropat. Urat në rrugë duhet kalkuluar për pesha jo më të vogla se dhjetë (10) tonë, derisa urat për rrugë të hyrjes në oborre – për pesha jo më pak se shtatë (7) tonë. Ura duhet të jetë aq e gjatë sa të mbahet në dheun natyror pas pjerrinës. Anët e gropës nën urat e vendosura duhet të përforcohen me pllaka.

9.8.11. STRUKTURA DHE THELLËSIA E KANALIT TOKËSOR

Kanali tokësor duhet të përbëhet nga këto pjesë:

- Shtresa e nivelimit;
- Shtresa e mbushjes fillestare;
- Shtresa e mbushjes finale.

Shtresa e nivelimit është shtresë që përbëhet nga produkte ndërtimore që formohen ose në dhe ose në strukturën e zgjedhur si bazë, si dhe është shtresa mbi të cilën do të shtrihen gypat. Trashësia e shtresës së nivelimit nuk mund të jetë më pak se 0.10 m. Madhësia maksimale e fraksionit të rërës, zhavorrit apo gurëve të thyer që përdoren për shtresën e nivelimit nuk mund të tejkalojë dhjetë (10) përqindja të diametrit të gypit; por në asnjë rast, nuk mund të jetë më shumë se 20 mm. Nëse dheu përmbush kërkesat e këtij paragrafi, shtresa e nivelimit nuk nevojitet. Shtresa e mbushjes fillestare shtrohet mbi shtresën niveluese përreth gypit për mbrojtjen e tij. Trashësia e shtresës së mbushjes fillestare nuk mund të jetë më e madhe se 0.30 m dhe jo më pak se 0.15 m mbi gyp.

Në zonë të urbanizuar, në përputhje me kushtet ekzistuese, për shtresën e mbushjes finale duhet zgjedhur produkte ndërtimore që ngjeshën lehtë. Produktet ndërtimore që përdoren për shtresën finale të mbushjes i nënshtrohen këtyre normave të fraksionit: shtresa me trashësi prej 1.00 m (e matur nga skaji i sipërm i gypit apo kabllos së komunikimit) nuk duhet të përmbajë gurë apo copëza gurësh me diametër më të madh sesa 0.30 m. Në zona jourbane, mund të përdoret dheu i gërmuar nga kanali për qëllimet e mësipërme. Thellësia e kanalit zgjidhet sipas trashësisë së planifikuar të shtresës së nivelimit, thellësisë së shtrimit të gypit, si dhe diametrave dhe llojeve të gypave. Thellësia e kanalit në hyrje të pusetës specifikohet në Tabelën si më poshtë:

Tabela 83 Thellësia e kanalit në hyrje të pusetës

Vendi i shtrirjes	Thellësia (m), kur numri i gypave kabllor në pusetë është:					
	1	2	3	4	5	6
Rrugë për këmbësorë (Trotuar[1])	0.82	0.96	1.10	1.24	1.38	1.52
Rrugë	0.92	1.06	1.20	1.34	1.48	1.62

Në trotuare me kubëza, thellësia mund të zvogëlohet deri në 0.20m por pronari i rrjetit duhet të sigurohet se kablli nuk do të dëmtohet nëse ndonjë makinë e rëndë parkohet në trotuar.

9.8.12. SHTRIMI I GYPAVE KABLLOR

Lloji i gypave kabllor do të zgjidhet në përputhje me Tabelën e mëposhtme duke marrë parasysh metodat e shtrimit të gypave, qëllimin, lokacionin e shtrirjes së gypave (vendin ku do të shtrihen gypat), thellësia e shtrimit të gypave, lloji i mbushjes fillestare me shtresë dheu, teknologjia e ngjeshjes së mbushjes fillestare, ngarkesës dhe karakteristikat e dheut.

Tabela 84 Llojet e gypave kabllor dhe fushat e përdorimit të tyre

Lloji i gypit kabllor	Klasa e ngurrtësisë	Fushat kryesore të përdorimit
110 PVC A	A	1. Në gypat kabllor të mbushura me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 2. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje. 3. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, kur thellësia e shtrirjes është më shumë se 1.60m. 4. Në vendkalimet, përmes përdorimit të një metode të shpimit.
110 PVC B	B	1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton. 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje, ku trafiku është i lejuar vetëm për automjete të lehta (≤3.5t). 4. Në vendkalimet, përmes përdorimit të një metode të shpimit.
HDPE	A	1. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 2. Në vendkalimet nën rrugë apo lagje. 3. Në kalimet e mbyllura (përmes përdorimit të metodës së shtyrjes ose shpimit).
110 PE	B	1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton. 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në gypat që kalojnë nën rrugë apo lagje, ku trafiku është i lejuar vetëm për automjete të lehta. 4. Në kalimet e mbyllura (përmes përdorimit të metodës së shtyrjes ose shpimit).
110 PE*	B	1. Në gypat kabllor të mbuluar me beton. 2. Në gypat kabllor të mbushur me rërë, të vendosur në një zonë me trafik të ngarkuar. 3. Në gypat që kalojnë nën rrugë apo lagje, ku trafiku është i lejuar vetëm për automjete të lehta. 4. Në tokë të lagur.
Çelik	-	1. Në zonat jashtëzakonisht të rrezikshme. 2. Për mbrojtje dhe përforcim.

Thellësia minimale e shtrimit të gypit kabllor (distanca minimale nga sipërfaqja e tokës deri te skaji i sipërm i gypit të sipërm) është specifikuar në Tabelën të mëposhtme :

Tabela 85 Thellësia minimale e shtrirjes së gypave

Lloji i gypit	Distanca nga sipërfaqja e tokës (m)	
	Rrugë për këmbësorë (Trotuar)	Rrugë
PVC, PE, HDPE	0.50	0.70
Çelik	0.40	0.60

Distancat mes gypave të shtrirë në rrafsh horizontal dhe vertikal nuk mund të jenë më të mëdha se 0.05m. Distanca nga skaji anësor i gypit deri te skajet anësore të kanalit nuk mund të tejkalojë 0.10m.

Kur gypat kalojnë përmes konstruksioneve të betonit, muret e pusetave, themelet e objektit, etj.), duhet të përdoren nyje adekuate për atë qëllim specifik. Brenda nyjës, duhet të ketë mbështjellës gome dhe pjesa e jashtme e nyjës duhet të betonohet sipër. Një gyp i shkurtër i diametrit më të madh mund të përdoret në vend të nyjës, ndërsa zgavrat mund të mbushen me shkumë poliuretani në vend të mbështjellësit të gomës.

Aty ku nuk kërkohet izolim nga uji, gypat mund të betonohen sipër në mur, pa nyjë.

Drejtimi i gypit duhet ndryshuar ashtu që të minimizohet fërkimi i kabllos që tërhiqet përmes gypit kundrejt mureve të gypit. Rrezja minimale e lejueshme e përkuljes së gypave PVC do të jetë 300 x d, ku d është diametri i jashtëm i gypit. Skajet e gypit që janë të përkulur duhet mbështetur, ashtu që të mos lejohet përkulja në pika të lidhjes së gypit. Devijimi maksimal i lejueshëm i këndit të lidhjes duhet të jetë 2 shkallë.

Gypat kabllor me kënd të përkuljes prej jo më shumë se 45 shkallë mund të përdoren për lidhje të gypave kabllor. Gypat kabllor që kanë kënd më të madh të përkuljes mund të përdoren vetëm në vende ku gypat futen në ndërtesa apo objekte tjera përcjellëse, por në asnjë rast, këndi i përkuljes së tyre nuk mund të tejkalojë nëntëdhjetë (90) shkallë.

Të gjitha punimet në lidhje me instalimin e gypave kabllor – prerja e gypave, lidhja e tyre, kalimi në struktura e betonit (muret e pusetave, themelet e objektit, etj.) – duhet kryer në pajtim me kërkesat e prodhuesve të atyre gypave.

9.8.13. INSTALIMI I PUSETAVE

Lloji i pusetave duhet zgjedhur në përputhje me numrin e gypave kabllor hyrës dhe ngarkesës vertikale.

Gypi kabllor dhe seksionet individuale të tyre duhet të jenë sa më të drejta që është e mundur.

Pusetat fundore duhet instaluar afër stacioneve telefonike, ndërtesave shumëkatëshe apo objekteve tjera përcjellëse si dhe duhet përdorur për instalimin e kabllove të komunikimit brenda ndërtesave apo objekteve tjera përcjellëse të lartpërmendura.

Pusetat fundore duhet të jenë të mbuluara nga jashtë me material rezistent ndaj ujit. Gypi kabllor hyrës i duhet të jetë në drejtim të pjerrët në pusetën fundore. Në rast se ka gjasa që uji të hyjë në pusetën fundore, atëherë puseta duhet të pajiset me drenazhim.

9.8.14. SHTRIMI I GYPAVE KABLLOR PËRGJATË URAVE

Gypat kabllor mund të shtrihen mbi ura që kalojnë mbi ujë, hekurudha, rrugë, viadukte dhe autostradat e ngritura (më tutje në tekst të quajtura ura) në strukturat e brendshme të urave në vendet e destinuara.

Gypat kabllor mund të shtrohen në trotuar të urave. Në mungesë të mundësisë për t'i shtruar në trotuar urash, gypat kabllor duhet instaluar në konstruksione të posaçme metalike, varur apo montuar në apo nën urë. Në këtë rast, fllanxhat mbajtëse të çelikut, sipas dimensioneve të trarëve, duhet të instalohen në konstruksione tipike.

Gypat kabllor mund të varen nën urë duke përdorur mbajtësit e gypave. Mbajtësi i fiksuar duhet të montohet në pjesën më të gjerë të gypit kabllor si dhe duhet të lidhet mirë me gypin; derisa në një mbajtës të lëvizshëm, gypi kabllor mund të lëvizë lirshëm sipas ndryshimeve të temperaturës. Distanca ndërmjet mbajtësve nuk duhet të tejkalojë 10 x d, ku d është diametri i jashtëm i gypit kabllor.

Distanca ndërmjet pusetave të përcaktohet nga kushtet dhe nevojat teknike për shtrirje të kabllit të komunikimit.

Në hyrje (afërsi) të urës, pusetat duhet instaluar sa më afër që është e mundur me shtyllën mbajtëse të urës.

Forma strukturale e gypave kabllor dhe e pusetave duhet të zgjedhet sipas dimensioneve dhe strukturës së urës; në çdo rast, forma strukturore duhet të prezantohet ndaras në projektin e ndërtimit të urës.

9.8.15. SHTRIRJA E GYPAVE KABLLOR PËRTEJ RRUGËVE NACIONALE, RAJONALE E LOKALE

Kur gypi kabllor kalon përtej rrugës nacionale, rajonale e lokale, lloji i gypit kabllor duhet të zgjedhet duke marrë parasysh ngarkesën e paraparë mbi atë rrugë në pajtim me Tabelën 85. Metoda e kalimit (gërmimi i kanalit, prerja/shpimi, shpimi i drejtuar) zgjedhet sipas llojit të rrugës apo (dhe) mbulesës së rrugës, dheut, peizazhit dhe faktorëve të tjerë.

Në kalimin përtej rrugës lokale, skaji i sipërm i gypit të sipërm kabllor duhet të vendoset në thellësi prej jo më pak 0.6 m nën sipërfaqen rrugore, në rrugë nacionale – në thellësi prej jo më pak se 1.20 m nën sipërfaqen rrugore.

9.8.16. DISTANCAT E GYPIT KABLLOR ME OBJEKTET TJERA

Kur gypi kabllor shtrihet paralelisht me rrjetet tjera inxhinierike, rrugët, ndërtesat dhe objektet tjera ose kur kalojnë përmes tyre, distancat minimale duhet të jenë jo më të vogla sesa ato që specifikohen si më poshtë.

Tabela 86 Distancat minimale e kabllove nëntokësore të komunikimit apo gypave kabllore nga objektet tjera

1.	Distanca vertikale me rrjetat e tjera inxhinierike nëntokësore	Distanca minimale (m)
1.1.	Distanca ndërmjet gypave të furnizimit me ujë, gypave të kanalizimit dhe të ujërave të zeza, gypave të ujërave të zeza fekale, sistemeve të drenazhimit, gypave të ujërave zeza - shiut dhe të:	
	a) Një kablloje të komunikimit;	0.25
	b) Një gypi kabllor.	0.15
1.2.	Distanca ndërmjet një kablloje të energjisë elektrike (duke përfshirë edhe kabullin e transmetimit të energjisë elektrike dhe rrjetin e kabllove të ndriçimit) dhe:	
	a) Një kablloje të komunikimit me mbrojtje;	0.25
	b) Një kablloje të komunikimit pa mbrojtje;	0.5
	c) Një gypi kabllor.	0.15
1.3.	Distanca ndërmjet gypave të sistemit të ngrohjes dhe:	
	a) Një kabulli të komunikimit ;	0.25
	b) Një gypi kabllor.	0.15
1.4.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të ulët, të mesëm dhe të lartë (deri në 6 kg/cm^2) dhe:	
	a) Një kablloje të komunikimit;	0.5
	b) Një gypi kabllor.	0.15
1.5.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të lartë (prej 6 kg/cm^2 deri 12kg/cm ^{2}) dhe:	
	a) Një kablloje të komunikimit (me mbrojtje ose pa mbrojtje);	0.5
	b) Një gypi kabllor.	0.25
1.6.	Distanca ndërmjet një gypi furnizues të gazit me presion të lartë (deri në 55 kg/cm^2) ose një gypi të vajit dhe:	
	a) Një kablloje të komunikimit me mbrojtje;	0.25
	b) Një kablloje të komunikimit me mbrojtje;	0.5
	c) Një gypi kabllor.	0.25

1.7.	Distanca nga një kabllo nëntokësore e komunikimit ose një gypi kabllor.	0.1
2.	**Distanca me objektet tjera në drejtim horizontal**	
2.1.	Deri te vendi ku takohet skaji i rrugës me pjesën e argjinaturës së tokës.	5
2.2.	Deri te skaji ku takohet baza e hekurudhës me argjinaturën e tokës.	5
2.3.	Distanca deri te ndërtimet inxhinierike të hekurudhës (urat, rrjetat furnizuese të kontaktit).	10
2.4.	Distanca deri te dritat sinjalizuese të trafikut hekurudhor, furnizuesve të tyre, furnizuesve të ndriçimit të jashtëm.	5
2.5.	Distanca deri te linjat elektrike me tension < 1 kV, rrjeti i ndriçimit dhe linjës mbështetëse për komunikim mbitokësor.	2
2.6.	Distanca deri te linja furnizuese e energjisë elektrike me tension > 1 kV:	
	a) të përforcuar në një bazë (metalike);	25
	b) të pa përforcuar në një bazë (dru ose beton).	10
2.7.	Distanca deri te një kabllo nëntokësore e energjisë elektrike me tension < 1 kV (përfshirë kabllot e transmetimit të energjisë elektrike dhe të rrjetit të ndriçimit).	0.5
2.8.	Distanca deri te kolektorët.	1
2.9.	Distanca deri te gypat e sistemit të furnizimit me ngrohje.	1
2.10.	Distanca ndërmjet një kablli të komunikimit dhe një gypi të sistemit për furnizim me gaz me presion të ulët, të mesëm dhe të lartë (deri në12 kg/cm^2) ose gypi të furnizimit me vaj.	1
2.11.	Distanca ndërmjet një kablli të komunikimit dhe një tubacioni furnizues të gazit me presion të lartë (deri në 55 kg / cm2) ose tubacioni furnizues të vajit.	10
2.12.	Distanca prej një gypi kabllor deri te:	
	a) një gyp furnizues i gazit me presion të ulët (deri në 0.05 kg/cm^2) ;	1
	b) një gyp furnizues i gazit me presion të mesëm (prej 0.05 deri në 3 kg/cm^2);	1.5
	c) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (prej 3 deri në 6 kg/cm^2);	2
	d) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (prej 6 deri 12 kg/cm^2) ;	3
	e) një gyp furnizues i gazit me presion të lartë (deri në 55 kg/cm^2).	10
2.13.	Distanca prej kabllove nëntokësore të komunikimit ose një gypi kabllor^2.	0.5
2.14.	Distanca nga themelet e ndërtimit.	0.6
2.15.	Distanca nga shkurret.	0.7
2.16.	Distanca nga trungjet e pemëve:	
	a) kur diametri i kurorës së gjetheve nuk është më i gjatë se 5 m;	2.0
	b) kur diametri i kurorës së gjetheve është më i gjatë se 5 m.	2+0.5 m për çdo metër shtesë të diametrit

9.8.17. SHTRIRJA E KABLLOVE - KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Elementet kryesore të kabllove janë kabllot e komunikimit dhe pajisjeve kabllore si: kornizat shpërndarëse, kabinetet shpërndarëse, kutitë shpërndarëse, shtyllat, nyjat, etj.

Kablloja mund të shtrihet brenda gypave kabllor, ose drejtpërdrejt në tokë ose në gypa mbrojtës, kolektorë, dhe bodrume, si dhe në shtyllat mbështetëse (linjat ajrore), të futura në ndërtesa apo objekte përcjellëse, si dhe të shtrira brenda ndërtesës.

Drejtimi i kabllos në mes të pajisjeve kabllore dhe rrugëve ndarëse duhet shtrirë në atë mënyrë që të ketë sa më pak ndërlidhje të mundshme lineare.

Kabllot duhet mbrojtur me masa të ndryshme të sigurisë nga shkarkimet elektrike atmosferike, nëse kablloja gjendet në afërsi të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, linjave hekurudhore të elektrifikuara, si dhe stabilimenteve tjera të transmetimit të energjisë elektrike – me masa të posaçme të sigurisë elektrike.

Gjatë shtrirjes së kabllove optike, duhet përdorur metoda të posaçme për të siguruar që kabllot me fije optike të mos ekspozohen ndaj presionit të tepërt mekanik, forcës së përkuljes dhe kompresionit. Vlerat e rrezes së përkuljes së kabllos me fije optike dhe instalimit janë të specifikuara në specifikimet saj teknike.

Përzgjatja e fijes së kabllos optike nuk duhet të jetë më e madhe se 0.20%. Është e ndaluar të tejkalohen forcat maksimale të tensionit që përcaktohen për kabllo me fije optike.

9.8.18. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË GYP KABLLOR

Kablloja e komunikimit duhet të shtrihet brenda një gypi mbrojtës apo të depërtohet drejtpërdrejt në gypin kabllor pa ndonjë gyp mbrojtës. Nëse aplikimi i kësaj metode nuk është i mundur, duhet përdorur metodat e tërheqjes mekanike të kabllos së komunikimit brenda gypit kabllor.

Kur kablloja e komunikimit kalon përgjatë disa pikave të gypit kabllor, duhet të sigurohet mbrojte e kabllos së komunikimit nga dëmtimet mekanike në hyrje dhe në dalje të gypit kabllor në çdo pusetë.

Kur shtrihet kabllo e komunikimit brenda gypit kabllor, është e obligueshme të kontrollohet forca e lejueshme e tërheqjes, ashtu që të mos tejkalojë forcën e përcaktuar me specifikimet teknike të prodhuesit të kabllos së komunikimit. Gjatësia e kabllos së komunikimit e tërhequr brenda gypit kabllor zgjedhet duke marrë parasysh forcën maksimale të lejueshme të tërheqjes për konstruksionin specifik të kabllos së komunikimit, fërkimit brenda gypit, si dhe peshës së kabllos së komunikimit.

Kabllot e komunikimit nuk duhet të përdredhen apo çiftëzohen me njëra-tjetrën në pusetë.

Kabllot e komunikimit në pusetë duhet shenjuar dhe përforcuar në konzollë.

Distanca nga kabllo e komunikimit deri te kapaku i pusetës dhe dyshemesë nuk mund të jetë më e vogël se 0.3 m.

Pas kryerjes së punimeve të shtrimit të kabllos së komunikimit, hapjet e hyrjes në gyp duhet mbyllur mirë (p.sh. "shkumë").

9.8.19. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT MBI URA

Kabllot e komunikimit që duhet shtrirë në ura shtrihen përmes kanaleve të siguruara në strukturat e urës (gypa apo kolektorë) si dhe në mungesë të tyre – në gypa mbrojtës; megjithatë, duhet marrë parasysh edhe lëvizja e strukturave të urës në vendet e tegelave të saldimit me ndjeshmëri temperature, vendet e vibrimit nga trafiku, si dhe kushtet teknike të personave që shfrytëzojnë (apo operojnë me urat).

Në vendet ku ka mundësi të vibrimit të madh (p.sh. në vendet e shtyllave mbajtëse dhe zgjerimit të urave), apo ku ka rrezik të lakimeve të tepërta (p.sh. seksionet e kabllove mes urave dhe pjerrinave), kabllot e komunikimit duhet shtrirë në gypa mbrojtës.

9.8.20. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT DREJTPËRDREJT NË TOKË

Të gjitha punimet e dheut, kur shtrihen kabllot e komunikimit, kryhen në pajtim me kërkesat të dhëna:

- Gërmimi dhe rivendosja e rrugëve dhe trotuareve për këmbësorë;
- Gërmimi i gropave dhe kanaleve;
- Punët e përforcimit për gropa e kanale;
- Mbushja e gropave dhe kanaleve me dhe;
- Ngjeshja e dheut;
- Ngarkimi dhe heqja e dheut sipërfaqësor;
- Nivelimi i dheut dhe punë të tjera me dhe.

Kur bëhet shtrirja e kabllove të komunikimit drejtpërdrejt në tokë, ato duhet shtrirë në thellësi prej jo më pak se 0.75 m nën sipërfaqen e dheut.

Metodat e shtrirjes së kabllove të komunikimit drejtpërdrejt në tokë zgjidhen duke marrë parasysh lokacionin e terrenit të dheut dhe rrjeteve tjera inxhinierike, trafikun rrugor, ndërtesat dhe objektet tjera. Për të shtrirë kabllot e komunikimit drejtpërdrejt në tokë, mund të përdoren metodat vijuese:

- Shtrirja në kanale;
- Shtrirja me "shtrirës kablloje";
- Shtrirja përgjatë pengesave, duke përdorur metodën e prerjes apo metodën e shpimit të drejtuar.

Drejtpërdrejt në dhe mund të shtrihen vetëm kabllot e komunikimit të posaçme me rezistencë më të madhe mekanike, apo të mbrojtura me gyp mbrojtës.

Kur shtrihen kabllot e komunikimit, duhet të sigurohet që ngarkesa mekanike, e shkaktuar nga aplikimi i njërës prej metodave të shtrirjes të përmendura tabelën Nr 4 më sipër, mbi kabllot e komunikimit, të mos tejkalohet, si për shembull forca maksimale e lejueshme e tërheqjes, e përkuljes, rrezja e përkuljes dhe forca ndrydhëse të përcaktuara në specifikimet teknike të prodhuesve duhet të mos tejkalohen.

Për të shmangur dëmet e mundshme ndaj kabllove të komunikimit të shtrira me punime gërmuese, kabllot e komunikimit të shtrira në tokë duhet mbrojtur duke shtruar një shirit paralajmërues në lartësi 0.3 m mbi to.

9.8.21. SHTRIRJA E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT NË KANALE

Kablloja e komunikimit e shtrirë në kanal nuk mund të tendoset si dhe duhet të shtrihet direkt në fund të kanalit.

Në tokë të butë, kabllot e komunikimit mund të shtrihet drejtpërdrejt në fund të kanalit të hapur, e pastaj të mbulohet me dhe të gërmuar më herët, e të shoshitur. Në tokë të fortë, kabllot e komunikimit duhet shtrirë mbi një shtresë rëre apo dheu të shoshitur me trashësi prej së paku 0.1 m, të hedhur direkt në fund të kanalit, si dhe së paku 0.1 m shtresë të mbushjes me dhe të shoshitur që shtrohet mbi kabllot e komunikimit.

Kur shtrihen disa kabllo të komunikimit në një kanal, ato duhet shtrirë paralelisht, pa kurrfarë përdredhje.

Para se të mbushet kanali me mbushje dheu, të gjitha kabllot nëntokësore të komunikimit dhe pajisjet tjera duhet shënjuar në skicat e punës duke shënuar edhe distancat e tyre me objektet e afërta.

9.8.22. KALIMI I RRUGËVE NACIONALE (LOKALE) DHE ARGJINATURAVE TË DHEUT GJATË SHTRIRJES SË KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT

Në kalimet mbi rrugë rajonale (lokale) dhe brezave të rrugës, kablloja mund të shtrihet me anë të këtyre metodave me:

- "Shtrirës kablloje";
- Hapje të kanalit;
- Mënyrë të mbyllur (duke kryer shpime);
- Linjë ajrore.

Metoda e shtrirjes së kabllove me "shtrirës kablloje" mund të përdoret vetëm kur kalohet përmes rrugës, shiritave për çiklistë dhe vende të tjera me mbulesë të shtrimit me zhavorr. Kablloja mund të shtrihet me "shtrirës kablloje" drejtpërdrejt në dhe në rrugët kur nuk ka shumë trafik,. Në rastet tjera, kabllot duhet shtrirë me gypa mbrojtës. Para shtrirjes së kabllove apo gypave mbrojtës me "shtrirës kablloje", pikat e kalimit nëntokësor të rrjeteve inxhinierike duhet të gërmohen ose duhet të instalohen kalime nëntokësore.

Kur përdoret metoda e hapjes së kanaleve, në kanal duhet shtrirë gypi mbrojtës, e pastaj që kanali të mbushet me mbushje dheu, ndërsa dheu në atë vend duhet të ngjeshët. Pas tërheqjes së tubit mbrojtës apo kabllos së komunikimit brenda këtij tubi, skajet e gypit duhet mbyllur mirë. Në rastin e shtrimit të kabllove nën rrugë nacionale (lokale), në argjinaturat e dheut në mënyrë të mbyllur, duhet të bëhen me gypa mbrojtës. Gypat mbrojtës duhet instaluar me anë të shpimit. Kabllo e komunikimit apo gypi mbrojtës duhet tërhequr brenda gypit kabllor me anë të metodës së shpimit.

Në kalime të rrugës, skaji i sipërm i gypit të sipërm mbrojtës duhet të vendoset në thellësi prej jo më pak se 0.7 m nën sipërfaqen e rrugës, mbi rrugë – në thellësi prej jo më pak se 1.2 m nën sipërfaqen e tokës. Nëse nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë, gypat shtrihen brenda një kolektori mbrojtës, apo betonohen në dhe.

Pas shtrirjes së tubit mbrojtës dhe tërheqjes së kabllos së komunikimit përmes tij, hapjet e gypit duhet mbyllur.

Rrugët nacionale (lokale), argjinaturat e dheut duhet kaluar me linjë ajrore në pajtim me kërkesat e nenit 19 të Rregullores 05/2017.

9.8.23. KRYQËZIMET ME HEKURUDHAT

Në kryqëzimin e kabllove me hekurudha, duhet përdorur gypa PVC, PE apo gypa kabllor të çelikut, ndërsa shtrirja e tyre nën hekurudhë duhet të bëhet në mënyrë të mbyllur (me anë të shtyrjes përtej apo shpimit të drejtuar), varësisht nga dheu dhe peizazhi.

Kur kablloja kalon përmes hekurudhës, këndi i kryqëzimit duhet të jetë sa më i pjerrët që është e mundur; gjithsesi, ky kënd nuk mund të jetë më i vogël se 45 shkallë.

Punimet e gërmimit të dheut duhet kryer në distancë prej jo më pak se 3 m nga skaji i bazës së argjinaturës së dheut të hekurudhës.

Distanca nga sipërfaqja e hekurudhës me gypin mbrojtës nuk mund të jetë më e vogël se 1.2 m si dhe jo më pak se 0.6 m nga baza e argjinaturës së dheut të hekurudhës.

Gypi mbrojtës duhet të shtrihet në dy skaje për së paku:

- 2.00 m nga skaji i jashtëm i bazës së gropës;
- 3.00 m nga skaji i bazës së argjinaturës së hekurudhës;
- 5.00 m nga shinat e jashtme të hekurudhës.

Kabllot me fije optike që duhet shtruar përgjatë shinave të hekurudhës duhet të jenë me mbrojtje dielektrike.

9.8.24. KRYQËZIMET ME UJËRA

Kur kalohet përtej ujërave, kabllot e komunikimit mund të shtrihen:

- Nën ujë;
- Mbi ura;
- Me linja ajrore.

Kabllot e komunikimit të shtrira nën ujë duhet të jenë të izoluara.

Rruga e kabullit përmes ujërave të navigueshëm nga urat rrugore dhe hekurudhore duhet të shtrihet nën këto ura në drejtimin e rrjedhës së ujit. Distanca e rrugës kabllore nga ura rrugore apo hekurudhore nuk mund të jetë më e vogël se 200 m.

Nëse ka urë në rrugën e kabllos së komunikimit që shtrihet mbi ujëra të navigueshëm, njëra kabllo duhet shtrirë mbi urë, ndërsa një kabllo rezervë nënujore rekomandohet të shtrohet në atë distancë nga ura.

Kur rruga kabllore kalon në ujëra të panavigueshëm, distanca ndërmjet kabllove nënujore të komunikimit dhe urës rrugore e hekurudhore nuk duhet të jetë më e vogël se 50 m.

Kabllot e komunikimit nënujore dhe nëntokësore duhet lidhur jo më afër se 30 m nga bregu i hapësirës ujore.

Nëse argjinatura e hapësirës ujore përbëhet nga graniti, guri, betoni apo druri, atëherë në vendet e lidhjes së kabllos nënujore të komunikimit me atë nëntokësore, duhet përdorur gypa kabllor me rezistencë më të madhe. Sipas nevojës, puseta duhet instaluar në brigje. Duhet të shtrihen gypa kabllor nga puseta deri te pjesa nënujore e asaj vije.

Kabllo nënujore e komunikimit duhet të ngjitet për dyshemenë e hapësirës ujore.

Kabllot e komunikimit përtej trupave ujorë mund të shtrihen përmes gypave mbrojtës nëntokësorë, që duhet shtrirë me metodën e shpimit të drejtuar.

9.8.25. DISTANCAT NËNTOKËSORE TË KABLLOVE ME OBJEKTET TJERA

Kur shtrohet kablloja nën tokë paralelisht me rrjetet tjera inxhinierike, trafikun rrugor, ndërtesat dhe objektet tjera, apo kur kalon nëpër to, distancat minimale duhet të jenë jo më të vogla sesa ato që specifikohen me Tabelën 4 të kësaj Shtojce.

Në kryqëzimet e kabllove me rrjetet tjera inxhinierike, punët e gërmimit duhet të bëhen manualisht. Nëse ka ndonjë rrjet inxhinierik që gjendet në thellësi më pak se 1.20 m, kablloja e komunikimit ose gypi mbrojtës duhet shtrirë nën këtë rrjet inxhinierik. Nëse objekti nëntokësor i rrjetit gjendet në thellësi prej 1.20 m apo më shumë, kablloja e komunikimit ose gypi mbrojtës duhet shtrirë mbi këtë rrjet inxhinierik në thellësi prej jo më pak se 0.75 m.

9.8.26. SHTRIRJA E LINJËS AJRORE KOMUNIKUESE

Kabllot e komunikimit që përdoren në linja ajrore duhet të jenë vetëm ato që janë të për këtë qëllim, pa shkelur kërkesat në specifikimet teknike të prodhuesit të kabllos së komunikimit.

Kabllot e komunikimit duhet varur në mbajtëse në atë mënyrë që pesha në shtyllë jetë baras e shpërndarë (dy kabllo komunikimi duhet varur në anët e kundërta të mbajtëses). Për montimin e tyre, duhet përdorur elementet e montimit të kabllos së komunikimit të specifikuar nga prodhuesi.

Gjatësia maksimale e lejueshme e linjave të kabllos së komunikimit ndërmjet shtyllave mbajtëse përcaktohet në bazë të parametrave mekanikë të kabllos së komunikimit, litarit mbajtës dhe shtyllave të përcaktuara nga prodhuesi.

Në rastin e përdorimit të veglave e duhura të montimit dhe metodën e tërheqjes së kabllos së komunikimit, është e detyrueshme të sigurohet që vlerat maksimale të lejueshme për rezistencën e kabllos së komunikimit në tërheqje, hapësirat mes shtyllave mbajtëse, ngarkesa e erës, të specifikuara në specifikimet teknike të kabllos së komunikimit të mos tejkalohen.

Në linja ajrore të komunikimit, duhet bërë bashkëngjitja e kabllove të komunikimit në shtyllë mbrojtëse në lartësi prej së paku 3.00m.

Kur shtrihet linja ajrore e komunikimit paralelisht me linjën ekzistuese ajrore, duhet ruajtur një distancë e sigurisë ndërmjet atyre linjave ajrore.

Kur kalohet përtej linjave të energjisë elektrike, këndi i kryqëzimit do të jetë sa më i pjerrët që është e mundur; megjithatë, ky kënd nuk mund të jetë më i vogël se 45 shkallë.

Kur kalohet përtej linjave të energjisë elektrike, linjat ajrore të komunikimit duhet pozicionuar nën linjat energjetike përveç për rrjetet e transmisionit të energjisë elektrike. Nëse për shkak të arsyeve objektive, nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë, linjat ajrore të komunikimit mund të pozicionohen mbi linjat elektrike 400/220 V në distancë që nuk duhet të jetë më e vogël se 1.25 m. Kablloja e komunikimit që duhet shtrirë mbi linjën elektrike duhet të ketë montim të dyfishtë. Në kryqëzime, telat e linjave ajrore të komunikimit duhet të kenë izolim rezistues ndaj efekteve atmosferike, tensioni testues i të cilave nuk mund të jetë më i ulët se 2 kV. Nëse kabllot nuk kanë pjesë metalike, nuk është e nevojshme të mbahet distanca prej 1.25 m.

Linja ajrore e komunikimit mund të kryqëzohet me linjë të energjisë elektrike deri në 1 kV në lokacionin e ndarjes dhe mbajtëses; megjithatë, linjat ajrore të komunikimit me fije të pa izoluara apo kabllot e komunikimit me fije apo litar mbrojtës të pa izoluar nuk mund të montohen mbi shtylla mbajtëse të linjave të energjisë elektrike.

Linja ajrore e komunikimit mund të kryqëzohet me linjën e energjisë elektrike me tension prej më shumë se 1 kV vetëm në pikën e ndarjes së saj. Distanca horizontale nga shtylla mbajtëse e linjës ajrore të komunikimit deri tek fija më e afërt e linjës së energjisë elektrike duhet të jetë së paku 15 m. Kur kryqëzohet me linjën e energjisë elektrike me tension prej 400 kV, distanca ndërmjet majës së shtyllës mbajtëse të linjës ajrore të komunikimit dhe fijes më të afërt të linjës së energjisë elektrike duhet të jetë së paku 20 m.

Kabllot e izoluara të linjës ajrore të komunikimit mund të shtrihen në shtylla mbajtëse të përbashkëta me linjat e energjisë elektrike 400/220 V. Kabllot e komunikimit duhet montuar në shtylla mbajtëse të linjës së energjisë elektrike nën linjat e energjisë elektrike. Distanca ndërmjet kabllove të komunikimit dhe linjave të energjisë elektrike në shtylla mbajtëse nuk mund të jetë më e vogël se 1.50 m.

Distancat minimale ndërmjet linjave ajrore të komunikimit ose rrjeteve të tjera inxhinierike me objektet tjera janë përcaktuar në Tabelën më poshtë si më poshtë :

Tabela 87 Distancat minimale ndërmjet linjave ajrore të komunikimit me objektet tjera

Nr.	Kushtet	Distanca minimale (m)
1.	Distanca në drejtim vertikal.	
1.1.	Me sipërfaqen e tokës.	4.5
1.2.	Me sipërfaqen e tokës, kur linjat e komunikimit kalojnë mbi rrugë ose lagje.	6.0
1.3.	Me hekurudhën, ku kalojnë trenat .	7.5
1.4.	Distanca nga një linjë mbitokësore e komunikimit (ajrore) deri në rrugë.	4.5
1.5.	Distanca nga një linjë ajrore komunikimit deri në trotuarin për këmbësorë brenda një zone të mbjellë të tokës.	3.0
1.6.	Distanca deri te sipërfaqja e ujit, ku kalojnë ujërat jo të navigueshëm, kanalet, etj.	2.5
1.7.	Distanca prej pikës më të lartë të telit të një linje mbitokësore të komunikimit ose një kabulli deri teli më i ulët i një linje të energjisë elektrike ose nivelit maksimal të një kabulli të varur kur kalojnë linjat energjisë elektrike me tension: a. deri në 1 kV; b. 6–10 kV; c. 35 kV, 110 kV;	 1.25 2 3

	d. 220 kV; e. 400 kV.	4 5
1.8.	Distanca në mes të linjave mbitokësore(ajrore) të komunikimit.	0.5
1.9.	Distanca nga maja e çatisë ose elementeve më të larta të vendosura mbi çati (me përjashtim të vendeve ku vështirë i qasemi).	0.8
1.10.	Distanca në mes "kutisë hyrëse" të linjave të komunikimit mbitokësor dhe "kutisë hyrëse" të linjës së energjisë elektrike (400 / 220V) brenda ndërtesave.	0.5
1.11.	Distanca nga degët e pemëve.	1.0
2.	Distanca në drejtim horizontal	
2.1.	Distanca më e afërt në mes të telit të jashtëm të një linje mbitokësore(ajrore)të komunikimit ose një kabulli të mënjanuar dhe një shtylle mbajtëse të energjisë elektrike , kur linjat ajrore të kalojnë njëri-tjetrin në një ndarje: a) Linjat elektrike me tension deri 1 kV; b) Linjat elektrike të tensionit mbi 1 kV.	 2.0 7.0
2.2.	Distanca prej telit më të afërt të jashtëm të një linje mbitokësore (ajrore) të komunikimit ose një kabulli të mënjanuar nga një ndërtesë e ndërtuar, maja e një çatisë, ballkonit.	1.5
2.3.	Distanca në mes të telit më të afërt e jashtëm të një linje mbitokësore (ajrore) të komunikimit ose një kabulli të larguar dhe shtyllave.	Lartësia e një shtylle
2.4.	Distanca në mes të telit më të afërt të jashtëm të një linje ajrore të komunikimit ose një kabulli të mënjanuar, shkurreve ose diametrit të kurorës së drunjëve.	1.5

9.8.27. KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR LIDHJEN E KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT

Kabllot e komunikimit duhet lidhur me anë të nyjave që janë prodhuar për këtë qëllim.

Kur shtrihen kabllot e komunikimit në gypa kabllor, në tokë dhe në linjat ajrore të komunikimit, duhet aplikuar nyjat që tkurren nga nxehtësia apo nyjat me aplikim të ftohtë. Nyjat e tilla duhet të përbëhen nga materialet që nuk ndërrojnë veçoritë e tyre për së paku tridhjetë (30) vjet.

Kur shtrihen kabllot e komunikimit drejtpërdrejt në tokë, duhet lënë një gjatësi rezervë e kabllos për lidhjen e kabllove të komunikimit. këtyre kabllove.

Në ndërtesa dhe kanale vertikale (të ndërtesës), duhet të përdoren nyja që tkurren në nxehtësi apo nyjat që mbyllen mekanikisht.

Nyjat që mbyllen mekanikisht, që përdoren për lidhjen e kabllove të komunikimit brenda ndërtesave, duhet të jenë të prodhuara me PE, plastikë tjetër apo çelik, si dhe duhet të ruajnë veçoritë e tyre për së paku tridhjetë (30) vjet.

Të gjitha llojet e nyjave duhet montuar në pajtim me udhëzimet e prodhuesit të tyre.

Montimi i nyjave për kabllot me fije optike duhet të bëhet në pajtim me kërkesat e sigurisë vetëm në hapësirat e caktuara të mbrojtura nga efektet atmosferike. Montimi i nyjave për kabllot optike bëhet vetëm me pajisje dhe vegla të dizajnuara enkas.

9.8.28. SHËNJIMI I KABLLOVE TË KOMUNIKIMIT

Kabllot e komunikimit në pusetë, kolektorë dhe kanalet vertikale duhet shënjuar me etiketë plastike apo plumbi të shënjimit të ngjitur për kabllon e komunikimit. Etiketa e shënjimit duhet të jetë së paku 40 mm në gjerësi dhe 20 mm në lartësi. Etiketa plastike e shënjimit duhet të jetë e bardhë ose e verdhë. Shënimet në etiketat e plumbit duhet gravuar me çekiç të posaçëm, derisa në karta plastike, shënimet shkruhen me laps të zi, shenjat e të cilit janë rezistente ndaj ndikimeve të mundshme mjedisore.

Etiketa e shënjimit duhet të përmbajë informatat që mundësojnë identifikimin e:

- Pronarit të linjës së komunikimeve elektronike (emri i entitetit, kodi, numri konvencional);
- Llojin e kabllos së komunikimit;
- Fillimin dhe fundin e linjës së komunikimeve elektronike (adresa e fillimit dhe e fundit).

Kabllot e furnizimit të energjisë nga largësia në pusetë, kolektorë, kanale vertikale e bodrume duhet ngjyrosur me shirita të kuq (dy shirita të kuq me gjerësi 0.20 m me distancë prej 0.10 m mes tyre) për secilin gyp, si dhe nga secili skaj i nyjës në distancë prej 0.10 m prej tij.

9.9. RRJETI I MBETURINAVE NËNTOKËSORE DHE MBI TOKËSORE

Bazuar në planet zhvillimore sektoriale të hartuara si pjesë e Planit Zhvillimor Komunal në fuqi, të Komunës së Vitisë, por edhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese të sistemit të mbeturinave, UA kërkon planifikimin e infrastrukturës teknike si: kapaciteti dhe shtrirja e rrjetit, ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet për rrjetin e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave mbitokësore e nëntokësore dhe ndërtesat dhe hapësirat për riciklim.

Pas hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Vitisë, çdo zgjerim i rrjetit në funksion të përmbushjes së Planit të Veprimit, projektet përgatiten nga komuna dhe kompania rajonale e mbeturinave, dhe akterët tjerë të rëndësishëm (qytetarët, bizneset, OJQ dhe hisedarët e tjerë të zonës për të cilën kryhet projekti). Projektet të cilat hartohen duhet të jenë në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, normat teknike, dhe direktivat e BE-së. PZHK parasheh përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe operacionale për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave komunale.

Skema e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave (SGTM) në komunë, ndjek këtë radhë:

- Vendosja e kontejnerëve për grumbullimin (ruajtjen e përkohshme) e tyre;
- Hedhja e mbeturinave nga konsumatorët;
- Mbledhja dhe transportimi i mbeturinave;
- Shkarkimi i mbeturinave në pikën përfundimtare të depozitimit në deponinë regjionale.

Për parashikimin dhe organizimin më të mirë të skemave dhe sistemeve të përshtatshme të grumbullimit të mbetjeve, rekomandohet që gjithë zona e mbetjeve të ndahet në nënzona, bazuar në tipologji të ndryshme urbane dhe sipas tipit të konsumatorit/prodhuesve të mbetjeve, me qëllim:

- Planifikimin e një infrastrukture të përbashkët të mbledhjes së mbetjeve
- Uniformitetin në ofrimin e shërbimit, dhe
- Organizimin e programeve të përbashkëta për minimizimin e mbetjeve

Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale detyrohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për grumbullimin e mbeturinave komunale, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në vendet e caktuara për to.

Amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale, janë të detyruar të bëjnë ndarjen e mbeturinave në lloje, sipas kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent, me qëllim të trajtimit dhe riciklimit të tyre.

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave

Personi i licencuar për mbledhjen, grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, mbledh dhe grumbullon mbeturinat prej prodhuesit dhe zotëruesit dhe i transporton deri tek objekti në të cilin bëhet menaxhimi i mbeturinave.

Mbeturinat e rrezikshme paraprakisht klasifikohen sipas llojeve, mblidhen, grumbullohen dhe transportohen.

Mbeturinat transportohen me mjete adekuate dhe mënyra të përshtatshme, për të mos ardhur deri tek shkapërderdhja, rrjedhja dhe rënia e tyre.

Nëse ndotja ndodhë gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar që vendin e ndotur ta kthejë në gjendje të mëparshme.

Nëse mbeturinat e transportuara, nuk pranohen në vendin e destinuar, transportuesi duhet ta kthejë mbeturinën në vendin ku është marrë.

Numri dhe vendndodhja e pikave të grumbullimit të mbeturinave (PGM)

Përbën një çështje të rëndësishme të skemës së grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave, pasi që ndikon në numrin e personelit të nevojshëm, numrin dhe kapacitetin e kontejnerëve, numrin dhe kapacitetin e kamionëve të mbeturinave, të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë në koston e grumbullimit.

Pikat e grumbullimit mund të përmbajnë një ose disa kontejnerë. Vendosen në pika të veçanta, pranë rrugëve kryesore dhe dytësore (pranë kryqëzimeve apo trotuareve) ose pranë konsumatorëve (brenda zonave të banimit, pranë njësive tregtare, zonave tregtare, restoranteve, etj). Për përzgjedhjen e tipit të pikës së grumbullimit (të përbashkët apo individuale) si dhe frekuencën e vendosjes së tyre duhet të mirren parasysh disa elemente:

- Pikat të jenë lehtë të qasshme për banorët dhe kamionët e mbeturinave
- Standardet dhe rregulloret në fuqi
- Pronësia dhe përgjegjësia
- Konsiderata të shëndetit dhe sigurisë (vendosja e PGM në distancë të tillë nga banorët që të ulë mundësitë për depozitim të paligjshëm dhe të dekurajojë tek konsumatorët përdorimin e papërshtatshëm të SGM)
- Kostot, mundësitë financiare dhe efektiviteti
- Përmbushja e objektivave të planit, dhe
- Faktorë të tjerë

Distancat mesatare mes PGM për zona të ndryshme urbane

Dendësia e vendosjes së PGM	Shumë e dendur	E dendur	Mesatarisht e dendur	Jo e dendur (e rrallë)	Shumë e rrallë
Largësia e vendosjes së PGM	100	100-150	150-250	250-400	>400

Për zonat rurale, që nuk është ofruar shërbimi i menaxhimit të mbeturinave më herët, rekomandohet që shërbimi të fillojë me një rrjet jo të dendur të pikave të grumbullimit, me një largësi vendosje ndërmjet pikave prej 400 m ose më shumë. Me fillimin e funksionimit dhe normalizimit të shërbimit dhe eksperiencës, në një fazë të dytë, mund të shtohet numri i pikave të grumbullimit dhe kontejnerëve, sipas nevojave.

Frekuenca e grumbullimit të mbeturinave

Frekuenca e grumbullimit lidhet dhe ndikon në vendosjen e PGM, numrin e kontejnerëve dhe kamionëve të mbetjeve, koston dhe efektivitetin e tyre. Në zona urbane, mbeturinat grumbullohen të paktën një herë në ditë nga kamionë të posaçëm teknologjikë, të pajisur me:

- Sistem hidraulik ngritës për zbrazjen automatike të kontejnerëve
- Shtytës pneumatik për të bërë ngjeshjen/kompaktësimin e mbeturinave

Në zonat tjera rekomandohet frekuencë më e vogël shërbimi (duke qenë se frekuenca e shpeshtë e grumbullimit sjell rritjen e mëtejshme të kostos së shërbimit) me një numër më të madh kontejnerësh, por pa cenuar elementet e higjienës dhe sigurisë së shëndetit. Për zona të veçanta (tregje, qendra tregtare, etj.) rekomandohet që mbeturinat të largohen dhe të pastrohen detyrimisht çdo ditë.

Kontejnerët e mbyllur mundësojnë largimin e mbeturinave deri një herë në tri ditë, ndërsa kontejnerët e hapur kërkojnë pastrim të përditshëm të mbeturinave.

Kontejnerët duhet të jenë:

- Funksional për sasinë dhe llojin e mbetjeve që grumbullojnë
- Të përshtatshëm për kamionët e mbetjeve që përdoren
- Të jenë të qëndrueshëm nga dëmtimet
- Të lehtë për t'u përdorur
- Ekonomikë
- Të rezistueshëm ndaj gërryerjes, motit dhe kafshëve, etj.

Frekuencat dhe oraret e pastrimit të rrugëve si dhe klasifikimi i tyre sipas nevojave për pastrim, përcaktohen nga Komuna, bazuar në monitorimet dhe vëzhgimet në terren. Përveç frekuencës së shërbimit, koha e pastrimit duhet të përcaktohet me kujdes për të shmangur trafikun, makinat e parkuara dhe këmbësorët.

Deponimi i mbeturinave

Mbeturinat, në varësi të karakteristikave të tyre, duhet të deponohen në deponitë e lejuara përkatëse, të cilat ndahen në: deponi për mbeturinat e rrezikshme; deponi për mbeturinat jo të rrezikshme; deponi të mbeturinave inerte.

- **Mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore**

Personat të cilët menaxhojnë mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore duhet të jenë të licencuar. Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 07/2015, menaxhimi i këtij lloji të mbeturinave është obligim i Komunës. Sipas këtij UA, Komuna në bashkëpunim me komunat përreth, mund ta ndërtojnë një deponi për mbeturinat nga ndërtimi/demolimi me qëllim të mos degradohet edhe më tej mjedisi. Ky UA gjithashtu përcakton kriteret për përzgjedhjen e vendeve të përshtatshme për këtë lloj të mbeturinave, ku ndër më të rëndësishmet janë: Vende të përshtatshme për deponimin e këtij lloji të mbeturinave mund të jenë vendet që më parë janë shfrytëzuar për eksploatim me qëllim të mbushjes së gropave, kanaleve të ndryshme të formuara në mënyrë të natyrshme, vende të degraduara si rezultat i erozionit ose rrëshqitjeve të dheut, apo vende tjera të ngjashme.

Megjithatë, siç është përmendur edhe më lartë, është përgjegjësi e komunës t'i trajtojë mbetjet e demolimit/inerte. Mund të thuhet se të gjitha komunat në Kosovë kanë mbetur prapa në krijimin e deponive/vendeve të përshtatshme për depozitimin e këtyre mbeturinave.

Plani Zhvillimor Komunal, në kuadër të zhvillimeve sipas sektorëve, parasheh që të bëhet caktimi i lokacionit dhe ndërtimi i pikës që do të shërbejë si pikë për grumbullimin e mbeturinave inerte. Andaj, me HZK janë paraparë edhe kushtet për caktimin e një lokacioni te mbeturinave inerte.

- **Kushtet për përzgjedhjen e lokacionit**

1. Deponitë e mbeturinave, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1.1. Në gryka të rrethuara me shpatina, sipërfaqe që kanë shërbyer për eksploatim, apo në lokacione të rrafshëta;
1.2. Në largësi nga kufiri i zonës neutrale, që rrethon deponitë deri tek shfrytëzimet në vijim:
1.3. Nga rrjetet e gazsjellësit: 60 m
1.4. Nga rrjetet elektrike: 100 m
1.5. Nga infrastruktura hekurudhore: 100 m;
1.6. Nga ndërtesat e banimit: 500 m,;
1.7. Nga zona e monumenteve kulturore, historike dhe religjioze: 600 m;
1.8. Nga shtretërit e lumenjve dhe brigjet e liqeve: 1000 m;
1.9. Nga vendbanimet: 1500 m;
1.10. Nga burimet e ujit dhe ujësjellësit dhe spitalet: 2000 m
1.11. Nga spitalet: 2000 m;
1.12. Nga infrastruktura ajrore: 4000 m.

2. Deponitë e mbeturinave, nuk duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

2.1. Në zonat e rrezikuara nga erozioni;
2.2. Në zonat e rrezikuara nga vërshimet apo të vërshuar në 25 vitet e fundit;
2.3. Në zonat me shkallë të lartë të rrezikshmërisë sizmike;
2.4. Në zonat me pjerrtësi të thukët;
2.5. Në zonat ku ujërat nëntokësorë janë afër sipërfaqes së tokës;
2.6. Në zonat me pasuri minerale dhe minimet;
2.7. Në zonat me përdorim intensiv të bujqësisë;
2.8. Në zonat ku rrezikon llojet e veçanta të florës dhe faunës;
2.9. Mbi strehimore apo tunele nëntokësore;
2.10. Në zonat ku distanca nga fundi i deponisë deri tek niveli ujërave nëntokësore gjatë sezonit është më e vogël se 2.00 m;
2.11. Në zonat ku përshkueshmëria e tokës është më e madhe se 0,00001 cm/s.
2.12. Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura ndalohet ndërtimi i deponisë për mbeturina. Në lokacionin ku ndërtohet apo planifikohet deponia e mbeturinave, paraqitet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zonat e veçanta të mbrojtura

- **Mbeturinat e rrezikshme**

Deponimi i MRr do të lejohet nëse gjatë dhe pas deponimit të tyre, mjedisi nuk kërcënohet nga ndotja apo nuk tejkalohen limitet për standardet e caktuara për ajrin, ujin dhe tokën. Deponimi i MRr bëhet në objekte dhe deponi të cilat janë të studiuara, dizajnuara apo konstruktuara mirë si dhe posedojnë Lejen përkatëse nga Ministria.

Menaxhimi i mbeturinave të rrezikshme

Vendet për magazinim duhet të jenë të ndara me rrethojë dhe të shënuara me vërejtjen për rrezikun dhe llojin e mbeturinës për trajtim, transferim, magazinim etj.

Të krijojnë hapësirë për qasje të lirë për transportuesit gjatë ngarkimit/zbrazjes së MRr.

MRr duhet të jenë sa më afër vendit për shkarkim-ngarkim.

Të shënohen qartë me shenja adekuate secila nga pajisjet, ambalazhet në mënyrë të veçuar nga njëra-tjetra.

Të ndalohet qasja e personave jo kompetent në vendet ku operohet.

Të pajisen me sistemin për mbrojtjen nga zjarri.

Të pajisen me automjete, kontejnerë dhe instalim të larjes si dhe instalim të ujësjellësit.

Të gjitha kullimet mblidhen ndarazi, përveç nëse është specifikuar ndryshe nga autoritetet kompetente.

Të sigurohet sasia e mjaftueshme e absorbuesve (dheu, rëra, leshi, tekstile etj.) për të kufizuar rrjedhjen e mundshme të MRr.

Në të gjitha vendet pranuese duhet bërë zgjidhje teknike adekuate për të izoluar sa më mirë MRr dhe për të siguruar pa depërtueshmëri te mbeturinave në ujë dhe tokë

MRr duhet të magazinohen ndarazi nga materialet ndihmëse të tjera.

Vendet për automjete transportuese të MRr dhe për qëndrim të përkohshëm të kontejnerëve duhet të jenë të shënjuara dhe të ndara nga vendi për magazinim e MRr.

Magazinimi i MRr të seleksionuara duhet të bëhet në distancë të mjaftueshme për të garantuar siguri nga rreziku.

Kur mbeturinat kërkojnë masa shtesë të sigurisë, ato masa duhet të sigurohen patjetër.

Rrjedhja ose shpërndarja e MRr nga kontejnerët duhet të sanuar sa më parë për të zvogëluar ndotjen.

MRr jo-kompatibile duhet të deponohet në një distancë të mjaftueshme ndaj njëra-tjetrës për të mos paraqitur rrezik për mjedisin.

Kapaciteti për ruajtje të përkohshme të MRr duhet të jetë në harmoni me kapacitetet për prodhim dhe magazinim të MRr.

Grupet e MRr me përqendrime të mëdha të substancave të dëmshme duhet të transferohen dhe të magazinohen në vende të veçanta.

Menaxhimi i mbeturinave të veçanta

Mënyra e menaxhimit, kushtet dhe rregullat për mbeturinat e veçanta, përcaktohen me aktet nënligjore përkatëse.

Personat që menaxhojnë mbeturinat e veçanta, duhet të jenë të licencuar.

- **Vajrat e përdorura dhe mbeturinat me vajra**

Është e ndaluar që vajrat mbeturinë të derdhen ne tokë, ujë, në rrjetin e ujërave të zeza, të magazinohen ose deponohen në vende të papërshtatshme dhe të përpunohen në pajisje të cilat ndotin ajrin, ujin dhe tokën.

Prodhuesit e vajrave mbeturinë janë të detyruar të sigurojnë dorëzimin e mbeturinave personave të licencuar për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra.

Mbeturinat e vajrave ushqimore duhet të mblidhen, grumbullohen dhe t'i dorëzohen personit të licencuar për përpunimin dhe trajtimin e tyre.

- **Bateritë dhe akumulatorët mbeturinë**

Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve si dhe pajisjeve për mbajtjen dhe vendosjen e tyre janë të detyruar të vendosin udhëzimet të cilat përbëjnë klasifikimin në lloje, përmbajtjen e metaleve të rënda dhe mundësinë e riciklimit ose magazinimit.

Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve janë të detyruar të mbajnë dhe ruajnë evidencën për sasinë e prodhuar apo importuar të tyre.

Çdo zotërues i baterive apo akumulatorëve është i obliguar ti kthej ato te prodhuesi apo importuesi.

Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve janë te detyruar të marrin mbrapa bateritë dhe akumulatorët nga klientët e tyre.

Prodhuesit dhe importuesit e baterive dhe akumulatorëve janë të detyruar të dorëzojnë bateritë dhe akumulatorët mbeturinë, në vende të caktuara ose vetëm te personat e licencuar.

- **Gomat jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës**

Prodhuesi dhe importuesi i të gjitha llojeve gomave duhet të mbaj evidencën për sasinë e prodhuar dhe importuar.

Personat që menaxhojnë me goma jashtë përdorimit dhe mbeturina të gomës duhet të mbaj evidencën, dhe shënimet për llojin dhe sasinë e mbledhur, trajtuar dhe deponuar si dhe t'i ruaj ato.

Zotëruesi i gomave jashtë përdorimit duhet ti kthej ato te prodhuesi, importuesi apo te personat e licencuar.

- **Pajisjet elektrike dhe elektronike**

Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike nuk duhet të përzihen me mbeturinat e llojeve tjera.

Ndalohet deponimi i mbeturinave elektrike dhe elektronike nëse më parë ato nuk janë trajtuar.

Mbeturinat e lëngëta nga pajisjet elektrike dhe elektronike duhet të grumbullohen të ndara dhe trajtohen në mënyrën e duhur.

Personat të cilët mbledhin mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike, pas pranimit lëshojnë dëshmi për mallin e pranuar dhe dorëzimin e tyre për ruajtje ose trajtim.

Personat të cilët mbledhin mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike mbajnë evidencën për sasinë e mbeturinave të prodhuara dhe pajisjet elektrike dhe elektronike të importuara.

- **Gypat fluoroshent të cilët përmbajnë merkur**

Mbeturinat nga gypat fluoroshent që përmbajnë merkur, mblidhen të ndara.

Ndalohet deponimi i tyre pa e bërë trajtimin paraprak. Personat të cilët mbledhin gypat fluoroshent që përmbajnë merkur duhet të mbajnë evidencën për sasinë e grumbulluar.

- **PCB dhe PCT dhe mbeturinave me PCB dhe PCT**

Mbeturinat që përmbajnë PCB dhe PCT, mblidhen, grumbullohen dhe klasifikohen në lloje.

Ndalohet: përdorimi i PCB në transformatorë; ripërdorimi i mbeturinave me PCB dhe PCT; riciklimi i PCB dhe PCT nga mbeturinat e PCB dhe PCT.

Zotëruesi i pajisjes që përmban PCB dhe PCT më shumë se 5 dm3 lajmëron pajisjen dhe duhet të bëjë planin për ndërrimin e saj, trajtimin ose deponimin.

Personat të cilët menaxhojnë PCB dhe PCT dhe mbeturinat me PCB dhe PCT mbajnë evidencë për sasinë e grumbulluar.

- **Mbeturinat që përmbajnë azbest**

Mbeturinat që përmbajnë azbest mblidhen të ndara, paketohen, magazinohen ose deponohen në vendin e caktuar për këto lloje të mbeturinave, i cili duhet të jetë i shënjuar.

Prodhuesi i produkteve nga azbesti dhe zotëruesi i mbeturinave që përmbajnë azbest është i detyruar që të ndërmerr të gjitha masat që fijet e azbestit dhe pluhuri, të mos emitohen në mjedis.

Zotëruesi i mbeturinave që përmbajnë azbest është i detyruar të mbajë evidencën dhe shënimet për sasinë e mbeturinave që i magazinon ose i deponon.

- **Automjetet mbeturinë**

Grumbullimi, demontimi dhe trajtimi i automjeteve mbeturinë bëhet në qendra për grumbullimin dhe trajtimin e këtyre mbeturinave.

Personat të cilët menaxhojnë automjetet mbeturinë mbajnë evidencën dhe shënimet për sasinë e grumbulluar dhe trajtuar të mbeturinave si dhe ndarjen e materialeve dhe komponentëve të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Zotëruesit e automjeteve janë të obliguar që automjetet mbeturinë ti dorëzojnë vetëm te personat e licencuar për menaxhim me mbeturina.

- **Produktet medicinale, humane dhe veterinare**

Mbeturinat që krijohen gjatë dhënies së shërbimeve mjekësore ndahen sipas kategorisë të rrezikshme dhe parrezikshme.

Personat që menaxhojnë mbeturinat nga produktet medicinale duhet të hartojnë planin për menaxhimin e mbeturinave dhe caktojnë personin përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave.

- **Ambalazhet dhe paketimet**

Materialet që përdoren për ambalazhe duhet të jenë të prodhuara dhe të dizajnuara në atë mënyrë që gjatë ciklit jetësorë të tyre të përmbushin kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, kushtet për transport të sigurt të produkteve dhe menaxhimin të mbeturinave.

- **Mbeturinat e biodegradueshme**

Grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave të biodegradueshme bëhet nga personat e licencuar, në qendrat për grumbullimin dhe trajtimin e tyre.

Personat të cilët menaxhojnë mbeturinat e biodegradueshme duhet të mbajnë evidencën dhe shënimet për sasinë e grumbulluar, trajtuar të mbeturinave dhe sasinë e kompostit apo gazit të përfituar.

- **Lymi nga trajtimi i ujërave**

Lymi nga kanalizimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura sipas ligjit mund të përdoret për: rikultivim të tokave; rregullimin e tokave për përdorime të veçanta; kultivimin dhe rritjen e bimëve që nuk janë të dedikuara për ushqim dhe ushqim të kafshëve.

Mbeturinat nga lymi i kanalizimit dhe trajtimi i ujërave të ndotura, shfrytëzohet vetëm atëherë kur është bërë stabilizimi i tij dhe në të cilin janë zbatuar përpunimet e duhura biologjike, kimike, termike dhe përpunime tjera, me të cilat evitohen rreziku për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

- **Mbeturinat nga industria ekstraktive dhe minierave**

Mbeturinat nga industria ekstraktive dhe e minierave duhet të mblidhen të klasifikuara në lloje, sipas nevojës të trajtohen ose deponohen në objekte dhe pajisje të lejuara sipas ligjit.

Personi që menaxhon mbeturinat nga industria ekstraktive dhe e minierave obligohet të hartoj Planin për menaxhimin e mbeturinave nga industria ekstraktive dhe e minierave.

Personi që menaxhon mbeturinat nga industria ekstraktive dhe e minierave është i detyruar të përdor teknikat më të mira të mundshme.

Personi që menaxhon mbeturinat nga industria ekstraktive dhe e minierave duhet të të mbajë evidencën për sasinë e krijuar, të trajtuar dhe të deponuar të mbeturinave.

10. ARSYETIMI PËR NEVOJËN E HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME TË PLANIFIKUARA

Të gjitha Planet Rregulluese të Hollësishme, hartohen vetëm në rastet kur nevojiten kushte zhvillimore hapësinore më të hollësishme për hapësirë specifike, përveç asaj që është ofruar në hartën zonale përkatëse.

Arsyeshmërinë dhe nevojën e hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme, e prezantojmë si në vijim:

Parashtrohet nevoja e përgatitjes së Planeve Rregulluese të Hollësishme, për lokacionet të cilat nuk janë paraparë me PZHK ose HZK. Për më tepër, përpos zonave të përcaktuara në këtë dokument, për të u trajtuar përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme, për shkak të zhvillimeve apo synimeve të reja të Komunës, Komuna mund të trajtojë zona të tjera të cilat nuk janë paraparë me PZHK ose HZK me Plane Rregulluese të Hollësishme, me kusht që në këto raste duhet ndjekur procedurat sipas Udhëzimit Administrativ për Plane Rregulluese të Hollësishme - UA _Nr.01_2018, siç është përshkruar në vijim:

Para se të merret vendimi për Plan Rregullues të Hollësishëm i cili nuk është paraparë me PZHK ose HZK, autoriteti i planifikimit hapësinor, duhet të përgatit një raport të arsyeshmërisë për të shpjeguar qartë pse nevojitet hartimi i Planit Rregulluese të Hollësishëm, në vend se të përfshihen të gjitha kushtet përkatëse në hartën zonale përkatëse.

Para procedimit të propozim-vendimeve për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, duhet t'i bashkëngjitet programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i cili program përmban të dhënat si në vijim :

- Arsyetimi i nevojës për përgatitjen;
- Llojin dhe përkufizimin e dokumentit të planifikimit hapësinor;
- Qëllimin e hartimit;
- Kufirin e territorit;
- Subjektin përgjegjës për hartimin;
- Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim.

Kushtet për rregullimin e hapësirës përfshirë shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore dhe masat mbrojtëse në nivel parcele kadastrale. Këto janë kushte dhe masa shtesë që nuk janë specifikuar tashmë me ndonjë dokument të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë d.m.th. në Hartën Zonale ose Plan Zhvillimor Komunal.

Komuna e Vitisë, pavarësisht hartimit të Hartës Zonale Komunale, vlerëson se për zona të caktuara ekziston nevoja për hartimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, me qëllim të trajtimit më të detajuar urban, funksional, infrastrukturor dhe zhvillimor të hapësirave të veçanta.

Hartimi i PRRH-ve konsiderohet i nevojshëm sidomos për zonat ku pritet intensitet më i lartë zhvillimi, transformim urban, zgjerim i strukturave ekzistuese, zhvillim i funksioneve të përziera apo nevojë për ndërhyrje të koordinuar publike dhe private. Në këto raste, PRRH-ja mundëson përcaktimin e detajuar të vijave rregulluese, vijave ndërtimore, rrugëve të brendshme, parcelimit, hapësirave të gjelbra, hapësirave publike, objekteve me interes publik dhe infrastrukturës përcjellëse.

Në aspektin ligjor dhe planifikues, HZK nuk e përjashton mundësinë e hartimit të PRRH-ve, por përkundrazi, mund të përcaktojë zona ku kërkohet trajtim më i hollësishëm. Kjo është në funksion të zbatimit më cilësor të dokumenteve planifikuese në fuqi dhe nuk paraqet barrë të paarsyetuar për komunën, por instrument për menaxhim më të mirë të zhvillimit hapësinor.

Arsyeshmërinë e hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme dhe dokumenteve të tjera të planifikimit hapësinir, e mbështesim edhe në faktin se këto Plane Rregulluese të Hollësishme, do shërbejnë për nevoja të rregullimit teknik dhe operacional të planifikimit hapësinor, për ti përcaktuar kushtet shtesë më të hollësishme për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nëpërmjet projekteve konkrete. E nevojat për hartimin e PRRH-ve, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në vendosjen e kushteve për rregullimin e hapësirave në pjesë të caktuara të zonave apo sipërfaqeve të planifikuara, duke i përfshirë kushtet ndërtimore, kushtet për rregullimin e hapësirës që janë më të hollësishme se kushtet e përcaktuar në Hartën Zonale të Komunës dhe dokumentet tjera të planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë, si Plani Rregullues i Hollësishëm dhe Raporti i Vlerësimit Strategjik.

Prandaj, në emër të realizimit të prioriteteve të shpalosura për shfrytëzim të tokës dhe jo vetëm, hartimi i Planeve të reja Rregulluese të Hollësishme si edhe Vlerësimeve Strategjike për Harta Zonale, ka arsyeshmëri të plotë për vetë faktin se duhet trajtuar si prioritet i lartë për zonat e Komunës së Vitisë, për:

Në këtë drejtim, me prioritet të lartë është hartimi i dokumenteve të Planifikimit Hapësinor si në vijim:

- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Debelldeh,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Drobesh,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Kabash,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Letnicë,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Pozheran,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Radivojc,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike Budrikë e Epërme,
- Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Viti,

Hartimi i dokumenteve të Planifikimit Hapësinor të cekura si më lartë, do ta mundësonte gjithashtu edhe:

- Promovimin e modelit të dendur të banimit në zonë urbane të Komunës së Vitisë,
- Promovimin e një dendësie banimore në këto zona.
- Promovimin e mbushjes me ndërtim në zonat e zbrazëta të qytetit.

Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme në Komunë të Vitisë, do ta ketë prioritet edhe mbajtjen nën kontroll të zhvillimeve lineare, respektivisht do ta mbante nën kontroll edhe:

- Parandalimin e ndërtimeve jashtë kufijve ndërtimor,
- Promovimin e një dendësie banimore në vendbanimet e shpërndara.

Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme do ti promovon hapësirat e gjelbërta, do të siguronin hapësira të hapura dhe të gjelbërta, sidomos në zonat e caktuara për banim të dendur dhe komercial në zonën urbane duke:

- Promovuar një koncept policentrik të parqeve të qytetit,
- Promovuar konceptin e gjelbërimit linear me kapacitete mjedisore të qytetit,
- Promovuar kulmet e gjelbërta,
- Promovuar hapësirat sportive rekreative,
- Evaluar hapësirat në pronësi publike, periodikisht për të përcaktuar nëse hapësirat e tilla mund të shndërrohen në parqe ose hapësira të hapura publike.

Bazuar në arsyeshmërinë e shpalosur si më sipër, si dhe për shkak të ngarkesave dhe komplikimeve që ka Komuna e Vitisë, sidomos në Zonën Urbane të Vitisë, si edhe në zonën rurale, përkundër kushteve në nivel zone të cilat krijojnë bazë të mirë për dhënien e kushteve dhe lejes ndërtimore, për shkak të plotësimit të normave dhe standardeve, si dhe plotësimit të parimeve të trajtimit të barabartë të parcelave dhe pronarëve dhe parimeve të tjera demokratike, rrjedhimisht ka nevojë urgjente për detajime më të mëdha të prioriteteve, objektivave dhe strategjive, të cilat duhet trajtuar me prioritet të lartë përmes planeve të reja rregulluese të hollësishme të listuara si më lartë, dhe të cilat do të duhet të hartohen konform arsyeshmërisë së përshkruar dhe shpalosur si më sipër.

11. TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE

Vendbanimet joformale në vendin tonë kanë ekzistuar edhe më parë, mirëpo kryesisht kanë qenë të njohura me emërtime të ndryshme si lagje të egra, ilegale, të paplanifikuara, mahalla etj.

Sipas Ligjit Nr.03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14, Neni 2. Vendbanimet joformale janë vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbime publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë.

Bazuar në Planin për Zbatimin e Standardeve në Kosovë, vendbanimet joformale kategorizohen si vijon :

- Zotërimi joformal ose jo i sigurtë i pronësisë,
- Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare,
- Pjesëmarrja joadekuate ose mospjesëmarrja në qeverisje, si dhe
- Rrezikshmëria deri në diskriminim.

Vendbanimet joformale të identifikuara në vendin tonë i përkasin kategorisë së parë, të zotërimit joformal ose jo të sigurt të pronësisë, gjersa të gjithë banorët e këtyre vendbanimeve gëzojnë qasje adekuate ose privim në shërbime elementare, pjesëmarrje adekuate ose pjesëmarrje në qeverisje, si dhe nuk janë rrezikuar nga diskriminimi. Karakteristikat identifikuese do të jenë bazë për të ju qasur rregullimit të tyre.

Dominimi i familjeve të mëdha dhe të zgjeruara, tregon gjithashtu shkallë mesatare të zhvillimit dhe arsimit dhe papunësi e varfëri të theksuar. Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë të vendbanimeve joformale të identifikuara kërkon zgjidhje, ku komuna në bashkëpunim me komunitetin të mundësojë zgjidhjen e statusit pronësor të tokave në pronësi komunale apo të nivelit qendror.

Para rregullimit të çështjes pronësore të posedimit të tokës, komuna duhet të trajtojë parcelat përmes hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRrH).

Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, ka identifikuar vendbanimet vijuese joformale në zonë rurale të cilat janë përfshirë në strategjinë zhvillimore, si: Vitia 1, Vitia 2, Vitia 3, Drobeshi dhe Binçë.

Në planin e kaluar është paraparë edhe trajtimi i këtyre vendbanimeve joformale dhe gjatë periudhës 10 vjeçare këto vendbanime janë trajtuar në nivelin e duhur sa i përket joformalitetit të tyre.

Në bashkëpunim me institucionet lokale të komunës së Vitisë, është konstatuar se aktualisht në këtë komunë nuk ka vendbanime joformale[14].

Në bazë të raportit mbi gjendjen e vendbanimeve joformale të vitit 2010, numri i përgjithshëm i vendbanimeve joformale në Kosovë është 174. Sipas këtij raporti, Kouna e Vitisë ka të regjistruara 4 vendbanime Joformale.



Grafiku 1 Numri i Vendbanimeve joformale sipas komunave në Kosovë (2010)

[14] PZHK Viti 2023-2031

Autoritetet përgjegjëse të Komunës së Vitisë, si edhe PZHK 2023-2031 për Komunlën e Vitisë, i cili është në fuqi konfirmojnë se të gjitha vendbanimet joformale të identifikuara në raportin e Institutit pëtr Planifikim Hapësinor dhe të prezantuar në raportin e vitit 2010, sipas Grafiku. 2. Grafiku me numrin e Vendbanimeve joformale sipas komunave në Kosovë (2010), zyrtarisht janë trajtuar duke kaluar nëpër të gjitha fazat e përcaktuara për trajtim të VJF, prandaj konsiderohet se i kanë përmbushur të gjitha kushtet për tu shëndruar në vendbanime formale, duke konfirmuar njëherit se Komuna e Vitisë tashmë nuk ka të identifikuara Vendbanime Joformale.

Formalizimi i Vendbanimeve Joformale në Viti konfirmohet edhe me PZHK 2023-2031 për Komunlën e Vitisë, i cili dokument është në fuqi (2.11.4 Vendbanimet Joformale, fq 118).

Tabela 88 Veçoritë e vendbanimeve joformale

Klasifikimi	**Statusi juridik**		**Pronësia**		**Kushtet**		**Infrastrukturë**	
Vendbanimet joformale	Formal	Joformal	E sigurt mbi tokën	E pasigurt mbi tokën	E mira fizike	E këqija fizike	Qasjes në infrastrukturë	Mungesë e qasjes në infrastrukturë
Vitia 1	x		x		x		x	
Vitia 2	x		x		x		x	
Vitia 3	x		x		x		x	
Dobresh	x		x		x		x	
Binçë	x		x		x		x	

11.1. NDËRTIMET PA LEJE DHE TRAJTIMI I TYRE

Në Regjistrin e ndërtimeve pa leje të Komunës së Vitisë, janë të regjistruara mbi 319015 raste, si ndërtesa të kategorisë I-rë dhe të II-të, sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i idnetifikuar i ndërtimeve pa leje, pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi Ligji Nr. 06/L-024. ndërtimeve pa leje, Autoriteti zyrtar përkatës do ti trajtoj dhe legalizoj shumicën e ndërtimeve të kategorisë I-rë dhe II-të, mirëpo, përsëri do të mbetet një numër i konsiderueshëm i objekteve/ndërtesave, të cilat janë ndërtuar pas 30 Gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, e të cilat tutje do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim. Prandaj, konform Ligjit, si rezultat i aplikimit dhe implementimit të të njejtit, si prioritet strategjik për legalizimin e të gjitha ndërtimeve pa leje, është zhvillimi i inspektimeve dhe lëshimi i çertifikatave të legalizimit.

Sipas të dhënave të MMPH-së, në Komunën e Vitisë, nga fillimi i viteve 2000 deri në vitin 2015 janë ndërtuar 3,190 ndërtesa pa leje (lista mund të përfshijë gjithashtu objekte pa leje të ndërtuara gjatë viteve të 90-ta) dhe ky numër nuk është përfundimtar, pasi që ndryshon prej ditës në ditë. Rreth 50 prej tyre janë në trajtim për legalizim dhe pjesa tjetër e ndërtimeve të identifikuara si ndërtime pa leje, duhet të trajtohen sipas Ligjit nr.06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

11.2. TRAJTIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE

Ndërtimet pa leje në pronën komunale klasifikohen si të tilla, pasi konsiderohen se janë ndërtuar pa vullnetin e pronarit dhe/ose lejen e autoritetit. Megjithatë, pavarësisht nga klasifikimi i tyre ligjor dhe pasojat, marrëveshjet e ndërsjella të palëve konsiderohen si zgjidhje parësore, qoftë kjo procedurë administrative apo gjyqësore.

Lejet e ndërtimit dhe procesi që i paraprinë dhënies së lejes së ndërtimit është i rëndësishëm për të siguruar që ndërtesat janë ngritur në përputhje me planet hapësinore, kanë infrastrukturë të përshtatshme, janë të sigurta për njerëzit dhe mjedisin, janë të përfshira në kadastër dhe i nënshtrohen tatimi në pronë, në mënyrë që komuna e Vitisë të mund të mbledhin të hyrat e veta që mundësojnë ofrimin e shërbimeve të nevojshme për qytetarët.

Procedurat aktuale të legalizimit kanë vështërsi në zbatim, marrë parasysh faktn se kan ngecje të dukshme në implementim të Ligjit për Trajtim të Ndërtimeve pa Leje. Rrjedhimisht lehtësime në procedurën zyrtare, për zgjidhje të qështjeve pronësore. Prandaj, duhet të letësohet trajtimi I ndërtimeve pa leje për lirim të ngërqit ligjor evident.

- Identifikimi i të gjitha ndërtimeve pa leje, sepse numri rritet në vazhdimësi
- Digjitalizimi i të njejtave përmes sistemit GIS
- Themelimi i një Komisioni për trajtimin e ndërtimeve pa leje .
- Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve për certifikatë legalizim, të mos jetë i kufizuar
- Aplikuesit të lirohen nga të gjitha taksat të kërkuara me ligj.
- Kërkesave të banorëve ti ipet prioritet i lartë në shqyrtim të lëndëve.
- Me urgjencë të trajtohen rastet nga lista e pritjes.
- Të ngritet dukshëm numri i zyrtarëve inspektues

Trajtimi i ndërtimeve pa leje duhet të vazhdojë sipas LIGJI Nr. 06/L-024 Për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Legalizimi ka të bëjë me dhënien e mandatit ligjor për banorët e shfrytëzuesit e ndërtimit paleje, e që do të sjellë pasurinë e akumuluar në mënyrë joformale në tregun formal.

[15] MMPH / DPHBN,Numri i ndërtimeve pa leje sipas Komunave nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje, Prishtinë 09.09.2015

12. PLANI I VEPRIMIT

12.1. PLANI I VEPRIMIT PËR VITIN 2026

12.1.1. PRIORITETET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

- PS.A1- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e potencialit real zhvillimor

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.A1.A.1.	Participimi i projekteve me donatorë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 200,000	MFPT
		I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	THV	€ 200,000	DEFZH
PS.A1.A.2	Blerja e fotoaparatit digjital	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 13,996	MFPT
PS.A1.A.3	Implementimi i konceptit Policentrik hapësinor si dhe zhvillimi sipas tërësive territoriale të planifikuara me këtë PZHK	I lartë	Afatgjatë	I lartë	THV	€ 3,000,000	DEFZH / MFPT

- PS.A2- Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në bujqësi, industri të lehtë, industri bujqësore, përpunuese, turizëm natyror, rural, kulturor dhe konsolidimi i tokës bujqësore të klasit I-IV

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.A2.A.1	Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2026	I ulët	Afatshkurtër	I lartë	THV	€ 500,000	DBPZHR
PS.A2.A.2	Hartimi dhe implementimi i masave adekuate për mbrojtjen e florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës	/	/	/	THV	/	DBPZHR

- PS.A3- Ndërtimi dhe decentralizimi i shërbimeve administrative edhe në disa qendra të tjera lokale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.A3.A.1	Objekt administrativ në vendbanimet Pozharan dhe Skifteraj	I lartë	Afatgjatë	I mesëm	THV	€ 100,000	DA
PS.A3.A.2	Ngitja e efikasitetit në administratë	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 10,000	DA
PS.A3.A.3	Avancimi i sistemit elektronik në ofrimin e shërbimeve për qytetarë	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 20,000	DA

12.1.2. PRIORITETET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS TEKNIKE

- PS.B1- Furnizimi i qëndrueshëm me ujë dhe përmirësimi i infrastrukturës furnizuese

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B1.A.1	Ndërtimi i ujësjellësve Ramjan- Novosellë	I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	GQ	€ 160,000	DSHPE/ MMPHI
PS.B1.A.2	Ndërtimi i ujësjellësve Devaj- Radivojc	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 32,033	DSHPE/ MMPHI
PS.B1.A.3	Funksionalizimi i ujësjellësve në Zhiti, Sllatinë e Ultë, Sllatinë e Epërme, Tërstenik, Sodovinë e Jerlive, e Çerkezve, Debëlldeh.	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 10,000	MMPHI
		I ulët	Afatshkurtër	I ulët	THV	€ 20,000	DSHPE
PS.B1.A.4	Monitorimi i sistemit të furnizimit me ujë të pijes në bashkëpunim me ISHPK	/	/	/	/	/	DSHPE

- PS.B2- Revitalizimi dhe shtrirja e ujësjellësit në fshatrat e komunës së Vitisë

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B2.A.1	Revitalizimi i ujësjellësve në Remnik, Beguncë, Budrikë, Skifteraj, Vërban, Smirë, Tërpezë	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 5,000	MMPHI
PS.B2.A.2	Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit përmes shpimit të puseve ose lidhjes me rrjetin e Letnicës-Pozharanit në vendbanimet Ballancë, Buzovik, Dobelldeh, Goden i Madh, Lubishtë, Mjak, Podgorc, Shashare, Vërnakollë dhe Vënez.torisë në komunën e Vitisë	I ulët	Afatshkurtër	I lartë	THV	€ 500,000	DSHPE

- PS.B3- Trajtimi i ujërave të zeza

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B3.A.1	Ndërtimi i fabrikës së ujit të pijes dhe kolektori i ujërave të zeza	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 10,000	DSHPE
PS.B3.A.2	Kyçja në impiantin (sipas Planit Hapësinor të Kosovës) deri në vitin 2026	I ulët	Afatshkurtër	I lartë	THV	€ 2,000,000	DSHPE

- PS.B4- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës ekzistuese të kanalizimit

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B4.A.1	Ndërtimi i kanalizimeve në Viti, Kabash, Binçë, Gërmovë, Drobesh, Beguncë, Gjylekarë, Budrikë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 100,000	MMPHI
PS.B4.A.2	Ndërtimi i kanaleve dhe prrockave në Viti, Pozheran, Kabash, Remnik, Vërban, Sllatinë, Tërpezë, Sodovinë.	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 70,000	MMPHI
PS.B4.A.3	Ndërtimi i kanalizimeve në Tërstenik, Radivojc, Pozheran, Sllatinë e Poshtme, Vërban	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 100,000	MMPHI
PS.B4.A.4	Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha (sipas prioritetit në vendbanimet që kanë probleme me vërshimet) dhe derdhja e tyre në shtratet e lumenjëve dhe përrockave në të gjitha vendbanimet rurale	I ulët	Afatshkurtër	I lartë	THV	€ 500,000	DSHPE

- PS.B5- Rregullimi i infrastrukturës se energjisë elektrike

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B5.A.1	Programimi për efiçiencë të energjisë dhe burimet e ripërtrishme të energjisë- pompa termike në objektet arsimore, shëndetësore dhe komunale	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 10,000	ME
		I ulët	Afatshkurtër	I ulët	THV	€ 6,080	DSHPE
PS.B5.A.2	Rritja e kapaciteteve të trafostacioneve	/	/	/	/	/	DSHPE/ KEDS

- PS.B6- Dizajnimi dhe unifikimi i infrastrukturës telekomunikuese

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.B6.A.1	Ndërtimi i "Qyteti inteligjent- mençur" (Ndërtimi i pritoreve, tabelave informuese, ulëse betoni, kontejner nëntokësor, instalimi I kamerave etj) Viti	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 10,000	DSHPE
PS.B6.A.2	Instalimi i kabllove optike në vendbanimet që nuk kanë qasje në sistemin optik të telekomunikimit	/	/	/	/	/	DSHPE

12.1.3. PRIORITETET STRATEGJIKE PËR TRANSPORTIN DHE TRANSPORTIN PUBLIK

- PS .C1- Rrjet i asfaltuar rrugor për tërë komunën

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.C1.A.1	Asfaltimi i rrugëve rurale në Viti, Beguncë, Lubishtë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnishtë, Smirë, Podgorc, Gërmovë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 100,000	MMPH
		I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 45,483	DSHPE
PS.C1.A.2	Asfaltimi i rrugëve rurale në Pozheran, Tërpezë, Balancë, Zhiti, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Tërstenik	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 80,000	MMPHI
PS.C1.A.3	Asfaltimi i rrugëve rurale në Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Çerkezve, Gjylekarë, Budrikë, Radivojc, Debëlldeh	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 80,000	MMPHI
PS.C1.A.4	Ndërtimi i rrugëve me zhavorr në Sodovinë e Jerlive, Sodovinë e Çerkezve, Vërban, Fshati i Ri, Goshicë, Stubëll e Epërme	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 60,000	MMPHI
PS.C1.A.5	Ndërtimi i rrugëve me zhavorr në Beguncë, Lubishtë, Buzovik, Remnik, Pozheran, Radivojc, Smirë, Podgorc, Gjylekarë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 60,000	MMPHI
PS.C1.A.6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Pozheran, Fshati i Ri, Tërstenik, Devaj, Ballancë, Ramjan, Ramnishtë, Sodovinë e Çerkezve dhe Jerlive	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 140,000	MMPHI
PS.C1.A.7	Ndriçimi publik i rrugëve në të gjithë zonën urbane si dhe zonat qendër të vendbanimeve tjera	I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	THV	€ 250,000	DSHPE
PS.C1.A.8	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik në Viti, Smirë, Kabash, Goshicë, Beguncë, Gërmovë, Lubishtë, Gjylekarë, Vërban	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 140,000	MMPHI
PS.C1.A.9	Asfaltimi i rrugëve Tërpezë- Novosellë- Lagja Alidema	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 10,000	MMPHI
PS.C1.A.10	Asfaltimi rrugës Goshicë- Sodovinë e Jerlive	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 42,818	MMPHI
PS.C1.A.11	Asfaltimi i rrugës Sllatinë e Epërme- Pozheran lagja Korrant	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 30,000	MMPHI
		I ulët	Afatshkurtër	I ulët	THV	€ 33,516	DSHPE
PS.C1.A.12	Asfaltimi i rrugës Gjylekar Toplant- Remnik	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 23,697	MMPHI
PS.C1.A.13	Ndërtimi i rrugës me zhavorr Ramjan- Sllakovc	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 33,104	MMPHI
PS.C1.A.14	Ndërtimi i rrugës me zhavorr: Remniku i ri (Pompa)- Sod. e Qerkezve, Sllatinë e Poshtme	I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	GQ	€ 100,000	MMPHI
		I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	THV	€ 79,285	DSHPE
PS.C1.A.15	Ndërtimi i rrugës me zhavorr Zhiti- Devaj	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 5,000	MMPHI

PS.C1.A.16	Asfaltimi i rrugës së xhepës- Lubishtë	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 10,000	MMPHI
PS.C1.A.17	Ndërtimi i rrugës me zhavorr Stubëll- Stançiç	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 60,000	MMPHI
		I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 36,205	DSHPE
PS.C1.A.18	Ndërtimi i urave (Jezava, Gelbushi, Podgorc-Lubishtë, Budrikë dhe Skifteraj)	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 10,000	MMPHI
		I ulët	Afatshkurtër	I ulët	THV	€ 10,000	DSHPE
PS.C1.A.19	Ndërtimi i urave në fshatin Samakovë, Vërban	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 10,000	MMPHI
		I ulët	Afatshkurtër	I ulët	THV	€ 15,000	DSHPE
PS.C1.A.20	Ndërtimi- Revitalizimi i rrugëve në Buzovik, Radivojc, Gjylekarë, Tërpezë, Pozheran, Podgorc, Sllatinë e Poshtme	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 20,000	DSHPE
PS.C1.A.21	Shfrytëzimi i traseve ekzistuese për lidhjen e vendbanimeve	/	/	/	/	/	DUPMM/ DSHPE
PS.C1.A.22	Kufizimi i shtrirjes së traseve të rrugëve në tokat bujqësore të klasit I-IV	/	/	/	/	/	DUPMM/ DSHPE

- PS.C2- Prioritetet strategjike për transportin publik

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.C2.A.1	Blerja e auto veturave	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 9,640	MMPHI

12.1.4. PRIORITETET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE SOCIALE

- PS.D1- Shërbime cilësore shëndetësore

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.D1.A.1	Renovimi i ambulantës në Viti	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 30,000	DSH/ MSH
		I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 30,000	

- PS.D2- Shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirje në arsim

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.D2.A.1	Riparimi i shkollave në Viti, Radivojc, Devaj, Pozheran, Ramjan, Gërmovë, Zhiti, Goshicë, Vërban, Ramnishtë	I mesëm	Afatmesëm	I mesëm	GQ	€ 130,000	MASHT
		I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 20,000	DKA
PS.D2.A.2	Rregullimi i rrethojave të shkollave (Bafti Haxhiu , Halil Alidema dhe Kuvendi i Lezhës	I ulët	Afatshkurtër	I ulët	GQ	€ 4,930	MASHT
PS.D2.A.3	Ndërtimi i çerdheve të reja në vendbanimet: Viti, Smirë, Gjylekar, Kabash, Drobesh, Ramnisht dhe Stubëll e Epërme	I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	GQ/ THV	€ 200,000	DKA/ MASHT
PS.D2.A.4	Zgjërimi i hapësirave të objekteve shkollore në: Binç, Sadovinë e Jerlive, Smirë, Tërpezë dhe Vërban	I lartë	Afatgjatë	I mesëm	GQ/ THV	€ 150,000	DKA/ MASHT
PS.D2.A.5	Ndërtimi i objektit të Shkollës Profesionale Bujqësore	I ulët	Afatshkurtër	I mesëm	GQ/ THV	€ 150,000	DKA/ MASHT

- PS.D3- Ndërtimi i institucioneve për shërbime sociale dhe familjare

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.D3.A.1	Ndërtimi i shtëpisë së komunitetit për personat me aftësi të kufizuar	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 50,000	MPFVLÇ

- PS.D4- Ndërtimi i hapësirave të varrezave publike deri në vitin 2031

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.D4.A.1	Zgjerimi i hapësirës për varreza në fshatin Pozharan	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 10,000	DSHPE
PS.D4.A.2	Mirëmbajtja e Varrezave në fshatrat e komunës	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 30,000	DSHPE
PS.D4.A.3	Zgjerimi i hapësirës për varreza në fshatin Sllatinë e Epërme	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 10,000	DSHPE
PS.D4.A.4	Shndërrimi i oborrit të shkollës së vjetër në fshatin e Novosellës në varrezat të reja	I lartë	Afatgjatë	I ulët	THV	€ 50,000	DSHPE

- PS.D5- Krijimi i hapësirave publike deri në vitin 2031

Përshkrimi i veprimit		Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi i burimit të financimit	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
PS.D5.A.1	Ndërtimi i hapësirave gjelbëruese publike në Viti, Smirë, Vërban, Gërmovë, Remnik, Budrikë, Goshicë, Drobesh	I mesëm	Afatmesëm	I ulët	GQ	€ 20,000	MIT
		I mesëm	Afatmesëm	I ulët	THV	€ 40,000	DUPMM

Administrimi sidomos në funksion të shqyrtimit të përputhshmërisë nënkupton edhe një përgjegjësi të administratës për menaxhimin me marrjen e vendimeve për miratimin ose refuzimin e kërkesave për dhënien e kushteve zhvillimore, kushteve zhvillimore për zona mbishtresore, kushteve për infrastrukturë teknike, rrugor, publike e sociale, masave mbrojtëse, lejeve ndërtimore, përjashtimeve, bonuseve të zonimit nëse janë përcaktuar edhe hartimit të PRRH-ve i cili duhet bëhet duke krahasuar vendimet me kriteret masat dhe kushtet e përcaktuara në HZK, por edhe ligje rregullore dhe dokumente tjera, përputhshmëria duhet shqyrtohet bazuar në përmbajtjet e dokumentuara dhe transparente.

Nëse kemi ankesa ndaj vendimeve të marra nga ana e komunës ose kërkesa për interpretime të ndryshme për përmbajtjet e pjesëve të HZK-së, në funksion të administrimit të zbatimit, interpretimi bëhet nga Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor(Drejtoria e Urbanizmit) në nivel komunal dhe nga MMPHI në nivel qendror.

Administrimi i zbatimit të Hartës Zonale Komunale të Vitisë bëhet nga të gjitha organet e komunës, edhe pse siç e sqaruam më lart, në mënyrë të veçantë është detyrë e vazhdueshme për APKPMH-në, gjegjësisht e drejtorisë së Urbanizmit të udhëheq dhe bashkërendojë aktivitetet e administrimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të HZK-së.

Komuna e Vitisë obligohet që të drejtojë dhe organizojë punën në këtë fushë sipas udhëzimeve administrative, rregullave dhe ligjeve në fuqi të shtetit, ashtu që të administrojë HZK-në edhe atë ta administrojë sa më mirë që është e mundur duke siguruar qëndrueshmëri.

Komuna duhet të kujdeset që bonuset e zonimit, përjashtimet, kushtet zhvillimore dhe të gjitha përmbajtjet e HZK-së së Vitisë, për të gjitha zonat, zonat mbishtresore, infrastrukturën teknike, rrugore e sociale, veçanërisht ato që konsiderohen si administrim i një pasurie ose për një vlerë të Vitisë, e si të tilla e bëjnë stacioni kryesor hekurudhor dhe hekurudhat, pozita në harmoni me aeroportin, pasuritë nëntokësore, korridoret, pozita afër kryeqytetit etj, që të menaxhohen mirë, sipas rregullave, bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjes ekzistuese, t'i mbrojë dhe të qeverisë me to bazuar në parimet dhe kushtet e HZK-së, të mbarështojë cilësinë dhe zhvillimet në dobi të përgjithshme; të përdorë ose të administrojë vlerat, të ardhurat, fondet në funksion të zbatimit të HZK-së, dhe krejt në fund të administrojë pasurinë e përbashkët-pronën, në funksion të zonimit dhe kushteve të parapara me këtë Hartë.

Administrimi i zbatimit të HZK-së së Vitisë nënkupton kryerjen e disa aktiviteteve dhe veprimeve sistematike që duhet të bëhen nga autoritetet kompetente që do prezantojmë si më poshtë: Kuvendi i Komunës së Vitisë është përgjegjës për aprovimin e fondeve për zbatimin e HZK-së, si dhe për vlerësimin dhe aprovimin e raportit vjetore për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit), bashkërendon aktivitetet e zbatimit dhe monitorimit të HZK-së, duke bashkërenduar dhe koordinuar aktivitetet e përgatitjes së planeve sektoriale vjetore të çdo drejtorie. Ky autoritet përgjegjës komunal, përkrah, përcjell dhe monitoron zbatimin dhe përgatit raportin vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së .

Drejtoritë komunale sektoriale zbatojnë dhe monitorojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre sipas procesit të monitorimit dhe vlerësimit në Planin e Veprimit, përgatisin planet e tyre vjetore për zbatim, përgatisin raportin sektorial vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së nga sektori i tyre.

Drejtoritë sektoriale, përmes anëtarit të tyre në Ekipin Punues, pasi ta kenë hartuar, e dorëzojnë raportin sektorial vjetor për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor(udhëheqësi i Ekipit nga drejtoria e Urbanizmit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor :

- Harton dhe dorëzon raportin vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës;
- Dorëzon raportin e miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së në Ministri;
- Raporti i miratuar vjetor ndërsektorial për zbatimin dhe monitorimin e HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna e Vitisë në funksion të administrimit të zbatimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të Hartës Zonale Komunale do të formojë Ekip Punues për përkrahje në zbatim të këtij dokumenti. Komuna e Vitisë në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK -së ka paraparë që me vendim të kryetarit të komunës të formojë Ekipin Punues që do të shërbejë edhe si një mekanizëm për administrim të zbatimit, zbatim, monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të Hartës Zonale në bazë të treguesve të matshëm.

Një rol të pa kontestuar në administrimin e zbatimit të HZK-së është roli i veçantë që ka inspektorati i komunës së Vitisë.

Për administrim cilësor rol kanë të gjitha organet e komunës, por duhet specifikuar Zyra e informimit dhe Teknologjisë informative.

Administrimi i zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së së Vitisë është procesi sistematik dhe i vazhdueshëm i cili do të udhëhiqet nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor(Drejtoria e Urbanizmit) e cila është përgjegjës për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës, me një koordinim dhe administrim praktik nga Ekipi Punues dhe akterët tjerë të lart përmendur, komuna për administrim cilësorë sidomos për trajtimin e bonuseve të zonimit, përjashtimeve dhe përmbajtjeve tjera që vijnë si kërkesa pas aprovimit të HZK-së mundet të krijoj edhe komisione profesionale për marrjen e vendimit apo këshillim përkatës mbi kërkesat për përjashtim ose çfarëdo kërkese tjetër.

Administrimi i zbatimit është përmbajtjesor dhe jashtëzakonisht i rëndësishëm, andaj i takon autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor(Drejtorisë së Urbanizmit) të propozojë mekanizma, ekipe profesionale, alokim mjetesh ashtu që komuna të marrë vendimet meritore për të siguruar administrim, zbatim e monitorim cilësor.

Udhëzuesi për monitorimin e zbatimit të HZK-së është bashkëngjitur në shtojcën 3.

13.2. ZBATIMI I HARTËS ZONALE KOMUNALE TË VITISË

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Hartës Zonale Komunale në Kuvend Komunale dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës, në ketë drejtim drejtoria e Urbanizmit do të fillojë me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se zbatimi i Hartës Zonale Komunale varet nga shumë faktorë në mënyrë direkte dhe indirekte. Pos punës brenda sektorëve të komunës, në funksion të krijimit të një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm, sistem i cili prezanton edhe një nga kërkesat ligjore, duhet punuar edhe me grupet tjera të interesit, punë e cila nuk mund të bëhet pa ngritur edhe cilësinë e informimit dhe komunikimit si dhe fuqizimin e faktorëve të tjerë.

APKPMH dhe Ekipi punues në rend të parë zbatimin do ta bëjnë në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim të Hartës Zonale të Vitisë, i cili është punuar bazuar në aktivitetet e parapara në Planin e Veprimit nga Planin Zhvillimor Komunal, bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese, përmes zhvillimit të projekteve konkrete të rrjetit të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale për çdo vit pasues, ku janë përcaktuar:

- Vendndodhja e dedikuar, përfshirë edhe shpronësimet eventuale;
- Koston e përafërt të zbatimit;
- Burimet e parapara të financimit;
- Periudhën e zbatimit; dhe
- Institucioni përgjegjës për zbatim.

Komuna e Vitisë në kuadër të planit të veprimit, për nga karakteri hapësinor, ka paraparë aktivitete shtesë nga ato që janë kërkuar në Planin e Veprimit nga Plani Zhvillimor Komunal ku janë paraparë kushte dhe masa mbrojtëse.

• Formimi i ekipit

Një nga faktorët e fillestar dhe të rëndësishëm të zbatimit të HZK-së është krijimi i Ekipit Komunal të Vitisë. Ky Ekip komunal do ketë obligimet për përkrahje në zbatim të HZK-së, por edhe për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, në të njëjtën kohë pasi që komuna e Vitisë nuk ka Ekip edhe për zbatim dhe monitorim të PZHK-së, ky Ekip duhet t'i kryej edhe ato detyra.

Komuna e Vitisë në funksion të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të HZK-së, si pjesë e këtij dokumenti, e parasheh krijimin e këtij Ekipi, që përveç rëndësisë së madhe në zbatim, do të shërbejë edhe si një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të komunës drejt arritjes së të gjitha aspekteve të planit, në bazë të treguesve të matshëm.

Ky Ekip Punues duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, i cili bazuar në kompetencat ligjore që ka ose e themelon vet ose i propozon Kuvendit të Komunës emërimin e Ekipit Punues për zbatimin e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë, si dhe për Monitorim

dhe Raportim lidhur me zbatimin e Hartës. Për arsye praktike Ekipi i njëjtë do ketë obligimet e njëjta edhe për PZHK-në e Vitisë, sepse komuna deri më tani nuk ka të emëruar ndonjë Ekip për përcjelljen e zbatimit të PZHK-së që nga aprovimi i saj.

Në kuadër të vendimit duhet përshkruhet përbërja e Ekipit, detyrat lidhur me zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit, periudhat e raportimit, kompensimin nëse aplikohet etj.

Ekipi Punues përbëhet nga përgjegjësit e të gjitha drejtorive, e udhëheqësi i Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit) është edhe koordinatori i Ekipit. Detyrat e Ekipit janë të koordinojë dhe bashkërendojë aktivitetet, lidhur me përgatitjen e Planeve Vjetore, për çdo drejtori brenda komunës së Vitisë, Planet vjetore duhet përgatitur për: Drejtorinë e

Administratës, Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, Drejtorinë e Inspeksionit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtorinë për Shërbime Publike.

Është detyrë e secilit përgjegjës që është pjesë e ekipit, nga secila drejtori të kujdeset për këto Plane Vjetore, dhe e koordinatorit të Ekipit të kujdeset për planin e drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, por në cilësinë e koordinatorit dhe si udhëheqës i Ekipit Punues edhe të koordinojë dhe të ndihmojë edhe planet vjetore të drejtorive të tjera.

Detyrë tjetër e Ekipit është që të verifikojë se Planet Vjetore Sektoriale të jenë të bazuara dhe në harmoni me Planin e Veprimit për Zbatim nga HZK-ja.

Ekipi duhet edhe të përcjell, koordinojë dhe bashkërendojë zbatimin praktik të projekteve dhe komponentës hapësinore në baza ditore, javore e mujore të punës.

Ekipi do të marrë edhe shënime për mundësitë, sfidat dhe problemet e zbatimit ashtu që të mundësojë përmirësimin e zbatimit në vitin tjetër të radhës.

Ekipi Punues dhe anëtarët nga të gjitha drejtoritë komunale, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë dhe funksionalizojnë Sistemin e Zbatimit të Planit si dhe Raportimin. Ekipi, nëpërmjet Zyrës për Informim, informon edhe qytetarët 15 ditë para datës së raportimit në një tubim të qytetarëve për gjetjet në procesin e zbatimit të planeve, dhe në atë takim kërkon edhe propozimet e qytetarëve për masa, zhvillime dhe projekte që, do të mund të futeshin në rishikim të buxhetit dhe KAB, përmes: Shpalljeve publike të vendosura në objektet publike, dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, mediave lokale, Ueb faqes zyrtare të Komunës.

Koordinatori i Ekipit, bashkë me Ekipin, ftojnë përfaqësuesit e Drejtorive, që të marrin pjesë në takime për t'u konsultuar dhe diskutuar lidhur me zbatimin e planeve, dhe përfaqësuesit e Drejtorive raportojnë për zhvillimet, por edhe propozojnë masat e aktiviteteve që i kontribuojnë zbatimit të planeve.

Konsultime organizohen edhe me kryetar të Këshillave Lokale të fshatrave, të Vendbanimeve, të Lagjeve Urbane dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile që të kontribuojnë me propozime, sugjerime dhe komente gjatë procesit të zbatimit të planeve për të gjitha fushat. Informojnë nëpërmes formave të ndryshme për zhvillimet ilegale në vendbanimet, lagjet urbane dhe përgatiten për projekt-propozimet, Masat dhe zhvillimet e parapara me plane në periudhën e dëgjimeve publike për buxhet, Tubimete rregullta publike, Takimet për planifikim strategjik që organizohen nga Komuna, përkatësisht Kuvendi i Komunës ose Kryetari.

Së paku një anëtar i Këshillit Lokal të Fshatit, të Vendbanimit apo të Lagjes urbane duhet të jetë person kontaktues për Zbatimit të Planit në fshat, vendbanim apo lagje urbane. Ky person, mund të jetë personi i cili, me rregulloren për Këshilla të Fshatrave, është përfshirë në grupet punuese komunale për planifikim të planit zhvillimore komunal.

Kryetari i Komunës, duhet që të organizojë (së paku) dy takime në vit me Ekipin Punues. Takimet, duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj, edhe pse preferohet çdo tre muaj të ketë takime. Për rendin e ditës, duhet të konsultohen edhe nëse konsiderohet se raportimi për zhvillimet lidhur me zbatimin e planeve dhe përgatitja e raporteve gjashtëmujore dhe

njëvjeçare, duhet të jetë pika kryesore. Kuvendi i Komunës, mund të kërkojë një opinion nga Ekipi për çështje të caktuara me interes për qytetarët dhe institucionet.

Procesi i zbatimit mbështet në parimin e Ligjshmërisë sipas të cilit parim, Komunat ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre brenda Kushtetutës, ligjeve dhe akteve të tjera normative të Republikës së Kosovës. Zbatimi i këtij parimi, nënkupton edhe zbatimin e parimit të transparencës dhe në këtë mënyrë komunat, promovojnë transparencën e organeve Legjislative, Ekzekutive dhe Administrative, duke e rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në zbatimin e planeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës.

- **Informimi dhe Komunikimi në procesin e Zbatimit të HZK-së së Vitisë luajnë një rol të jashtëzakonshëm**

Komuna e Vitisë dhe akterët e tjerë relevantë, duhet të kontribuojnë ndjeshëm në krijimin e kushteve për përkrahje në zbatimin Hartës Zonale. Fusha e informimit dhe e komunikimit në funksion të zbatimit të këtij dokumenti, ka nevojë për mbështetje të madhe të drejtuesve të institucioneve dhe të vetë institucioneve komunale.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me publikun, do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e praktikave të zbatimit të planeve, në përmirësimin e mbledhjes dhe përdorimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, në përdorimin efektiv të aseteve të komunës, në krijimin e një klime miqësore me bizneset, në inkurajimin e shoqërisë civile dhe të sektorit privat etj. Nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm të buxhetimit me pjesëmarrje, do të inkurajohen qytetarët në përfshirjen e tyre në zbatimin e kushteve, masave dhe përmbajtjeve të HZK-së, në vlerësimin e nivelit të shërbimeve publike dhe në rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike. Komuna është e detyruar të zbatojë kuadrin ligjor në lidhje me transparencën dhe informimin e publikut, në lidhje me tërë veprimtarinë ekonomiko-financiare të komunës dhe në këtë funksion, plani i informimit dhe i komunikimit do të përmbushte edhe këtë kërkesë, nga kuadri ligjor.

Në vijim, Komuna e Vitisë do të respektojnë me rigorozitet procedurat ligjore të transparencës edhe gjatë zbatimit të Hartës Zonale. Plani i informimit dhe i komunikimit, është baza mbi të cilën duhet të zhvillohet procesi i zbatimit transparent të HZK-së, dhe i sigurimit të përkrahjes së gjerë nga të gjithë akterët në proces të zbatimit. Në këtë drejtim, komuna do t'i shfrytëzoj të gjitha mjetet e informimit dhe të komunikimit, për qasje sa më të gjerë dhe të qëndrueshëm në institucione dhe dokumente, aty ku ligjërisht është e mundur për publikun dhe akterët e tjerë relevant. Në ketë drejtim në funksion të zbatimit të dokumentit rekomandohet: Të ketë komunikim dhe motivim lidhur me strategjinë dhe planin e informimit dhe komunikimit me të gjithë akterët, duhet mbahet plani në fokus të të gjithëve . Informatat dhe udhëzimet lidhur me zbatimin e Hartës Zonale duhet të publikohen në mjete të informimi, në faqen elektronike të komunës, sepse do të ndihmojnë për të ndërtuar dhe fuqizuar dinamikën e zbatimit të planit.

Një udhëzim tjetër i dobishëm në këtë drejtim, është një "Memo vjetore", dërguar nga Kryetari i Komunës të gjithë liderëve të vendbanimeve, shoqatave jo qeveritare, bizneseve, qeverisë qendrore, institucioneve publike etj. Kjo memo, i përkujton ata në lidhje me Hartën Zonale aktuale dhe me këtë rast nga anëtarët e grupeve të tjera të interesit, mund të kërkohen komente dhe sugjerime lidhur me informimin, me komunikimin, zbatimin e dokumentit si dhe për çështjet tjera me interes. Si shumë me interes për zbatim të Hartës konsiderohet analiza, informimi dhe komunikimi adekuat, cilësor etj., me të gjithë akterët dhe veçanërisht, me ata që ndihmuan në hartimin e planit. Njerëzit të cilët kanë ndihmuar me inpute, duhet mbajtur të përfshirë në vazhdimësi, përmes fuqizimit të informimit dhe të komunikimit, si një komponentë e rëndësishme dhe strategjike e zbatimit.

- **Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në funksion të zbatimit të planeve**

Përkundër që në komuna e Vitisë mund të thuhet lirisht se kishte një proces cilësor gjatë përgatitjes së HZK-së në kuptimin e gjithëpërfshirjes edhe të zbatimit të ligjit në fuqi, përkundër që bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë hartimit të dokumentit ishte i mirë por, vlerësohet se ende ka mjaft shumë hapësirë për informim, bashkëpunim dhe bashkëveprim në mes të drejtorive, sidomos sa i përket zbatimit të Hartës Zonale të Komunës.

Në ketë drejtim, çdo drejtori duhet të jetë e përgatitur që të jetë në funksion të zbatimit të dokumentit, duhet të jetë e pajisur me të gjithë mekanizmat dhe mjetet e nevojshme duke filluar: nga posedimi i kopjeve të shtypur dhe digjitale të Hartës, stafi i secilës drejtori duhet të informohet me përmbajtjen, detyrat, si dhe me obligimet që dalin nga HZK-ja. Drejtoritë, duhet të komunikojnë

dhe t'i koordinojnë veprimet për kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të HZK-së por edhe aktivitetet që janë rezultat i Hartës, por edhe të jenë të informuara për zhvillimet tjera që janë të veçanta brenda drejtorive, si dhe duhet komunikuar edhe për kufizimet dhe mundësitë ligjore nga fushat e tyre kompetente që prekin drejtoritë por, edhe zhvillimet, aktivitetet dhe projektet e tjera.

Vlerësohet shumë i rëndësishëm krijimi i një sistemi digjital, i cili do të mundësojë komunikimin adekuat, azhurnimin e shpejtë dhe cilësor, transparencën në mes të drejtorive, por edhe transparencën ndaj akterëve të tjerë. Një sistem i tillë, e ngritë shkallën e zbatimit (implementimit) të Hartës dhe mundëson informim dhe koordinim efikas, cilësor dhe në masë të madhe e ngritë edhe shkallën e zbatimit të detyrave, si dhe përgjegjësinë dhe transparencën ndaj të gjithë akterëve relevantë. Krijimi i sistemit të përbashkët të GIS-it, shihet si domosdoshmëri nga që është edhe mundësi shumë më e madhe e informimit dhe e komunikimit të shpejtë dhe të saktë në mes të drejtorive. Por, deri sa të krijohet ky sistem, drejtoritë duhet t'i shfrytëzojnë mjetet më pak të sofistikuara ose, ato mjete që i kanë në dispozicion.

Drejtoritë komunale, gjithsesi duhet të vazhdojnë të i shkëmbejnë informatat, të bashkëpunojnë dhe të bashkëveprojnë në mënyrë cilësore mes tyre për zbatim të dokumentit. Zbatimi i Hartës, i aktiviteteve dhe i zhvillimeve të tjera fillon menjëherë pasi që ato të jenë aprovuar nga Kuvendi Komunal, mirëpo për lehtësimin e zbatimit të Hartës Zonale Komunale vlerësohet hartimi i planeve të punës për çdo drejtori dhe zbatimi i tyre sipas sektorëve përkatës, bazuar edhe në plane të lartpërmendura. Këto plane sektoriale, do të prezantohen para Ekipit Punues për Zbatim për t'u analizuar, për koordinim të aktiviteteve por edhe për të ndihmuar në zbatimin e tyre. Nga fusha e bashkëpunimit dhe e bashkëveprimit në mes të gjitha drejtorive, duhet theksuar se një rol të madh dhe strategjik ka Drejtoria e Inspektoratit, ose inspektorët e fushave të ndryshme të nivelit komunal. Zbatimi i dokumentit është i lidhur ngushtë edhe me punën inspektorëve të fushave përkatëse. Vlerësohet mjaft i rëndësishëm dhe duhet bashkëpunuar ngushtë për t'i informuar ata me zhvillimet e planifikuara, si dhe për t'i pajisur me harta (të shtypura me përpjesë të duhur ose digjitale) adekuate për këto zhvillime, dhe për kufijtë ndërtimorë në veçanti, por edhe për zhvillime të tjera. Kjo bëhet pastaj, edhe për ta funksionalizuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin në mes të drejtorive në funksion të zbatimit sa më efikas dhe cilësor të planit.

Vlen të theksohet se rolin kryesor në fushën e bashkëpunimit me inspektoratin ose edhe me inspektorët, e mbanë Drejtoria e Urbanizmit dhe mbikëqyrjes por, në funksion të zbatimit të planit një rol të rëndësishëm e ka edhe Ekipi Punues për Zbatim, si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror.

Drejtorinë për Financa dhe Buxhet dhe Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë janë ndër drejtoritë komunale të cilat duhet të jenë të informuar për zhvillimet e parapara me plan, sidomos duhet të jenë të informuara me projektet dhe me masat konkrete nga plani si dhe për prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjatë. Duhet që sa më shumë projekte, zhvillime të parapara me HZK të futen në parashikimet buxhetore të trevjeçarit të ardhshëm që njihet si KAB Korniza Afatmesme Buxhetore. Vetëm me futjen e këtyre kushteve, zhvillimeve, masave dhe projekteve në kalendarët buxhetor dhe aprovimin e tyre në nivelin komunal dhe qendror, jemi një hap më përpara në zbatimin e tyre.

Mund të konstatohet se në funksion të zbatimit të Hartës Zonale Komunale në ketë rast, por edhe çfarëdo dokumenti tjetër, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi në mes të drejtorive gjatë zbatimit duhet fuqizohet dhe avancohet.

- **Sektori privat, Shoqëria Civile dhe përfaqësuesit e Lagjeve dhe të Vendbanimeve**

Bashkëpunimi me sektorin privat, me shoqërinë civile dhe me përfaqësuesit e lagjeve dhe të vendbanimeve në komunë, është shumë i rëndësishëm si në të gjitha fazat e hartimit të dokumentit edhe në zbatimin e tij. Sektori privat është forca shtytëse kryesore e zhvillimeve, prandaj në funksion të zbatimit të Hartës me këtë sektor, duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në këtë drejtim. Ajo që është e planifikuar, duhet ofruar për zbatim këtij sektori dhe mënyra e ofrimit duhet jetë e qëndrueshme dhe transparente. Duke e njohur rolin dhe fuqinë e sektorit privat, Drejtoria e Urbanizmit dhe e Mbikëqyrjes, Ekipi Punues dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, në funksion të zbatimit të Hartës duhet t'i ofrojnë kushte për mes HZK -së për thithje të investimeve, dhe këtë sektor ta orientojnë në zhvillime të planifikuara dhe të qëndrueshme.

Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, por edhe përfaqësues të tjerë të Lagjeve dhe të Vendbanimeve, janë po aq të rëndësishëm: sa në përgatitjen e Hartës, po aq edhe në zbatimin e sajë. Prandaj, duhet fuqizuar bashkëpunimin me ta, sikurse edhe me sektorin privat dhe duhet krijuar një traditë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëpunimit cilësor, dhe gjithsesi duhet shfrytëzuar të gjitha mjetet në ketë drejtim. Shpeshherë, përfaqësuesit e OJQ-ve, janë bartës të projekteve të ndryshme. Do të ishte mirë, që edhe ata të jenë në funksion të ngritjes së vetëdijes për zbatim të HZK-së ose edhe të kushteve, masave e të zhvillimeve që rrjedhin nga HZK-ja. Në këtë drejtim, informimi dhe komunikimi me ta, është i një rëndësie jetike. Bashkëpunimi, mund të ngritët në atë nivel që, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e lagjeve e të vendbanimeve, të arrijnë që të marrin përgjegjësi për projekte, për masa dhe zhvillime, e deri te roli i kujdestarit për zhvillime të pa planifikuara dhe ilegale. Niveli më i lartë i bashkëpunimit në këtë drejtim, arrihet atëherë kur Zonat e caktuara që dalin nga Harta, janë të përbashkëta.

- **Bashkëpunimi me Gjykata**

Në zbatim të dokumenteve, disa zhvillime të caktuara bëhen çështje e gjykatave: prej atyre komunale, e deri te nivelet e më të larta gjyqësore. Vlerësohet si i domosdoshëm bashkëpunimi me gjykatat dhe krijimi i një vije komunikimi dhe bashkëpunimi cilësor me to, në funksion të marrjes së vendimeve adekuate dhe me peshë të duhur. Ky bashkëpunim, është shumë i rëndësishëm sepse, është në funksion adekuat të parandalimit dhe të amortizimit të zhvillimeve të pa planifikuara. Duke e ditur se gjykatat tona janë shumë të ngarkuara, lëndët që vijnë nga kjo fushë duhet parë dhe duhet trajtuar me prioritet sepse, pasi që të bëhet zhvillimi apo implementimi në këtë drejtim, edhe tentimi për revidim ose edhe sanksioni eventual është i pa vlerë dhe jo efikas.

Nëse nuk krijohet një urë e bashkëpunimi efikas me gjykatat, lejohen apo stimulohen edhe më shumë zhvillimet e pa planifikuara dhe jo legale. Duke njohur rolin dhe fuqinë e gjykatave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbikëqyrjes, e në funksion të zbatimit të HZK-së edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ofruar kushte, duhet krijuar komunikimin dhe bashkëveprimin të duhur në mënyrë që aty ku është e domosdoshme (madje edhe duke bashkëpunuar edhe me mekanizma të tjerë, siç është policia), të pengohen ndërtimet e pa planifikuara dhe ilegale në funksion të zbatimit efikas dhe cilësorë të HZK-së.

- **Bashkëpunimi me Byro Projektuese**

Bashkëpunimi me Byro Projektuese dhe me Institute adekuate si dhe me institucione që merren me projekte zhvillimore në mënyrë profesionale, është i rëndësishëm dhe në funksion të zbatimit të HZK-së, e të informimit adekuat. Komunikimi dhe bashkëpunimi në këtë drejtim, është shumë i rëndësishëm. Nëse vendosen ura të bashkëpunimit dhe të komunikimit dhe ngritet niveli i bashkëpunimit në shkallë adekuate, këto institucione nuk do të hartojnë projekte pa qenë të bazuara në kushtet zhvillimore dhe ndërtimore të parapara me HZK dhe pa qenë brenda shfrytëzimeve që lejohen, lejohen me kushte ose me kushte të veçanta. Në të njëjtën kohë, këtyre institucioneve duhet bërë të kuptojnë se për veprime të jashtëligjshme, mund edhe të dënohen madje, edhe t'u ndalohet veprimtaria. Paralajmërimi si dhe shqiptimi i sanksioneve, besojmë se kontribuon direkt në zbatim e mirëfilltë të HZK-së. Në këtë drejtim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbikëqyrjes por edhe Ekipi Punues si dhe instancat e tjera të nivelit komunal dhe qendror, duhet ta luajnë rolin e vetë të informimit, të komunikimit dhe të bashkëveprimit me këto institucione.

- **Bashkëpunimi me institucionet e nivelit qendror**

Pasi që HZK-ja është dokument multisektorial, lirisht mund të themi se edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe ndikimet janë të ndryshme (si për nga niveli, ashtu edhe për nga fushëveprimtaria), bashkëpunimi në mes të institucioneve të caktuara, është njëra ndër shtyllat tjera ku duhet mbështetur për zbatim të HZK-së. Në këtë drejtim, aktiviteteve dhe masat për zbatim, do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit të HZK -së. Dihet fare mirë se, çfarë roli ka MMPHI-ja, MBPZHR-ja, Ministria e infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por edhe ministritë e tjera në zbatim dhe në përcjellje të zbatimit të HZK-së.

Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në mes të niveleve të caktuara për zbatim të HZK-së. Dihet se ministritë e ndryshme si për shembull MMPHI-ja, mundet që edhe të lëshoj leje. Siç thuhet në ligjin për planifikim, autoritetet duhet t'i lëshojnë lejen secilit aplikues, derisa propozimi për ndërtim përputhet me dispozitat e ligjit të planifikimit, dhe me ligjet e tjera dhe planet zhvillimore

komunale dhe hartat Zonale dhe dokumentet tjera të planifikimit., duke i ditur edhe kompetencat për ujin, për Tokën dhe për ajrin që i ka (në këtë rast) MMPHI-ja, një fuqizim i bashkëpunimit do të ndihmonte shumë në zbatimin e dokumentit.

Qeveria e vendit, me propozim të MMPHI-së ka nxjerr akt të veçantë me të cilin, e rregullon mbikëqyrjen, por edhe ndëshkimin dhe marrjen e masave të përcaktuara me ligj të planifikimit. Prandaj, mbikëqyrja e akteve të përgjithshme dhe veç e veç, e kushteve dhe e mënyrës së punës të personave të juridik dhe fizik dhe marrja e masave është e përcaktuar po me këtë ligj dhe nga ministria nëpërmjet inspektorëve. Në këtë drejtim, për pos procesit të nxjerrjes së dokumenteve dhe të akteve të tjera, zbatimin e tyre, si dhe aplikimin e procedurave i inspekton MMPHI.

Bashkëpunimi, informimi dhe komunikimi është çelësi i zbatimit të HZK-së. Një rol të rëndësishëm, e ka edhe MBPZHR, e cila është kompetente për zhvillime të qëndrueshme bujqësore por, edhe për zhvillime të pyjeve. Në këtë drejtim, edhe mbrojtja e tokës bujqësore, është fushë ku gërshetohen interesat e nivelit lokal dhe qendrorë. Në këtë drejtim, planet për zbatim do të jenë një bazë e mirë për informim, për komunikim dhe për bashkëpunim dhe bashkëveprim drejt zbatimit. Fuqizimi i lidhjeve me këtë ministri, është çelës i mbrojtjes së tokës bujqësore për çka është i themeluar edhe Inspeksioni i Bujqësisë i cili me anë të inspektorëve të tij kryen punë inspektuese në fushat e bujqësisë: në tokat bujqësore, në sferën e Pylltarisë dhe të Gjuetisë, të mbrojtjes së Bimëve, të Blegtorisë dhe të Peshkatarisë, si dhe të Veterinarisë dhe të sigurisë së Ushqimit. Edhe përmes kësaj ministrie si dhe përmes inspektoratit të saj, duhet fuqizuar informimin, komunikimin dhe bashkëpunimin dhe bashkëveprimin për mbrojtjen e tokës bujqësore, si dhe të fushave të tjera relevante dhe ky, do të konsiderohej si një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të HZK- së.

Pasi që planifikimi është multisektorial, gati të gjitha ministritë dhe të gjitha agjensionet e tjera publike, kanë një fushëveprimtari, kompetencë dhe ndikim që prek edhe zbatimin e HZK -së. Vlerësohet se, një bashkëpunim cilësor duhet krijuar në funksion të zbatimit të HZK-së edhe në mes të niveleve, dhe dihet mirë se zonat e veçanta arkeologjike, arkitektonike janë fusha për zhvillim të përbashkët, mbrojtje por edhe zbatim, njëjtë si edhe një pjesë e madhe e grandeve që vijnë nga niveli qendror. Lirisht, duhet theksuar se cilësia e këtij bashkëpunimi, konsiderohet si mjaft përmbajtjesore për zbatim të HZK-së.

- **Mbështetja administrative**

Komuna e Vitisë, duhet të ofrojë një mbështetje cilësore administrative për zbatim të HZK-së, duke e synuar lirimin nga vonesat burokratike dhe duke reaguar me cilësi ndaj vështirësive ligjore, duke vendosur afate dhe orare të duhura etj. Parashikohet edhe shfrytëzimi i teknologjive, si dhe i aplikime ve online për zhvillime.

Informimi, komunikimi dhe bashkëpunimi për thjeshtim sa më të madh të procedurave administrative, ndikon dukshëm në zbatim të dokumentit. Në këtë drejtim aplikimi online, matja e kohës se për sa kohë pala e interesuar e merr përgjigjen, janë parametra shumë të rëndësishëm për zbatim, por edhe për transparencë në zbatim.

Për t'u mundësuar zbatimi i HZK-së, si mbështetje administrative duhet ofrohet mundësia e detajimeve më të mëdha në disa pjesë të trajtuara me HZK, Zona në të cilat mund të jepen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore, por për shkak mos trajtimit në nivel parcele, dhe mundësisë për trajtim jo të barabartë të parcelave dhe pronarëve të ndryshëm, në funksion të sigurimit të hapësirave publike, gjelbërimit dhe përmbajtjeve tjera urbane, duhet trajtuar me PRRH, ose mundësuar propozimet për detajime më të mëdha të vijnë nga pronarët dhe një komision profesional t'i trajtojë konceptet e propozuar për detajet, sepse HZK nuk i ofron të gjitha detajet.

Duhet theksuar se si një mundësi e detajimeve të mëtejme që do preferohej, është një lloj komasacioni urban, ku disa pronarë do t'i bashkonin parcelat dhe do e propozonin një zgjidhje për zonën me disa parcela dhe të gjithë do t'i definonin interesat e përbashkëta me përqindje të pjesëmarrjes dhe përfitimeve, do të ofronin infrastrukturën publike dhe përmbajtjet tjera urbane, të cilat me marrëveshje do të barteshin si pronë publike dhe me të njëjtën marrëveshje do përfitonin bonuse zonimi. Marrëveshja e tillë do bëhej me nënshkrimin e të gjithë pronarëve te noteri, me nënshkrimet të cilat i bartin të drejtën një zhvilluesi privat te noteritë, dhe nga ana e komunës me aprovim në kuvendin komunal, në ketë rast si pjesë e marrëveshjes do të ishte edhe bartja kadastrale dhe bartja e drejtës së ndërtimit, edhe varianti tjetër me një lloj të komasacionit urban, sipas marrëveshjes së të gjithë pronarëve brenda zgjidhjes urbane në zonë, do ofronin infrastrukturën publike dhe përmbajtjet tjera urbane, të cilat me

marrëveshje do barteshin si pronë publike, dhe me të njëjtën marrëveshje pronarët do përfitonin bonuse zonimi, marrëveshja e tillë do bëhej me nënshkrim të gjithë pronarëve te noteri, me nënshkrimet të cilat i bartin të drejtën e pronës te pronarëve, në parcelat e ri parceluara te noteri, dhe nga ana e komunës me aprovim në kuvendin komunal dhe bartja kadastrale e parcelave të reja, ku banorët do ndërtonin ose kryenin zhvillime të caktuara në parcelat e reja me bonuse zonimi.

Kodi i ndërtimit për projektim dhe ndërtim duhet nga momenti që aprovohet me ndihmën e administratës komunale të gjej zbatim, dhe deri në atë fazë si Projekt të shfrytëzohet si bazë për projektim dhe ndërtim.

13.3. MONITORIMI IZBATIMIT

Brenda kapitullit të V -Zbatimi dhe Monitorimi i Zbatimit, ekipet hartuese të Hartës Zonale Komunale të Vitisë kanë sqaruar përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij dokumenti.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria e Urbanizmit) pas aprovimit të Hartës Zonale Komunale në Kuvend Komunale dhe publikimit zyrtar, fillon të kryej përgjegjësitë ligjore që ka lidhur edhe me monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, në ketë drejtim drejtoria e Urbanizmit do të fillojë me një punë mjaft komplekse dhe të vështirë në koordinimin dhe bashkëpunimin me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Duhet theksuar se monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale Komunale është një aktivitet i vazhdueshëm me qëllim të sigurimit të informatave në mënyrë të rregullt dhe sistematike, përmes treguesve kuantitativ dhe kualitativ të cilët do të masin progresin e arritur në zbatimin e HZK-së së Vitisë me qëllim të vlerësimit se a janë arritur rezultateve e planifikuara por edhe identifikuar vështirësitë, sfidat dhe problemet.

Monitorimi trajton në mënyrë sistematike raportin ndërmjet gjendjes së zbatuar dhe asaj që është planifikuar me HZK por edhe pritjeve bazuar në treguesit e paracaktuar. Është mënyra sistematike e mbledhjes dhe e analizës së të dhënave të grumbulluara nga drejtoritë komunale dhe burimet tjera/informacionit, në lidhje me zbatimin e planeve për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm të zbatimit.

Monitorimi, është procesi nëpërmjet të cilit, zbatuesit e Hartës Zonale Komunale të Vitisë do të sigurohen që kushtet, masat dhe aktivitetet që janë duke u zbatuar, janë në përputhje me ato të planifikuara në Hartë dhe brenda afateve të caktuara. Është një përpjekje sistematike për të krahasuar punën në zbatim por edhe performancën e HZK-së me kushtet zhvillimor, ndërtimore, zhvillimet e parapara, projektet, masat, aktivitetet dhe standardet e caktuara për të vlerësuar nëse, po bëhet progres. Gjithashtu, parashikon dhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime, parashikimin e vështirësive para se të shfaqen dhe kryerjen e korrigjimeve të nevojshme për ta mbajtur Hartën brenda detyrimeve të tyre.

Monitorimi, është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe i matjes së progresit drejt arritjes së kushteve zhvillimore, zhvillimeve të parapara, projekteve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara me HZK.

Procesi sistematik dhe i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizës së të dhënave, për një ndërhyrje të caktuar. Monitorimi, vlerëson shkallën sipas të cilës Harta po zbatohet në përputhje me planin e Veprimit për zbatim të HZK-së ose edhe përmbajtjeve tjera të HZK-së dhe vlerëson se sa po i adreson nevojat e grupit ose grupeve të synuar.

Ky kapitull, përmban pjesën mjaft të rëndësishme të Hartës Zonale të Komunës së Vitisë që paraqitet si obligim ligjor dhe për fokus ka monitorimin e zbatimit si në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në aspektin kualitativ, dhe që nuk është kërkuar më parë(në dokumentet e punuara me ligjin e kaluar), kapitull përfundimisht që e bën ndryshimin dhe nëse pas 4 viteve nuk vlerësohet se Harta Zonale e Vitisë është zbatuar mbi 40%, dokumenti duhet të rishikohet dhe plotësohet.

Bazuar në përvojat e kaluara ekziston nevoja për zhvillimin të një sistemi qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të dokumenteve të planifikimit e sidomos HZK-së në ketë rast, Komuna e Vitisë është e bindur se përpos një planifikim i qëndrueshëm dhe hartimit të dokumenteve cilësore, po aq është i rëndësishëm është edhe aplikimi i tij në praktikë dhe përkrahje më të madhe që komuna, institucionet dhe sektorët e tjerë kompetentë duhet bëjnë për gjetjen e rrugëve adekuate për zbatim.

Komuna e Vitisë e konsideron këtë kapitull si një përpjekje për të ndërtuar një sistem dhe koncept të monitorimit dhe vlerësimit të planit në praktikën e përditshme dhe në procesin e planifikimit hapësinor.

Komuna e Vitisë edhe për qëllim që të kontribuojë sa më shumë në orientimin dhe profesionalizimin jo vetëm të administratës dhe autoriteteve lokale por dhe të aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces. Do të përshkruhen në mënyrë të thjeshtë, të përmbledhur dhe të saktë të gjithë hapat që duhen ndjekur për të monitoruar zbatimin e HZK-së, dhe njëkohësish të përgatiten raportet e nevojshme për Kuvendin Komunal, MMPHI-në dhe që i duhen çdo pale të interesuar për zbatimin e HZK-së.

Monitorimi i zbatimit të HZK-së së Vitisë bëhet në baza ditore, ndërsa Raportimi i monitorimit kryhet në intervale kohe të ndryshme: mujore, dy mujore, tre mujore por për qëllime praktike më i rëndësishmi është ai gjashtë mujore dhe vjetore, por edhe për çdo vit radhazi, për katër dhe tetë vite, pasi që HZK-ja është dokument i cili planifikohet për disa vite, intervalet tjera kohore për raportin e monitorimit mund të caktohen varësisht edhe nga zhvillimet brenda drejtorive por edhe asaj që është paraparë me plan zbatimit, një raport përmbledhës i monitorimit të zbatimit të HZK -së përgatitet nga Ekipi Punues i cili udhëhiqet nga koordinatori, e koordinatori raportin përfundimisht e trajton dhe përmbyll brenda Autoritetit përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit), raport i cili prezanton Monitorim dhe Vlerësim e zbatimit të HZK-së, edhe atë në intervale kohore të arsyeshme gjashtë mujore për nevoja të brendshme të komunës, dhe vjetore i cili është për nevoja të brendshme të komunës por edhe për raportim në MMPHI.

Monitorimi i Zbatimit të HZK-së bazohet në: Projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të parapara në Planin e Veprimit për Zbatimin e HZK-së, plan i cili duhet jetë bazë për përgatitjen e planit vjetor sektorial të zbatimit të HZK-së.

Monitorimi i zbatimit trajton edhe projektet, kushtet, masat dhe përmbajtjet tjera të cilat nuk janë paraparë me Planin e Veprimit për Zbatimin e HZK-së, rrjedhimisht as me plan vjetor sektorial të zbatimit të HZK- së, dhe të cilat mund të konsiderohen si zhvillime të momentit, të pa planifikuara.

- **Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit**

Caktimi i stafit nëpër drejtori dhe i mjeteve për mbledhjen e të dhënave, që mund të ndryshojë nga drejtoria në drejtori, por edhe nga projektet, kushtet, masat dhe aktivitetet që do monitorohen (fillimisht do preferohej që një staf i cili është trajnuar për matjen e performancës së Komunës të jetë pjesë e procesit të monitorimit).

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës në koordinim dhe bashkëpunim me drejtoritë përgjegjëse sektoriale të komunës.

Drejtoritë komunale sektoriale brenda komunës së Vitisë përgatisin raportin monitorues të zbatimit të planeve zhvillimore sektoriale në baza vjetore si obligim ligjor dhe sipas nevojës bazuar në intervalet e lartpërmendura, Raportet vjetore duhet përgatitur për: Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë për Financa dhe Buxhet, Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbikëqyrje, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, Drejtorinë e Inspeksionit, Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe sport, Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Drejtorinë për Shërbime Publike.

Drejtoritë sektoriale komunale përgatisin Raportin Monitorues të zbatimit të Hartës Zonale të Komunës dhe e dorëzojnë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim, pasi të jetë integruar nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor (Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbikëqyrje) dhe pas shqyrtimit dhe miratimit të raportit nga Kuvendi i Komunës, në baza vjetore dorëzon në Ministri raportin informues për gjendjen e zbatimin të Hartës Zonale të Komunës.

Raportet vjetore të monitorimit të zbatimit përfshijnë rekomandime për veprim dhe prezantohen para Kuvendit Komunal, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë me statistika financiare për çështjet e zonimit në baza vjetore dhe për rishikimin katër (4) vjeçar dhe tetë (8) vjeçar.

• Raportet vjetore të monitorimit

Raportet vjetore të monitorimit bazohen në analizat e informatave bazë. Gjatë gjithë procesit duhet të sigurohen informata; informatat duhet siguruar në të gjitha drejtoritë dhe instancat tjera. Këto informata sigurojnë bazë të mirë për analizën dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së së Vitisë.

Raporti vjetor i monitorimit dhe raportet sektoriale bazohen në analizat e këtyre informatave bazë: Informatat për projektet, kushtet dhe masat dhe përmbajtjeve tjera të HZK-së, të planifikuara në secilin sektor, që në rastin e komunës së Vitisë bëhet bazuar në informatat e zbatimit të planit sektorial të zbatimit të Hartës. Raporti vjetor bazohet edhe në analizat informatave që pasqyrojnë, kushte, masa, projekte, zhvillime që nuk kanë qenë të planifikuara me HZK por janë ndërtua ose zhvillu në ndërkohë.

Ndër informatat tjera të rëndësishme në të cilat raporti dhe raportet vjetore të monitorimit bazohen janë edhe informatat që pasqyrojnë:

- Numrin e lejeve ndërtimore dhe numrin e certifikatave të shfrytëzimit të lëshuara sipas kategorisë së ndërtimit;
- Statusi i mjedisit të rrezikuar;
- Shkalla e prodhimtarisë;
- Shkalla e ngritjes së cilësisë të shërbimeve publike dhe sociale;
- Shkalla e ngritjes së cilësisë të shërbimeve transportuese dhe teknike;
- Përqindja e investimeve kapitale publike dhe publiko-private të zbatuara, sipas planifikimeve për vitin përkatës si: ndërtimin e infrastrukturës teknike, sociale dhe publike;
- Shkalla e investimeve private të mëdha të planifikuara, nëse posedohen informata;
- Anketimi i familjeve bujqësore; dhe
- Rishqyrtimi i sasisë së përmbajtjes dhe përmasave të zbatimit të ndryshim plotësimeve, përjashtimeve dhe bonuseve të zonimit.

• Cilët janë treguesit

Për të pasur një monitorim të zbatimit të HZK-së së Vitisë duhet siguruar që informatat bazë të pasqyrojnë treguesit adekuat për zbatim, ata tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ. Çdo drejtori bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së përgatit Planin vjetor sektorial për Zbatimin e HZK-së, dhe brenda këtij plani duhet definuar edhe treguesit e qartë për monitorimin e zbatimit të kushteve, zhvillimeve, të masave ose të projekteve të parapara.

• Si i përcaktojmë treguesit për zbatim?

Duhet të sigurohemi që ka një pajtim mbi treguesit para aplikimit të tyre (gjatë përgatitjes së planit sektorial vjetor për zbatim nga të gjithë amtarët e ekipit).

- Miratoni treguesit që janë të qartë dhe të kontrollueshëm.
- Miratoni treguesit që janë të matshëm, të afërt dhe konsistentë.
- Miratoni treguesit që janë të rëndësishëm për kontekstin komunal.
- Miratoni treguesit që janë të ndjeshëm ndaj kushteve të ndryshueshme, dhe që mundtë azhurnohen lehtë.
- Miratoni treguesit që janë të krahasueshëm me programet apo planet tjera.
- Ndërlidheni monitorimin me ndikimin në mjedis dhe studimet e revidimit.
- Ndërlidheni monitorimin me auditimet tjera të aktiviteteve të qytetit, zonave rurale, fondit të ndërtimeve, etj.
- Ndërlidhni problemet e zhvillimeve aktuale me sistemin e monitorimit, që të mund të zgjerohet apo ndryshohet edhe përdorimi i treguesve.

• **Për ilustrim :**

Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Vitisë kemi potencuar se për 5% të zonës synohet të jepen lejet e ndërtimit gjatë vitit 2018 dhe 5% nënkupto 100 leje ndërtimi.

Treguesi do jetë numër dhe në fund të vitit bazuar në informatat bazë mund të themi se kemi lëshuar 50, 100 ose 200 leje dhe në ketë formë analizojmë zbatimin e HZK-së nga fusha e banimit, duke realizuar 50%, 100% ose edhe 200 % . Nëse në planin vjetor sektorial, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Vitisë kemi potencuar

se synohet të jepet leja e ndërtimit të një shkolle në fshatin e caktuar, ku ka nevojë për eksproprijim ose do sigurohet hapësira me bonuse zonimi gjatë vitit 2018.

Treguesi do jetë fillimisht numerik një shkollë, treguesi i dytë do jetë a janë respektuar kushtet zhvillimore dhe ndërtimor nga HZK-ha dhe tregues i tertë do jetë a është zhvilluar me eksproprijim ose me bonuse zonimi .

Në të njëjtën formë përcaktohen treguesit për monitorimin e zbatimit të HZK-së si pjesë e planit vjetor sektorial, për të gjitha aktivitetet, bazuar në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së së Vitisë

• **Caktimi i standardeve të monitorimit**

Standardet e monitorimit i përcaktojmë në fazën e planifikimit të monitorimit: kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore, infrastruktura rrugore, sociale, teknike, projektet, aktivitetet, masat dhe afatet ko hore zbërthehen në tregues sasior dhe cilësor për monitorim të zbatimit, këta tregues duhet të jenë të kuptueshëm dhe të pranuar nga të gjithë, dhe do trajtohen si pjesë e integruar në zbatimin e Hartës, ky standard i monitorimit për fillim do ketë për bazë të gjitha ato që konsiderohen të rëndësishme për standardin e Kosovës, nga cila do fusha e zbatimit të Hartës, e që lidhet me monitorimin e zbatimit, mirëpo ma vonë do shikohen edhe mundësitë e një standardi që do ta caktonte standardin e treguesve sasiorë dhe cilësorë, që do të shërbenin edhe për matje të performancave ndërkombëtare, pos atyre për interes komunal dhe qendror.

• **Ngritja e një sistemi/mekanizmi/fidbeku/ushqyerje me informacion**

Efektiviteti i monitorimit varet nga saktësia dhe besueshmëria e informacionit. Për këtë qëllim duhet ngritur një mekanizëm që siguron mbledhjen e informacionit, statistikave, të dhënave, raporteve etj, që sigurojnë bazën për posedim të vazhdueshëm të një informacioni të vlefshëm.

Mekanizmi i fidbek- ut, ushqyerja me informacion mund të jetë me të dhëna gojore (vizita në terren), ose me shkrim (informatë, formularë raportimi).

Ekipi Punues do të trajtohet si trupi ose mekanizmi kryesor në këtë funksion dhe drejtoritë, institucionet, grupet e individët do futen në shërbim për këtë qëllim nga mekanizmi kryesor.

• **Matja dhe vlerësimi i përformances**

Një nga qëllimet e monitorimit është edhe sigurimi i informatave për matjen e performancës/punës në zbatim të HZK-së, tregues të cilët nuk na ofrojnë informata, vetëm me matjen dhe vlerësimin e performancës, në kuptimin e asaj çfarë ka ndodhur me zbatimin e kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave dhe afateve kohore por do të shfrytëzohet si bazë edhe për të parashikuar, se çfarë do të ndodhë. Kjo do të thotë se devijime, mungesa, mbivendosje, parashikohen me kohë dhe ndërmerren masa korrigjuese.

• **Marrja e masave korrigjuese**

Kur vihen re devijimet nga plani për zbatim në kuptimin e kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave dhe afateve kohore, kostove financiare duhen marrë masa korrigjuese. Kjo do të thotë ndryshim të planit të zbatimit, ndryshim në institucionet dhe në personelin kompetent, mbikëqyrje më e rreptë, vizita më të shpeshta në terren, motivim të pjesëmarrësve dhe grupit të synuar, procedura me të thjeshta financiare etj.

- **Cila do jetë metodologjia e monitorimit dhe vlerësimit në procesin e Zbatimit të HZK-së së Vitisë**

Duke e trajtuar metodologjinë si tërësinë e metodave që përdoren në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Zbatimit të HZK-së së Vitisë në përgjithësi për dokumentin por edhe në fusha të caktuara sektoriale.

Lirisht mundet të thuhet se këto metoda bazohen në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së si dhe në Planet Sektoriale për Zbatim ku janë paraparë: kushtet zhvillimore, kushtet ndërtimore, infrastruktura rrugore, sociale, teknike, projektet, aktivitetet, masat dhe afatet kohore, kostot financiare dhe pritjet nga zbatimi i tyre, thjesht duke krahasuar gjendjen e planifikuar dhe gjendjen e realizuar. Metoda e cila preferohet të shfrytëzohet është metoda e orientuara në rezultate dhe në gjendjen faktike në terren. Ekipi punues duhet të përdorë metodat statistikore dhe mund të përdorë edhe metodat tjera sipas nevojës dhe përcaktimeve edhe në plan pune për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit.

Metodologjia e punës do të ndjek hapat e njëjtë të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së dhe planeve sektoriale, duke ndjekur këta hapa:

- **Hapi 1 - Identifikimi**

Identifikimi i Qëllimeve, Objektivave, kushteve zhvillimore, kushteve ndërtimore, infrastrukturës rrugore, sociale, teknike, projekteve, aktiviteteve, masave, afateve kohore, kostove financiare të cilat duhet të jenë edhe pjesë e planit të punës për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të HZK-së dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik.

- **Hapi 2 - Definimi i treguesve**

Në varësi të asaj se çka është pjesë e planit të veprimit për zbatim të HZK-së, dhe planeve sektoriale të cilat duhet zbatohen gjatë vitit vijues kalendarik duhet përcaktohen tregues të cilët do të jenë kuantitativ (numra, përqindje) dhe tregues kualitativ për më shumë në materialin e lartpërmendur: Cilët janë treguesit dhe materialet tjera.

- **Hapi 3 - Përcakto metodat e grumbullimit të të dhënave dhe afatet kohore**

Grumbullimi i të dhënave bëhet duke u bazuar në formularët e përgatitur për monitorim sipas specifikave të zhvillimeve dhe drejtorive. Treguesit kuantitativ dhe kualitativ mblidhen në baza ditore dhe hedhja e tyre në data-bazë bëhet në baza javore.

Në rast se do të duket e nevojshme, mund organizohen intervista, pyetësorë dhe metoda tjera të grumbullimit të informatave.

Grumbullimi i informatave bëhet edhe nga burimet tjera pos burimeve zyrtare të komunës.

- **Hapi 4 - Identifikoni Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit**

Në kuadër të planit të monitorimit përcaktohen edhe Rolet dhe Përgjegjësitë e Monitorimit dhe Vlerësimit për përgjegjësit e drejtorive, stafin brenda secilës drejtori për më shumë shih materialin më lartë: Kush është përgjegjës për monitorimin e zbatimit dhe materialet tjera

- **Hapi 5 - Krijo një Plan Vlerësimi dhe Format të Raportimit**

Duke konsideruar se të dhënat bazë (treguesit dhe të dhënat tjera) duhet vlerësuar për të konstatuar dhe raportuar progresin e zbatimit, duhet hartuar një Plan transparent dhe profesional Vlerësimi dhe Format të Raportimit

- **Hapi 6 - Kompletimi i Raportit dhe raportimi në Kuvendin komunal të Graqanic dhe në MMPHI**

Kompletimi i Raportit përfundimtar duhet bëhet nga autoriteti kompetent komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor doke integruar dhe strukturuar vlerësimet nga raportet e secilës drejtori lidhur me vlerësimin e zbatimit, raport i cili duhet prezantohet në Kuvendin komunal të Graqanic dhe në MMPHI.

13.4. VLERËSIMI I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Vlerësimi, do të thotë gjetja e vlerës në përqindje (%) të realizimit të Hartës Zonale Komunale dhe cilësisë së zbatimit.

Vlerësimi, thjesht i referohet procedurave të fakteve të gjetura, të cilat janë grumbulluar dhe sistemuar gjatë procesit të monitorimit.

Vlerësimi përbëhet nga vlerësimet nëse janë apo jo zhvillimet, masat, aktivitetet, projektet, trajtimi, ndërhyrjet në përputhje me rezultatet e planifikuara në Planin e Veprimit për Zbatim të HZK-së, Planet sektoriale të Zbatimit dhe me standardet e pranuara përgjithësisht profesionale.

Për çdo të dhënë, informacioni që është marrë nga procesi i monitorimit dhe rezultati i ndërhyrjeve, trajtimit apo të zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve të parapara me HZK, ndryshimi i dy gjendjeve konsiderohet të jetë vlerësimi.

Vlerësimi është i determinuar për të siguruar informacione sistematike, të besueshme dhe të vlefshme mbi sjelljen, ndikimin dhe efektivitetin e zhvillimeve, masave, aktiviteteve dhe projekteve të parapara me HZK.

Komuna e Vitisë do orientohet kryesisht në Vlerësimin e brendshëm i cili është bërë në nga stafi i komunës, vetë bordi i drejtorëve, kryetari i komunës dhe përfituesit.

Mirëpo komuna e Vitisë mund të angazhojë edhe vlerësim dhe monitorim të jashtëm, ky vlerësim mund të bëhet nga një trupi jashtë strukturave të komunës.

13.5. METODAT E VLERËSIMIT

Gjatë viteve, një shumëllojshmëri e metodave janë evoluar nga akademikët, institucionet dhe profesionistët për vlerësimin e çdo zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti. Disa prej praktikave të përdorura zakonisht janë dhënë më poshtë.

- **Informacione të dorës së parë:**

Një nga metodat më të thjeshtë dhe më e lehtë e vlerësimit nga marrjen e informacionit të dorës së parë në lidhje me progresin e performancës, etj. Problem zonat e një zhvillimi, mase, aktiviteti dhe projekti nga një mori e stafit, ekipi komunal për monitorim dhe vlerësim, të personelit në terren, specialistë të tjerë dhe publiku që lidhen direkt me zhvillimin, masën, aktivitetin dhe projektin. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe dëgjimi në lidhje me ecurinë, rrit shanset e një vlerësimi efektiv.

- **Raportet formale / Informale periodike:**

Vlerësimi bëhet edhe përmes raporteve formale dhe joformale.

Vlerësimi bazohet në një listë të treguesve të paracaktuar për të siguruar zbatimin e vlerësimit, rezultatet dhe përputhshmërinë e vlerësimit, gjegjësisht bazohet në metodologjinë e vlerësimit të përcaktuar në planin e monitorimit.

Vlerësimi do jetë pjesë e raportit të monitorimit të zbatimit të HZK-së dhe do bëhet në çdo fund vit, por edhe në baza mujore e gjashtëmujore.

Katër vite pas fillimit të zbatimit dhe monitorimit, duhet të kryhet një vlerësim afatmesëm i zbatueshmërisë së HZK-së.

Monitorimi duhet të planifikohet ashtu që, në më pak se katër vite duhet të ketë të dhëna të mjaftueshme për vlerësim të HZK-së.

Nëse vlerësimi rezulton se zbatueshmëria e HZK-së është më pak se 40% nga ajo çka është planifikuar për katër vitet e para, vendimi për të reviduar HZK-në është i detyrueshëm. Në rast të vendimit për të reviduar

HZK-në, planifikimi i një HZK-je të re, do të bazohet në raportet e monitorimit dhe të vlerësimit, mbi të cilat do të vendoset orientimi i HZK-së së re.

Një prezantim i raportit të vlerësimit, bëhet si më poshtë:

- Hyrje.
- Përshkrim i ndërlidhjes me HZK-në dhe me raportet paraprake të monitorimit (vjetore, raportit afat mesëm katër vjeçar).
- Përmbledhje e zhvillimit të ndodhur.
- Prezantimi i raporteve monitoruese.
- Rezultatet paraqiten me tekst, grafikone dhe diagrame, sipas kritereve të paracaktuara të vlerësimit.
- Vlerësimi dhe diskutimi i rezultateve të monitorimit.

Këtu jepet vlerësimi i dokumentit, ku analizohen rezultatet e monitorimit. Jepet përmbledhje e mospërputhjeve ndërmjet zhvillimeve të parashikuara dhe të zbatuara dhe ofrohen rekomandime për vendimmarrje nga autoritetet.

Duke u bazuar në raportin dhe rezultatet e vlerësimit, vendimmarrësit mund të marrin vendim për revidim të HZK-së.

▪ **Kush do t'i përgatit raportet e monitorimit**

Ekipi punues mund të angazhohet në përgatitje të Raportit të Monitorimit. Ky ekip përbëhet nga koordinatori i cili vjen nga autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor si dhe nga përgjegjësit e drejtorive. Pastaj do të sqarohet se kush do përgatit raportin e monitorimit nga organet e caktuara duke e kuptuar se ekipi punues do të bartë këtë proces.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, bashkërendon aktivitetet për përgatitjen e Raportit të Monitorimit të zbatimit të HZK-së.

Drejtoritë komunale sektoriale zhvillojnë aktivitetet sektoriale përkatëse të tyre për përgatitjen e Raportit sektorial të Monitorimit të zbatimit të HZK-së.

Drejtoritë sektoriale hartojnë dhe dorëzojnë Raportet sektoriale vjetore të Monitorimit të zbatimit të HZK- së tek autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor harton dhe dorëzon raportin vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së, për miratim tek Kuvendi i Komunës.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, dorëzon raportin e miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së në Ministri.

Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor siguron se raporti i miratuar vjetor të Monitorimit të zbatimit të HZK-së publikohet në faqen e internetit të komunës dhe ofrohet në kopje të letrës sipas kërkesës.

Komuna mund të angazhojë kompani konsulente për kapitullin e zbatimit, monitorimit të zbatimit dhe vlerësimit, e cila do të përkrahë Ekipin dhe Autoritetet në këtë proces.

Raportimi nga Ekipi Komunal për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim duhet të jetë i atillë që do t'i mbajë drejtuesit e komunës të informuar për atë që po ndodh dhe të sigurojë raportet e progresit në zbatimin e HZK-së. Ky raportim në lidhje me ecurinë e zbatimit, dhe i bënë ata pjesë të procesit dhe aty ku mund të hasen probleme. Ekipi, duhet të jetë në gjendje për t'i adresuar shqetësimet apo për të propozuar ndryshime të mundshme.

14. NDRYSHIM PLOTËSIMET DHE PËRJASHTIMET

Duke e ditur se ndryshimi dhe plotësimi – nënkupton ndryshimet në pjesët tekstuale dhe hartografike të Hartës Zonale të Komunës, të cilat do të bëhen vetëm në përputhje me nenin 35 të aktit nënligjor, ku është përcaktuar se pjesët tekstuale ose hartografike të hartës zonale në këtë rast të komunës së Vitisë mund të ndryshohen plotësohen me vendim të Kuvendit të Komunës dhe ndryshim plotësimi duhet të miratohet nga Ministria (MMPHI).

Ndryshim plotësimet mund të propozohen nga :

- Nga anëtarët e Kuvendit të Komunës ;
- Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor; ose
- Pronarët e parcelave kadastrale të sipërfaqes e cila do të jetë subjekt i ndryshim plotësimit të propozuar.
- Ndryshim plotësimet nuk përdoren për ti dhënë privilegje ndonjë pronari të veçantë të pronës.
- Ndryshim plotësimet përdoren vetëm për të përshtatur dispozitat e Hartës Zonale të Komunës si rezultat i ndryshimeve të kushteve rishtas të identifikuara, ose t'i shërbej për një interes bindës publik.

Ndryshim plotësimet përbëhen nga një proces dy-hapësh:

- **Hapi 1**

Propozimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimit e cila miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit të Komunës; dhe

- **Hapi 2**

Propozimin për ndryshim plotësimin e Hartës zonale të Komunës që miratohet nga dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kemi edhe raste kur propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës bëhet nga ndonjë subjekt tjetër e jo nga komuna.

Nëse propozimi për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës dorëzohet nga ndonjë subjekt tjetër e jo nga komuna, të gjitha shpenzimet për hartimin e këtij ndryshim plotësimi kompensohen nga aplikuesi. Të gjitha propozimet për ndryshim plotësim duhet t'i dorëzohen Komunës në formë fizike dhe në formë digjitale (GIS).

Komuna e Vitisë do sqarojë edhe si bëhet propozimi për të nisur procedurën e ndryshim plotësimit

Para dorëzimit të propozimit për ndryshim plotësim të Hartës Zonale të Komunës, aplikuesi së pari dorëzon propozimin përmes autoritetit përgjegjës komunal për planifikimin dhe menaxhim hapësinor (Drejtorisë së Urbanizmit të Vitisë) në Kuvendin e Komunës ku kërkon miratimin për fillimin e procedurës së ndryshim plotësimit.

Aplikimet për fillimin e procedurave të ndryshim plotësimit përfshijnë arsyetimin, një përshkrim të shkurtër dhe përshkrimin e hapësirave që do të përfshihen nga ndryshim plotësimi i propozuar. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë informata shtesë para se të vendosë për propozimin.

14.1. ÇKA DUHET TË PËRMBAJË PROPOZIMI PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË VITISË

Propozimet për ndryshim plotësimin do të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për komunën për të marrë një vendim. Dokumentacioni që kërkohet, përfshin por nuk kufizohet në:

- Harta e pronave apo sipërfaqeve të propozuar për ndryshim plotësimin;
- Përshkrimi i gjendjes ekzistuese;
- Plani i lokacionit të propozuar për zhvillim me ndryshim plotësim;
- Përshkrimiihollësishëmipropozuarpërndryshimplotësimsishfrytëzimidhekërkesathapësinore;dhe
- Arsyetimi me shkrim për ndryshim plotësimin e propozuara.

Duhet sqaruar se nuk merren parasysh ndryshim plotësimi për zvogëlimin e kërkesave hapësinore për parkingje dhe sipërfaqe të hapura, që janë të përcaktuara me kushtet zhvillimore sipas Hartës Zonale të Komunës.

Kuvendi i Komunës para miratimit të propozimit për ndryshim plotësim të Hartës Zonale të Komunës, nga Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor kërkon rekomandim me shkrim, të cilat hyjnë në procesverbal.

Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (Drejtoria e Urbanizimit) apo komisioni që ka themeluar komuna për të trajtuar çështjet e planifikimit hapësinor(i cili mund të themelohet) shqyrton propozimet për ndryshim plotësime dhe harton rekomandime në bazë të kritereve, si:

- Në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal;
- Në harmoni me zonimin dhe shfrytëzimin e lejuara të parcelave kadastrale fqinje dhe karakterin e zonës në atë shkallë dhe intensitet që lejon një cilësi të lartë të jetesës për banorët, përfitime të arsyeshme për zhvilluesit dhe kosto të arsyeshme infrastrukturore për tatimpaguesit;
- Në harmoni me shfrytëzimet në zonë të propozuara me ndryshim plotësim për parcelat kadastrale që përfshihen nga ndryshim plotësim;
- Kapacitete të mjaftueshme dhe të përshtatshme të shërbimeve dhe infrastrukturës publike për shfrytëzimet e lejuara brenda zonës së propozuar; dhe
- Në harmoni me ligjet tjera, përfshirë Ligjin për Tokën Bujqësore.

14.2. PROCESI PËR MIRATIM TË ÇFARËDO NDRYSHIM PLOTËSIMI

Para miratimit të çfarëdo ndryshim plotësimi të kërkuar, Kuvendi Komunal do të caktojë dhe njoftojë për shqyrtimin publik, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.05/2014.

Njoftimi për shqyrtimin publik përfshin:

- Datën, kohën dhe vendin e dëgjimit publik dhe afatet e shqyrtimeve publike;
- Një përshkrim të konceptit të ndryshim plotësimit të propozuar;
- Listën me të gjitha parcelat kadastrale që përfshihet nga ndryshim plotësimi i propozuar;
- Kontaktin me zyrtarin e komunës nga i cili mund të merren informata shtesë;
- Kohën dhe vendin ku ndryshim plotësimi i propozuar mund të shikohet nga çdo person i interesuar para shqyrtimit publik, dhe
- Vegzën ku mund të gjendet ndryshim – plotësimi i propozuar në faqen zyrtare elektronike të komunës.

Kur ndryshim plotësimi i propozuar vlen vetëm për një parcelë kadastrale të veçantë apo për disa parcela kadastrale, komuna njofton me shkrim për shqyrtimin dhe dëgjimin publik përmes postës me rekomandim, së paku tridhjetë (30) ditë para dëgjimit publik dhe i adresohet:

- Pronarëve të të gjitha parcelave kadastrale që janë subjekt i ndryshim plotësimit të propozuar;
- Pronarëve të parcelave kadastrale brenda rrezes prej së paku 150 metra(m) nga subjekti i ndryshim plotësimit i propozuar;
- Komunën fqinje në rast se është brenda rrezes prej së paku 150 metra nga sipërfaqja që është subjekt i ndryshim plotësimit të propozuar; dhe

Nëse numri i personave që kanë të drejtë të pranojnë njoftimin sipas asaj që e shkruam më lart tejkalon një qindëshin (100), atëherë komuna nuk ka nevojë të sigurojë njoftim me postë me rekomandim, por së paku 8 ditë para fillimit të shqyrtimit publik, duhet të shpall njoftimin në tri gazeta ditore dhe në ueb -faqen e komunës.

Kur një ndryshim plotësim i propozuar vlen vetëm për një parcelë kadastrale të veçantë apo për disa parcela kadastrale, komuna kërkon nga aplikuesi të postojë një informim / pllakatë për së paku 15 ditë, që përmban njoftimin e kërkuar nga ky nen në pronën në fjalë. Informimi / pllakata të jetë së paku i formatit A1, i qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike dhe i postuar në pronë në vend të dukshëm nga çdo anë e pronës që kufizohet me rrugë.

Në dëgjimin publik, komuna lejon të gjitha palët e interesuara, komentet e pranuara me gojë dhe me shkrim dhe dërgon propozimin për ndryshim plotësim për miratim sipas procedurave.

Miratimi i ndryshim plotësimit të propozuar apo ndryshim plotësimit të reviduar kërkon miratimin nga dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Përfshirë në mënyrë specifike personat që kanë të drejtë në njoftim me postë me rekomandim sipas këtij neni të paraqesin pikëpamjet e tyre gojarisht ose me shkrim lidhur me ndryshim plotësimin e propozuar. Të paktën një përfaqësues nga autoriteti përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim hapësinor, merr pjesë gjatë gjithë dëgjimeve publike të organizuar nga komuna në përputhje me këtë nen.

Pas shqyrtimit publik komuna shqyrton për të përfshirë të gjitha komentet, sugjerimet dhe propozimet, në raportin e shqyrtimit publik jepen edhe arsyetimit për ose kundër.

14.3. REVIDIMI I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË VITISË

Revidimi i Hartës Zonale të Komunës së Vitisë bëhet katër (4) vite pas miratimit përfundimtar të tij, sipas procedurës së përcaktuar për hartimin dhe miratimin e tyre paraprak, në rast se nga të gjitha masat e parapara në Hartën Zonale të Komunës për këtë periudhë, më pak se dyzet për qind (40%) të jenë zbatuar.

Harta Zonale e Komunës së Vitisë është hartuar për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

15. PËRJASHTIMET

Duhet sqaruar se në Hartën Zonale të Vitisë Përjashtimet – nënkuptojnë një devijim të lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, në përputhje me bazën ligjore.

Dhe komuna e Vitisë mund të lejojë përjashtime nga kushtet zhvillimore vetëm në rastet kur dëshmohet privimi i mundësisë së zhvillimit të një parcele kadastrale sipas kritereve të poshtë shkruara. Përjashtimi nga kushtet zhvillimore mund të jepet nëse aplikuesi e dëshmon se ka një privim që e bën atë jashtëzakonisht të vështirë për pronarin e tokës t'u përmbahet kushteve zhvillimore dhe nuk ka të bëj me nevojat personale apo dëshirat e pronarit.

Për ta dëshmuar privimin duhet të dëshmojë se:

1. Karakteristikat e veçanta të tokës e bëjnë të pamundur që aplikuesi t'u përmbahet të gjitha kushteve zhvillimore;
2. Përjashtimi kërkohet për shkak të kushteve unike të pronës e jo për shkak të kushteve të përgjithshme të lagjes;
3. Përjashtimi nuk ka efekt dëmtues në mjedis ose në hapësirën gjithëpërfshirëse;
4. Privimi nuk është rezultat i veprimeve të marra nga pronari i tokës ose ish pronari;
5. Përjashtimi nuk do të krijojë ndikime negative në pronat fqinje ose pronave të tjera në afërsi duke ndikuar në:
    - Diellzimin dhe ajrosjen e pronave fqinje;
    - Trafik të shtuar dhe vështirësi në qarkullim të korridoreve transportues në afërsi;
    - Sigurinë publike duke përfshirë dhe rritjen e rrezikut nga zjarri ose rreziqet tjera të mundshme;
    - Vlerat e pronave fqinje; dhe
    - Shfrytëzimin dhe zhvillimin e pronave fqinje.

Përjashtimet mund të lejohen edhe për nevojat e personave me aftësi të kufizuar.

Përjashtimi mund të bëhet edhe për qëllime të bërjes së parcelës dhe ndërtesës të qasshme për personin me aftësi të kufizuara që jeton në pronë.

Përjashtimi mund të jetë i kufizuar me kohëzgjatjen e aftësisë së kufizuar ose me kohën derisa personi jeton në atë pronë.

Përjashtimet vendosen nga autoriteti komunal përgjegjës për planifikim dhe menaxhim hapësinor. Komuna mund të themelojë një komision profesional të vendos apo këshillojë mbi kërkesat për përjashtim.

Përjashtimet shqyrtohen në një takim dëgjimor që është i hapur për publikun.

Minutat dhe vendimet e takimeve shpallen në faqen zyrtare të komunës. Takimet mbahen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin për Procedurën Administrative.

Përjashtimet mund të jepen vetëm nëse :

- Struktura dhe shfrytëzimi i propozuar plotëson kushtet zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës, përveç dispozitës specifike nga e cila kërkohet lehtësim;
- Aplikuesi dëshmon kriteret e përcaktuara në këtë nen.

Përjashtim mund të jepet me kushte të veçanta sipas nevojës, për të parandaluar dëmin ndaj parcelave dhe ndërtesave tjera në zonë, ndaj shërbimeve apo infrastrukturës publike dhe për të zvogëluar ndikimet tjera negative.

Kushtet e veçanta të përjashtimit përfshihen në vendimin për miratimin e përjashtimit dhe në çdo leje ndërtimore të lëshuar më pas në bazë të përjashtimit.

Shkelja e kushteve të veçanta të përjashtimit është shkelje e Hartës Zonale të Komunës.

Në rastet kur miratohet përjashtimi, aplikuesi aplikon për leje ndërtimore sipas procedurës së rregullt. Aplikacioni për leje ndërtimore dorëzohet brenda një (1) viti pas vendimit për miratim të kushteve të veçanta për përjashtim, kurse pas këtij afati kohor përjashtimi bëhet i pavlefshëm.

Dhe krejt në fund pjesa ndryshim plotësimet dhe përjashtimet, bazuar në legjislacionin në fuqi, është pjesa dinamike e Hartës Zonale të Vitisë dhe të gjitha ndryshim plotësimet dhe përjashtimet që janë bërë pas hartimit të Hartës Zonale të Komunës, duke ndjekur procedura e lartpërmendura, duke plotësuar edhe kushtet e lartpërmendura, pas aprovimit nga kuvendi i komunës së Vitisë bazuar edhe në pëlqimin paraprak të MMPHI-së, komuna obligohet të njëjtat ndryshim-plotësime dhe përjashtime t'i shtojë këto në këtë pjesë, atëherë ndryshim plotësimet dhe përjashtimet bëhen zyrtare dhe zëvendësojnë ato parcela, zona nga HZK për të cilat është aplikuar për ndryshim plotësimet dhe përjashtimet.



Figura 56 Shembull i ilustrimit të përjashtimeve nga kushtet zhvillimore ku parcelat siç shihen nuk kanë qasje në parcelë

Komuna përshkruan procedurat dhe përgjegjësitë për detyrat lidhur me zonimin,

- Përfshirë shqyrtimin e përputhshmërisë me zonimin,
- Lëshimin e lejeve ndërtimore dhe vendimeve për zonim,
- Interpretimin e shfrytëzimeve dhe kushteve zhvillimore,
- Marrjen e vendimeve për kërkesat për ndryshime dhe përjashtime dhe procesin e ankimim.

Sqarimi i procedurave përfshin deklaratën se komuna do të ndjekë procedurat e përcaktuara me ligj kur të bëjë shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për miratim të zonimit dhe të gjitha kërkesat për zonim do të shqyrtohen shpejt dhe arsyet për refuzim të kërkesës për miratim të zonimit do të jepen me shkrim.

Kjo pjesë u shërben qytetarëve të marrin informata shtesë për Hartën Zonale të Komunës dhe proceset e zonimit dhe se si mund të dorëzohen pyetjet dhe kundërshtimet.

16. JO KONFORMITETET

Jo konformitet është një shfrytëzim, ndërtim apo parcelë kadastrale ekzistuese që nuk është në përputhje me kërkesat aktuale të zonimit. Jo konformiteti që ka ekzistuar para se të miratohet Harta Zonale e Komunës lejohet të vazhdojë edhe nëse nuk është në përputhje me shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore të caktuara me Hartën Zonale të Komunës për aq sa jo konformiteti vazhdon të plotësojë kërkesat e ligjeve të tjera. Rregulloret në fuqi që promovojnë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien publike, duke përfshirë por duke mos u kufizuar kërkesat ndërtimore kundër zjarrit dhe shëndetësore zbatohen ndaj jo konformiteteve. Komuna zbaton kushtet zhvillimore ndaj jo konformitetit në rastet kur:

- Shfrytëzimi jokonform është ndryshuar; ose
- Ndërtimi jokonform është zgjeruar, ndryshuar apo edhe rindërtuar si shfrytëzim jokonform për arsye tjera që nuk janë me rëndësi madhore.



Figura 57 Shembulli ku zona është e paraparë për industri kurse në zonë kemi objekt të banimit

Figura 58 Shembulli ku objekt me vlera arkitektonike i cili ndodhet në zonë të banimit kolektiv

Zona në të cilat janë zhvillimet jo konforme me zonat, Harta 1 është objekt me vlera arkitektonike i cili ndodhet në zonë të banimit kolektiv, kurse harta 2 ka zhvillime jo konforme për shkak se si zonë është e paraparë për industri, kurse në zonë kemi objekt të banimit.

17. BONUSET E ZONIMIT

Komunat mund të miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit.

Bonuset e zonimit janë stimulime që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik. Bonuset e zonimit duhet të jenë brenda normave teknike të planifikimit hapësinor dhe përfshijnë si më poshtë:

- Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit;
- Zvogëlim apo lirim nga taksat për leje ose tarifat për infrastrukturë;
- Zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parcelës, gjerësi dhe thellësi;
- Rritje e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmerisë së shputës në raport me parcelën kadastrale;
- Rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës;
- Rritje të dendësisë; dhe
- Stimulim i propozuar nga zhvilluesi ose komuna për të integruar dhe përmirësuar vendbanimet joformale.

Rregulloret e tilla komunale janë në përputhje me qëllimet, objektivat, vizionin dhe strategjitë e Planit Zhvillimor Komunal dhe përdoren për të:

- Rritur hapësirat e hapura ose sipërfaqet e gjelbra;
- Ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizje të këmbësorëve;
- Ruajtur sipërfaqet kulturore dhe historike;
- Ruajtur tokën bujqësore;
- Krijuar ndërtesa dhe hapësira publike dhe sociale prej të cilave përfiton komuniteti;
- Përfshirë dhe përmirësuar vendbanimet joformale; ose
- Ofruar mundësitë tjera të dëshiruara nga komuna në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal.

Rregulloret komunale përmbajnë:

- Përshkrimin e Bonusit të Zonimit që lejohet;
- Përshkrimin e strategjive me sqarime se si përfiton komuniteti nga Bonusi i Zonimit që është zgjedhur;
- Listën e të gjitha llojeve dhe kategorive të përfitimeve të komunitetit që mundtë pranohen nga zhvilluesit;
- Sipërfaqet dhe standardet për zhvillim të përfitimeve publike;
- Kërkesat për përfitimet publike do të vihen në dispozicion të përhershëm për komunitetin duke respektuar ligje dhe rregulloret përkatëse në fuqi përmes:
    - Bartjes së pronësisë në komunë ose ndonjë organi tjetër publik ose
    - Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtartë punës; dhe
    - Kërkesës që pronari i pronës të ofrojë garancion bankar duke garantuar zbatimin e bonusit të zonimit deri në marrjen e lejes së përdorimit, si për: bartje të pronësisë në komunë ose te ndonjë organ tjetër publik; ose kërkesës që pronari i pronës të ofrojë mirëmbajtje të përhershme dhe ta mbajë të hapur për publikun së paku gjatë orarit zyrtartë punës.
- Identifikimi i saktë i zonave në të cilat Bonuset e Zonimit mund të lejohen;
- Procedurat për zbatimin e Bonusit të Zonimi; dhe
- Dispozitat për të siguruar njoftim dhe shqyrtimin publik për projektin e propozuar që është përcaktuar sipas Nenit 36 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr. 24/2015 Mbi Elementet Dhe Kërkesat Themelore Për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Për të zbatuar çfarëdo Bonusi të Zonimit, komuna dhe aplikuesi do të:

- Nënshkruajnë marrëveshje për zhvillim, me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta ose stimulimeve të tjerë që pranon zhvilluesi dhe përfitimin e saktë publik të cilin zhvilluesi ofrojë në këmbim për këto bonuse ose stimulime;
- Publikimin e të gjitha marrëveshjeve për zhvillim në faqen zyrtare elektronike të komunës;
- Vlerësimin nëse infrastruktura publike ekzistuese që do të shërbejë për densitetin e shtuar mund të jetë e kënaqshme për zhvillimin shtesë; dhe
- Sipas kërkesave ligjore mjedisore përgatitet vlerësimi i ndikimit në mjedis për përmbajtjen e propozuar.

18. INTERPRETIMI

Harta Zonale e Komunës parashihen të jenë e hollësishme dhe gjithëpërfshirëse, për Çështje praktike Harta Zonale e Komunës nuk mund të adresojë çdo çështje specifike të zonimit. Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor është përgjegjës për interpretimin e rregulloreve të zonimit. Sidoqoftë, ky autoritet i interpretimit të rregulloreve të zonimit nuk ka për qëllim të shtojë apo ndryshojë përmbajtjen thelbësore të Hartës Zonale të Komunës.

Përkufizimet ose Shprehjet e përdorura në këtë, përkundër disa tendencave për interpretime profesionale ose akademike, nga disa subjekte fizike dhe ligjore duhet të kuptohen vetëm dhe saktësisht si është definuar me ligjin NR. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe aktet nënligjore, dhe si të tilla janë përdorur gjatë përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës.

Krijimi dhe Precizimi i zonave, zonave mbi-shtresore si dhe aktivitetet, masat, projektet që lidhen me zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit që rrjedh nga Plani Zhvillimor Komunal është bërë kryesisht duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjen ekzistuese dhe duke analizuar e sqaruar arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale për krijimin dhe precizimin e tyre duke marrë në konsideratë parimet e përcaktuara në nenin 5 të Udhëzimet Administrativ dhe ligjit, Raportin e shqyrtimit publik si dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet e planifikimit hapësinor për rajonin më të gjerë e të cilat ndikojnë në identifikimin e hapësirave dhe përcaktimin e zonave.

Shfrytëzimet e tokës: shfrytëzimet të lejuara, dytësore, të lejuara të veçanta , të përkohshme dhe të ndaluara ,janë të definuara në të gjithë territorin e Komunës së Viti-së , dhe janë dhënë për të gjitha zonat dhe territorin e komunës, eventualisht nëse trajtohet ndonjë shfrytëzim i pa definuar ose diçka që nuk është përfshirë, atëherë i vetmi organ kompetent për interpretim është Autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

1. **Rasti 1**

Për të gjitha parcelat zhvillimor për të cilat shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore (dhe kushtet ndërtimore si pjesë e kushteve zhvillimore) janë të mjaftueshme për ti dhënë kushtet dhe lejen e ndërtimit komuna procedon me leje.

2. **Rasti 2**

Për të gjitha parcelat zhvillimor për të cilat shfrytëzimet dhe kushtet zhvillimore (dhe kushtet ndërtimore si pjesë e kushteve zhvillimore) janë të mjaftueshme për ti dhënë kushtet dhe lejen e ndërtimit por forma e parcelave, hapësirat publike dhe faktorët tjerë e pengojnë procesin, preferohet të ofrohen kushtet dhe bonuset e zonimit në nivel të parcelës zhvillimore ose edhe zonës(pas një koncepti ose komasacioni urban në nivel parcelës zhvillimore apo zonës),me pëlqim të pronarëve dhe të mundësohen përfitimet për pronarët dhe për komunën dhe të jepen kushtet dhe komuna të procedon me leje.

3. **Rasti 3**

Nëse duhen detajime të mëtejme që nuk janë as pjesë e rastit 1 por as e rasti 2 atëherë komuna duhet të përgatis Planin Rregullues të Hollësishëm.

Sa i përket Infrastrukturës teknike, Infrastrukturës rrugore, Infrastrukturës publike dhe sociale kushtet, sqarimet dhe specifikat tjera janë planifikuar bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe marr parasysh gjendjes ekzistuese por nuk interpretohen si projekte kryesore por si përmbajtje mbi të cilat përgatitet projektet.

Projektimi dhe ndërtimi bazohen në Projekt kodin e Ndërtimit dhe në momentin që aprovohet dhe hyn në fuqi, plotësisht duhet punuar sipas kodit të ndërtimit.

Në rast se hyn në fuqi ndonjë plan i nivelit më të lartë sidomos për siguri dhe emergjencë, akte nënligjore, standarde, norma të reja etj, të njëjtat duhet zbatuar me HZK duke zëvendësuar të mëparshmet ose duke u promovuar për herë të parë.

Kërkesat për Jo konformitet – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur shfrytëzimi ekzistues, ndërtesa ose parcela kadastrale nuk është në harmoni me kërkesat aktuale të zonimit nga HZK-ja trajtohen gjatë procesit të hartimit të HZK-së por edhe pas miratimit dhe duhet trajtohen në pajtim me nenin 38 të Udhëzimit Administrativ të MMPH- Nr. 24/2015 Mbi Elementet Dhe Kërkesat Themelore Për Hartimin, Zbatimin Dhe Monitorimin E Hartës Zonale Të Komunës.

Përjashtimet – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur kërkohet një devijim i lejuar nga kushtet zhvillimore apo kushtet ndërtimore, gjatë procesit të hartimit të HZK-së por edhe pas miratimit, dhe rastet e tilla duhet trajtohen në përputhje me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ të MMPH - nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Bonuset e zonimit – që nënkupton kërkesën nga subjektet fizike ose ligjore në rastet kur mundet të përdoret ky mjet planifikimi që lejon komunat të mund të sigurojnë përfitime të komunitetit (të tilla si rritja e sipërfaqes së hapur, parqeve, shtigjeve për këmbësorë, etj.) në këmbim të një ndryshimi në kushtet e ndërtimit (zakonisht në formën e dendësisë së rritur, lartësia së shtuar, apo cilësisë më të lartë të kushteve zhvillimore kapacitete shtesë për drenazhim, të menaxhimit të peizazhit, etj.), të ofruara nga aplikuesi, dhe rastet e tilla duhet trajtohen në përputhje me Udhëzimin Administrativ të MMPH - nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës. Komunat mund të miratojnë rregullore për të përcaktuar dhe zbatuar bonuse të zonimit Në rastet kur janë planifikuar korridoret për zhvillimin e infrastrukturës ,dhe ndodhë që gjatë hartimit të projektit kryesorë në segmente të caktuara për arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale nuk është siguruar gjerësia ose thellësia e duhur gjatë hartimit të HZK-së, kur përgatitet projekti komuna ose duhet ti siguroj këto me bonuse zonimi, eksproprijim ose bashkëpunoj në ofrimin e zgjidhjes tekniko inxhinierike të duhur.

Në rast të kërkesave për saktësi ose edhe interpretim të kushteve ndërtimore, sidomos: Vijës rregulluese, Vijës ndërtimore, Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike, Lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri anësor dhe i pasmë i parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e ndërtimit brenda parcelës kadastrale të lejuar në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Përqindja e sipërfaqes nëntokësore e shfrytëzueshme në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale, Kërkesat minimale për vendparkingje, E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese, Materialet që lejohen të përdoren në sipërfaqet e jashtme të ndërtimeve të reja, Kushtet e qasjes adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike, Kufizimet e ndotjes mjedisore dhe të zhurmës sipas legjislacionit përkatës në fuqi; dhe Masat për mbrojtjen e vlerave natyrore, historike dhe kulturore.

Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor (ose komisioni profesionale) bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shkrim për saktësim ose edhe interpretim të kushteve ndërtimore, por çdo saktësim ose edhe interpretim duhet jetë brenda kushteve të Hartës Zonale(dhe nëse vija ndërtimore sillet nga 2-6,bazuar në gjendjen në teren dhe arsyet ligjore, mjedisore, ekonomike, financiare dhe sociale e saktëson nga 2 deri 6).

Kërkesa për interpretim mund të bëhen edhe te Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës, për sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në platformë të GIS-it, hartat. Për mos ndryshimin eventual që lidhet me përditësimin e bazës së të dhënave hapësinore dhe pjesës së printuar të Hartës Zonale të Komunës për të gjitha ndryshim plotësimet dhe përjashtimet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të tyre nga ana e komunës së Viti-së.

dhe për mos ndryshimin eventual që lidhet me përditësimin e bazës së të dhënave hapësinore dhe pjesës së printuar të Hartës Zonale të Komunës me të gjitha lejet ndërtimore të lëshuara.

Komuna mundet të formoj edhe komisione profesionale për qëllime të caktuara të Hartës Zonale Komunale e që mundet mu lidh me përgjigjeje në kërkesa mirëpo edhe me interpretimin. për çdo pakënaqësi nga subjektet fizike ose ligjore me interpretimin e nivelit komunal mundet të kërkoj te Autoriteti përgjegjës për planifikim hapësinor në nivel qendrorë interpretimin. procedimi për aplikim bëhet sikurse është paraparë me procedura normale administrative. Autoriteti përgjegjës komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor bën shqyrtim in dhe merr vendim me shkrim pas kërkesës me shkrim për interpretim të zonimit brenda 30 ditësh.

19. ANKESAT

Ankesat ndaj vendimeve të nxjerra sipas këtij Udhëzimi Administrativ bëhen në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

20. PËRKUFIZIMET

- **Plani Hapësinor i Kosovës**
  Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e nenit 12 të ligjit nr. 04/L-174.
- **Harta Zonale e Kosovës**
  Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e nenit 13 të ligjit nr. 04/L174.
- **Plani Zhvillimor Komunal**
  Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e nenit 15 të ligjit nr. 04/L174.
- **Harta Zonale e Komunës**
  Dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e nenit 16 të ligjit nr. 04/L174.
- **Vendbanim**
  Zonë me karakteristika urbane, fshat, qytet apo vendbanimin tjetër.
- **Zonë Urbane**
  Zona e cila fizikisht formon pjesën e një qyteti dhe karakterizohet me pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, densitetit të lartë të popullsisë dhe banimit, punësim dhe transport të konsiderueshëm dhe infrastrukturë tjetër. Zonat urbane mund gjithashtu të përmbajnë zona të gjelbra zakonisht të shfrytëzuara për qëllime rekreative.
- **Zonë Rurale**
  Një sipërfaqe që karakterizohet me një sasi të ultë të ndërtimit, dendësisë së popullsisë, dhe të infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, si dhe të punësimit përmes zhvillimit të agrikulturës, turizmit rural, qendrave shëruese dhe të prodhimtarisë që nuk ndot mjedisin rrethues.
- **Zonë**
  Një grup të parcelave kadastrale fqinje me përcaktim të njëjtë të shfrytëzimit të tokës, zhvillimit apo të mbrojtjes dhe ruajtjes, duke përdorur përkufizimet e zonave.
- **Zonë Mbrojtëse**
  Një zonë përreth perimetrit të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore të ndërtuar, që është shpallur nën mbrojtje që përcaktohet nga institucioni kompetent, në të cilën ndalohet çdo zhvillim apo aktivitet që mund të dëmtojë pamjen e kuadrit ose dëmtim tjetër të burimeve natyrore dhe të trashëgimisë kulturore.
- **Parcela Kadastrale**
  Përkufizohet me Ligjin Nr.04-L-013 për Kadastrën dhe nënkupton sipërfaqen e tokës të identifikuar me numër të parcelës kadastrale dhe regjistruar në hartën kadastrale me sipërfaqe të vërtetë në hartën projektuese dhe sipërfaqe të regjistruara në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme në bazë të Ligjit Nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrit e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme dhe Ligjit Nr.04/L- 009/2011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.
- **Kushtet Zhvillimore**
  Nënkuptojnë kushtet zhvillimore që përcaktojnë vendndodhjen, shfrytëzimin, dendësinë dhe karakterin e zhvillimit dhe kushtet ndërtimore.
- **Zonat Mbishtresore**

  Nënkupton teknikën e zoonimit që përdoret për vendosjen e kushteve zhvillimore alternative në kuadër të një sipërfaqeje specifike të komunës e cila kërkon vëmendje të veçantë.

21. PJESA HARTOGRAFIKE

Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës së Vitisë përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike zhvillimore të tërë hapësirës së komunës së Vitisë të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit në platformën GIS në programin Arc GIS 10.5, i cili paraqet informacione thelbësore në formë Gjeodatabaze për ti shpjeguar publikut për mundësitë e shfrytëzimit të tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse.

KËTO HARTA PËRFSHIJNË:

- 00 Zona Urbane Harta zonale e shfrytëzimit bazë të tokës
- 01 Harta e të dhënave bazë
- 02 Harta me sipërfaqe dhe ndërtime me rëndësi për Kosovën
- 03 Harta zonale e shfrytëzimit bazë të tokës
- 04 Harta Zonale e Shfrytëzimit të Tokës Bujqësore
- 05 Harta Zonave Mbishtresore
- 06 Harta e Infrastrukturës Rrugore
- 07 Harta e Infrastrukturës Publike dhe Sociale
- 08 Rrjetin e ujësjellësit
- 09 Rrjetin e kanalizimit
- 10 Sistemet e drenazhimit
- 11 Rrjeti i ujitjes
- 12 Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji termike
- 13 Rrjetin e shpërndarjes lokale me energji elektrike
- 14 Rrjetin e telekomunikacionit dhe instalimet e ngjashme
- 15 Ndërtesa dhe hapësira për riciklim dhe dekompozim
- 16 Harta e Planeve Rregulluese
- 17 Harta e trashëgimisë kulturore